



Mësime të zgjedhura për *Ramazanin*

Ibrahim Ibn Muhamed Hukajli



Titulli i Librit: Mësime të zgjedhura për ramazanin

Autori: Ibrahim Ibn Muhamed el Hukajl

Përkthyes: Arjan Haskasa, Ruzhdiu...???, Sali Bardhoshi

Redaktor fetar dhe krahasues me origjinalin: Ismail Bardhoshi

Redaktor letrar: Ilir Haxhiaj

Vërejtje: Këtë libër ka të drejtë ta përvetësojë veçse një person që e lexon vetë ose një pjesëtar i familjes së tij, në të kundërt, libri duhet t'i dhurohet një tjetri që e lexon.

PARATHËNIE

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botërave, lavdërimi dhe paqja qofshin për Muhamedin, më të nderuarin e profetëve!

Ramazani është muaji i muslimanëve, muaji i umetit të fundit, të cilin Allahu i Lartësuar e zgjodhi ndër gjithë umetet e tjera dhe e veçoi me vulën e pejgamberisë, Muhamedin (a.s.). Muslimanët garojnë në këtë muaj për bamirësi dhe bindje ndaj Zotit të Lartësuar. Ata dëgjojnë

me dëshirë ligjëratat fetare, prandaj hoxhallarët dhe predikuesit zgjedhin këtë muaj si kohën më të mirë për të dhënë mësim e për të mbajtur ligjëratat me tema të ndryshme islame.

Për këtë arsye, kam punuar për mbledhjen e të gjitha haditheve që flasin për agjërimin, itikafin, namazin e natës në ramazan dhe Natën e Kadrit, po ashtu disa dobi dhe dispozita, shkurtimisht, si ndihmës për thirrësit dhe imamët.

Kjo është rruga që kam ndjekur në përpilimin e librit:

- 1- Kam vënë si bazë të çdo mësimi tekstet e Kuranit dhe Sunetit. Nëse për një çështje nuk ka ajete mbështetëse nga Kurani, atëherë kam sjellë hadithet që kanë lidhje me të.
- 2- Nuk i kam përfshirë të gjitha hadithet që përmenden mbi një temë të caktuar, por kam përzgjedhur hadithet që më janë dukur më të përshtatshëm dhe më përmbledhës.
- 3- Përcjellësit e haditheve i kam përmendur shkurtimisht, bashkë me gradën e saktësisë së hadithit në futnota.
- 4- Janë cituar vetëm hadithet e sakta (*sahih*) dhe të mira (*hasen*), duke lënë mënjanë hadithet e dobëta. Për hadithet që janë të diskutueshme, jam përpjekur të zgjedh atë që e kam parë si më të saktë, por këto janë raste të rralla.
- 5- Për sa i përket renditjes së haditheve sipas rëndësisë, në radhë të parë vijmë ata që i gjen njëherësh te Buhariu dhe Muslimi, pastaj ata që i gjen veç te njëri prej tyre, pastaj hadithet e katër librave të Sunetit. Kjo renditje është prishur vetëm nëse ka qenë e nevojshme. Po ashtu, së pari u është kushtuar rëndësi haditheve që shkojnë deri te Pejgamberi (a.s.) me transmetim, pastaj ata që shkojnë deri te sahabët, pastaj thëniet e të parëve tanë të mirë.
- 6- Pas haditheve kam përmendur një sërë dobishë dhe dispozitash, një pjesë të të cilave i kam nxjerë vetë nga hadithet, por për pjesëm më të madhe kam shfrytëzuar si burim librat që shpjegojnë hadithet, librat e fetvave etj. Në çështjet e diskutueshme jam munduar të sjell atë që më është dukur më e saktë. Këtu kam patur parasysh edhe qëndrimin që mbahet nga dijetarët në Arabinë Saudite mbi këto çështje.¹
- 7- Te dobitë dhe dispozitat që kanë nxjerrë dijetarët nga hadithet gjen shumë mësimë edukative, që nuk kanë lidhje vetëm me agjërimin, por edhe me sjelljen individuale, sjelljen në familje, në shoqëri etj.

Së fundmi, kërkoj nga vëllezërit e mi muslimanë, nga imamët apo çdokush tjetër që e lexon këtë libër dhe ka sugjerime, që të m'i dërgojë ato, në mënyrë që të përfitojmë sa më tepër, duke e falënderuar për bashkëpunimin në mirësi dhe devotshmëri.

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, me mirësinë e të Cilit realizohen veprat e mira!

¹ Të gjitha poshtëshënimet ose pjesët e poshtëshënimeve ndërmjet dy kllapave katrore [] janë të redaktorit fetar.

1-NDALIMI I AGJËRIMIT PARA RAMAZANIT

Përcillet nga Ebu Hurejra (r.a.) se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Asnjëri nga ju të mos i paraprijë ramazanit me një ditë ose dy ditë agjërim, përveç atij që ka agjërim të rregullt *nafile* dhe dita e tij përkon me ditët para ramazanit, atëherë një person i tillë mund ta agjërojë këtë ditë”²

Ndërsa në variantin që sjell imam Tirmidhiu, Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Mos i paraprini muajit të ramazanit duke agjëruar një ditë ose dy përpara, përveç nëse ajo ditë përkon me agjërimin tuaj që e bëni rregullisht...”.

Mësime dhe dispozita:

- 1- Ndalimi i agjërimit para ramazanit për të treguar më shumë siguri për fillimin e ramazanit. Dijetarët thonë se kuptimi i hadithit është ky; mos e filloni agjërimin para ramazanit me qëllim që të tregoni më shumë siguri për ramazanin”.³ Imam Tirmidhiu thotë se, në bazë të këtij hadithi dijetarët e shohin si të papëlqyeshëm nxitimin për të agjëruar para hyrjes së muajit të ramazanit me qëllimin e rrokjes me siguri të ditës së parë të ramazanit, por nëse dikush ka ditë agjërimi *nafile* të rregullta dhe agjërimi i tij përkon me këto dy ditë, atëherë s’ka problem nëse agjëron këto ditë.⁴
- 2- Ndalohet agjërimi i papërcaktuar *nafile* para ramazanit.⁵ Përfshihet nga kjo ndalesë agjërimi për shlyerje a për një zotim, ose agjërimi vullnetar i vazhdueshëm, si agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte.
- 3- Më e sakta që është thënë për urtësinë e kësaj ndalesë është se ramazani është i lidhur me shikimin e hënës së re. Kush agjëron para se të shihet hëna, një ditë ose dy, ai nuk e pranon këtë dispozitë dhe nuk pranon tekstet fetare të cilat e kanë lidhur agjërimin me shikimin e hënës së re.⁶

² Buhariu (1815) dhe Muslimi (1082).

³ Fet’hul Bari (4/128).

⁴ Suneni i Tirmidhiut (684).

⁵ Burimi i mësipërm (4/128). Është fjala për ndalimin e agjërimit *nafile* të ndonjë dite për të cilën nuk ka ndonjë përcaktim në Sheriat dhe të cilën njeriu nuk e ka agjërim *nafile* të rregullt. Ky ndalim në fakt fillon që kur bëhet gjysma e muajit shaban e deri sa fillon ramazani. Sh.r.

⁶ Shiko: Fet’hul Bari (4/128).

- 4- Ky hadith kundërshton rafiditë (shiitët), të cilët e nisin agjërimin para shikimit të hënës.⁷
- 5- Është e ligjshme ndarja mes veprave të detyrueshme dhe atyre vullnetare në adhurime. Kështu, në agjërim bëhet ndarja mes agjërit vullnetar në muajin Shaban dhe agjërit farz në muajin e Ramazanit, me ndalimin e agjërit të ditës që është e dyshimtë. Po kështu kur mbyllet ramazani dhe fillon muaji sheval, ndalohet agjërimi i ditës së Bajramit. Mes namazit farz dhe nafilë, Ibn Abbasi (r.a.) dhe një grup nga të parët tanë të mirë kanë pëlqyer të bëhet një ndarje, qoftë ajo duke thënë diçka, duke u ngritur, duke ecur apo duke lëvizur nga vendi.⁸
- 6- Është i detyrueshëm zbatimi i rregullave të fesë, pa shtuar dhe pa hequr asgjë prej saj sepse diçka e tillë të shpie në teprim ose në largim prej fesë. Kjo vihet re te ndalimi i agjërit para ramazanit me qëllimin sigurie se ndoshta është ramazan.

2- SI NJIHET HYRJA DHE DALJA E RAMAZANIT

Përcillet nga Abdullah Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) se Pejgamberi (a.s.) përmendi ramazanin dhe tha: “Mos agjëroni pa parë hënën e re (të ramazanit) dhe mos e ndërprisni agjërimin pa parë hënën tjetër të re (të shevalit). Nëse nuk mund ta shikoni hënën, atëherë plotësojeni (muajin tridhjetë ditë)”.⁹

Në një variant tjetër të Buhariut thuhet: “Kur të shikoni atë (hënën e re të ramazanit), agjëroni, dhe kur të shikoni tjetrën (hënën e re të shevalit), ndërprisni agjërimin. Nëse nuk mund ta shikoni hënën, atëherë plotësojeni (muajin tridhjetë ditë)”.¹⁰

Kuptimi i fjalës “plotësojeni” është: çojeni muajin deri në cakun e tij dhe caku i tij është 30 ditë. Ky është shpjegimi i shumicës së dijetarëve të parë dhe brezave pas tyre,¹¹ duke u mbështetur në transmetime të tjera, si: “Nëse nuk mund ta shihni hënën (për shkak të reve), atëherë përcaktojeni muajin me 30 ditë.” Në një variant tjetër thuhet: “llogarisni 30 ditë”, ndërsa në një tjetër: “plotësoni numrin”. Të gjitha këto transmetime gjenden në ‘*Sahih*’-un e Muslimit.¹²

⁷ Burimi i mësipërm (3/371).

⁸ Istidhkar (3/371).

⁹ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁰ Buhariu (1807) dhe Muslimi (1080).

¹¹ Shpjegimi i Neveviut mbi Muslimin (7/186).

¹² Muslimi (1080-1081).

Nga Ebu Hurejra (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kur ta shikoni hënën e re, filloni e agjëroni, dhe kur ta shikoni atë përsëri (pas një muaji), ndërpriteni agjërimin. Nëse hëna nuk mund të shihet (për shkak të reve), atëherë agjëroni plot 30 ditë”.

Në një variant tjetër thuhet: “Filloni të agjëroni kur të shihni hënën e re dhe ndërpriteni agjërimin kur ta shihni përsëri atë. Nëse nuk arrini ta shihni atë, atëherë llogariteni muajin shaban me 30 ditë”. Sipas një tjetri: “Nëse nuk arrini ta kapni me sy, plotësoni muajin shaban me 30 ditë”.¹³

Përcillet nga Abdullahi i biri i Omerit (Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve): “Njerëzit ishin mbledhur për të parë hënën e ramazanit, por unë njoftova të Dërguarin e Allahut se tashmë e kisha parë atë. Kështu, ai filloi agjërimin e ramazanit dhe dha urdhër që edhe njerëzit të fillonin agjërimin.”¹⁴

Mësime dhe dispozita

1- Agjërimi i ramazanit është i lidhur më shikimin e hënës së re të këtij muaji. Nëse shikimin e hënës e pengojnë retë, pluhuri, tymi apo diçka tjetër, bëhet i detyrueshëm mbyllja e muajit shaban me 30 ditë.

2- Nuk agjërohet dita e fundit e muajit Shaban për të treguar siguri për ramazanin, edhe nëse hëna nuk shikohet për shkak të reve, pluhurit apo diçkaje tjetër, sepse këtë e ka ndaluar Pejgamberi (a.s.) kur ka thënë: “Mos agjëroni pa parë hënën e re!”. Siç dihet, në parim, kur bëhet një ndalim në tekstet e Kuranit apo të Sunetit, ai duhet të merret si ndalim kategorik (haram).

3- Nëse shihet hëna e re e ramazanit, bëhet i detyrueshëm agjërimi, pa marrë parasysh parashikimet e përllogaritësve.¹⁵

4- Nga normat që tregojnë lehtësinë e Sheriatit Islamik për zbatim është dhe lidhja e agjërit me shikimin e hënës, e kjo nuk ka nevojë për nxënie dhe studim, sepse hënën e re arrin ta shohë ai që ka shikim të fortë. Sikur kjo çështje të varej nga përllogaritjet, atëherë do të kishte qenë e vështirë për shumicën e muslimanëve, në ato vende ku mungojnë specialistët që bëjnë mirë llogaritjen astronomike.¹⁶

¹³ Buhariu (1810) dhe Muslimi (1081).

¹⁴ Ebu Davudi (2343), Darimi (1691), Darekutni (2/156), Bejhekiu (4/212), Tabaraniu në Evset (3877). E saktëson Ibn Hibbani (3447). Hakimi ka thënë se është me kushtet e Muslimit (1/585). E saktëson Neveviu në Mexhmu (6/276).

¹⁵ Sherh Ibn Mulekkan ala Elumdeh (5/178)

¹⁶ Sherh Ibn Battal ala el Buhari (4/27)

5- Fillimi i agjërimit është i detyrueshëm për popullin e atij vendi ku është parë hëna e re e ramazanit. Kështu, vendi në të cilin nuk është parë hëna nuk e nis agjërimin, sepse mundësia e shikimit të hënës ndryshon në varësi të vendeve të ndryshme.¹⁷

6- Për hyrjen e muajit të ramazanit mjafton dëshmia e një njeriu të drejtë, siç tregon hadithi i Ibn Omerit, ndërsa për daljen e ramazanit duhen dy dëshmitarë të drejtë, siç tregojnë hadithet e tjera.¹⁸

¹⁷ Sherh ibn Mulekin (5/181-182). [Mendimi më i saktë i dijetarëve në këtë çështje është se shikimi i një vende vlen dhe për çdo vend tjetër ku arrin lajmi i shikimit sikurse ka sqaruar me argumente Ibn Tejmije ne Mexhmuul fetava. Arsyeja që përmend më lart autori nuk qendron për shkak se: 1- Nuk ka asnjë argument për të ndarë kufijtë e vendeve ku mund të shihet hëna nga ato ku nuk mund të shihet hëna . 2- Për ndarjen e vendeve me kufij nga njëri-tjetri do të nevojitej llogaritje, sepse nuk ka mënyrë tjetër, e siç dihet bazimi në llogaritje është i ndaluar. 3- Edhe ndarja me hamendje e kufirit të një vendi nga një vend tjetër apo të vendeve të largëta nga ato të afërta është e papranueshme në fe. 4- Edhe brenda atij që përkrahësit e këtij mendimi e quajnë një vend apo një shtet, siç është përshebull Arabia Saudite, ka zona më në lindje të tij ku nuk mund të shihet hëna e re, dhe ka zona më në perëndim të tij ku shihet hëna e re, a do të thotë kjo atëherë se edhe njerëzit e këtij vendi duhet të ndahen në disa rajone!? 5- Madje ka mundësi që hëna të shihet në një fshat, dhe të mos shihet në një fshat tjetër kufitar me të parin, por pak më në lindje, a do të thotë kjo se në varësi të mundësisë së shikimit të hënës duhet të ndahen dhe zona kaq të afërta me njëra tjetrën!? Pejgamberi e pranoi atë shikimin e grupit të udhëtarëve që e lajmëruan gjatë ditës se në mbrëmjen e djeshme kishin parë hënën e re. 6- Nëse do të vihej një kufi që ndan një vend nga një tjetër, atëherë do të duhej që njerëzit që janë përtej këtij kufiri qoftë edhe disa metra të mos e fillonin agjërimin, ndërkohë që ju ka arritur lajmi i shikimit të hënës, e kjo është e pavlefshme, sepse bie ndesh me hadithet e mësipërme që urdhërojnë të fillohet agjërimi kur shikohet hëna e re. 7- Ibn Kudame ka sqaruar në librin “el mugni” se mosmarrëveshja mes dijetarëve mbi pranimin e shikimit të një vendi tjetër ka të bëjë vetëm me zëvendësimin si kaza të ditës së parë të ramazanit. Kjo do të thotë se dijetarët në të kaluarën nuk e vinin në diskutim pranimin e lajmit të shikimit të hënës së re kur arrinte në kohë, gjatë natës ose ditës së parë, por diskutimi ka qenë vetëm për rastin kur lajmi i shikimit arrin mbasi ka kaluar dita e parë: nëse duhet të bëhet kaza ajo ditë apo jo. Kjo vërteton se ky fenomen që ndodh në kohën tonë ku pranohet shikimi i një vend tjetër, madje ndonjëherë edhe kufitar, ndërkohë që lajmi ka arritur që në natën e parë, është në kundërshtim dhe me ixhmain dhe praktikën ndërshekullore të muslimanëve. Për hadithin që sjell Kurejbi nga Ibn Abasi themi se fjala e Ibn Abasit nuk ka të bëjë me rastin në fjalë, sepse Ibn Abasit i arriti lajmi mbasi kishte kaluar dita e parë e muajit të ramazanit, dhe prandaj nuk e mori për bazë. Nëse do ta merrte për bazë, do të duhej ta bënte kaza ditën e parë. Kështu, nëse lajmi i shikimit të hënës së re të ramazanit na arrin mbasi ka kaluar dita e parë e këtij muaji, këtu vlen të merret për bazë hadithi i Ibn Abasit, që tregon se nuk e kemi detyrë ta agjërojmë kaza ditën e parë meqë nuk na ka arritur lajmi.

Por megjithëkëtë, nëse autoriteti që ju shpall muajin muslimanëve të një vendi ecën me këtë mendim të gabuar, ose ndonjë mendim tjetër të gabuar të ngjashëm me këtë, siç është bazimi në llogaritje, ose nëse muslimanët e këtij vendi gabojnë në fillimin e muajit të ramazanit, ditën e fitër bajramit apo ditën e kurban bajramit, në këtë rast pra individët duhet t'i bashkohen xhematit dhe të mos e fillojnë ramazanin veças, të mos e bëjnë ditën e fitër bajramit veças dhe të mos e bëjnë ditën e kurban bajramit veças. Kështu pra individët duhet t'i bashkohen xhematit në fillimin e ramazanit, ditën e fitër bajramit dhe ditën e kurban bajramit, qoftë edhe nëse janë në dijeni se xhemati i muslimanëve ka rënë në gabim për shkak të një mendimi a vendimi të gabuar të autoritetit që ju shpall muajin. Argument për këtë është hadithi i Ebu Hurejres i cili tregon se Pejgamberi ka thënë: “Agjërimi fillon ditën kur ju filloni agjërimin, fitër bajrami bëhet në ditën kur ju bëni fitër bajram dhe kurban bajrami bëhet në ditën kur ju bëni kurban bajram”. Shënon Tirmidhiu. Në shpjegimin e këtij hadithi, Tirmidhiu menjëherë pas përmendjes së tij thotë: “Disa dijetarë e shpjegojnë këtë hadith kështu: “Kuptimi është se agjërimi dhe fitër bajrami bëhen bashkë me xhematin dhe shumicën e njerëzve”. Albani thotë se hadithi është i saktë (Sh. i redaktorit fetar).

¹⁸ Thotë Tirmidhiu në ‘El Xhami’ (3/74): “Nuk kanë diskutim dijetarët se për shikimin e hënës së ndërprerjes së agjërimit (fitër bajramit) nuk pranohet vetëm se dëshmia e dy burrave”. Neveviu në Sherhul Muslim (7/190) thotë:

- 7- Prijësi i muslimanëve është ai i cili shpall hyrjen e ramazanit ose ditën e Bajramit.¹⁹
- 8- Personi që shikon hënën e re të ramazanit duhet që të lajmërojë kryetarin e muslimanëve ose zëvendësin e tij.
- 9- Duhet të merret parasysh lajmërimi i mediave të kohës për hyrjen dhe daljen e muajit, nëse ato e bëjnë lajmërimin me urdhër të prijësit ose zëvendësit të tij.²⁰
- 10- Është e pëlqyeshme që muslimanët të vëzhgojnë në grup hënën e re natën e tridhjetë të muajit shaban dhe natën e tridhjetë të muajit ramazan, që të mësojnë hyrjen e muajit dhe daljen e tij.
- 11- Çështja e pranimit të dëshmisë së një gruaje për shikimin e hënës mbetet e diskutueshme në mesin e dijetarëve. Dijetari Ibn Baz (Allahu e mëshiroftë!) ka përzgjedhur mospranimin e dëshmisë së saj, sepse shikimi i hënës është një punë me të cilën merren vetëm burrat; ata arrijnë ta shohin hënën e re dhe kanë njohuri më shumë sesa gratë për këtë çështje.²¹

3- AGJËRIMI ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT E ISLAMIT

Nga Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi (a.s.) është rob dhe i dërguari i tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, haxhi dhe agjërimi i ramazanit”.²²

Ebu Xhumrah Nasr Ibn Imrani (r.a.) rrëfen: “Si përkthyes i Ibn Abasit, e kam dëgjuar atë të thotë njëherë: “Kur erdhi delegacioni i Abdul Kajsit, Pejgamberi (a.s.) pyeti? “Nga vjen ky delegacion?” – “Nga fisi Rebia” – i thanë. Atëherë, Pejgamberi (a.s.) tha: “Mirë se të vijë delegacioni ose fisi që nuk do tu shkelet krenaria e nuk do të dëshpërohen për zgjedhjen e

“Qëllimi është ta shohin hënën disa prej muslimanëve. Nuk është kusht që ta shikojë çdo njeri, përkundrazi, shikimi i dy persona të drejtë mjafton për të tjerët, madje sipas mendimit më të saktë për fillimin e agjërimit mjafton vetëm një dëshmitarë i drejtë, ndërsa për fitër bajram, për shikimin e hënës së re të shevalit, nuk mjafton dëshmia e një personi të drejtë, sipas të gjithë dijetarëve, përveç Ebu Theurit i cili mendon se mjafton një person i drejtë edhe për fitër bajram”. Shiko dhe fetvatë e Ibn Baz (15/62).

¹⁹ El bulug bi tealiq Ebi kutejbeh El farjani. Shiko dhe El fetava Esseadije (216)

²⁰ Shih dhe Mexhmuul fetava Ibn Baz (15/86-87)

²¹ Kush merr për bazë hadithin e Ibn Omerit r.a në pranimin e lajmit të një personi për shikimin e hënës së re, ai e pranon dëshminë e gruas dhe të robit (mbi shikimin e hënës së re të ramazanit), siç përmend Hattabi në Mealimussunen (2/753) . Ndërsa Ibn Bazi (Allahu e mëshiroftë!) është i mendimit se nuk pranohet dëshmia e gruas mbi shikimin e hënës së re, siç përmendet në Mexhmuul fetava (15/62).

²² Buhariu dhe Muslimi (16).

tyre²³!” Delegatët i thanë: “Ne vijmë nga një udhëtim i largët. Në rrugën mes nesh dhe jush gjendet fisi jobesimtar i Mudarit, prandaj mund të vijmë këtu vetëm në një muaj të shenjtë. Na trego se cilat janë detyrat tona, që t’ua përcjellim edhe njerëzve që kemi lënë atje, dhe kështu të futemi në Xhenet.” Profeti (a.s.) u përcolli katër urdhëresa. Së pari, ai (a.s.) i urdhëroi që ta besonin Zotin si një të vetëm. Profeti (a.s.) i pyeti: “A e dini se ç’do të thotë ta besoni Allahun si një të vetëm?” Ata thanë: “Allahu dhe i Dërguari i tij e dinë më së miri!” Profeti (a.s.) tha: “Të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi (a.s.) është rob dhe i dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh ramazanin dhe të jepni një të pestën e plaçkës së luftës.” Pastaj u tha: “Mbajini mend këto dhe përcilluani atyre që përfaqësoni!”.²⁴

Mësime dhe dispozita²⁵

1- Në hadithet më lart tregohet kuptimi i imanit dhe i islamit. Imani është pohimi i brendshëm, pranimi me zemër, ndërsa islami është nënshtrimi i jashtëm, me vepra. Kështu shpjegohen këta terma nëse përmenden së bashku në një tekst. Nëse përmenden veçmas në tekste të ndryshme, atëherë koncepti ‘iman’ bart në vetvete edhe kuptimin e ‘islamit’ ose anasjelltas.

2- Me pohimin e shehadetit njeriu bëhet musliman. Islami ka shtyllë kryesore shehadetin, të cilin e shoqërojnë namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi, si adhurimet më të mëdha dhe më të dukshme të kësaj feje.

3- Braktisja e pesë shtyllave të Islamit ose e ndonjëres prej tyre tregon mosdorëzim dhe mosnënshtrim ndaj Allahut të Lartësuar.

4- Renditja e agjërit të ramazanit ndër shtyllat kryesore të fesë Islame dëshmon për vlerën dhe gradën e tij të lartë tek Allahu.

5- Mësimi i rregullave të rëndësishme të fesë, siç janë urdhëresat ose ndalesat, është detyrë e domosdoshme e muslimanit që më pas ai të punojë sipas tyre e t’ua përcjellë të tjerëve. Kjo përftohet nga thënia e Pejgamberit (a.s.): “Mbajini mend këto dhe përcilluani atyre që përfaqësoni!”.

4- DISA NGA MIRËSITË E RAMAZANIT

²³ Ngaqë nxituan dhe nuk u vonuan të përqafojnë islamin (Sh.p).

²⁴ Buhariu (87) dhe Muslimi (17).

²⁵ Shiko: Shpjëgimi i Neveviut mbi Muslimin (1/148).

Nga Ebu Hurejra (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kur hyn muaji i ramazanit, hapen dyert e qiellit dhe mbyllen dyert e Zjarrit, kurse shejtanët lidhen me pranga”.²⁶

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti (a.s.) ka thënë: “Kur hyn nata e parë e ramazanit, lidhen me zinxhirë shejtanët dhe xhindët agresivë, mbyllen dyert e Zjarrit dhe nuk hapet asnjë prej tyre, hapen dyert e Xhenetit dhe nuk mbyllet asnjë prej tyre, ndërsa një zë thërret: “O ju që doni të mirën, ejani! O ju që kërkonit të bëni të këqija, hiqni dorë!” Allahu liron robër nga Zjarri, dhe kjo ndodh çdo natë (të ramazanit).”²⁷

Kuptimi i thënies: “O ju që doni të mirën, ejani!” është: “O ju që doni të mirën, ejani për të kryer vepra të mira, sepse kjo është koha juaj, kur shpërbleheni shumë me pak punë. Ndërsa ju të tjerët, që kërkonit të bëni të këqija, ndaluni dhe pendohuni, sepse kjo është koha e pendimit.”²⁸

Sipas një hadithi tjetër, Pejgamberi (a.s.) ka përgëzuar shokët e tij: “Ju erdhi ramazani, një muaj i begatë. Allahu e ka bërë detyrë agjërimin e tij. Në këtë muaj hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e Zjarrit dhe lidhen shejtanët më agresivë. Allahu ka bërë një natë në të, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kush privohet nga mirësia e kësaj nate, me të vërtetë është privuar nga një mirësi e madhe”.²⁹

Nga Ebu Hurejra ose Ebu Seidi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu liron robër nga Zjarri çdo ditë dhe çdo natë dhe secilit nga këta robër i pranohet një lutje (nga Allahu)”.³⁰

Nga Xhabiri (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu liron robër nga Zjarri në çdo kohë iftari, dhe kjo ndodh çdo natë”.³¹

Mësime dhe dispozita

1- Hadithet e mësipërme tregojnë mirësinë e muajit të ramazanit, në të cilin ndodhin ngjarje të mëdha si; hapja e dyerve të Xhenetit, mbyllja e dyerve të Zjarrit dhe prangosja e shejtanëve. Këto ndodhin natën e parë të ramazanit dhe vazhdojnë deri në fund të tij.

²⁶ Buhariu (1800) dhe Muslimi (1079).

²⁷ Ky transmetim është i Tirmidhiut (682) dhe Ibn Maxhes (1642). E ka saktësuar Ibn Huzejmeh (1883) dhe Ibn Hibbani (3453). Hakimi ka thënë se plotëson kushtet e Buhariut dhe Muslimit (1/582). Edhe Albani e quan hadith të saktë në sahih Et tirmidhi.

²⁸ Hashijetus-sindi ala sunen En-nesai (4/130).

²⁹ Ky është transmetimi i Nesaiut (4/129), Ahmedit (2/230) dhe Abd Ibn Humejd (1429).

³⁰ Ky është transmetimi i Ahmedit (2/254) dhe i Taberaniut në Evsat (6/257) me zinxhir të saktë.

³¹ Ibn Maxheh (1643). Albani në sahih ibn Maxheh ka thënë se është hasenun sahih (i mirë –i saktë).

2- Hadithi i parë tregon se Xheneti dhe Xhehenemi janë tashmë të krijuar dhe se hapja dhe mbyllja e dyerve të tyre ndodh realisht.³²

3- Kohët e volitshme për ibadet dhe veprat e mira që bëhen në to janë shkak për të fituar kënaqësinë e Allahut, si rezultat i së cilës hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen dyert e Zjarrit.

4- Përgëzimi dhe urimi për ardhjen e ramazanit është i ligjshëm në fe. Pejgamberi (a.s.) përmendte avantazhet e ramazanit, si përgëzim për shokët e tij, por dhe për t'i shtyrë të bënin sa më tepër punë të mira. Të njëjtin gjykim ka dhe përgëzim për çdo të mirë.

5- Shejtanët agresivë qëndrojnë të lidhur në ramazan, prandaj ndikimi i tyre mbi njerëzit është i dobët gjatë këtij muaji. Shkaku i kësaj janë punët e mirë që kryejnë njerëzit gjatë këtij muaji.

6- Është mirësia e Allahut ndaj robërve të Tij që ua mbron agjërimin njerëzve, duke dobësuar ndikimin e xhindëve agresivë, në mënyrë që të mos ua prishin adhurimin në këtë muaj të begatë.³³

7- Hadithet dëshmojnë për ekzistencën e shejtanëve, të cilët kanë trupa, që mund të lidhen me pranga. Disa prej tyre janë agresivë që prangosen gjatë muajit të ramazanit.³⁴

8- Mirësitë e posaçme të ramazanit i përfitojnë vetëm besimtarët, të cilët e nderojnë ramazanin duke kryer gjatë tij detyrimet që u ka caktuar Allahu. Ndërsa për jobesimtarët, të cilët nuk e respektojnë shenjtërinë e tij, për ta nuk hapen dyert e Xhenetit dhe nuk mbyllen dyert e Zjarrit. Për jobesimtarët nuk lidhen shejtanët dhe nuk ka çlirim nga Zjarri.³⁵ Kështu që, nëse ata vdesin në ramazan ose edhe jashtë tij, do të marrin dënimin e merituar të Zotit.

9- Për sa u përket atyre që u përngjajnë jobesimtarëve në shkeljen e shenjtërisë së ramazanit, duke mos agjëruar ose duke ia ulur vlerën atij me vepra të tilla si: përgojimi, thashethemet, gënjeshttrat, dëshmitë e rreme etj., ekziston droja se mund t'iu humbasin mirësitë e posaçme të këtij muaji. Ndoshta të tillë njerëzve iu mbyllen dyert e Xhenetit, iu hapen dyert e Zjarrit dhe shejtanët e tyre qëndrojnë të lirë.

10- Çështja e hapjes së dyerve të Xhenetit dhe e mbylljes së dyerve të Xhehenemit në ramazan nuk bie në kundërshtim me thënien e Allahut të Lartësuar: “Vërtet, për njerëzit që ruhen nga gjynahet ka kthim të mirë, në kopshtet e Adnit, dyert e të cilit janë të hapura për ta” [Sad, 49-50], pasi kjo nuk tregon që këto dyer qëndrojnë gjithnjë të hapura. Madje, ky ajet flet konkretisht për Ditën e Gjykimit. Gjithashtu, nuk ka asnjë mospërputhje as me fjalën e Allahut në lidhje me

³²Shiko:Shpjegimi i Ibn Batta (1 4/20) dhe El MufhiM (3/163).

³³ DhekhijretuL Ukba (20/255).

³⁴ Burimi i mësipërm.

³⁵Shiko: Fetava shejkh El islam (5/131-474).

Xhehenemin: "...kur të arrijnë atje, dyert e tij do të hapen..." [Zumer, 71], sepse dyert e Xhehenemit mund të jenë mbyllur edhe herë tjetër më parë.³⁶

11- Mirësia e Natës së Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj pa Natë Kadri, prandaj kush e humb atë, është i privuar nga një mirësi e madhe.

12- Allahu i Lartësuar liron robër nga zjarri i Xhehenemit çdo natë të ramazanit. Njerëzit që e meritojnë së pari shpëtimin nga Zjarri janë ata të cilët e kryejnë agjërimin pa cen, falen natën në formën më të mirë, i shtojnë veprat e mira me dashuri për Zotin, duke shpresuar në shpërblimin e Tij dhe duke u frikësuar nga dënimi i Tij.

13- Njerëzit që lirohen nga zjarri i Xhehenemit kanë lutje të pranuar tek Allahu i Lartmadhëreshëm. Në këtë mënyrë, Allahu u jep njëherësh dy shpërblime madhështore, që janë shpëtimi nga Zjarri dhe pranimi i lutjes së tyre.

14- Çdo musliman duhet të ketë kujdes që ta ruajë agjërimin e tij nga veprimet që e prishin ose ia ulin vlerën atij, duke ruajtur sidomos dëgjimin, shikimin dhe gjuhën e tij nga haramet, në mënyrë që të fitojë çlirimin nga zjarri i Xhehenemit.

15- Agjëruesit duhet t'i shtojnë sa më tepër lutjet, sepse shpresohet më shumë që lutjet e tyre të pranohen nga Allahu i Madhëruar.

5- NIJETI NË AGJËRIMIN E DETYRUESHËM

Përcillet nga Hafsa e bija e Omerit (r.a.) se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Kush nuk e vendos për agjërim që përpara sabahut, ai nuk ka agjërim të vlefshëm". Hadithin e sjell Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, por sipas qëndrimit më të saktë, kjo është thënie e Hafsës.

Ndërsa te Nesaiu përcillet se: "Kush nuk e bën nijet para sabahut që të agjërojë, ai nuk ka agjërim të vlefshëm."³⁷

Nga Abdullah Ibn Omeri (r.a.) përcillet se ai ka thënë: "Nuk i quhet agjërimi veçse atij që e vendos që para sabahut për agjërim".³⁸

³⁶ Dhekhijretul Ukba (20/235).

³⁷ Ebu Davudi (2454), Tirmidhiu (730), Nesaiu (4/196), Ibn Maxheh (1700) dhe Ahmedi (6/287) dhe Ibn Khuzejmeh (1933). Spas një varianti ky hadith përcillet me zinxhir transmetimi të plotë deri tek Pejgamberi a.s dhe sipas një varianti tjetër sillet me zinxhir transmetimi deri tek sahabët si një thënien e tyre dhe jo e Pejgamberit. Më e sakta është që është thënie e sahabëve.

³⁸ Muetta i Imam Malikut (1/288).

Tirmidhiu (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Dijetarët shpjegojnë se nuk i vlen agjërimi atij që nuk e vendos për të agjëruar para hyrjes së sabahut në ramazan, ose për zëvendësimin e ditëve të ramazanit (kazanë), ose për agjërimin që njeriu ia bën detyrë vetes me zotim. Me fjalë të tjera, nëse njeriu nuk e bën nijetin për agjërimin detyrë natën, para agimit, nuk i vlen agjërimi. Sa i përket agjërimit vullnetar, lejohet ta bësh nijetin pasi të hyjë sabahu. Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.”³⁹

Mësime dhe dispozita

1- Është i domosdoshëm që agjërim të kryhet me nijetin si ibadet për Allahun e Lartmadhëruar. Nëse dikush nuk i konsumon gjërat që prishin agjërimin për të mbajtur dietë, ose nga këshillat e mjekut, ose thjesht sepse nuk i hahet e pihet, ose për ndonjë arsye tjetër, ky nuk vlen si agjërim fetar, për të cilin shpërblehet nga Zoti.

2- Vendi i nijetit është zemra. Kushdo që e çon në mendje se të nesërmen do të agjërojë, e ka bërë nijetin.

3- Agjërimi i detyrueshëm, si agjërimi në ramazan, agjërimi që njeriu ia ka bërë detyrë vetes me zotim apo agjërimi për shlyerje⁴⁰, duhet që të përfshijë gjithë ditën, nga hyrja e agimit e deri në përfundimin e diellit, prandaj këtë e arrin vetëm ai i cili e vendos të agjërojë që para çeljes së agimit. Ndërsa kush e bën nijetin gjatë ditës, agjërimi i tij nuk e përfshin gjithë ditën, prandaj nuk ka agjërim të vlefshëm. Për këtë, është detyrë që nijeti i agjërimit të detyrueshëm të bëhet para agimit.

4- Lejohet bërja e nijetit të agjërimit, i detyruar qoftë apo vullnetar, në çdo pjesë të natës. Edhe nëse pas nijetit bën diçka që e prish agjërimin, nuk është e detyrueshme ribërja e nijetit, nëse ende nuk ka hyrë agimi.

6- ETIKA E AGJËRIMIT

Nga Ebu Hurejra (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Agjërimi është mburojë. Nëse jeni me agjërim, atëherë mos flisni fjalë të pista dhe mos u sillni pa edukatë. Nëse ju shan dikush, thuajini: “Jam me agjërim, jam me agjërim”. ”⁴¹

³⁹ Xhamiut-tirmidhi (3/108).

⁴⁰ Si për shlyerje (kefaret) betimi, dhitari, apo vrasje gabim.

⁴¹ Transmeton Maliku dhe hadithi është sjellë sipas versionit të tij (1/310). Transmeton edhe Buhariu (1795) dhe Muslimi (1151).

Në një variant tjetër qëndron: “Nëse jeni duke agjëruar, atëherë mos flisni fjalë të pista dhe mos u grindni me zë të lartë. Nëse ju shan dikush ose kërkon të grindet, thuajini: “Jam me agjërim!”⁴²

Një hadith tjetër thotë: “Mos shaj kur je me agjërim! Nëse të shan dikush, thuaji: ‘Unë po agjëroj’, dhe nëse je në këmbë, ulu ndenjor.”⁴³

Nga Ebu Hurejra (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush nuk i lë gënjeshtat⁴⁴, mashtrimin e punët e këqija⁴⁵ dhe sjelljen e injorancës, ta dijë se Allahu nuk ia vlerëson lënien e ushqimit dhe të pijes.”⁴⁶ Me fjalët ‘dhe sjelljen e injorancës’ ka për qëllim sjelljen me mendjelehtësi.

Nga Aishja (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Agjërimi është mburojë nga Zjarri. Kushdo që gdhiet me agjërim, të mos sillet si mendjelehtë, e nëse dikush sillet ulët ndaj tij, të mos e fyejë dhe të mos e shajë atë, por le t’i thotë: “Unë po agjëroj!”⁴⁷

Nga Ebu Hurejra (r.a.) përcillet se ai me shokët e tij kanë qëndruar në xhami gjatë agjëritit, duke thënë: “Po ruajmë të pastër agjërimin tonë!”⁴⁸

Mësime dhe dispozita

1- Agjërimi është shkak për mbrojtje nga Xhehenemi, sepse agjërimi frenon epshet dhe Xhehenemi është ‘i rrethuar’ me gjëra që janë kenaqësi të ndaluara.

2- Agjëruetit i ndalohen fjalët e kota dhe fjalët e pista. Po ashtu, atij i ndalohen marrëdhëniet intime dhe veprimet joshëse që i paraprijnë këtij akti, përveç puthjes dhe përqaimit e përkëdheljes, nëse e përmban epshin.

3- Agjëruetit i ndalohen veprat tipike të injorantëve, si ngritja e zërit, veprimet e ulta prej mendjelehti, polemikat e kota etj.

4- Nëse agjërueti provokohet me britma, sharje e sulme personale, atij nuk i takon të kundërpërgjigjet me të njëjtën formë, por të ketë parasysh këto norma:

⁴² Ky transmetim është i Buhariut (1805) dhe i Muslimit (1151).

⁴³ Ky transmetim është i Nesaiut në Kubra (3259), Tajalisi (2367). Ibn Khuzejme (1994) dhe Ibn Hibani (3483) e quajnë të saktë.

⁴⁴ Këtu hyjnë të gjitha gjynahet e gojës si: dëshmia e rremë, shpifja, gënjeshtra, sharja, mallkimi etj.

⁴⁵ Këtu përfshihen të gjitha punët e ndaluara të cilat njeriu i bën me gjymtyrë.

⁴⁶ Buhariu (5710), Ebu Davudi (2362), Nesaiu në Kubra (3245-3246) dhe Tirmidhiu (707).

⁴⁷ Nesaiu (4/167) dhe Tabaraniu në Evset (4179). Albani e vlerëson të saktë në sahihun e Nesaiut.

⁴⁸ Ahmedi në Ez-zuhd (178) dhe Ebu Nuejmi në El-hiljeh (1/382).

a- Të jetë i butë dhe durimtar.

b- Të mos reagojë me fjalë ndaj provokatorit, në mënyrë që të mos gabojë, pasi në disa transmetime të tjera të hadithit thuhet: “Nëse e fyen ndokush, ai të mos flasë.”⁴⁹

c- T’i përgjigjet provokatorit me fjalët: “Unë po agjëroj!”. Këtë t’ia thotë me zë haptazi, për ta ndalur nga devijimi në sjellje dhe për t’i treguar tjetrit arsyen e mosreagimit, qoftë agjërim i detyrueshëm apo vullnetar.⁵⁰

d- Nëse sulmuesi nuk ndalet, agjëruesi thotë sërish: “Jam me agjërim”, sepse edhe në hadith është përsëritet.

e- Nëse agjëruesi është në këmbë dhe ka mundësi të ulet, atëherë le të ulet, duke zbatuar kështu hadithin e Profetit (a.s.). Në këtë mënyrë ulet zemërimi dhe i pritët rruga kundërshtarit të tij dhe shejtanit.

5- Nga hadithet e mësipërme nuk nënkuptohet aspak se sharja, sjellja e keqe, polemikat e kota etj. janë të lejuara jashtë kohës së agjërit, por theksohet ndalimi i tyre gjatë këtij adhurimi, për arsye se ato janë në kundërshtim të hapur me qëllimin e agjërit.⁵¹

6- Në hadithet e mësipërme tregohet madhështia dhe gjithëpërfshirja e fesë Islame. Ato dëshmojnë për rolin e kësaj feje në edukimin e pasuesve të saj me moral të lartë, qoftë edhe ndaj injorantëve e mendjelehtëve. Falënderimi i takon Allahut, i Cili e solli këtë fe dhe na udhëzoi në të!

7- Nëse agjëruesi sulmohet fizikisht nga dikush, qoftë për rrahje apo vrasje, atëherë mund të reagojë për vetëmbrojtje, sepse këtë rast e përfshin e drejta e vetëmbrojtjes ndaj agresorit, por ky rrezik duhet të largohet me formën më të lehtë të mundshme. Domethënë, nuk është e ndaluar që agjëruesi t’i përgjigjet këtij lloj sulmi.⁵²

8- Agjërimi i vërtetë është ‘agjërim.i’ nga gjynahet, nga gënjeshttrat dhe fjalët e pista, pastaj nga ushqimi, pirja, marrëdhëniet intime dhe (për ata të cilët nuk e përmbajnë veten) përqafimi i grave.⁵³

⁴⁹ Këtë pjesë e përmend Ibn Haxheri në Fet-h, por unë nuk e kam gjet diku tjetër. [Ibn Haxheri përmend se e ka shënuar Ebu Kurre në Sunen, por këtë libër nuk e kemi në dorë. Megjithatë, këtë pjesë e kam gjetur në mu’xhemul eusat të Taberaniut, por senedi është i dobët. Sh.r.].

⁵⁰ Kjo çështje ka diskutim në mesin e dijetarëve. Kush do më shumë informacion le të kërkojë në librin “Elmufijid fi khutab elxhumati eel-ijid”. Më e sakta është ajo që përmenda më sipër dhe kjo është ajo që duket nga fjalët e Kurtubiut në Elmufhim (2/126-127). Ky është qëndrimi Ibn Tejmije në librin El minhaxh (5/197) dhe në El fetava El kubra (4/460). Kështu mendon dhe Ibn Muflih në librin El furuu (3/66).

⁵¹ Shiko El Mufhim (3/214) dhe Elfet-h (4/104).

⁵² Shiko El Fet-h (4/105).

⁵³ Ehadijth Es-sijam te Adullah Feuzan (75).

9- Shumica e dijetarve kanë rënë dakord se agjëruesi që bën përgojim, gënjen apo sillet keq me të tjerët, ai nuk e prish atë ditë agjërimi me këtë veprim, por merr gjynah dhe i ulet shpërblimi.⁵⁴

10- Qëllimi i agjëritimit nuk është thjesht uria dhe etja, por është kontrolli i epshit, shuarja e zemërimit dhe frenimi i egos nga e keqja, përmirësimi i vetvetes dhe arritja e paqes shpirtërore. Nëse këto nuk arrihen me agjërim, atëherë nuk ka ndryshim mes agjëritimit dhe mosagjëritimit, pasi ai nuk ka ndikuar aspak te njeriu.⁵⁵

11- Gënjeshtria është baza e paturpësive dhe burimi i gjynaheve. Për këtë arsye, ajo është përmendur krahas me shirkun në ajetin: “Largohuni nga ndyrësitë e idhujve dhe largohuni prej fjalëve të pavërteta.” [Haxh 30]. Dihet se shirku është e kundërta e sinqeritet, ndërsa tipar kryesor i agjëritimit është vërtetësia e sinqeriteti, prandaj nëse agjërimi bashkohet me gënjeshtren, të kundërtën e tij, atëherë ai asgjësohet.⁵⁶

7- AGJËRIMI DHE MBYLLJA E TIJ BËHEN BASHKARISHT ME XHEMATIN

Nga Ebu Hurejra (r.a.) përcillet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Agjërimi fillon atë ditë kur agjëroni të gjithë, dita e fitër bajramit është atë ditë kur të gjithë bëni fitër bajram dhe dita e Kurbanit është atë ditë kur të gjithë bëni kurban”.Tirmidhiu për këtë hadith ka thënë që është i *hasen* (mirë përse i përket gradës së saktësisë), por edhe *garib* (jo shumë i njohur përse i përket përhapjes së tij ndër transmetuesit e haditheve).⁵⁷

Ndërsa në një version të Ebu Davudit thuhet: “Dita e fitër bajramit është atë ditë kur të gjithë bëni fitër bajram dhe dita e Kurbanit është atë ditë kur të gjithë bëni kurban.”⁵⁸

Nga Aishja (r.a.) përcillet se Profeti (a.s.) ka thënë: ““Dita e fitër bajramit është atë ditë kur të gjithë njerëzit bëjnë fitër bajram dhe dita e Kurbanit është atë ditë kur të gjithë njerëzit bëjnë kurban.””⁵⁹

⁵⁴ Shiko: Elfet-h (4/104) dhe Umdetulkarii (10/276).

⁵⁵ Këtë shpjegim e ka dhënë Bejdavi, siç përmendet në Fet-h (4/117) dhe Fejd el kadijr (6/224).

⁵⁶ Këtë shpjegim e citon Menavi nga Ettijbi. Shiko:Fejd el kadijr (6/224).

⁵⁷ Për gradën e saktësisë së këtij hadithi Tirmidhiu përdor shprehjen “*hasen garib*”. Dijetarët e hadithi, si shejh Albani, kanë sqaruar se, kur Tirmidhiu jep një vlerësim të tillë për senedin e hadithit, ai nënkupton që në vetvete senedi është i gradës *hasen* (i mirë). Kështu pohon Albani në librin “Difa ani sira”. Në një vend tjetër në “*sunen*” Tirmidhiu e quan këtë senen si *sahih*. Ne fakt, senedi i këtij hadithi është *hasen*, por duke marrë parasyshë dhe rrugën tjetër të këtij hadithi, që edhe autori më lart e përmend pas kësaj rruge, hadithi bëhet padiskutimisht i saktë. Për më gjerë mund të shihet libri Irrvaul galil i Albanit].

⁵⁸ Ebu Davudi (2324), Tirmidhiu (697), Ibn Maxheh (1660) , Darekutnij (2/164), Abdurrezaku (7304) dhe Is’haku (496).

Mësime dhe dispozita

1- Këtu vihen re toleranca dhe lehtësia që karakterizojnë Sheriatin Islam. Ky legjislacion fetar nuk i vë në vështirësi njerëzit dhe për të mësuar kohët e ibadeteve ka caktuar shenja që mund t'i kapin me lehtësi, siç është shikimi i hënës së re.

2- Interesimi i Sheriatit për bashkimin e muslimanëve, duke njësuar për të gjithë ata ditën e hyrjes së ramazanit, daljes së tij dhe ditët e festave të tyre.

3- Gabimi në gjetjen e saktë të ditës së parë ose të fundit të muajit hënor është i falshëm, nëse njerëzit ndjekin metodën që obligon Allahu e që është shikimi i hënës së re, ose plotësimi i muajit tridhjetë ditë kur nuk shihet hëna.⁶⁰ El Hafidh Ibn Abdulberri (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Dijetarët kanë rënë dakord se, nëse bashkësia gabon në përcaktimin e hënës së muajit dhulhixhe dhe qëndron në Arafat në ditën e dhjetë të këtij muaji, quhet periudhë e plotësuar, jo e mangët. Po kështu është edhe me çështjen e ditës së Fitër Bajramit dhe të ditës së Kurban Bajramit. Në fund, Allahu e di më së miri”.⁶¹

4- Këto hadithe tregojnë se për caktimin e ditës së bajramit duhet të merret parasyshtë fakti që qëndrimi i individëve duhet të jetë në përputhje me njerëzit. Individui duhet të pajtohet me xhematin, edhe nëse e ka parë hënën vetë. Kjo vlen edhe për ditën e parë dhe të fundit të ramazanit. Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Ky hadith tregon se personi që e shikon

⁵⁹ Tirmidhiu për këtë hadith ka thënë që është *hasen garib* dhe sahih nga kjo rrugë. Këtë hadith e shënon edhe Is'haku. Porse një transmetues i dobët në këtë sened ka gabuar dhe ka thënë se hadithi është transmetuar nga Aishja, se në fakt ky hadith është tranametuar veçse nga Ebu Hurejra, sikurse vërtetohet nga rrugët e tjera. Për më gjerë të shihet libri “Irrvaul galil”.

⁶⁰ [Të njëjtin gjykim ka dhe kur bashkësia e muslimanëve e fillon ramazanin gabim, e bën ditën e fitrit të bajramit gabim dhe ditën e kurban bajramit gabim për shkak se autoriteti që ju shpall muajin me interpretim të gabuar nuk ndjek metodën e caktuar në Sheriat. Ja disa raste kur nuk respektohet metoda e caktuar në shariat e që është marrja parasyshtë e lajmit të shikimit të hënës së re: 1- Kur autoriteti nuk pranon lajmin e shikimit të hënës së re në një vend tjetër, duke vënë për pranimin e lajmit të shikimit të hënës së re kushte dhe kufij për të cilët nuk ka asnjë argument, e duke kundërshtuar kështu hadithet që urdhërojnë për fillimin e agjërimit kur shihet hëna e re. 2- Kur pranohet lajmi i shikimit të hënës së re brenda një shteti, edhe pse distanca nga një anë e shtetit është shumë e largët nga ana tjetër, dhe nuk pranohet lajmi i shikimit prej një një shteti tjetër kufitar, edhe pse distanca e disa qyteteve prej këtij shteti kufitar është më e shkurtër! E kjo ndodh për shkak se pranohet lajmi brenda atij shteti dhe nuk pranohet prej një shteti tjetër kufitar! Kjo gjë është në kundërshtim me Kuranin, Sunetin, dhe ixhmain. Nuk mund të ketë logjikë të shëndoshë që mund ta pranojë këtë metodë përcaktimi si të saktë. 3- Kur hyrja e muajit hënorë bazohet në llogaritë astronomike mbi mundësië e shikimit të hënës së re dhe jo në shikimin real të hënës, gjë që bie ndesh me Kuranin, Sunetin dhe ixhmain. Të gjitha këto pra janë raste gabimesh që vijnë nga bazimi në mendime të gabuara, por që në këtë çështje nuk ka argument për t'i trajtuar ndryshe nga rastet e tjera të gabimit të përmendura më lart apo të përmendura në vende të tjera, përkundrazi hadithi i mësipërm i përfshin të gjitha këto raste gabimi dhe nuk ka argument për ti trajtuar disa gabime ndryshe nga të tjerat në këtë çështje. Ky është dhe qëndrimi i Ibn Tejmijes, Ibn Bazit dhe Albanit për këtë çështje].

⁶¹ Et-temhijid (14/356). Shejh Ibn Bazi:” (Allahu e mëshiroftë!) thotë: Nëse njerëzit gabojnë ndërkohë që kanë punuar me shikimin fetar të hënës, ata kanë shpërbllim”. Mexhmu fetava ve resail (15/133).

hënën i vetëm nuk e ka të detyrueshme të marrë për bazë këtë shikim (në kundërshtim me xhematin) në çështjen e fillimit të agjërimit, ditës së Fitër Bajramit apo të ditës së qëndrimit në Arafat.”⁶²

Kështu, nëse dikush e shikon hënën e ramazanit i vetëm, por nuk ia pranojnë dëshminë, ai nuk fillon të agjërojë i vetëm, por fillon atëherë kur fillojnë njerëzit, duke patur të njëjtin gjykim si ata në këtë çështje, bazuar në domethënien e drejtpërdrejtë të këtyre haditheve.⁶³

8- LIGJSHMËRIA E NAMAZIT TË TERAVIVE

Abdurrahman Ibn Abdulkarij rrëfen: “Shkova një natë në ramazan me Omer Ibn Hattabin në xhami, ku njerëzit faleshin grupe-grupe të ndarë. Ca faleshin vetëm e ca me grupe të vogla. Omeri tha: “Mendoj se, nëse i bashkoj njerëzit të falen pas një imami, do të ishte më mirë.” E vendosi dhe i bashkoi ata pas Ubej Ibn Keabit. Dola sërish me të një natë tjetër dhe pamë se njerëzit faleshin pas një imami. Omeri tha: “Sa bidat i mirë është ky! Koha në të cilën ata flejnë është më e mirë për namaz sesa kjo kohë në të cilën falen.” Ai kishte për qëllim pjesën e fundit të natës, sepse njerëzit faleshin në pjesën e parë të saj.”⁶⁴

Tek Imam Maliku thuhet se: “Omer Ibn Hattabi urdhëroi Ubej Ibn Keabin dhe Temijm Eddarimin që të dilnin si imamë dhe të falnin 11 rekatë. Imami këndonte sure që kishin më shumë se njëqind ajete, aq sa mbështeteshim në shkopinj nga qëndrimi i gjatë në këmbë dhe nuk largoheshim përveçse kur afronte agimi.”⁶⁵

Tek Ibn Huzejme shënohet se Omeri tha: “Pasha Allahun, mendoj se po t’i kishim bashkuar këta njerëz pas një imami, do të kishte qenë më mirë.” Kështu vendosi Omeri dhe e urdhëroi Ubej Ibn Keabin që të falej si imam i tyre në ramazan. Omeri doli një natë, ndërkohë që njerëzit po faleshin pas imami, dhe tha: “Sa bidat i mirë është ky, mirëpo ajo kohë në të cilën flenë është më e mirë se kjo në të cilën po falen.” Ai kishte për qëllim pjesën e fundit të natës. Njerëzit faleshin pjesën e parë të natës. Në gjysmën e dytë të ramazanit ata mallkonin qafirët (në lutjen e kunutit): “O Allah, shkatërroji qafirët, atë të cilët pengojnë nga rruga Jote, quajnë gënjeshtarë të dërguarit e Tu dhe nuk e besojnë premtimin Tënd. O Allah, përçaji dhe futu frikën në zemër, lësho mbi ta zemërimin dhe dënimin tënd, o Zoti i Vërtetë!” Pastaj çonin salavate mbi Pejgamberin (a.s.), pastaj luteshin që Allahu t’u jepte mirësi muslimanëve, pastaj kërkonin falje për besimtarët. Pas këtyre, thoshin në fund: “O Allah, vetëm Ty të adhurojmë, për Ty falemi dhe vetëm Ty të përulemi, kah Ti vijmë dhe shpejtojmë! Shpresojmë mëshirën Tënde dhe i

⁶² Tehdhijbus-sunen (6/317).

⁶³ Shiko: El-Fetava es-seadijeh (216) dhe Mexhmu fetava ve resail Ibn Baz (15/64-72-73).

⁶⁴ Buhariu 1906, Maliku 1/114, Abdurrezaku 7723 dhe Ibn Ebi Shejbeh 2/165.

⁶⁵ Transmeton Saib Ibn Jezijd. Hadithi gjenedet tek Maliku (1/115), Abdurrezaku (7730) dhe Ibn Ebi Shejbeh (2/162).

frikësohemi dënimit Tënd! Vërtet, dënimi Yt do t'i kapë armiqtë e Tu!” Pastaj imami thoshte “Allahu Ekber” dhe binte në sexhde.”⁶⁶

Mësime dhe dispozita:⁶⁷

- 1- Namazi i teravive është vepër që e ka bërë Pejgamberi (a.s.), që pastaj e ndërpreu, nga droja se mos bëhej detyrë për muslimanët. Më pas, në kohën e tij dhe në kohën e Ebu Bekrit, njerëzit i falën teravitë të shpërndarë, jo me një xhemat. Ndërsa kur u bë Omeri kalif, ai i bashkoi muslimanët të falnin teravitë me xhemat pas një imami, duke ringjallur kështu një sunet të Pejgamberit (a.s.). Muslimanët e asaj kohe dhe të mëvonshmit kanë qëndrim unanimitet se kjo vepër është e pëlqyer.⁶⁸
- 2- Ndoshta ai i cili është më pak i mirë mund të ringjallë një sunet ose të bëjë një të mirë, të cilën nuk e ka bërë ai i cili është më i mirë, ashtu siç ndodhi me Omerin, që Allahu e frymëzoi për ta ringjallur këtë traditë të mrekullueshme. Për këtë nuk u frymëzua Ebu Bekri, edhe pse ishte më i mirë se Omeri, saqë vetë Omeri ka thënë për të njëherë: “Për Allah, nuk garoj më kurrë me të për asgjë!”⁶⁹
Kur kalonte afër xhamive dhe i shikonte kandilët e ndezur në muajin e ramazanit, Aliu thoshte: “Allahu i dhëntë dritë Omerit në varr, ashtu siç i ka ndricuar xhamitë tona (me namazin e teravive) për ne!”⁷⁰.
Kështu, muslimani nuk duhet assesi ta nënçmojë veten në kryerjen e veprave të mira, sepse ndoshta Allahu i hap atij ndonjë derë të hajrit, të cilën nuk ia ka hapur atyre që janë më të mirë se ai. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën ia jep kujt të dojë. Vërtet, Allahu zotëron mirësi të madhe.
- 3- Bashkimi i muslimanëve është më parësor se përçarja e tyre dhe e kanë detyrë prijësit e muslimanëve që të punojnë për ta bërë realitet këtë.
- 4- Gjykimi i prijësit në çështjen e suneteve është i detyrueshëm për besimtarët, që duhet t'i binden atij, ashtu siç iu bindën sahabët Omerit, kur i bashkoi pas një imami.
- 5- Pajtimi për ringjalljen e një suneti dhe bashkimi në kryerjen e ibadetit është diçka me bereqet, sepse lutja e secilit individ përfshin të gjithë xhematin. Për këtë arsye, namazi me xhemat është 27 herë më i mirë se namazi që falet vetëm. Sejjd Ibn Xhubejri ka thënë: “Preferoj më tepër të falem pas një imami që lexon suren “Gashije”, sesa të falem vetëm duke lexuar 100 ajete”.⁷¹

⁶⁶ Ky transmetim është i Ibn Huzejmes (1100). Albani e konsideron si transmetim të saktë.

⁶⁷ Sherh Ibn Battal ala el Buhari (4/146-147), Ikmalul mual-lim (3/114) dhe Fet'hul barîi (4/252).

⁶⁸ E përcjellin këtë unanimitet shumë dijetarë muslimanë, njëri prej të cilëve është imam Nevevi në tehdhibul esmai vel-lugat (2/332).

⁶⁹ Ebu Davudi (1618) dhe Tirmidhiu (3675) nga Omeri r.a. Tirmidhiu thotë se është hadith i mirë dhe i saktë.

⁷⁰ Ibn Asakir fit tarikhihi (44/280) dhe Ibn Abdulberri në temhijid (8/119).

⁷¹ Ibn Abdulberri në temhijid (8/118.)

- 6- Nëse vepra lihet për një arsye dhe kjo arsye largohet, atëherë nuk ka problem nëse e rikthejmë prapë atë vepër, ashtu siç riktheu Omeri namazin e teravive me xhemat në ramazan.
- 7- Nëse është e mundur, imam duhet të bëhet ai që di më shumë Kuran përmendësh, sepse Ubej Ibn Keabi ishte hafizi më i mirë i Librit të Allahut në mesin e tyre, prandaj e zgjodhi Omeri. Kjo është e pëlqyeshme dhe jo e detyrueshme, sepse Omeri nxori imam edhe Temijm Eddari, ndërkohë që në mesin e sahabëve kishte të tjerë që dinin Kuran përmendësh më shumë se ai.
- 8- Lejohet për gratë që të marrin pjesë në faljen e namazit të teravive në xhami, ashtu siç lejohet që një burrë të bëhet imam vetëm për gratë, nëse xhemati është vetëm gra, me kusht që të mos ketë vend për fitne.
- 9- Lejohet të lidhesh në namaz pas një tjetri që po falet më vete, edhe nëse ky tjetri nuk e ka patur qëllim të bëhet imam.
- 10- Nëse imami e ka bërë zakon që të pushojë pas dy apo katër rekatëve, nuk duhet që xhemati të falë nafile gjatë kësaj kohe. Këtë veprim e ka parë të urryer imam Ahmedi, ashtu siç ka dëshmi edhe për tre sahabë, që janë: Ubade Ibn Essamit, Ebu Derda dhe Ukbete Ibn Amiri.⁷²
- 11- Nuk ka problem nëse fal teravitë me një imam derisa të mbarojë, pastaj arrin një xhemat tjetër, që po falin teravitë, dhe të falesh me ta.⁷³
- 12- Nuk lejohet të falen rregullisht me xhemat namazet nafile, përveç teravive në ramazan, pasi është bidat,⁷⁴ siç është përshebull grumbullimi i disa njerezve për të falur namaz nate me xhematë përgjatë gjithë vitit, ose veçimi i disa netëve të caktuara me namaz nate me xhematë. Pejgamberi (a.s.) nuk i ka bashkuar besimtarët për të falur namaz nafile me xhemat jashtë ramazanit.

9-LARJA DHE FRESKIMI I TRUPIT NË AGJËRIM.

Përcillet se Aishja (r.a.) ka thënë: “Pejgamberi (a.s.) gdhiehej xhunub, pastaj lahej, pastaj shkonte në xhami dhe koka i pikonte ujë. E kështu atë ditë agjëronte.”⁷⁵

⁷² Elistidhkar (2/72.)

⁷³ Kjo vepër quhet ‘*teakijb*’. Atë e ka lejuar Enes Ibn Maliku r.a., duke thënë: “Nuk kthehen për tu falë prapë vetëm sepse shpresojnë për të mira ose të ruhen nga e keqja”. Ka thënë imam Ahmedi: “Nuk ka problem”. Shih: Elmugnij (1/457).

⁷⁴ Shiko: Ikmalul mual-lim (3/114).

⁷⁵ Ahmedi (6/99), Nesaiu në Kubra (29-86), Ebu Jeala (4708), Bezzari (1552) dhe Tajalisi (1503). Zinxhiri i transmetimit është i saktë. Ky hadith gjendet dhe në dy librat e sakta (Buhariu dhe Muslimi), por me një formulim tjetër.

Ebu Bekër Ibn Abdurrahmani përcjell nga një shok i Pejgamberit (a.s.) që ka thënë se e ka parë Pejgamberin (a.s.) në Arxh të hidhte ujë mbi kokë, nga etja ose nga të nxehtit, ndërkohë që ishte me agjërim”.⁷⁶

Imam Buhari (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Ibn Omeri (r.a.) ka lagur rrobën e vet dhe e ka hedhur në trup, ndërkohë që ka qenë me agjërim. Gjithashtu, Sheabiu ka bërë banjë, ndërkohë që ka qenë me agjërim. Ndërsa Ibn Abbasi (r.a.) ka thënë: “Nuk ka problem nëse e provon vetëm me gjuhë ushqimin ose diçka tjetër.” Haseni (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Për agjëruenin nuk ka problem shpëlarja e gojës me ujë ose freskimi i trupit me të.” Ibn Mesudi (r.a.) ka thënë: “Nëse ndonjëri nga ju është me agjërim, le të parfumoset dhe krihet”. Enesi (r.a.) ka thënë: “Unë kam një basen të vogël, ku futem e lahem edhe kur jam me agjërim”.⁷⁷

Mësimet dhe dispozitat

- 1- Agjëruenit i lejohet të freskohet duke hedhur ujë mbi trupin e tij, qoftë për larje të detyrueshme, të pëlqyeshme ose të lejueshme.⁷⁸
- 2- Agjëruenit i lejohet të zhytet në ujë, por duhet të ketë kujdes që të mos i depërtojë gjë në brendësi të trupit.⁷⁹
- 3- Zbutja e vështirësive të adhurimit me forma të lejuara nuk konsiderohet mërzi me ibadetin. Gjithashtu nuk është e përligjur shpërfillja e metodave të lejuara që lehtësojnë adhurimin.
- 4- Njeriu është i dobët dhe i pafuqishëm nga natyra e vet, prandaj ka nevojë për të shfrytëzuar mjetet e lehtësimit që ia ka bërë mirësi Allahu i Lartësuar.
- 5- Lejohet për agjëruenin hyrja në banjo me avull ose të ngjashme. I lejohet gjithashtu parfumosja, zbukurimi dhe përdorimi i vajrave ose kremrave për lëkurën dhe flokët. Aromat nuk e prishin agjërimin dhe as nuk janë të urryera.

⁷⁶ Ebu Daudi (2365), Maliku në Muvetta (1/294), Shafiu në Musnedin e tij (1/157), Ahmedi (3/457) dhe Hakimi (1/590). Ibn Abdulberri equan të saktë në Temhijid (22/47), por edhe Hafidhi në Teglijkut Tealijk (3/153), Ajni në Umdëtul kari (11/11) dhe Albani në sahih Ebu Dauud.

⁷⁷ Sahih Buhari (2/681). Shiko: teglijkut-tealijk (3/151).

⁷⁸ Avnul Meabud (6/352)

⁷⁹ Mirkatul mefatijh (4/441)

6- I lejohet agjëruesit të zhytet në ujë për freskim ose për pastrim, ose edhe për sport, sepse nuk i prishet agjërimi.

7- I lejohet kuzhinierit provimi i ushqimit me gjuhë, pa e gëlltitur, nëse është e nevojshme. Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: Për mendimin tim, është më e pëlqyeshme që agjëruesi t'i shmanget shijimit të ushqimit, por nëse e bën, nuk ka problem.”⁸⁰ Gjithashtu, Komisioni i Përhershëm i Fetvave në Arabinë Saudite ka dhënë fetva për lejin e këtij veprimi.⁸¹

10- FAZAT E DETYRIMIT TË AGJËRIMIT

Berai (r.a.) tregon: “Ka ndodhur me shokët e Pejgamberit (a.s.) që, duke qenë me agjërim, nëse i zinte gjumi në kohën e iftarit, ata nuk hanin më atë natë, as ditën vijuese, derisa vinte akshami tjetër. Kështu, njëherë, Kajs Ibn Sirmete el Ensari ishte me agjërim dhe, kur afroi koha e çeljes, i tha së shoqes: “A ka gjë për të ngrënë?” – “Jo, - i tha ajo, - por po dal e po kërkoj diçka për ty.” Kajsi kishte qenë gjithë ditën duke punuar, prandaj e zuri gjumi duke pritur. Kur erdhi gruaja dhe e gjeti në gjumë, i tha: “Ah, e humbe atë që e kërkoje!” Dhe Kajs i nuk hëngri më. Por aty nga gjysma e ditës së nesërme, atij i ra të fikët. Kur kjo ngjarje iu tregua Pejgamberit (a.s.), zbriti ajeti kuranor: “Tani është e lejuar për ju që, gjatë netëve të agjërit, të shkoni më bashkëshortet tuaja.” [Bekare 187]. Sahabët u gëzuan shumë. Pastaj zbriti ajeti: “Hani dhe pini deri në agim, atëherë kur të dallohet peri i zi nga peri i bardhë.” [Bekare 187].⁸²

Muadh Ibn Xhebeli (r.a.) ka thënë: “Namazi është ligjësuar në tre faza, po ashtu edhe agjërimi është ligjësuar në tre faza...” Pasi ka shpjeguar fazat e namazit, ka folur për agjërimin: “Në fillim, Pejgamberi (a.s.) agjëronte tri ditë në çdo muaj si edhe ditën e Ashuras. Pastaj Allahu Lartësuar shpalli: “O ju që keni besuar, e keni detyrim agjërimin, ashtu siç ishte detyrim për pararendësit tuaj...”, deri tek “...ushqen një të varfër” në suren Bekare, ajeti 183. Në këtë fazë, besimtarët e kishin me zgjedhje: ose mund të agjëronin, ose nuk agjëronin, por ushqenin për çdo ditë nga një të varfër. Kjo mënyrë e zëvendësimit të agjërit ishte e lejuar. Më pas, Allahu i Lartësuar shpalli: “Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kurani..” deri tek “le të agjërojnë po aq ditë (sa ka lënë pa agjëruar) më vonë”, që bën të detyrueshëm agjërimin për çdo njeri që e arrin muajin e ramazanit, ndërsa për udhëtarin lejohet të mos agjërojë gjatë udhëtimit, por e ka detyrë

⁸⁰ Elmugnij (3/19)

⁸¹ Fetvatë e komisionit të përhershëm nr (9845). Po ashtu ka dhënë fetva edhe shejh Uttejmini: Shiko ‘Kushtet e fesë’ (484).

⁸² Buhariu (1816), Ebu Davudi (2314), Tirmidhiu (2968) dhe Ahmedi (4/295).

zëvendësimin i ditëve që ka lënë pa agjëruar. Gjithashtu, u përcaktua praktika e ushqimit të të varfërve si kompensim nga të moshuarit (që nuk mund të agjërojnë).”⁸³

Nga Ahmedî është përcjellë se ka thënë: “Për sa u përket fazave të agjërit, kur Pejgamberi (a.s.) erdhi në Medinë, në fillim agjëronte tri ditë të çdo muaji. Jezid Ibn Haruni thotë se për nëntëmbëdhjetë muaj me radhë që nga muaji Rabiul Euel e deri në Muajin Ramazan të vitit pasues, Profeti (a.s.) agjëronte tre ditë për çdo muaj, gjithashtu agjëronte dhe ditën e Ashuras.

Pastaj Allahu i Lartësuar e bëri detyrim agjërimin me ajetin: “O ju që keni besuar, e keni detyrim agjërimin, ashtu siç ishte detyrim për pararendësit tuaj....” [Bekare 183] deri tek: “...e ata që i rëndon agjërimi janë të obliguar për kompensim: ushqim ditor i një të varfëri”. Kështu, me dëshirë, besimtarët mund të agjëronin, ose mund të ushqenin një të varfër për të zëvendësuar agjërimin.

Më pas, Allahu i Lartësuar zbriti ajetin tjetër: “Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kurani” deri tek: “Kushdo nga ju që e jeton këtë muaj, le të agjërojë!” Këtu Allahu e bëri detyrim agjërimin për ata që nuk janë udhëtarë dhe që janë në gjendje të mirë shëndetësore, e lehtësoi çështjen për udhëtarët dhe të sëmurët, si edhe caktoi kompensimin e agjërit me ushqimin e të varfërve për ata të moshuar të cilët nuk kanë mundësi të agjërojnë. Besimtarët gjatë natës hanin, pinin dhe shkonin me gratë e tyre, përderisa nuk i zinte gjumi. Nëse i zinte gjumi, nuk bënë më pas asgjë nga këto.

Njëherë – vijon shpjegimin imam Ahmedî (Allahu e mëshiroftë!) - një ensar, që quhej Sirme, ishte duke punuar, ndërkohë që ishte me agjërim në ramazan, derisa perëndoi dielli. Shkoi në shtëpi, fali jacinë pastaj fjeti, duke mos ngrënë e pirë asgjë, derisa u gdhi. Kështu u zgjua përsëri me agjërim. Të nesërmen, Pejgamberi (a.s.) e vuri re që ensari ishte tepër i lodhur, prandaj e pyeti: “Çfarë halli ke, se po më dukesh i rraskapitur?” – “O i Dëguari i Allahut, - i tha Sirme - unë punova dje gjithë ditën, dhe kur shkova në shtëpi, u shtriva për të pushuar, por më zuri gjumi. Kur u zgjova, kishte filluar agjërimi.

Gjithashtu, - përfundon imam Ahmedî - Omeri (r.a.) kishte shkuar me gruan gjatë natës, prandaj shkoi te Pejgamberi (a.s.) për ta pyetur. Atëherë Allahu i Lartësuar shpalli ajetin: “Gjatë netëve të agjërit, e keni të lejuar kontaktin me gratë tuaja....” deri tek: “Pastaj, vazhdojeni agjërimin deri në mbrëmje.”. [Bekare, 187]”

Mësime dhe dispozita

1- Lehtësimi për besimtarët është mëshirë nga Allahu i Lartësuar. Në fillim të detyrimit të agjërit, nëse nuk haje menjëherë pas perëndimit të diellit deri në kohën e namazit të jacisë, ose

⁸³ Ebu Davudi (507), Ahmedî (5/246), Taberani në elkebijr (20/132) nr (270) dhe Hakimi. [Albani thotë se hadithi është i saktë].

nëse të zinte gjumi në kohën e iftarit, ishte e ndaluar të haje e pije më pas, deri në akshamin e ditës së nesërme. Kjo qe shumë e vështirë, siç u tregua më lart, prandaj Allahu i Lartësuar solli lehtësimin duke lejuar ngrënien, pirjen dhe marrëdhëniet intime gjatë natës, pavarësisht se fle ose jo pas perëndimit të diellit. Vetëm Allahut i takon lavdërimi dhe falënderimi për këtë lehtësim!

2- Në hadithe tregohet se si gruaja i shërbente bashkëshortit të saj, dhe kjo vinte prej respektit ndaj tij dhe tregon bashkëjetesën e mirë.

3- Shihet se sa të kujdesshëm ishin sahabët për të mos rënë në haram, sa të bindur ishin ndaj urdhrave të Allahut, në intimitet dhe në publik. Në disa versione të tjera të hadithit thuhet se gruaja u vonua në gjetjen e ushqimit, prandaj burrin e zuri gjumi. Ajo e zgjoi, por burri nuk deshi të kundërshtonte Zotin dhe të Dërguarin e Tij, prandaj refuzoi të hante, dhe kështu që u zgjua në mëngjes me agjërim.⁸⁴ Ndërsa sipas një transmetimi tjetër thuhet: “Burri mbështeti kokën dhe mori një sy gjumë. Gruaja solli ushqimin dhe i tha të shoqit: “Çohu e ha!” Ai i tha: “Por mua më zuri gjumi!” – “Jo, - i tha gruaja - nuk fjete.” Megjithatë, burri ra për të fjetur dhe u zgjua në mëngjes i uritur dhe i lodhur.”⁸⁵

4- Lejohet të kënaqesh me lehtësimet e Allahut të Lartësuar dhe kjo nuk bie ndesh me zbatimin e kërkesave të detyrueshme, sepse të gjitha janë nga Allahu i Lartësuar. Allahu i Lartësuar e pëlqen që rob i t’i pranojë e t’i zbatojë lehtësimet e Tij, ashtu siç e pëlqen që të zbatojë detyrat.

5- Është prej mëshirës së Allahut, që ka caktuar ibadete të dobishme për njerëzit, si pastrim për zemrën dhe shpirtin e tyre.

6- Allahu i Lartësuar i ka sjellë shkallë-shkallë detyrimet në rastet kur njerëzit nuk ishin të mësuar me to. Kështu ndodhi me namazin, që u bë detyrim në tri etapa, me agjërimin dhe me ndalimin e alkoolit. Kjo qe mëshirë dhe lehtësim nga Allahu i Lartësuar për robërit e tij. Atij i takon lavdërimi dhe falënderimi!

7- Detyrimi i agjërimit erdhi gradualisht, sepse njerëzit nuk ishin mësuar me të në fillimet e Islamit. Sipas transmetimit të dytë të hadithit, Muadhi (r.a.) ka thënë: “Ata ishin popull që nuk ishin mësuar me agjërim, prandaj e kishin të vështirë të agjëronin”.⁸⁶

8- Agjërimi u bë i detyrueshëm në tri etapa:

Etapa e parë: Agjërimi tre ditë në çdo muaj dhe agjërimi ditën e Ashures.

Etapa e dytë: Mundësia për të zgjedhur: ose të agjëroje në ramazan, ose të ushqeje të varfërit, nëse nuk doje të agjëroje.

⁸⁴ Këtë transmetim e përcjell Taberiu në tefsirin e tij nëpërmjet es Suriij (2/167).

⁸⁵ Këtë transmetim e përcjell Taberiu në tefsirin e tij nëpërmjet Muhammed ibn Jahja ibn Hibban.

⁸⁶ Ky transmetim është i Ebu Davudit (506) dhe i Bejhakiut në Sunen (4/201) dhe në Fadailul evkat (30). Shih: Sahihj Ebu Davud.

Etapë e tretë: Detyrimi i agjërit për çdo njeri që ka mundësi dhe lehtësimi për të moshuarit, të cilët nuk kanë mundësi të agjërojnë, duke iu dhënë mundësinë që të ushqejnë për çdo ditë të agjërit nga një të varfër; këtu përfshihet edhe i sëmuri për të cilin nuk ka shpresa se shërohet.

11- NAMAZI I TERAVIVE

Nga Zejd Ibn Thabiti (r.a.) përcillet se ka thënë: “Pejgamberi (a.s.) rrethoi një pjesë të vogël në xhami me degë palme (ose me kashtë) dhe filloi të falet në të. Disa burra e ndoqën dhe falën namaz bashkë me të. Ata erdhën edhe natën tjetër, por Pejgamberi (a.s.) nuk doli. Ata ngritën zërin dhe i ranë derës së Profetit (a.s.) me ca gurë të vegjël. Pejgamberi (a.s.) doli i zemëruar dhe iu tha: “Mendova se, po të vazhdonit të vepronit kështu, do tu bëhej i detyrueshëm ky namaz, prandaj faluni në shtëpitë tuaja, sepse namazi më i mirë është ai që falet në shtëpi, përveç namazeve të detyrueshme”.⁸⁷ Në një transmetim tjetër thuhet: “Kisha frikë se mos u bëhej namaz i detyrueshëm, se po të ishte bërë i detyrueshëm, ju nuk do mund ta kryenit!”⁸⁸

Mësime dhe dispozita:

- 1- Shihet thjeshtësia e Pejgamberit (a.s.) në mjetet që përdorte.
- 2- Mësojmë për adhurimin e shumtë të Pejgamberit (a.s.), edhe pse i ishin falur gjynahet e kaluara dhe të ardhme.
- 3- Interesimi i sahabëve (r.a.) për të bërë vepra të mira dhe për ta ndjekur sa më shumë Pejgamberin (a.s.) në atë që vepronte.
- 4- Në hadith tregohet vlera e namazit të natës në përgjithësi dhe veçanërisht në ramazan.
- 5- Lejohet falja e namazeve nafile në xhami.⁸⁹
- 6- Namazi i teravive në ramazan është vepër e Pejgamberit (a.s.), që më pas e ndërpreu nga frika se mos i bëhej detyrë ymetit. Këtë sunet e ringjalli më pas Omeri (r.a.)⁹⁰

⁸⁷ Buhariu (5762) dhe Muslimi (781).

⁸⁸ Buhariut (6860) dhe Muslimi (781).

⁸⁹ Sherh Ennevevij ala Muslim (6/69).

⁹⁰ Shiko Fet’hul Bari li Ibn Haxher (3/14).

7- Nëse udhëheqësi apo komandanti bën një veprim në kundërshtim me atë që janë mësuar pasuesit e tij, duhet t'ua shpjegojë atyre arsyen, gjykimin, si dhe urtësinë e këtij veprimi, ashtu siç bëri Pejgamberi (a.s.).⁹¹

8- Këtu duket dhembshuria dhe mëshira e Pejgamberit (a.s.) për ymetin e tij, por edhe lehtësimi që bënte për ta - Allahu i dhëntë shpërblimet më të mira! Prijësit dhe njerëzit e mëdhej që kanë pasues në dije apo diçka tjetër, duhet të kenë model Pejgamberin (a.s.) në këtë aspekt.⁹²

9-Lejohet lënia e disa gjërave me interes për të shmangur të këqijat e mundshme, që mund të vijnë më pas. Gjithashtu, ndër dy gjëra të dobishme, duhet t'i japim përparësi asaj që ka më tepër vlerë, kur nuk mund të arrihen të dyja.⁹³

10- Kur namazet nafie falen me xhemat, si namazi i teravive, nuk thirret ezan apo ikamet.⁹⁴

11- Falja në shtëpi e namazeve nafie është më e mirë se falja e tyre në xhami, përveç namazeve që, sipas traditës profetike falen me xhemat si për shembull, namazi i kërimit të shiut dhe për teravitë, që më e mira është që të falen me xhemat.⁹⁵

12-AGJËRIMI SHLYEN GJYNAHET

Allahu i Lartësuar thotë: “Sigurisht, pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, ndërsa tek Allahu është shpërblimi i madh.” [Tegabun 15]. Po ashtu, në suren Enbija, ajeti 35: “Ne ju sprovovmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju në fund ktheheni tek Ne”. Ibn Abbasi (r.a.) shpjegon këtë ajet: “Ju sprovovmë me vështirësi dhe komoditet, shëndet dhe sëmundje, me pasuri dhe fukarallëk, me të lejuara dhe të ndaluara, me bindje dhe rënie në gjynahe, me udhëzim dhe humbje.”⁹⁶

⁹¹ Burimi i mësipërm (3/14) dhe Tarhut-tethrijb (3/90).

⁹² El fet'h (3/14).

⁹³ Sherhun Nevevi ala Muslim (6/69) dhe El Fet'h (3/14).

⁹⁴ Burimi i mësipërm (3/14) dhe Tarhut-tethrijb (3/90).

⁹⁵ Sherhun Nevevi ala Muslim (6/70) dhe Mirkatul Mefatijh (3/334).

⁹⁶ Tefsijr Ibn Kethijr (3/286).

Hudhejfja (r.a.) tregon se, njëherë, Omeri (r.a.) tha: “Kush mban mend ndonjë fjalë të Pejgamberit (a.s.) rreth sprovës?” - “Unë – tha Hudhejfja - e kam dëgjuar atë (a.s.) të thotë: “Sprovimin me rënie në gjynahe, për shkak të familjes, pasurisë ose fqinjëve e shlyen namazi, agjërimi dhe sadakaja.”⁹⁷

Ebu Hurejra (r.a.) përcjell nga Pejgamberi (a.s.): “Zoti i juaj ka thënë: “Për çdo punë të keqe (gjynah) ka shlyerje. Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të”.⁹⁸

Nga imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) vjen kështu ky hadith: “Çdo punë e mirë është shlyerje gjynahesh. Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të”.⁹⁹ Edhe në një transmetim tjetër qëndron: “Çdo punë e mirë është shlyerje gjynahesh, përveç agjërit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të”.¹⁰⁰

Përcillet nga Ebu Hurejra (r.a.) se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Pesë namazet, xhumaja deri në xhumanë e ardhshme, ramazani deri në ramazan, i shlyejnë gjynahet që bëhen mes tyre, nëse shmangen gjynahet e mëdha.”¹⁰¹

Nga Ebu Seid el Hudriu (r.a.) përcillet se ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s.) të thotë: “Kush e agjëron ramazanin dhe i njeh caqet e tij, të cilat nuk duhet t’i tejkalojë, dhe ruhet nga ato që i takon të ruhet (si: gënjeshtria, përgojimi e të tjera gjynahe), i fshihen gjynahet e mëparshme”.¹⁰²

Mësime dhe dispozita

1- Njeriu mund të vihet në provë me të mira dhe me të këqija. Të mirat që vijnë si provë mund të jenë: shtimi i pasurisë, sukseset e njëpasnjëshme etj. Të këqija janë problemet si mërzia, lodhja, sëmundjet etj.

2- Fëmijët dhe pasuria janë sprovë për njeriun, pasi ai mund të shkelë disa norma për shkak të tyre, dhe kështu ato bëhen shkak për dënimin e tij në botën tjetër. Allahu i Urtë ka caktuar

⁹⁷ Buhariu (1796) dhe Muslimi (144).

⁹⁸ Buhariu (7100) dhe Ahmedi (2/504).

⁹⁹ Ahmedi (2/457) dhe Tajalisi (2485).

¹⁰⁰ Sjellë nga Ibn Rahavejh (58) . El Hejthemi në Mexhmeuz-zevaid (3/179) pohon se e shënon edhe Ahmedi, duke shtuar se transmetuesit e tij janë të saktë. Edhe Ibn Haxheri e quan të saktë në Fet’h (4/109).

¹⁰¹ Muslimi (233).

¹⁰² Ahmedi (3/55), Ebu Je’ala (1058) dhe Bejhakui (4/304). Ibn Hibbani e vlerëson si të saktë (3433). [Hadithi është i dobët për shkak të një njeriu të panjohur në sened (Silsile daife: 5083)]

gjithashtu detyrime ndaj fëmijëve, për shembull, si edukimin apo kujdesin shëndetësor e financiar për ta. Nëse nuk i përmbush këto detyrime, atëherë është gjynaqar.¹⁰³

3- Gjynahet janë sprova. Kush bën një gjynah, në fakt, ka rënë në sprovë, dhe kjo mund të ndodhë edhe me njerëzit e mirë.¹⁰⁴ Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: “Ata që i frikësohen Allahut kur u vjen ndonjë mendim i lig nga shejtani, kujtojnë Atë, e atëherë shohin rrugën e drejtë.” [Araf 201]. Ose: “...Ata të cilët, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë padrejtësi vetes, kujtojnë Allahun dhe i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal grynahet përveç Allahut?! – dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet e tyre” [Al-Imran 135].

4- Kush bën një gjynah në mënyrë të vazhdueshme, duhet të shtojë veprat e mira, sepse, siç thotë Allahu i Lartësuar: “Veprat e mira i shlyejnë të këqijat” [Hud 114]. Ndoshta shtimi i veprave të mira bëhet shkak që të lirohesh nga robëria e gjynahut dhe që Zoti të të japë sukses për një pendim të pranuar.

5- Agjërimi fshin gjynahet. Në hadithin e Ebu Hurejres, që duket sikur e mohon këtë fakt, qëllimi është se: veprat e mira janë fshirje gjynahesh, përveç agjërit, i cili jo vetëm që fshin gjynahet, por edhe rrit shpërblimin. Fjala është për agjërimin që bëhet me sinqeritet për Allahun, larg syfaqësisë dhe formave të tjera të shirkut.¹⁰⁵

6- Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë!) shpjegon: “Nëse vetëm abdesi i fshin gjynahet, atëherë po namazi, çfarë fshin?! Nëse namazi vetëm i fshin gjynahet, atëherë po namazi me xhemat?! Po ramazani, agjërimi ditën e Arafatit dhe ditën e Ashures, po kur thua ‘Amin’ njëherësh me melekët pas leximit të Fatihës nga imami!’ pas Fatihës, më lutjen e melekëve?!”

Për të gjitha veprat e përmendura më lart kanë ardhur dëshmi se ato i fshijnë gjynahet. Dijetarët përgjigjen se, secila prej tyre shërben për fshirjen e gjynaheve. Nëse ka gjynahe të vogla, ato e fshijnë. Nëse nuk ka as gjynahe të vogla, as të mëdha, besimtarit i shkruhen si vepra të mira dhe ngrihet në grada. Nëse ka gjynahe të mëdha, shpresohet që veprat e mira mund ta lehtësojnë peshën e tyre”.¹⁰⁶

7- Cënimi i të drejtave të njeriut nuk falet me këto vepra, qoftë shkelja e të drejtës njerëzore gjynah i madh apo i vogël, por duhet së pari t’i shlyesh detyrimin tjetrit ose t’i kërkosht që të ta falë padrejtësinë që i ke bërë.¹⁰⁷

8- Hadithet tregojnë mirësinë e agjërit, që është shkak për faljen e gjynaheve.

¹⁰³ Shiko: Sherh Ennevevi ala Muslim (2/171).

¹⁰⁴ Ettemhijid i Ibn Abdulberr (17/ 394).

¹⁰⁵ Shiko: El Fet’h (4/111).

¹⁰⁶ Sherh En Nevevi (3/113) dhe Eddijbaxh ala Muslim (2/17).

¹⁰⁷ Shiko: Tenvijru Havalik (2/42) dhe Tuhfetul Ehvedhij (1/535).

9- Këto mirësi i përfiton ai i cili e ruan agjërimin e tij nga gjërat që e prishin atë, siç thotë hadithi: “Kush e agjëron ramazanin dhe i njeh caqet e tij dhe ruhet nga ato që i takon të ruhet, i fshihen gjynahet e mëparshme”. Për këtë arsye, muslimani duhet të ruhet ditën dhe natën nga përgojimet, thashethemet, shikimi në haramë, ndjekja e programeve televizive plot me haramë, qofshin ato seriale filmash apo shfaqje argëtuese, të cilat shtohen në muajin e ramazanit më shumë se në muajt e tjerë.

E lus Allahun e Madhëruar që të na udhëzojë të gjithëve tek e mira dhe e drejta!

13- KUPTIMI I “PERIT TË BARDHË” DHE “PERIT TË ZI”

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: “Hani e pini deri sa të dalloni perin e bardhë nga peri i zi në agim” [Bekare 187].

Nga Adi Ibn Hatimi (r.a.) përcillet se ka thënë: “Kur zbriti ajeti: “Hani e pini deri sa të dalloni perin e bardhë nga peri i zi” mora dy litarë, një të bardhë e një të zi, i vendosa nën jastëk dhe pastaj vazhdova t’i shikoja gjatë natës, por nuk dallova gjë. Në mëngjes shkova te Pejgamberi (a.s.) dhe i tregova çfarë më ndodhi. Ai më tha: “Ajete flet për errësirën e natës dhe bardhësinë e agimit.”¹⁰⁸

Mësime dhe dispozita

1- Përkujdesja e sahabëve për zbatimin e urdhëresave të Zotit dhe të Pejgamberit (a.s.). Sipas disa transmetimeve, Adiu (r.a.) ka thënë: “O i Dërguari i Allahut, kam kuptuar çdo porosi tënden, përveç çështjes së perit të bardhë dhe perit të zi. Kur rashë mbrëmë për të fjetur, mora dy penj dhe shikoja herë njërin, herë tjetrin.” Pejgamberi (a.s.) buzëqeshi dhe tha: “Ata janë peri i bardhë dhe peri i zi, që shfaqen në qiell.”¹⁰⁹ Siç shihet, interesi i Adiut që aq i madh, saqë mori dy penj nën jastëk.¹¹⁰

2- Vihet re mosteprimi i sahabëve në pyetje, përveç rasteve kur kishin paqartësi në çështje që kishin të bënin me ibadetin. Ata përpiqeshin shumë në kuptimin e ajeteve të Kuranit dhe kur

¹⁰⁸ Buhariu (1817) dhe Muslimi (1090).

¹⁰⁹ Ky transmetim është i Taberaniut në Elkebijr (17/79) nr (175).

¹¹⁰ Shiko El mufhim (3/148-15), ku Kurtubiu përmend se në fillim u shpall fjala e Allahut “Hani e pini deri sa të dalloni perin e bardhë nga peri i zi” dhe një vit më vonë u shpall togu sqarues “në agim”.

kishin diçka të paqartë, pyesnin Pejgamberin (a.s.). Kështu duhet të jetë çdo musliman: të pajtohet dhe të zbatojë tekstet fetare, të mos e teprojë me pyetje dhe të pyesë vetëm atëherë kur ka paqartësi me veprat e adhurimit.

3- Kuptimi i ajetit: “Hani e pini deri sa të dalloni perin e bardhë nga peri i zi” është që: Hani e pini, derisa të dalloni bardhësinë e ditës nga errësira e natës.¹¹¹

4- Për çështje problematike dhe të dyshimta duhet të pyesim dijetarët e rrënjësuar në dije.

5- Koha e agimit është pjesë e ditës dhe jo pjesë e natës.¹¹²

6- Koha e ngrënies dhe e pirjes në syfyr përfundon kur shfaqet agimi. Nëse e ndërpret ngrënien e pirjen në çastin kur hyn agimi, agjërimi është i plotë, dhe nëse e vazhdon qëllimisht të ushqyerit, agjërimi nuk vlen.¹¹³

14- ÇËSHTJA E GRAVE ME PERIODA NË RAMAZAN

Muadhe Bintu Abdullah el Adevijeh tregon: “Pyeta Aishen (r.a.): Përse gruaja që është me menstruacione e kompenson agjërimin, por nuk i kompenson namazet?” Ajo më tha: “*Haruriye* je ti?” – “Jo, nuk jam *haruriye*, por po pyes.” – “Kur na ndodhte kjo, ne urdhëroheshim që ta kompensonim agjërimin, por jo namazet.”¹¹⁴

Tek imam Tirmidhiu (r.a.) qëndron: “Muadhja e pyeti Aishen (r.a.): “A i kompenson gruaja namazet që i kalojnë në ditët e menstruacioneve?” Aishja i tha: “Mos je *haruriye* ti? Kur ishim me perioda, nuk urdhëroheshim t’i kompensonim namazet”.¹¹⁵

Aishja (r.a.) ka thënë: “Në kohën e Pejgamberit (a.s.), pasi kalonim ciklin e menstruacioneve dhe pastroheshim, ai na urdhëronte që ta kompensonim agjërimin, por jo namazet”. Këtë rrëfim e sjell Tirmidhiu, që thotë: “Dijetarët e kanë zbatuar këtë hadith dhe nuk dimë të ketë ndonjë diskutim mes tyre për çështjen e gruas, që, pasi pastrohet nga menstruacionet, e kompenson agjërimin, por nuk i kompenson namazet”.¹¹⁶

¹¹¹ Shiko: Tefsir Ibn Kethir (1/222) dhe Fet’hul Bari (4/134).

¹¹² Sherh Ennevevi ala Muslim (7/201) dhe Fet’hul Bari (4/134).

¹¹³ Shiko: Elfet’h (4/135).

¹¹⁴ Buhariu (315) dhe Muslimi (335).

¹¹⁵ Tirmidhiu (130).

¹¹⁶ Shënon Tirmidhiu dhe thotë se është hadith i mirë (787).

Pyetja e Aishes (r.a.): “*Haruriye* ti?” shprehte një lloj mosmiratimi për pyetjen që iu bë. Për sqarim, *haruriye* ishte një grup havarixhësh, që jetonin në qytetin Harura, afër Kufës. Ata shquheshin për ashpërsi dhe ekstremizëm fetar.¹¹⁷ Disa prej tyre e quanin të detyrueshëm për gruan kompensimin e namazeve që i kalonin gjatë ciklit menstrual, duke kundërshtuar hadithet e Profetit (a.s.) dhe unanimitetin e dijetarëve të umetit.¹¹⁸ Për këtë arsye e pyeti Aishja (r.a.) në atë mënyrë.

Mësime dhe dispozita

- 1- Ekstremizmi në fe është i ndaluar. Është e detyrueshme që t’u përmbahesh fort teksteve fetare, ashtu si edhe të pranohen lehtësimet që ka bërë Allahu për robërit e Tij. Shtrëngimi i tepërt është i papranueshëm, ashtu siç është edhe lirimi i tepërt. Rruga e mesme është e vetmja zgjidhje, dhe kjo arrihet me marrjen parasysh të të gjitha teksteve fetare.
- 2- Ligjshmëria e kundërshtimit të çdokujt që e ashpëron fenë. Kjo bëhet me një mënyrë të përshtatshme, e cila arrin qëllimin dhe nuk sjell dëme më të mëdha.
- 3- Nëse dijetari që pyetet mendon se i interesuari është provokues, nisur nga mënyra jo e mirë e drejtimit të pyetjes, atëherë i takon pyetësit që ta qartësojë pozicionin dhe qëllimin e vet, ashtu siç bëri Muadhja kur tha: “Nuk jam haruriye, por po pyes”. Më pas, edhe dijetari e ka detyrë që të përgjigjet qartë me argumentim, ashtu siç bëri Aishja (r.a.).
- 4- Baza kryesore ligjore që arsyeton dispozitat e Sheriatit janë urdhrat e Allahut dhe urdhrat e të Dërguarit të Tij. Kështu veproi edhe Aishja (r.a.) kur dha përgjigjen e saj. Po të kishte qenë kompensimi i namazeve i detyrueshëm, patjetër që Pejgamberi (a.s.) do t’i kishte urdhëruar ato që ta bënin, sepse ai ishte njeriu që nuk la asgjë pa shpjeguar dhe qartësuar për bashkësinë e tij.¹¹⁹ Kështu duhet të jetë muslimani: i dorëzuar tek Allahu i Lartësuar, respektues i Sheriatit, i kapur pas teksteve fetare të sakta dhe zbatues i tyre, edhe nëse ndonjëherë nuk e kupton urtësinë apo motivin.
- 5- Ibn Abdulberri thotë: “Dijetarët janë të gjithë të mendimit se gruaja nuk agjëron gjatë periudhës së ciklit menstrual, por e kompenson agjërimin më pas, ndërsa namazet nuk i kompenson. Nuk ka diskutim në asnjë nga këto çështje. Çështjet ku ka ixhma të muslimanëve janë hak. Kur ka qëndrim unanim të ymetit islam në një çështje, nuk mbetet më asnjë arsye për kundërshtim!”¹²⁰
- 6- Mosngarkimi i grave për të zëvendësuar namazet pas ciklit menstrual është një lehtësim i fesë dhe mëshirë e Allahut për to, sepse zëvendësimi i namazeve është vërtet vështirësi,

¹¹⁷ Shiko: Fet’hul Bari (1/422).

¹¹⁸ Shiko: Elmugni (1/188), Hashijetus-sindi ala sunen Ennesai (4/191) dhe Umdetul-karii (3/300).

¹¹⁹ Umdetul-karii (3/301).

¹²⁰ Ettemhijid (22/107).

për shkak se krijohet një numër namazesh i madh që do duhet të zëvendësohen. Gratë duhet ta falënderojnë Allahun e Lartësuar për këtë lehtësim.

- 7- Nëse gruaja pastrohet menjëherë pas hyrjes së agimit, agjërimi për atë ditë nuk është i rregullt, prandaj ajo duhet ta zëvendësojë atë ditë më vonë.
- 8- Nëse gruaja hyn në ciklin menstrual qoftë edhe një çast para perëndimit të diellit, agjërimi i asaj dite priset, prandaj ajo duhet ta zëvendësojë atë.¹²¹
- 9- Nëse gruaja fillon ciklin menstrual vetëm një çast pas perëndimit të diellit, agjërimi i asaj dite për të është i saktë.
- 10- Nëse gruaja ndien lëvizjen e gjakut të menstruacioneve ose dhimbjet e tij, ndërkohë që është me agjërim, por nuk del gjë prej saj para perëndimit të diellit, atëherë agjërimi i saj është i saktë.¹²²
- 11- Të sëmurit i lejohet të mos agjërojë, - edhe pse mund të ndihet disi i fuqishëm, - nëse agjërimi e dobëson më tepër apo druhet se mos i rëndohet sëmundja, sepse edhe gruaja me menstruacione mund të ketë fuqi të agjërojë, por gjakrrjedhja e shoqëruar me agjërim e dobëson së tepërmi atë.¹²³

15- TË SHTROSH IFTAR PËR AGJËRUESIN

Zejd Ibn Halid el Xuheni përcjell se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush i jep ushqim për të çelur një agjëruesi, merr të njëjtin shpërblim si agjëruesi, pa e cenuar shpërblimin e agjëruetit”. Tirmidhiu thotë se hadithi është i mirë e i saktë.¹²⁴

Një transmetim tjetër: “Kush i jep ushqim dhe pije një për të çelur agjëruesi, ka të njëjtin shpërblim me të, pa e zvogëluar shpërblimin e agjëruetit”.¹²⁵

Kur Ebu Hurejrën (r.a.) e ftoi një e afërme për iftar, ai i tha: “Po të tregoj se, sa herë që dikush ha iftar tek një familje, ajo familje merr të njëjtin shpërblim me atë të tij.” – “Do të kisha dëshirë – tha gruaja - të vijë prapë tek ne”. – “Dua ta bëj këtë për familjen time”.¹²⁶

¹²¹ Fetvatë e komisionit të përhershëm (15/155) fetvaja nr (10343).

¹²² Kjo fetva është e Ibn Uthejmin. Shiko: Fetava xhamia lilmereti elmuslimeh (1/325).

¹²³ Sherh Ibn Battal ala Elbuhari (4/97-98).

¹²⁴ Tirmidhiu (807), Ibn Maxheh (1746) dhe Nesaiu në librin elkubra (3331-3330) . Ibn Huzejmeh (2064) dhe Ibn Hibbani (3429) e quajnë të saktë. Por është transmetuar dhe si fjalë e Aishes tek Nesaiu në Elkubra (3332) dhe gjithashtu si fjalë e Ebi Hurejrës tek Abdurrezaku (7906).

¹²⁵ Ky është transmetimi i Abdurrezakut (7905) dhe i Taberaniut në librin Elkebijr (5/256) me nr (5269).

¹²⁶ Abdurrezaku në musannef (7908).

Mësime dhe dispozita:

- 1- Është bujaria e Allahut të Lartësuar që ka hapur rrugët e mirësisë dhe të shpërblimit. E tillë është nxitja për bamirësi dhe vendosja e shpërblimeve të mëdha për këtë vepër.¹²⁷
- 2- Këtu tregohet mirësia e ofrimit të iftarit. Kush ushqen një agjërues, ka të njëjtin shpërblim me agjëruesin.
- 3- Allahu i Lartmadhëruar i jep shpërblim nga Vetja e Vet atij që ushqen agjëruesin, dhe jo nga shpërblimi i agjëruesit. Ky është një nga treguesit e bujarisë së Allahut.¹²⁸
- 4- Është i pëlqyeshëm pranimi i ftesës për iftar. Refuzimi i kësaj ftese nga frika se mos bie në haram apo se mos pakësohet shpërblimi është diçka e tepruar, sepse agjëruesit nuk i pakësohet shpërblimi kur ha iftar tek një tjetër. Refuzimi është i arësyeshem kur personi është i pasur ndërsa ftesa është vetëm për fukarenjtë.
- 5- Mësojmë për mirësjelljen ndaj të afërmeve dhe familjarëve, duke pranuar ftesën për iftar, me qëllim që ata të marrin shpërblimin e shtrimit të iftarit për agjëruesit, siç bëri Ebu Hurejra (r.a.).
- 6- Qëllimi i ofruesit të iftarit duhet të jetë arritja e shpërblimit të kësaj vepre, si dhe nderimi i vëllait musliman, sidomos nëse agjëruesi është i varfër.
- 7- Iftarin mund ta shtrosh në shtëpinë tënde dhe ta ftosh agjëruesin, ose mund t'ia dërgosh atij, ose mund t'ia bleshë ushqimin. Nga ana tjetër, duhet të kemi kujdes nga shpërdorimi, sidomos që sofrat e iftarit në kohën tonë janë bërë të shumta.
- 8- Nëse dikush i jep një të varfri të holla që të blejë ushqim, ndërsa i varfri blen me disa prej tyre ushqim dhe një pjesë e ruan për nevojat e tij, dhuruesin e përfshijnë hadithet që flasin për mirësinë e shtrimit të iftarit për agjëruesit¹²⁹.

¹²⁷ Shiko: Aridatul Ehvedhij (4/21).

¹²⁸ Shiko: Fejd elkadijr (6/187).

¹²⁹ [Disa këshilla që lidhen me etikën dhe rregullat e iftarit , pjesmarrjen në iftarin e shtruar nga ai që nuk agjëron, pjesmarrjen në iftarin e shtruar nga një kafir dhe pjesmarrjen në iftarin e shtruar nga një qeveritar. Këto këshilla janë për ata që shtrojnë iftare në ramazan dhe për ata që marrin pjesë në iftar: **1.** Ushqimi duhet të jepet për hirë të Allahut, dhe jo për të shitur mend, për mburrje apo për të konkurruar të tjerët. Ikrimë thotë: Ibn Abbasi radijallahu anhu ka thënë: “Pejgamberi alejhi ssalatu vesselam e ka ndaluar ngrënien e ushqimit të atyre që konkurojnë njëri- tjetrin”. Shënon: Ebu Daudi. Pra, Pejgamberi e ka ndaluar përgatitjen e ushqimit për krenim dhe syfaqësi, në konkurrencë me të tjerët. Arsyeja e ndalimit të ngrënies së këtij ushqimi është se ai përgatitet për mburrje dhe syfaqësi. Përderisa ndalohet përgatitja e ushqimit me një qëllim të tillë, atëherë edhe pjesmarrja në këtë ushqim është e ndaluar. **2.** Shtruesit e iftarit duhet të bëjnë kujdes të mos shpërdorohet ushqimi, të mos shkojë dëm aspak ushqim, sepse shpërdorimi është i ndaluar. Është e mira të mos tepruhet me llojet e ushqimeve. Në shumë iftare vihet re shpërdorimi i ushqimit të tepërt dhe llojshmëri të tepërt të ushqimeve. **3.** Agjëruesit nuk duhet ta teprjnë me ngrënie, sepse ushqimi i tepërt bën të mos e arrijnë qëllimin e agjërimit, që është devotshmëria (tekvaja) ndaj Allahut. Përveç kësaj, i bën edhe të plogët për kryerjen e ibadetit. **4.** Ai që shtron iftare për bamirësi bën mirë të ftojë njerëzit që kanë nevojë për ushqim. Njeriu merr shpërblimin e përmendur në hadith edhe kur shtron iftare për njerëz jonevojtarë, porse dobia dhe shpërblimi i ushqimit të të varfërve është më i madh. Po kështu do të ishte e mira që në iftare të ftojmë njerëzit fillestarë në Islam dhe njerëzit që në vendin tonë agjërojnë, por nuk falen, me qëllim që të ftojmë zemrat e tyre dhe që të forcohen në Islam. Dihet që Pejgamberi

alejhissalatu vesselam u jepte pasuri disa njerëzve për të fituar zemrat e tyre dhe për t'i shpëtuar nga zjarri. **5.** Muslimanit nuk i lejohet të lypë ushqim apo të kërkojë pjesmarrjen në iftarë vetëm se në rastin kur nuk ka ushqim. Por edhe në rastin kur ka ushqim më e mira është të mos u lypë ushqim njerëzve dhe të mos kërkojë pjesmarrjen në iftarë. Hakim Ibn Hizam tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Dora e lartë (dora dhënëse) është më e mirë sesa dora e poshtme (dora marrëse). Filloje me shpenzimin për ata që i ke në varësi (familjen). Sadakaja më e mirë është ajo që e jep mbasi ke plotësuar nevojat e tua. Kush ruhet nga lypja, Allahu do ta bëjë të dëlirë dhe me nderë. Kush tregon se nuk ka nevojë për pasuritë e njerëzve, Allahu do t'i japë aq sa të mos ketë nevojë për njerëzit”. Shënojnë Buhariu dhe Muslimi. **6.** Kur të fton dikush për iftarë, bën mirë që ta ftosh edhe ti. Kur dikush të bën mirë, duhet ti bësh mirë. Kur dikush të jep, bën mirë që ta shpërblesh. Kur dikush të bën një dhurarë, bën mirë ta shpërblesh me një dhuratë edhe më të mirë. Besimtari musliman, kur ka mundësi, nuk duhet të jetë vetëm dora e poshtme (marrëse), por duhet të jetë edhe dora e lartë (dhënëse). Ky është virtyti i krenarisë, dinjitetit, dëlirësisë dhe bujarisë që duhet të gëzojë muslimani. **7.** Ka raste që iftaret i shtrajnë njerëz që nuk agjërojnë, kështu që këtu agjëruetit duhet të kenë parasyshë disa gjëra: a - duhet të bëjmë kujdes se mos mendon ai që shtron iftarin, por nuk agjëron, se në këtë mënyrë e ka plotësuar detyrën!! Nëse shtruesi i iftarit ecën me këtë ide, nuk duhet të pranohet ftesa e tij. b - duhet që shtrimi i iftarit në këtë rast të mos prekë dinjitetin, dëlirësinë dhe krenarinë e muslimanit, nëse mendon shtruesi i iftarit se është më i mirë se muslimanët, se po u bën nder muslimanëve apo se po plotëson nevojat e muslimanëve nevojtarë. Kjo gjë mund të mënjanohet veçse duke e ftuar për ushqim ashtu siç të fton, ose duke e shpërblyer në mënyrë të barabarta apo edhe më mirë. c - duhet të bëjmë kujdes se mos e ka të gjithë pasurinë haram. Ndërsa në rastin kur shtruesi i iftarit e ka pasurinë të përzier me halla e me haram, ose nuk dihet se si e ka, nuk ka gjë t'i përgjigjesh ftesës së tij, sepse Pejgamberi i është përgjigjur ftesës së kafirave. **8.** Ka raste që ndonjë kafir shtron iftarë për agjëruetit. Në këtë rast, përveç atyre që u përmendën në pikën e shtatë, duhet të respektojmë edhe hadithin: “Islami ngrihet lart dhe nuk ka ngritje mbi të”. Shënojnë Dare Kutni dhe Bejhakiu. Kështu që nëse na fton një kafir për ushqim iftari, lejohet ti përgjigjemi ftesës, por duhet të kemi parasyshë ato që u përmendën në pikën e shtatë. **9.** Ka raste që edhe qeveritarët shtrajnë iftare. Prandaj, në lidhje me pranimin e ftesës së tyre duhet të sqaroj disa gjëra: a - Nëse ka haramë, nuk lejohet pjesmarrja. b - Qeveritarët mund ta shfrytëzojnë shtrimin e iftarit për qëllime të këqija, e nëse është kështu nuk lejohet pjesmarrja, sepse ju shërben qëllimeve të tyre. Nga qëllimet e këqija është, përshembull, nxitja e frymës së afritit mes feve, dhe eliminimi i ballafaqimit mes fesë së vërtetë dhe mes feve të pavërteta, mes të vërtetës dhe të kotës. Një qëllim tjetër i keq është përdorimi i shtrimit të iftarit nga qeveritari për mashtrimin e njerëzve për të mbajtur pushtetin ose për ta marrë atë, ndërkohë që mund të ketë grupe të tjera që qeverisin më mirë se sa ky. c - Pjesmarrja në iftaret që shtrajnë qeveritarët mund të ketë edhe problemet që përmenden në pikën e shtatë dhe të tetë. d - Parimisht, nuk lejohet pjesmarrja në iftaret e shtruara prej tyre. Ebu Hurejra thotë: Pejgamberi ka thënë: “Kush shkon tek dyert e sultanit sprovohet¹²⁹. Sa më shumë që robi të afrohet nga sultani aq më shumë largohet nga Allahu¹²⁹”. Trasmeton: Ahmed. e - Por bën përjashtim rasti kur ndonjëri është i fortë në fe, i njeh mirë interesat e muslimanëve dhe merr pjesë për mbrojtjen e interesave të muslimanëve e jo të interesave vetjake, merr pjesë në shërbim të qëllimeve të islamit e jo në shërbim të qëllimeve të këqija të qeveritarëve. Megjithëse ky përjashtim qëndron, shumica e atyre që hyjnë në kuvendet e qeveritarëve apo ulen në sofrën e tyre janë të dobët në fe, ose nuk i njohin mirë interesat e islamit, ose mbrojnë interesat vetjake, ose me vetëdije apo pa vetëdije u shërbejnë qëllimeve të tyre të këqija. Prandaj, këshilla për muslimanët në përgjithësi është të qëndrojnë larg kuvendit dhe sofrës së njeriut me pushtet.]

16- VLERA E UMRES NË RAMAZAN

Ibn Abbasi (r.a.) tregon: “Kur u kthye Pejgamberi (a.s.) nga haxhi, i tha Ummu Sinan el Ensarijes: “Pse nuk e bërë haxhin?” Ajo i tha: “Burri im kishte dy deve, të cilat i përdorte për vaditje. Me njëren prej tyre bëri haxhin, kurse tjetra ngeli për të bërë vaditjen e tokës.” Atëherë, Pejgamberi (a.s.) tha: “Umreja në ramazan është sikur të kryesh një haxh me mua”.¹³⁰

Po te Buhariu dhe Muslimi është hadithi: “Kur të vijë ramazani, bëj umre, sepse umreja në ramazan ka vlerën e një haxhi”.¹³¹

Pejgamberi (a.s.) i ka thënë Ummu Meakil (r.a.): ‘Bëj umre në ramazan, sepse ajo është si haxhi’.¹³² Po kështu vjen hadithi nga Xhabiri, Enesi, Ebu Hurejra dhe Vehb Ibn Hanbeshi (r.a.).¹³³

Ibn Battali (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë se Pejgamberi (a.s.) fliste për haxhin vullnetar, sepse dijetarët e umetit pajtohen se umreja nuk e shlyen haxhin e detyrueshëm. Ndërsa hadithi: “Bëj umre në ramazan, sepse ajo është si haxhi”, ka qëllim shpërblimin e haxhit. Allahu ia jep mirësitë atij që Ai do.¹³⁴

Mësimet dhe dispozitat:

- 1- Këtu duket mëshira dhe mirësia e Allahut, që ka caktuar shpërblime kaq të mëdha për punë të vogla. E falënderojmë Allahun për këtë.
- 2- Në hadithe tregohet kujdesi dhe interesimi i Pejgamberit (a.s.) për popullin e tij. Pejgamberi (a.s.) ishte njeriu që ka këshilluar me çiltërsi njerëzit më shumë se çdokush tjetër. Nga kjo rrjedh se çdokush që Allahu i ka lënë në kujdestari ndonjë grup njerëzish, ka detyrë që të jetë i butë me ta, t’i trajtojë me dashamirësi dhe çiltërsi, të interesohet për çështjet e tyre dhe të punojë për të realizuar interesat e tyre fetare dhe sociale.
- 3- Umreja në ramazan nuk e shlyen haxhin e detyrueshëm, nuk zë vendin e tij, por ka shpërblim sa një haxh. Dijetarët kanë qëndrim unanimit për këtë.¹³⁵
- 4- Shpërblimi i punës shtohet në bazë të vlerës së kohës, siç shtohet me sinqeritetin dhe përkushtimin.¹³⁶

¹³⁰ Buhariu (1764) dhe Muslimi (1256).

¹³¹ Ky është transmetimi i Buhariut (1690) dhe i Muslimit (1256).

¹³² Ebu Davudi (1989), Nesaiu në librin elkubra (4226) dhe Tirmidhiu. Ky i fundit thotë se hadithi është hasen garib (939). Ibn Huzejme (3075) e quan të saktë. Hakimi ka thënë se hadithi plotëson kushtin e Muslimit (1/656).

¹³³ Tirmidhiu (3/276).

¹³⁴ Sherh Ibn Batta (1 4/428) dhe Minhatul Bari (4/233).

¹³⁵ Fethul Bari i Ibn Haxherit (3/604) dhe Tuhfetul ehvedhij (4/361).

¹³⁶ Fethul Bari (3/604), Avnul Meabud (5/323) dhe Fejd el Kadijr (4/361).

- 5- Si ky hadith ka edhe të tjerë, si për shembull: “Surja “Kul huu’allahu ehad” vlen sa një e treta e Kuranit”. Domethënë, ka të njëjtin shpërblim, por nuk zë vendin e leximit të Kuranit.¹³⁷
- 6- Umreja në ramazan arrin shkallën e haxhit, për arsye se ramazani është muaj madhështor. Shenjtëria e muajit ramazan bashkohet me shenjtërinë e umres dhe vendit ku ajo kryhet. Vlera e kohës dhe vendit të umres është konsideruar e barabartë me vlerën e kohës së haxhit (muajve të haxhit) dhe vendit të tij¹³⁸. Përveç kësaj, vështirësia dhe lodhja që ka umreja në ramazan, kur je me agjërim, - apo edhe kur nuk je me agjërim, për arsye të udhëtimit. Pejgamberi (a.s.) i ka thënë Aishes (r.a.), pasi e ka urdhëruar të bëjë umre: “Ajo (Umrja) vlerësohet në bazë të lodhjes tënde”, ose: “...sipas masës së shpenzimeve të tua.”¹³⁹
- 7- Këtë mirësi e përfiton kushdo që kryen ritet e umres në ramazan, edhe nëse nuk qëndron në Mekë, por largohet menjëherë mbas kryerjes së umres.
- 8- Nga këto hadithe nuk duhet të kuptohet që duhet të bësh sa më tepër umre brenda një ramazani, duke dalë nga zona e shenjtë (harem) në zonën jo të shenjtë e duke bërë kështu më shumë se një umre në të njëjtin muaj. Kjo vepër, e cila është përhapur shumë këto kohë, është në kundërshtim me traditën e Profetit (a.s.) dhe të sahabëve, sepse nuk ka dëshmi që ndonjëri prej tyre të ketë bërë më shumë se një umre brenda një muaji apo në një vajtje atje.¹⁴⁰
- 9- Ai i cili vendos të qëndrojë pranë Shtëpisë së Shenjtë të Zotit (Qabesë) në ramazan ose në dhjetëditëshin e fundit të tij, e ka detyrë të ruhet më fort nga harami, sepse e keqja në atë vend është më e madhe se në vendet e tjera. Po kur shtohet këtu edhe shenjtëria e ramazanit?!
- 10- Ai që merr me vete familjen dhe fëmijët për të qëndruar në Vendin e Shenjtë në ramazan duhet të ketë kujdes që edhe ata të mos bien në harame, se ndryshe mund marrin më shumë gjynahe se shpërblime.
- 11- Nëse bën ihram (nijetin) për të bërë umre dhe arrin në Mekë ndërkohë që je me agjërim, dhe duhet që të zgjedhësh: ose të ndërpresësh agjërimin dhe të kryesh umren, ose të presësh derisa të perëndojë dielli, pastaj ta kryesh umren, më e mira është të ndërpresësh agjërimin gjatë ditës dhe ta kryesh umren, sepse më e mira është ta kryesh umren sapo të arrish në Mekë, ashtu siç ka vepruar Pejgamberi (a.s.).

17- VLERA E SYFYRIT (1)

¹³⁷ Tirmidhiu në librin el Xhamiu nga Is’hak ibn Rahuvejh (3/276).

¹³⁸ Shiko: Mexhmu-ulfetava (26/293).

¹³⁹ Muslimi nga Aishe r.anha (1211) . Shiko: El Mufhim (3/370).

¹⁴⁰ Shiko: Mexhmu-Ul Fetava (26/292), Zadul mead (2/93) dhe Tehdhijb essunen (7/36).

Ebu Seid el Hudriu (r.a.) rrëfen se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Ushqimi që hahet në syfyr është bereqet (i begatë), prandaj mos e lini atë, qoftë edhe duke pirë veç një gllënjë ujë, se ata që hanë syfyr i lavdëron Allahu, kurse melekët kërkojnë falje për ta.”¹⁴¹

Abdullah el Harithi (r.a.) përcjell nga një sahab se, njëherë, një burrë hyri te Profeti (a.s.) dhe e gjeti duke ngrënë syfyr. Profeti (a.s.) i tha: “Ushqimi i syfyrin është begati që jua ka dhënë Allahu, prandaj mos e lini atë”.¹⁴²

Ebu Suvejdi, një nga sahabët, tregon se Pejgamberi (a.s.) është lutur: “O Allah, mëshiroji ata që hanë syfyr!”. Ubade Ibn Nesij rrëfen: “Më herët thuhej: ‘Ha syfyr, qoftë edhe vetëm ujë, sepse kanë thënë që është i bekuar’”.¹⁴³

Ibn Omeri (r.a.) tregon se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu i mëshiron dhe melekët kërkojnë falje për ata që hanë syfyr”.¹⁴⁴

Gjithashtu, Ebu Hurejra (r.a.) tregon se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Sa ushqim i mirë për syfyr është hurma e arabisë”.¹⁴⁵

Mësime dhe dispozita:

- 1- Mësojmë për vlerën e ushqimit të syfyrin, si bekim dhe lehtësim nga Allahu, të Cilin e falënderojmë për këtë.
- 2- Nga bereqeti i syfyrin është dhe fakti se Allahu dhe melekët çojnë salavate mbi ata që hanë syfyr. Salavati nga Allahu për ata që hanë syfyrë është mëshira që bën për ta, kënaqësia e Tij prej veprës së tyre dhe lavdërimi i tyre, ndërsa salavati i melekëve është kërkimi i faljes për ta.¹⁴⁶
- 3- Pejgamberi (a.s.) e ka ndaluar lënien e syfyrin, dhe kjo tregon rëndësinë e tij.
- 4- Syfyri mund të quhet duke ngrënë diçka, sado e vogël qoftë, madje edhe një gllënjë ujë, ashtu siç përmendet në hadithe.

¹⁴¹ Ahmedi (3/12). Sujuti në Xhamius-sagijr (4801) e quan të saktë. Albani e ka vlerësuar si hadith të mirë në Sahijh Xhami (3683).

¹⁴² Ahmedi (5/370) dhe Nesaiu (4/154). Albani e vlerëson hadith të saktë në Sahih Xhami (1636).

¹⁴³ Bezari (974), Ibn Ebi Asin në el ahad vel methane (2758), sipas të cilit është marrë dhe teksti i hadithit, por edhe Taberaniu në Elkebijr (22/337) me numër (845). Ibn Haxheri e quan hadith të mirë në Muhteser zzevaïd musned ElBezar (691).

¹⁴⁴ Ebu Nuejmi në Elhiljeh (8/320). Ibn Hibani (3467) e vlerëson të saktë. Po kështë edhe Albani e quan hadith të mirë në Sahijh Xhami (1844) dhe në Essahijhah (1654).

¹⁴⁵ Ebu Davudi (2345) dhe Bejhekiu (4/236). Ibn Hibani (3475) e quan të saktë, por edhe Albani në Sahijh Ebu Davud.

¹⁴⁶ Shiko: Sherhu kasijde Ibn Kajjim (20), Fet’hul Bari i Ibn Haxherit (11/156) dhe Fejd ElKadij (3/137).

- 5- Ushqimi më i mirë në syfyr janë hurmat e arabisë, sepse Pejgamberi (a.s.) i ka lavdëruar ato.
- 6- Çdo musliman duhet të kujdeset ta ruajë këtë traditë profetike, duke ngrënë syfyr, qoftë edhe diçka të vogël.

18- VLERA E SYFYRIT (2)

Nga Enesi Ibn Maliku (r.a.) përcillet se Profeti (a.s.) ka thënë: “Hani syfyr, se me të vërtetë syfyri ka bereqet”.¹⁴⁷

Amru Ibn el Asi tregon se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Dallimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ithtarëve të Librit është vakti i syfyrit.”¹⁴⁸

Irbad Ibn Sarijeh rrëfen: “Më ftoi njëherë Pejgamberi (a.s.) për të ngrënë ushqim syfyri në ramazan, duke më thënë: “Eja në një mëngjes të begatshëm!”.¹⁴⁹

Mikdam Ibn Meadijkerib përcjell se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Hani vaktin e syfyrit, se ai është me të vërtetë ushqim i begatshëm”.¹⁵⁰

Kuptimi është që ta mos e lëmë asnjëherë pa ngrënë vaktin e syfyrit.

Në hadithin e mësipërm është përdorur fjala arabe *Es-sehur*, në gjuhën shqipe *syfyri* që nënkupton ushqimin e përgatitur për atë vakt. Gjithashtu po kjo fjalë arabe duke marrë një formë tjetër si *Es-suhur*, nënkupton veprimin e ngrënies në kohën e syfyrit. Kjo formë rrjedh nga fjala *es-sehar* që tregon pjesën e fundit të natës.¹⁵¹

Bereqeti (begatia) është ekzistenca e hajrit të krijuar nga Allahu në diçka me bollëk dhe vazhdimësi; mirësi pas mirësie.¹⁵²

Për hadithin: “Eja në një mëngjes të begatshëm”, Hattabi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Është quajtur ‘mëngjes’, sepse ky vakt e forcon agjëruetin, njëlloj sikur të kishte ngrënë mëngjes.”¹⁵³

Mësime dhe dispozita

¹⁴⁷ Buhariu (1823) dhe Muslimi (1095). Këtë hadith e kanë transmetuar disa shokë të Pejgamberit a.s. : Ebu Hurejra, Ebu Seidi, Ibn Mesudi, Xhabiri, Aishja, Amru Ibn Elasi, Irbadi, Ebu Lejla, Talku dhe Eljeijshu Ibn Talk, poashtu e transmeton dhe Omeri, Utbe Ibn Abd, Ebu Derda dhe Selmani r.anhum. Shiko: Shpjegimin e Ibn Mulekkan mbi Umden (5/189) dhe Mexhmuuz-zevaid (3/154).

¹⁴⁸ Muslimi (196).

¹⁴⁹ Ahmedi (4/126), Ebu Davudi (2344) dhe Nesaiu (4/154). Ibn Huzejme (1938), Ibn Hibani (3465) dhe Albani në Sahijh Ebu Davud e quajnë të saktë.

¹⁵⁰ Nesaiu (4/164) dhe Ahmedi (4/142). Albani e quan të saktë në Sahijh Ennesai.

¹⁵¹ Shiko:Fet’hul Bari të Ibn Haxherit (4/140) dhe Tevdijhul Ehkam (3/155).

¹⁵² Shiko: Elmufredat lirr-rragib (44), Tefsirin e Kurtubiut (4/139) dhe Bedaiul kavaid (2/182-183).

¹⁵³ Shiko: Mealimus-unen bihamish Ebi Davud (2/758) dhe Avnul Meabud (6/337).

- 1- Mësojmë se në syfyr zbret bekimi i Zotit. Allahu bekon atë që dëshiron, dhe një prej tyre është syfyri.
- 2- Dijetarët kanë qëndrim unanim se ngrënia e syfyrit është e pëlqyeshme, jo e detyrueshme. Gjithashtu, syfyri është një veçori e këtij umeti në agjërim.¹⁵⁴
- 3- Disa nga begatitë e syfyrit janë:
 - a- Respektimi i normave të fesë, sepse Pejgamberi (a.s.) ka urdhëruar për ngrënien e syfyrit. Bindja ndaj Pejgamberit (a.s.) jep dobi për këtë jetë dhe tjetrën.¹⁵⁵
 - b- Me ngrënien e syfyrit bëhet dallim me ithtarët e Librit, sepse ata nuk hanë syfyr.¹⁵⁶ Dallimi me ta është një nga bazat kryesore të fesë sonë, prandaj është ndaluar përngjasimi me ta në simbolet e tyre në fe, zakone apo moral.
 - c- Ngrënia e syfyrit jep forcë për të agjëruar dhe për bindje ndaj Zotit gjatë ditës. Po ashtu, ajo largon sjelljen e keqe, që vjen si rezultat i urisë dhe etjes.¹⁵⁷
 - d- Kush çohet për syfyr ka mundësi t'i kërkojë falje Zotit të Lartësuar, ose ta përmendë Atë, ose t'i lutet Atij, meqënëse është kohë kur shpresohet pranimi i lutjeve. Kjo është e përealizueshme nëse fle gjumë në këtë kohë. Allahu i ka lavdëruar ata të cilët i kërkojnë falje Atij natën.
 - e- Ai që çohet për syfyr do ta falë namazin e sabahut në kohë dhe me xhemat. Ndoshta shkon herët në xhami dhe merr shpërblimin e faljes në rresht të parë dhe afër imamet, duke shtuar edhe shpërblimin e përsëritjes së ezanit dhe faljen e suneteve para farzit. Ndër sunetet më të forta janë dy rekatet sunet të sabahut, siç është përcjellë në një hadith: “Sunetet e sabahut janë më të mirë se dynjaja dhe çfarë ka në të”.
 - f- Kush çohet për syfyr i bëhet e mundur të japë sadaka një pjesë të ushqimit të tij atij që ia lyp, ose të hajë ushqim bashkë me nevojtarin, duke marrë shpërblimin e tij dhe shpërblimin e ushqyerjes së lypsit a nevojtarit.¹⁵⁸
 - g- Në syfyr falënderohet Zoti i Lartmadhërishëm për mirësitë që na ka dhënë. Një prej këtyre mirësive është lehtësimi dhe lejimi i agjëruarit të hajë ushqim që prej perëndimit të diellit e deri në agim, gjë që më parë pati qenë e ndaluar.¹⁵⁹

¹⁵⁴ Shiko: Shpjegimin e Ibn Mulekin mbi Umden (5/188) dhe Dhehijretu ukba (20/366).

¹⁵⁵ Shiko: Fethul Bari (4/140) dhe Tevdijhul ehkam (3/ 155).

¹⁵⁶ Dy burimet e mësipërme dhe shpjegimi i Neveviut mbi Muslimin (7/207).

¹⁵⁷ Shiko: Fet'hul Bari (4/140)

¹⁵⁸ Shiko burimin e mësipërm (4/140)

¹⁵⁹ Shiko: Avnul Meabud (6/336).

- 4- Muslimani nuk duhet ta neglizhojë këtë traditë të bukur, meqenëse Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Mos e lini atë”, dhe me njetin e mirë në vëmendje të shpresojë shpërblimin për këtë, në mënyrë që syfyri të mos i bëhet thjesht një zakon.¹⁶⁰
- 5- Mësojmë mbi pëlqyeshmërinë e ftesës së të tjerëve për syfyr si dhe të pranimi të saj, sepse Pejgamberi (a.s.) ftoi Irbad Ibn Sarijeh për të ngrënë syfyr bashkë me të. E pëlqyeshme është edhe mbledhja për të ngrënë së bashku, sepse është një variant tjetër hadithi: “Ejani të hamë bashkë ushqim të bekuar.”¹⁶¹
- 6- Hattabi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Këtu shihet se kjo fe është me lehtësime dhe pa vështirësi. Ndryshe ishin rregullat fetarë të ithtarëve të librit të cilët, nëse i zinte gjumi pas iftarit, nuk u lejohej të konsumonin përsëri ushqim dhe pije deri në agim. Allahu bëri lehtësim për ne me fjalën: **“...dhe hani e pini derisa të dalloni qartë perin e bardhë (bardhësinë) të agimit nga peri i zi (errësira)”**. [el Bekare: 187]”. E falënderojmë Allahun shumë për mirësitë që na ka dhënë, të cilat nuk mund të numërohen.

19- KOHA E NGRËNIES SË SYFYRIT

Ibn Mesudi (r.a.) tregon se Profeti (a.s.) ka thënë: “Mos e ndërprisni syfyrin prej ezanit të Bilalit.” Ose: “Ai e thërret ezanin, me qëllim që të kthehet ai që është duke falur namaz nate, dhe që të zgjojë atë që është duke fjetur. Agimi nuk është të themi kështu – Jahja Ibn Sejjd mbledhi shuplakat e duarve - derisa të thotë kështu – dhe Jahja shtriu dy gishtat tregues (horizontalisht)”.¹⁶² Sehl Ibn Seadi (r.a.) rrëfen: “Haja syfyr me familjen time, pastaj shpejtoja që ta arrija namazin e sabahut me Pejgamberin (a.s.).”

¹⁶⁰ Shiko: Tevdijhul ehkam (3/156) . Urdhëri këtu nuk bën fjalë për obligueshmëri, sepse ka hadithe të tjera të cilat tregojnë se Pejgamberi a.s e ka agjëruar pandërprerë, duke mos e prishur farë agjërimit gjatë natës, bashkë me shokët e tij. Sikur të kishte qënë syfyri i obligueshëm, ata nuk do të kishin agjëruar pandërprerë (duke lidhur ditën me ditën tjetër pa çelur natën). Për më gjerë shiko dhe “Dhehijretul ukba (20/366)”.

¹⁶¹ Shënon Nesaiu nga Irbadi r.a. (4/145). Albani e vlerëson të saktë në Sahijh Ennesai.

¹⁶² Buhariu (6820) dhe Muslimi (1039). [Sipas një varianti tjetër hadithi është kështu: “Drita e agimit të vërtetë nuk është ajo që shfaqet kështu (duke treguar me shenjë i mbledhi gishtërinjtë e pastaj i ktheu poshtë nga toka), por ai që shfaqet kështu (vendosi njërin gisht tregues mbi tjetrin dhe i hapi duart horizontalisht).” Domethënë, agimi i vërtetë është ai që shfaqet për së gjerë në vijën horizontale dhe jo ai që shfaqet vertikalisht (nga lart poshtë). Në këtë hadith Pejgamberi a.s. ka treguar me shenjë agimin e rremë dhe agimin e vërtetë. Drita e agimit të rremë shfaqet vertikalisht në qiell, nga lart poshtë, si bishti i ujkut, kurse drita e agimit të vërtetë shfaqet dhe përhapet fort në vijën horizontale.]

Te Buhariu qëndron: “Pastaj shpejtoja që të arrija sexhden me Pejgamberin (a.s.)”¹⁶³

Zirr Ibn Huvejsh (Allahu e mëshiroftë!) tregon: “Hëngra syfyr me Hudhejfen (r.a.) e pastaj dolëm për namaz. Kur arritëm në xhami, falëm dy rekatë (sunete). Pastaj u thirr ikameti për farzin. Mes tyre ishte një kohë shumë e shkurtër.”¹⁶⁴

Kuptimi i hadithit: “Ai e thërret ezanin, me qëllim që të kthehet ai që është duke falur namaz nate...” është: Bilali e thërret ezanin natën, që t’iu tregojë juve se agimi nuk është larg, e kështu ta kthejë atë që është duke falur namaz nate, që të pushojë ose të flejë pak, që të zgjohet i zellshëm, ose të falë vitrin nëse nuk e ka falur, ose të përgatitet për namazin e sabahut, nëse ka nevojë për pastrim, ose ndonjë gjë tjetër.¹⁶⁵

Ndërsa: “...që të zgjojë atë që është duke fjetur”, domethënë, të përgatitet për sabah, të falë pak namaz nate, të falë vitrin, ose të hajë syfyr nëse do të agjërojë, ose të lahet apo të marrë abdes, ose diçka tjetër.¹⁶⁶

Mësime dhe dispozita:

- 1- Pejgamberi (a.s.) dhe shokët e tij e kanë shtyrë syfyrin deri afër agimit.¹⁶⁷ Aq shumë e vononin syfyrin sa që hanin vetëm një pjesë të ushqimit të përgatitur dhe shpejt e shpejt nga frika se mos ju kalonte namazi i sabahut me xhemat, ose koha e ngrënies së syfyrin. Kështu suneti është që ngrënia e syfyrin të vonohet deri afër agimit.
- 2- Lejohet shpejtimi në ngrënie, në rast nevoje. Imam Buhariu në librin e tij ka shkruar një kapitull të emërtuar: “Kapitulli i shpejtimit të ngrënies për syfyr.”¹⁶⁸

¹⁶³ Buhariu (552). Varianti i dytë është po te Buhariu (1820), por dhe tek Ebu Jeala (7533). [Fjala Sexhde në variantin e dytë bën fjalë për të gjithë namazin e sabahut, pra shpejtonte për të kapur namazin e sabahut. Transmetuesi ka përdorur fjalën sexhde meqë është pjesë e namazit, por duke patur si qëllim të gjithë namazin. Ky hadith tregon se ky sahabiu e hante aq vonë syfyrin sa që ngutej në ngrënie nga frika se mos e zinte agimi, si dhe nga frika se mos i humbte namazi i sabahut me Pejgamberin a.s. Hadithi gjithashtu tregon se Pejgamberi e falte namazin e sabahut mjaft herët në muzgun e agimit, në fillimin e kohë së sabahut (Fethul Bari)].

¹⁶⁴ Nesaiu (4/124). Albani e quan të saktë në Sahijh Nesaiu.

¹⁶⁵ Shpjegimi i Neveviut mbi Muslimin (7/204). Shiko: ElMufhim (3/153).

¹⁶⁶ Burimi i mësipërm (7/204) dhe ElMufhim (3/153).

¹⁶⁷ Fet’hul Bari (4/138).

¹⁶⁸ Sahih Buhari (2/678) dhe Shiko: Fet’hul Bari (4/137).

Maliku sjell nga Abdullah Ibn Ebi Bekr, e ky nga i ati, rrëfimin: “Në ramazan, largoheshim nga namazi i natës dhe i shpejtonim shërbyesit që të na sillnin ushqimin, nga frika se mos hynte agimi”.¹⁶⁹

20- Koha e syfyrit (2).

Buhariu dhe Muslimi shënojnë nga Abdullah Ibn Umeri (r.a.) se i Dërguari (a.s.) ka thënë: **“Bilali e thërret ezanin natën, prandaj hani dhe pini derisa të thirret ezani tjetër nga Ibn Umme Mektumi.** Ibn Umme Mektumi, ngaqë ishte i verbër, nuk e thërriste ezanin derisa t’i thoshin njerëzit: “U gdhi, u gdhi”.

Sipas një varianti tjetër që gjendet tek Muslimi, shënohet: “I Dërguari (a.s.) kishte dy muezinë, Bilalin dhe Ibn Umi Muktumin, i cili ishte i verbër. Prandaj i Dërguari (a.s.) ka thënë: **“Bilali e thërret ezanin natë, prandaj hani e pini derisa ezani të thirret nga Ibn Umme Mektumi.”** Diferenca ndërmjet dy ezaneve ishte vetëm aq sa zbriste njëri (nga muri) dhe ngjitej tjetri lart”.¹⁷⁰

Semurah Ibn Xhundubi (r.a.) tregon se Profeti (s.a.v.s) ka thënë: “Mos e ndërprisni syfyrimin prej ezanit të Bilalit, as prej dritës së bardhë që shfaqet vertikalisht, por prisni derisa të përhapet drita fort kështu”. Hamadi (një transmetues i hadithit) e tregoi me duar përhapjen e dritës së agimit të vërtetë, duke bërë të ditur se drita përhapet horizontalisht. Këtë e shënon Muslimi.

Nesaiu shënon një variant tjetër kështu: “Mos u mashtroni me ezanin e Bilalit, e as me këtë dritën e bardhë (e ka fjalën për dritën e parë, që është drita e agimit të rremë dhe që shfaqet vertikalisht e ngritur lart në qiell), por prisni derisa drita të përhapet fort (në vijën horizontale) kështu e kështu”. Ebu Daud Et Tajalisi tregon: “Ai shtriu duart, duke i hapur majtas dhe djathtas”.¹⁷¹

Ebu Hurejre (r.a.) tregon se Profeti (a.s.) ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush dëgjon ezanin dhe ka enën e ushqimit në dorë, të mos e lejë enën, por le të vazhdojë derisa ta mbarojë.” Kështu e shënon Ebu Daudi, ndërsa Hakimi e vlerëson të saktë.¹⁷²

Në variantin e Ahmedit është edhe kjo shtesë: “Muezini e thërriste ezanin kur fillonte të shfaqej agimi”¹⁷³.

¹⁶⁹ Maliku (1/116) dhe Bejhakiu (2/497).

¹⁷⁰ Shënon Buhariu (592) dhe Muslimi (1092).

¹⁷¹ Shënon Muslimi. (1094), Ebu Daudi (2346), Tirmidhiu (706) dhe Nesaiu (4/148).

¹⁷² Shënon Ebu Daudi (2350), Amedi (2\510), Darelkutni (2\165), Bejhakiu (4\218). Hakimi e vlerëson të saktë dhe thotë: Hadithi është sipas kushteve të Muslimit. Pajtohet me të në këtë edhe Dhehebiu (1\588).

Dobi dhe rregulla:¹⁷⁴

E para: Lejohet ngrënia, pirja, marrëdhëniet intime dhe gjithçka që çel agjërimin, deri në shfaqjen e agimit.

E dyta: Të verbërit i lejohet të thërrasi ezanin nëse ai vetë përcakton kohën, ose e informon dikush tjetër që e njeh atë.

E treta: Në namazin e agimit është e ligjshme thirrja e dy ezaneve, njëri para agimit, ndërsa tjetri në të hyrë të tij.¹⁷⁵

E katërta: Lejohet ngrënia mbasi të kesh bërë nijetin, sepse Profeti (a.s.), e ka lejuar ngrënien deri në agim. Nëse bën nijetin në darkë për të agjëruar ditën e nesërme, pastaj para agimit ha ushqim, në këtë rast nijeti nuk është prishur.

E pesta: Kur dyshon se ka hyrë koha e agimit apo jo, lejohet të hash, pasi në origjinë është ende natë, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“..dhe hani e pini derisa të dalloni qartë perin e bardhë (agimin) nga peri i zi (errësira e natës)”**. Përderisa hyrja e agimit është e dyshimtë, parimisht quhet se ka akoma natë, derisa të bëhet e sigurtë hyrja e agimit. Te Bejhakui, në një transmetim të saktë nga Ibn Abasi përcillet se ka thënë: "Kur dyshon, ha derisa ta dallosh agimin qartë".¹⁷⁶ Kjo ka të bëjë me rastin kur njeriu është duke vërtetuar hyrjen e agimit dhe dyshon nëse ka hyrë apo jo, ndërsa kur bazohet në ezan e në orë, këtu nuk ka vend për të dyshuar, sepse ai mund të sigurohet duke pyetur dhe duke parë kohën.

E gjashta: Është e pëlqyeshme ngrënia e syfyrit dhe vonimi i tij.

E shtata: Neveviu - (Allahu e mëshiroftë!) - ka thënë në lidhje me fjalën e transmetuesit: “koha mes njërit ezan dhe tjetrit ishte aq sa zbriste njëri muezin dhe ngjitej tjetri”, se: Bilali e thërriste ezanin para agimit dhe qëndronte në pritje duke bërë lutje etj., dhe më pas vërtetonte agimin. Kur afrohej koha e shfaqes së tij, zbriste dhe lajmëronte Ibn Umi Mektumin, i cili bëhej gati duke u pastruar etj., pastaj ngjitej dhe thërriste ezanin në fillim të hyrjes së agimit.¹⁷⁷

¹⁷³ Musned Ahmed (2\510). E shënon Taberi në Tefsirin e tij (2\175) dhe Bejhakui (4\218).

¹⁷⁴ Mufhim (3\150), Sherhu Nevevii (7\204), Fet’hu El Bari (2\99-100), Dijbaxh (3\194).

¹⁷⁵ [Sipas disa dijetarëve diferenca kohore ndërmjet dy ezaneve të sabahut ka qenë aq sa koha e ngrënies së syfyrit. Shejh Albani ka thënë në ‘tamamul mineh’ se kjo kohë është, përafërsisht, një çerek ore. Suneti është që për sabahun të ketë dy muezina: njëri për ezanin e parë dhe tjetri për të dytin, sikurse ishte Bilali dhe Abdullah Ibn Ummi Mektumi në kohën e Pejgamberit. Shprehja ‘*esalatu hajrun minen neumi*’ duhet të thuhet vetëm në ezanin e parë të sabahut dhe jo në të dytin, sepse kështu tregojnë hadithet që flasin për këtë çështje.]

¹⁷⁶ Neveviu thotë : Nëse dyshon në hyrjen e sabahut, lejohet të hajë, të pijë dhe të kryejë marrëdhënie intime etj., deri në agim. Në këtë çështje nuk ka kundërshti mes dijetarëve. Mexhmu (6/313). Shih: ‘Dhehiretu elukba’ (20/ 355).

¹⁷⁷ El Mufhim (3\151). Shih: Sherh Elnevevii (7\204) dhe Ed Dibaxh (3\194).

E teta: Për kohën mbas agimit nuk thuhet se është natë, por quhet ditë.¹⁷⁸

E nënta: Lejohet që burri t'i atribuohet nënës së tij (biri i filanes), nëse është e nevojshme dhe nëse shquhet me atë llogarë.¹⁷⁹

E dhjeta: Agimi i parë nga i dyti dallon me tri karakteristika:

- 1- Agimi i dytë është zbardhja që shfaqet në vijën horizontale, në vendin ku lind dielli, nga jugu në veri dhe ka një përhapje të gjerë, të fortë e të qartë në vijën horizontale, ndërsa agimi i parë është një shkëlqim drite me rreze që shfaqet e ngjitet vertikalisht në qiell, nga lindja në perëndim.
- 2- Nuk ka errësirë mbas agimit të dytë, sepse përhapja e dritës vazhdon deri në lindjen e diellit, ndërsa agimin e parë e pason errësira.¹⁸⁰
- 3- Agimi i dytë e ka të ngjitur bardhësinë e tij me vijën horizontale, ndërsa tek agimi i parë ka errësirë ndërmjet tij dhe horizontit.¹⁸¹

¹⁷⁸ El Mufhim (3\151). Kështu përmendet nga ai dhe në Dijbaxh (3\194). Shih në 'Fet'h' (2\101).

¹⁷⁹ El Fet'h (2\101).

¹⁸⁰ [Në varësi të kushteve dhe kthjelltësisë të motit, ndonjëherë ka errësirë poshtë agimit të rremë dhe ngjitur me vijën horizontale (Meshruu dirasetish shafak). Madje agimi rremë shfaqet në lartësinë qiellore i rrethuar nga errësira e natës lart dhe poshtë, djathtas dhe majtas. Ndonjëherë agimi i rremë zhduket plotësisht dhe pasohet me errësirë, e pas këtij errësimi fillon shfaqja e agimit të vërtetë, por jo gjithmonë ndodh kjo gjë, pasi ndodh që të fillojë shfaqja e agimit të vërtetë nën agimin e rremë pa u errësuar ky i fundit.]

¹⁸¹ Fikhu El Ibadat, shejh Ibn Uthejmin (172-173). [Të gjitha rregullat si imsaku dhe hyjra e kohës së sabahut lidhen me agimin e dytë. Asnjë rregull fetarë nuk ka të bëjë me agimin e parë. Talk Ibn Aliu tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Hani dhe pini, e mos e lini syfyrin të shqetësuar nga drita vezulluese e ngritur lart në qiell, (pasi ky është agimi i rremë), por hani dhe pini derisa t'u shfaqet në vijën horizontale agimi 'i kuq' (el ahmer)". Shënojnë Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Albani thotë se hadithi është hasen. Duke komentuar rreth këtij hadithi Tirmidhiu thotë: "Kështu është dhe qëndrimi i dijetarëve të ymetit; ata thonë se nuk ndalohej ngrënia dhe pirja derisa të shfaqet agimi 'i kuq' që përhapet në vijën horizontale". Ibn Hazmi thotë: "Ky agim është fillimi i dritës së diellit. Bardhësia e tij vjen në rritje. Mbase shoqërohet dhe me një përzierje të kuqe të shkëlqyeshme (el Muhala). Hatabi thotë: "Drita vezulluese që ngjitet lart në qiell është drita që ngjitet lart para se të shtrihet në vijën horizontale. 'E kuqja' e agimit këtu do të thotë që zbardhja e shtrirë në vijën horizontale të përmbajë fillimet e një të kuqeje. Kur del plotësisht bardhësia shfaqen dhe fillimet e të kuqes. Arabët e krahasojnë agimin me kalin pullali, për shkak se përmban të bardhë dhe të kuqe." (Mealimus sunen). Albani thotë: "Përshkrimi i agimit të vërtetë si 'i kuq' nga Pejgamberi a.s. nuk bie ndesh me përshkrimin që i bën Allahu i Lartësuar: "peri i bardhë", sepse qëllimi është për të bardhën e përzier me të kuqe, ose ndonjëherë agimi shfaqet i bardhë dhe ndonjëherë shfaqet si i kuq, çka do të thotë se ndryshon në varësi të stinëve dhe të pozicionit gjeografik të linjës së agimit (Seria e haditheve të sakta). Xhabir Ibn Abdilahi thotë: Pejgamberi a.s. ka thënë: "Janë dy agime: njëri është ai që quhet: 'dhenibus sirhan-bishti i ujkut', e ky është agimi i rremë që shfaqet për së gjati (vertikalisht) e jo për së gjeri (horizontalisht), kurse agimi tjetër përhapet për së gjeri (horizontalisht) e jo për së gjati". Shënon Hakimi. Albani thotë se hadithi është i saktë. Sipas variantit të Bejhakiut hadithi është kështu: "Janë dy agime: ai që shfaqet si bishti i ujkut as nuk lejon gjë dhe as nuk e ndalon, ndërsa ai që përhapet për së gjati në vijën horizontale e lejon namazin dhe e ndalon ushqimin."

E njëmbëdhjeta: Nëse thirret ezani i agimit ndërkohë ai që dëshiron të agjërojë ka enën në dorë, i lejohet që ta plotësojë ngrënien dhe pirjen, e të mos e lërë atë, sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të hadithit. Ky është lehtësim që na e ka bërë Allahu, të Cilit i takon lavdërimi dhe falënderimi.¹⁸²

21- Koha ndërmjet ezanit dhe syfyrit.

Te Buhariu e Muslimi, Enesi tregon se Zejd Ibn Thabiti i tha: “Hëngrëm syfyr bashkë me Pejgamberin, dhe pastaj ai u çua për faljen e namazit.” Enesi i tha: “Sa ishte koha ndërmjet ezanit dhe syfyrit?” Ai tha: “Aq sa për të lexuar pesëdhjetë ajete”.¹⁸³ Sipas një varianti tjetër të

Ibn Abasi tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ka dy agime: kur shfaqet njëri agim (pra, i vërteti) ndalohet ushqimi dhe lejohet namazi (i sabahut), ndërsa kur shfaqet agimi tjetër (i rremi) ndalohet namazi (i sabahut), por lejohet ushqimi”. Shënojnë Ibn Huzejme, Hakimi dhe Bejhakui. Albani thotë se hadithi është i saktë. Ibn Huzejme thotë: “Ky hadith dëshmon se nuk lejohet të falet namazi farz para hyrjes së kohës së tij. Togu ‘ndalohet ushqimi’, flet për agjëruetin. Togu ‘lejohet namazi’ bën fjalë për namazin e sabahut.” (Silsiletul ehadith esahiha). Abdurrezaku sjell se Atau ka dëgjuar Ibn Abasin duke thënë: “Janë dy agime: sa i përket agimit që shfaqet si shkëlqim në qiell, ai nuk quhet gjë dhe as nuk ndalon grënien e ushqimit, porse ushqimin e ndalon agimi që përhapet në majat e maleve”.

Koha e sabahut në Shqipëri:

E kam vrojtuar kohën e sabahut këtu në Shqipëri që prej vitesh, nga një kohë në tjetrën, në pika të ndryshme të vendit, sidomos gjatë stinës së verës. Kam vërejtur se koha e sabahut në periudhën e verës hynë përafërsisht 35-40 minuta pas kohës së imsakut të shënuar në kalendar, ndërsa në periudhën e dimrit hynë përafërsisht 25-30 minuta pas kohës së imsakut të shënuar në kalendar. Atëherë, diferenca e gabimit të kalendarit nga dimri në verë është përafërsisht dhjetë minuta. Në zonat që ndodhen larg ndikimit të ndriçimit, ndotjes dhe pluhurit të qyteteve, sidomos qyteteve të mëdha, agimi dallohet më qartë, por dhe në qytet e mëdha si Tirana ndikimi tyre në dallimin e agimit është i vogël; mbase mund të dallohet agimi pak minuta më vonë se në vendet ku nuk ka ndriçim dhe ndotje. Njëfarë kohe para se të shpërtheje zbardhja e qartë e agimit të vërtetë në vijën horizontale shfaqet në anën lindore të qiellit në zonën ku lind dielli njëfarë zbardhëllimi i cili zgjat derisa përhapet zbardhje e fortë dhe e qartë e agimit të vërtetë. Ky zbardhëllim konsiderohet prej agimit të rremë. Këtë zbardhëllim që i paraprin agimit të vërtetë mund ta vëshë re më lehtë nëse e vrojton agimin në zonat larg ndriçimit të qyteteve. Problemi më i madh që më ka shtyrë të bëj këtë sqarim është se mund të falet namazi i sabahut para kohe, prandaj duhet të bëjmë kujdes që namazin e sabahut ta fëlim mbasi ka hyrë koha me siguri, por gabimi i kalendarit ketu ka dhe probleme të tjera, siç është ngrënja e syfyrit mjaft heret, e kjo është në kundërshtim me sunetit].

¹⁸² Shih: ‘Hashijetu Ahmed Shakir ala el Muhtesar EIMundhirij bi send Ebi Daud’ (3\233), dhe Temamul Mine të Albanit (417-418).

¹⁸³ Buhariu (1821), Muslimi (1097), Tirmidhiu(703), Nesai (4\134) e Ibn Maxhe (1694). [Në shumicën e transmetimeve, siç tregon Ibn Rexhebi, përmendet se kjo diferencë kohore ka qenë ndërmjet syfyrit dhe namazit të sabahut, ndërsa në transmetimin që sjell Buhariu në kapitullin e agjërimit përmendet se kjo kohë ka qenë ndërmjet syfyrit dhe ezanit. Porse fjala “ezan” përdoret dhe për ikametin, kështu që dhe në hadithin e fundit flitet për intervalin kohorë ndërmjet syfyrit dhe ikametit. Atëherë, qëllimi është koha nga përfundimi i syfyrit deri në

Buhariut në kapitullin e agjërimit, Enesi tregon se Zejd Ibn Thabiti kishte ngrënë syfy bashkë me Pejgamberin dhe pastaj janë çuar për faljen e namazit të sabahut. Transmetuesi nga Enesi tregon: “Pyetëm Enesin: “Sa ishte koha ndërmjet përfundimit të syfyrit dhe hyrjes në namaz)?” Ai u përgjigj: “Aq sa koha e leximit të pesëdhjetë ajeteve”. ”¹⁸⁴

Dobitë dhe rregullat

E para: Është sunet të vonohet syfyri, se kështu ushqimi i syfyrit e mban më shumë agjëruesin dhe kështu realizohet më mirë kundërshtimi i ithtarëve të Librit .

E dyta: Sahabët - Allahu qoftë i kënaqur me ta - kohët i kishin të mbushura me adhurim, prandaj Zejdi (r.a.) e përcaktoi kohën me periudhën e leximit të ajeteve.

E treta: Lejohet matja e kohës me punë të ndryshme. Arabët e kishin zakon një gjë të tillë: si për shembull, sa koha e mjeljes së një dhije, sa koha e therjes së një deveje etj.

E katërta: Koha ndërmjet ezanit dhe syfyrit në këtë hadith është sa koha që merr leximi i pesëdhjetë ajeteve mesatare, as të gjata dhe as të shkurtra, me një lexim mesatar, jo i shpejtë dhe jo të ngadaltë.¹⁸⁵

E pesta: Vonimi i syfyrit është i pëlqyeshëm. Këtu bën përjashtim vonimi i kontaktit me bashkëshorten, sepse nuk është prej gjërave që të jep fuqi gjatë ditës dhe bart rrezikshmërinë e tejkalimit të kohës së syfyrit, për shkak të dëshirës seksuale që, ndoshta mund ta ketë të vështirë ta braktisë, e kështu agjëruesi rrezikon të prishë agjërimin dhe t’i bëhet detyrë *kefar*-ja (shryerja) e prishjes së agjërimit me marrëdhënie intime.

E gjashta: Interesimi për kërkimin e dijes, shqyrtimin e çështjeve, gjurmimin e suneteve, njohja e kohëve të tyre dhe përkujdesja për to. Kjo mësohet prej pyetjes së Enesit dhe përgjigjes së Zejdit (r.a.).

fillimin e namazit (Fet’hul Bari). Ibn Rexhebi ka përmendur se sipas transmetimit të Muamerit thuhet se ndërmjet syfyrit të Pejgamberit dhe namazit të sabahut kishte kohë vetëm për faljen e dy rekateve sunet të sabahut dhe daljes për në xhami (Fet’hul Bari).

¹⁸⁴ Ky është varianti i Buhariut (551).

¹⁸⁵ Shih: *Fet’h* (4\138) dhe *Tuhfetu el Ahvedhi*(3\317).[Ibn Haxheri sqaron se koha e leximit të pesëdhjetë ajeteve është sa tre të pestat e një ore, domethënë: katër minuta. Mbase kjo kohë, vazhdon ai, është aq sa koha e marrjes avdes. Në një vend tjetër në Fethul Bari, Ibn Haxheri, thotë se kjo kohë është sa një gradë. Një gradë është e barabartë me katër minuta. E bëra provë vetë (fjala është e redaktorit fetar) me suren “El Hakka”, dhe arrita ta lexoja për gjashtë minuta. Dijetarët kanë shpjeguar se ky hadith tregon për disa gjëra, dhe përveç atyre që përmenden më lart janë dhe dy të tjera: a- për faktin se koha e namazit të sabahut hynë sapo del agimi. b- se Pejgamberi a.s. e fillonte namazin e sabahut në muzgun e agimit (Shiko Fethul Bari)].

E shtata: Dhembshuria e Profetit (a.s.) për umetin, që duket në lejimin e ngrënies së syfyrit, me qëllim që besimtarët të jenë më të fortë gjatë agjërimit. Gjithashtu, Profeti (a.s.) e vonoi ngrënien e syfyrit qëllimisht, në mënyrë që umeti ta merrte për shembull. Nëse ai nuk do të hante syfyr, shokët e tij do ta merrnin për shembull dhe kjo do t'i çonte në vështirësi. Por edhe nëse do ta caktonte kohën e syfyrit në pjesën e parë të natës apo në mesin e saj, përsëri syfyri nuk do ta jepte aq shumë efektin e tij për mbajtjen e agjëruetit.

E teta: Edukata me të Dërguarin (a.s.) dhe mënyra e bukur e të shprehurit, sipas fjalës së Zejdit (r.a.): “Hëngrëm syfyr bashkë me Pejgamberin (a.s.)”, e jo: “Hëngrëm ne dhe Pejgamberi (a.s.)”.

22 – Gjykimi i puthjes apo përkëdheljes së gruas për agjëruetin

Aishja (r.ea), thotë: "I Dërguari (a.s) puthte dhe përqafonte gruan, kur ishte me agjërim, por ai ishte më i afti nga të gjithë për të frenuar epshin". Sipas një varianti tjetër, Aishja (r. anha) thotë: "I Dërguari (a.s) e puthte gruan në Ramazan, ndërkohë që ishte me agjërim".

Në një version tjetër po tek Muslimi, Aishja (r. anha) thotë: "Kush nga ju mund të frenojë epshin e vet siç e frenonte i Dërguari (a.s.)?".

Në versionin e Ebu Daudit, Aishja (r. anha) thotë: " I Dërguari,(a.s.), më puthte, ndërkohë që ai dhe unë ishim agjëruet".

Ibni Hibani sjell një version nga Ebu Selme Ibn Abdurahmani, se Aishja (r. anha) ka thënë: "I Dërguari (a.s.) puthte disa nga gratë e tij, ndërkohë që ishte me agjërim. E pyetën: “Gjatë agjërimit farz dhe vullnetar?” Ajo tha: “Në të dyja llojet, farz dhe vullnetar”.¹⁸⁶

Hafsa (radijallahu anha)tregon se: "I Dërguari (a.s.) i puthte gratë ndërkohë që ishte me agjërim.¹⁸⁷

Umer Ibn Ebu Seleme (r.a.) tregon se e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (a.s.): “A e puth gruan agjërueti?” I Dërguari i Allahut (a.s.) i tha: “Pyete këtë” për Umu Selemen. Ajo i rrëfeu se i Dërguari i Allahut e vepronte një gjë të tillë. Atëherë, ai tha: “O i Dërguari i Allahut, ty t'i ka falur Allahu gjynahet që ke bërë dhe ato që do të bësh...” I Dërguari (a.s.) i tha: “Për Allah, unë jam më i devotshmi ndër ju ndaj Allahut dhe jam ai që e kam më shumë frikë Atë”.¹⁸⁸

Omeri (r.a.) rrëfen: “Njëherë, duke shikuar gruan, m'u ngacmuan ndjenjat dhe e putha, ndërkohë që isha me agjërim. Më pas, shkova te Pejgamberi (a.s.) dhe i thashë: “O i Dërguari Allahut, sot kam bërë një gjë të rëndë: kam puthur gruan, ndërkohë që po agjëroja...” Ai më tha: “Po sikur të

¹⁸⁶ Buhariu (1826), Muslimi (1106), Ebu Daudi (2384), Ahmed (6\44).

¹⁸⁷ Muslimi (1107), Ibn Maxhe (1685) dhe Ahmed (6/286).

¹⁸⁸ Muslimi (1108) dhe Maliku (1/291).

kishe shpërlarë gojën me ujë ndërkohë që po agjëroje?" – "Kjo s'ka gjë" - i thashë. – "Epo, atëherë, përse bëhesh merak?!" – ma ktheu ai."¹⁸⁹

Dobi dhe rregulla:

E para: Agjëruesi i lejohej ta puthë dhe përqafojë gruan, si gjatë agjërit farz, po ashtu edhe vullnetar, në ramazan dhe në muajt e tjerë, si për të riun edhe për të moshuarin, kur ka siguri se nuk e humb kontrollin e epshit të tij e të bjerë në haram, si për shembull në marrëdhënie intime apo ejakulim.

E dyta: Me fjalën 'përkëdhelje apo përqaftim të gruas' hadithi ka për qëllim përqaftimin e gruas prej burrit të saj, puthitjen e trupit të burrit me të gruas, prekjen e lëkurës, shtrëngimin apo afrimin e saj, dhe jo marrëdhënien seksuale, sepse kjo e fundit e prish agjërimin.¹⁹⁰

E treta: Agjëruesi duhet të ketë parasysh se agjërimi priset kur ejakulon për shkak të puthjes, puthitjes së trupit me trupin e gruas, përkëdheljes, prekjes apo shtrëngimit të saj, por ai duhet të vazhdojë agjërimin dhe ta kompesoj atë ditë pas ramazanit, të pendohet tek Allahut dhe t'i kërkojë falje Atij. Për këtë Allahu i Lartësuar thotë në hadith kudsij: "Për hirin Tim, agjëruesi ka lënë epshin, ngrënien, e pirjen"¹⁹¹. Në një version tjetër: "Ai, për hirin Tim, ka lënë ëndjen dhe gruan e tij".¹⁹²

Ndërsa dalja e sekrecioneve (*medhi*) nuk e prish agjërimin, bazuar në mendimin më të saktë të dijetarëve,¹⁹³ por agjëruesi duhet t'u largohet gjërave epshndjellëse, të cilat të çojnë në haram.

E katërta: Hadithet që përmendëm dëshmojnë se puthja e gruas nga ana e agjëruetit nuk është e lejuar vetëm për Profetin (a.s.), por ajo është e lejuar edhe për umetin në përgjithësi, me kusht që mos të çojë në haram, si ejakulim apo marrëdhënie intime.¹⁹⁴

E pesta: Profeti (a.s.) ishte njeriu që kishte më shumë drojë Allahun, sepse ai e njihte më mirë madhërinë e Tij.¹⁹⁵

¹⁸⁹ Ebu Daudi (2385), Daremiu (1724), Abd ibn Humejd(21). Ibn Hibani e vlerëson të saktë (3544). Po ashtu dhe Hakimi Dhehebiu pajtohet me qëndrimin e tyre (1/596). Albani e shënon në Sahih Ebi Daud.

¹⁹⁰ Taberiu në Tefsirin e tij thotë: Fjala "mubasheretu" do të thotë: 'kontakti i lëkurës me lëkurën' (2/168). Shih: 'Fet'hu Elbari' (4/149).

¹⁹¹ Shënojnë, nga Ebu Hurejra, Buhariu (7054) dhe Muslimi (1151).

¹⁹² Ky është versioi i Ibni Huzejmes në Sahihun e tij (1897). Shih 'Fetava Ibni Baz', kapitullin e daves (2/164) dhe *Mexhmuu fetava veresail* (15/315).

¹⁹³ Shih *Fetavat* e Ibni Bazit, kapitullin e daves (2/164), dhe *Mexhmuu Fetava ve Resail* (15/268- 315) dhe *Fetava Sijam Ibn Xhibrin* (54).

¹⁹⁴ Shih: Sherh Ibn Betal (4/56), Munhatu Elbari (4/364) dhe Tuhfetu Elahfedhi (3/350).

¹⁹⁵ El Mufhim (3/165).

E gjashta: Nga hadithet përfitojmë se e kemi detyrë që ta lëmë thellimin dhe teprimin në çështjet e fesë, ose të menduarit se vetëm Profetit i lejohej të puthte bashkëshortet e tij gjatë agjërit, por jo umetit të tij. Prandaj kur u diskutua kjo gjë, Profeti (a.s.) u nevrikos dhe tha: "Ndërsa unë, pasha Allahun, jam më i devotshmi ndër ju ndaj Allahut dhe e kam më shumë frikë Atë".¹⁹⁶ Ndërsa në hadith tjetër thotë: "Unë i njoh më mirë se ju kufijtë e Allahut."

E shtata: Interesimi i shokëve të Profetit për të njohur gjërat e lejuara dhe të ndaluara, devotshmëria që kishin ndaj Allahut të Lartësuar dhe frika prej gjërave që cenojnë ibadetin apo e prishin atë.

E teta: Në këto hadithe ka kundërpërgjigje ndaj sufive ekstremistë, të cilët ia kanë hequr vetvetes ose liderëve të tyre detyrimet fetare, me preteksin se gjoja kanë arritur gradë të lartë në besim e në sjellje. Ndërsa Profeti (a.s.), i cili ishte njeriu me besimin më të plotë dhe që i përmbahej më shumë Sheriatit, e korrigjoi gabimin e atyre që menduan se, përderisa Profetit i janë falur mëkatet, atëherë i lejohet të bëjë disa gjëra të ndaluara¹⁹⁷.

E nënta: Hadithi i Umer Ibn Hatabit (r.a.) mbështet metodën e analogjisë në gjykimin fetar, kur kemi të bëjmë me çështje të ngjashme. Kësisoj, me shpërlarjen e gojës, uji mund të kalojë në gurmaz, duke prishur agjërimin. E tillë është edhe puthja, e cila mund të çojë në kryerjen e marrëdhënieve intime, që prishin agjërimin. Përderisa njëri veprim nuk e prish agjërimin, po ashtu edhe tjetri, i ngjashëm me të, nuk e prish agjërimin.¹⁹⁸

23 – Dënimi për atë që prish agjërimin

Ebu Uname Elbahilij (r.a.) tregon se ka dëgjuar të Dërguarin (a.s.) duke thënë: 'Kur isha duke fjetur, erdhën dy burra më morën për krah dhe më dërguan në një mal të thyer e më thanë: 'Ngjitu!' – 'Nuk mundem' - thashë unë. Ata më thanë: 'Ne do të ta lehtësojmë.' Atëherë, unë u ngjita. Ndërkohë që isha në rrafshinën e malit, dëgjova zëra të fortë. Atëherë thashë: 'Ç'janë këta zëra?' – 'Këto janë klithmat e banorëve të Zjarrit', - më thanë ata. Më pas, më morën. Papritmas,

¹⁹⁶ Sherh Nevevija ala Muslim (7/219).

¹⁹⁷ E tillë është dhe ajo që ju shkon nëpërmend disave në lidhje me hadithin që flet për atë që bën teube pas gjynahut të tretë, dhe thënin e Allahut për të: "Puno ç'të duash, se të kam falur!". Kurtubiu thotë se ky mendim është i pavlefshëm, bazuar në thënien e Pejgamberit: "Ndërsa unë, pasha Allahun, jam më i devotshmi ndër ju ndaj Allahut dhe e kam më shumë frikë Atë sesa ju". Një argument tjetër që hedh poshtë këtë përfytyrim të pavlefshëm është dhe ixhmai i padiskutueshëm i ymetit që njeriu nuk lirohet nga përgjegjësia fetare përderisa plotëson kushtet e saj.

¹⁹⁸ Mealim sunen hamish Ebi Daud (2/780).

pashë disa njerëz të varur për leqet e këmbëve: anën e gojës e kishin të çarë, ndërsa nofulla u rridhte gjak...” Më pas, Profeti (s.s) tregon: “U thashë atyre: ‘Kush janë këta?’ - Janë ata që çelin agjërimin para se të vijë koha e çeljes” - u përgjigjën ata.¹⁹⁹

Dobi dhe rregulla

E para: Në hadith pohohet dënimi i varrit, që pohohet gjithashtu edhe në Kuran, Sunet dhe ixhmain e umetit, derisa imam Ahmeti ka thënë: ‘Këtë nuk e mohon kush, por veç ai që është i humbur dhe humb edhe të tjerët.’²⁰⁰

E dyta: Dënimi i varrit do ta vuaj shpirti dhe trupi, në një mënyrë që vetëm Allahu i Lartësuar e di. Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Besimi e të parëve të këtij umeti dhe imamëve të tij është se i vdekuri ose do të jetë në begati, ose në dënim. Kjo gjë i ndodh shpirtit dhe trupit. Ne besojmë se shpirti, pas ndarjes prej trupit, përjeton mirësi ose dënohet. Gjithashtu, besojmë se shpirti ndonjëherë ka kontakt me trupin. Ai përjeton mirësi ose dënohet me të. Ndërsa kur të vijë Dita e madhe e Ringjalljes, shpirtrat do të kthehen në trupat e tyre e do të dalin prej varreve për të shkuar më pas para Zotit të botëve.”

E treta: Pejgamberi (a.s.) pa në ëndërr disa forma të dënimit të varrit. Ëndrrat e pejgamberëve janë të vërteta. Ato janë një pjesë e Shpalljes prej Zotit.

E katërta: Hadithi sqaron se sa i rëndë është dënimi i varrit. Besimtari duhet ta ketë frikë, t'u largohet faktorëve që të çojnë në të dhe të bëjë çdo gjë të mundshme që të shpëtojë prej tij.

E pesta: Në hadith ka kërcënim të fortë për ata që çelin para kohës së iftarit duke qenë të vetëdijshëm, me dashje dhe pa arsye. Një veprim i tillë është gjynah i rëndë, andaj është dhe shkak për dënim të ashpër.

E gjashta: Përderisa ky është dënimi i atij që çel para iftarit, atëherë në mënyrë më parësore e meriton dënimin ai që nuk agjëron fare muajin e Ramazanit ose një pjesë të tij pa arsye të konsiderueshme. Ai duhet të shpejtojë në pendim të sinqertë, në mënyrë që të mos e kapë dënimi i ashpër në varr.

¹⁹⁹ Shënon Nesai në *Sunen Kubra* (3286), Tabarani në *El Kebir* (8/7667) dhe në *Musned Eshamijin* (577); Bejhakiu (4/216). Ibn Huzejme (1986) dhe Ibn Hibani (7491) e vlerësojnë të saktë. Hakimi thotë se hadithi përmbush kushtin e Muslimit. Hadithi është sjellë sipas tekstit të tij. Me këtë qëndrim pajtohet edhe Dhehebiu (1/595).

²⁰⁰ ‘*Ruh*’ Ibn Kajim (57). Shih *Sunen Lalekai* (6/1127) dhe *Ithbat adhabul kabri* të Bejhakiut (1/110).

24 – Vlera e shpejtimit të iftarit

Allahu i Lartësuar ka thënë: "...Plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje." ” [Bekare: 187].

Sehl Ibn Sadi (r.a.) përcjell se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Njerëzit do të vazhdojnë të jenë në mirësi, përderisa shpejtojnë iftarin."²⁰¹

Në variantin që sjell Ibn Maxhe, i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Njerëzit do të vazhdojnë të jenë mirë, përderisa të shpejtojnë iftarin. Shpejtojeni iftarin, se judejtë e vonojnë atë."²⁰²

Kurse tek Ibn Huzejmeh dhe Ibni Hibani: "Kjo fe do të vazhdojë të ngadhënjejë, të jetë e lartë dhe të jetë e dukshme, për sa kohë që njerëzit do të shpejtojnë iftarin, ndryshe nga judejtë dhe të krishterët, të cilët e vonojnë atë."²⁰³

Në variantin tjetër: "Umeti im do të vazhdojë të jetë në udhën time, për sa kohë nuk presin shfaqjen e yjeve për të çelur iftar."²⁰⁴

Ebu Atije el Hamedani (Allahu e mëshiroftë!) rrëfen: "Unë me Mesrukun shkuam tek Aishja (r.a.) dhe i thamë: "O Nëna e Besimtarëve, njëri nga shokët e Muhamedit (a.s.) e shpejton iftarin dhe namazin, kurse tjetri e vonon iftarin dhe namazin. Ajo tha: "Kush është ai që e shpejton iftarin e namazin?" – "Abdullah Ibn Mesudi" - i thamë ne. Atëherë, ajo tha: "Kështu vepronte i Dërguari i Allahut (a.s.)". Ebu Kurejbi shton se "...tjetri ishte Ebu Musa".²⁰⁵

Enesi (r.a.) thotë: "Profeti nuk e falte namazin e akshamit pa çelur iftarin, qoftë edhe me një gllënjë ujë."²⁰⁶

Umer Ibn Mejmun Eudij thotë: "Shokët e Muhamedit (a.s.) ishin njerëzit që shpejtonin më së shumti iftarin dhe vononin më së shumti syfyrimin".²⁰⁷

Dobi dhe rregulla:

E para: Pëlqehet që të shpejtohet iftari kur vërtetohet përfundimi i diellit me anë të shikimit ose kur të lajmëron ndonjë njeri i besueshëm, ose mendon vetë se mundësia më e madhe është se

²⁰¹ Shënon Buhari (1856) dhe Muslimi (3503).

²⁰² *Sunen Ibn Maxhe* (1698).

²⁰³ *Sahih Ibn Huzejmetu* (2060) dhe në *Sahih Ibn Hiban* (3503).

²⁰⁴ Ky është varianti i Ibni Huzejmes (2061). Atë e ka vlerësuar të saktë Ibni Hibani (3520) dhe Hakimi, i cili thotë se hadithi është sipas kushtit të Buhariut dhe Muslimit. Me këtë qëndrim është pajtuar edhe Dhehebiu (1/599).

²⁰⁵ Shënon Muslimi (1099), Ebu Daudi (2354), Tirmidhiu (702), Nesai (4/144) Amedi (6/48).

²⁰⁶ Shënon Ebi Jaëla (3792), Bezari (984), Bejhaki (4/239). Ibn Huzejme e vlerëson të saktë (2063), por dhe Ibn Hiban (3504-3505). Hejthemi në Mexhma Zeuaid (3/155) thotë se transmetusit e Ebi Jaëlasë janë të dy librave të saktë.

²⁰⁷ Shënon Abdurrezaku (7591) dhe Bejhakiu (4/238). Hafidh në Feth e vlerëson të saktë (4/199).

dielli ka perënduar.²⁰⁸ Këtë e dëshmon tradita profetike dhe ajo e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Hafidh Ibn Abdulberri (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Dijetarët janë në ixhma se, po hyri koha e faljes së akshamit, ka hyrë koha e iftarit, qoftë ky agjërim farz apo vullnetar. Gjithashtu, ata janë në ixhma (një mendje) se namazi i akshamit i përket natës. Allahu i Lartësuar thotë: “Plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje.” [Bekare: 187].²⁰⁹

E dyta: Mirësia gjendet tek ata njerëz që e shpejtojnë iftarin dhe largohet nga ata që e vonojnë atë.²¹⁰

E treta: Shpejtimi i iftarit është prej mirësisë së këtij umeti, një praktikë kjo që na dallon nga judejtë dhe të krishterët, të cilët e vonojnë iftarin.²¹¹ Dallimi nga ithtarët e Librit dhe kundërshtimi i tyre është një parim në fenë tonë i cili qëndron në shumë norma ligjore. Ky është

²⁰⁸ Teudih el ahkam min Bulug elmeram (3/153). [Nëse muezini e vonon ezanin, agjëruesi nuk ka pse të presë, por sipas sunetit çel me të perënduar dielli. Madje edhe nëse muezini e thërret ezanin me të perënduar dielli, agjuruesi çel që në fillimin e ezanit pa pritur përfundimin e tij. Agjëruesi çel kur bindet për perëndimin e diellit. Por lejohet të çelë edhe kur mendon se mundësia më e madhe është që të ketë perënduar dielli. Si argument për rastin e fundit kemi hadithin e Esmasë e cila tregon: “Në kohën e Pejgamberit a.s. në një ditë me re ne çelëm dhe pastaj u hapën retë dhe u shfaq dielli. Dikush pyeti Hishamin (një transmetues të hadithit që është dhe nipi i Esmasë): A u urdhëruan njerëzit për zëvendësimin e asaj dite? Hishami tha: “Patjetër duhet të zëvendësohet”. Muameri ka thënë: “Kam dëgjuar Hishamin të thotë se nuk e di nëse e zëvendësuan atë ditë apo jo”. Ibn Tejmije thotë: “Ky hadith tregon për dy gjëra, njëra prej të cilave se nuk është e pëlqyeshme në kohë me re që të vonohet çelja e agjërimit derisa të krijohet bindje e plotë për perëndimin e diellit, pasi sahabët nuk e bënë diçka të tillë dhe as Pejgamberi a.s. nuk i urdhëroi për të. Sahabët që shoqëruan Pejgamberin ka qenë më të ditur dhe më të dëgjueshëm ndaj Allahut dhe Pejgamberit të tij sesa ata që erdhën më pas. E dyta, se nuk është detyrë zëvendësimi i ditës së agjërimit në një rast të tillë, sepse nëse Pejgamberi do t’i kishte urdhëruar për zëvendësimin e kësaj dite, ky lajm do të ishte përhapur ashtu sikurse u transmetua lajmi i çeljes së tyre. Përderisa nuk është transmetuar diçka e tillë, kjo tregon se Pejgamberi nuk i ka urdhëruar për të. Për faktin se, kur dikush pyeti Hishamin nëse sahabët ishin urdhëruar për zëvendësimin e asaj dite apo jo, ai tha: “Patjetër duhet të zëvendësohet”, themi se Hishami shprehu mendimin e vet; ai nuk e ka transmetuar këtë gjë në hadithë. Për faktin se ai nuk ka pas dijeni për këtë gjë tregon dhe dëshmia që sjell Muameri i cili thotë: “Kam dëgjuar Hishamin duke thënë: “Nuk e di nëse e zëvendësuan atë ditë apo? Të dyja këto transmetime i sjell prej tij Buhariu. Këtë hadith Hishami e transmeton nga e ëma, Fatime Binti Mundhir, e kjo nga Esmaja. Hishami vetë ka transmetuar se babai i tij, Urve, ka thënë që ata nuk u urdhëruan për ta bërë kaza atë ditë. Urve është më i ditur sesa i i biri.” (Mexhmuul fetava v.25). Kështu, nëse agjëruesi çel duke menduar se mundësia më e madhe është që të ketë perënduar dielli, e pastaj bëhet e qartë se nuk ka pas perënduar, ai nuk e zëvendëson këtë ditë. Ndërsa nëse njeriu dyshon në perëndimin e diellit, atij nuk i lejohet të çelë derisa të bindet për perëndimin e tij ose të krijojë mendimin se mundësia më e madhe është që dielli ka perënduar. Nëse çel me dyshim në perëndimin e diellit, quhet gjynahqarë. Kjo ditë agjërimi nuk i quhet përveç nëse bëhet e qartë se çelja është bërë pas perëndimit të diellit. (*el Muhala* dhe *el Mugni*).]

²⁰⁹ El Istidhkarë (3/288).

²¹⁰ Referimi i mëparshëm.

²¹¹ Fethu Elbari (4/199).

një fakt që tregon se ky umet është më i dalluari dhe i mirë nga mbarë njerëzimi, prandaj është i ndaluar imitimi i jomuslimanëve.

E katërta: Vonimi i iftarit përtej perëndimit të diellit tregon shmangie nga tradita e Pejgamberit (a.s.) dhe risi në fenë e Allahut të Madhërishëm.

E pesta: Në këto hadithe ka kundërpërgjigje ndaj *rafidive* (sekt shi'it) dhe atyre që pajtohen me ta, të cilët e shtyjnë çeljen e iftarit përtej perëndimit të diellit deri në shfaqjen e yjeve.²¹²

E gjashta: T'i përmbahesh kohës së caktuar të adhurimit, pa shtuar e pakësuar, të mbron nga ekstremizmi në çështjet e fesë, braktisja e rregullave të fesë dhe largon vesveset e Shejtanit. Shpejtimi në çeljen e iftarit, kur vërtetohet perëndimi i diellit, të mbron nga gjëra të tilla.²¹³

E shtata: Nga hadithet përfitojmë se njeriu, me shpejtimin e iftarit, shfaq paaftësi dhe nënshtrim dhe robëri përpara Allahut të Lartësuar, si dhe nxitim për të pranuar lehtësimin nga Ai.²¹⁴

E teta: Nga hadithet përfitojmë se vazhdimësia e agjërimit pas perëndimit të diellit, natën, është i papëlqyeshëm, prandaj është sunet që më parë të çelësh iftar, pastaj të falësh akshamin, sepse kështu arrin ta shpejtosh më shumë iftarin.²¹⁵

E nënta: Hadithet nxisin për pasim të Sunetit dhe moskundërshtim të tij, pasi me lënien e Sunetit punët shkojnë keq. Sahabët, kur pësonin ndonjë disfatë, kontrollonin çfarë tradite profetike kishin lënë. Kur e gjenin, e mësonin që shkaku i dështimit ishte pikërisht braktisja e asaj tradite.²¹⁶

E dhjeta: Hadithi flet dhe për vlerën e këtij umeti, meqë është udhëzuar për pasimin e Sunetit. Pasimi i Sunetit sjell dashurinë e Allahut të Lartësuar, bazuar në fjalën e Tij: “Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është falës i Madh dhe Mëshirëbërës”. [Ali Imranë: 31].²¹⁷

25 – Mosagjërimi për udhëtarin, shtatëzënë dhe gjidhënësen

²¹² Referimi i mëparshëm.

²¹³ Shih Mufhim (3/157) dhe Tuhfetu Ahfedhi (3314).

²¹⁴ Referimi i mëparshëm. (3/315)

²¹⁵ Sherh Ibn Mulekin ala elumdetu (5/311).

²¹⁶ Referimi i mëparshëm (5/310- 311).

²¹⁷ Tuhfetu Ahfedhi(3/316).

Enes Ibn Malik El Kabij rrëfen: “Ne na sulmoi kalorësia e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Unë pastaj shkova tek ai dhe e gjeta duke ngrënë drekë. Ai më tha: "Hajde, afrohu të hash" – “Unë po agjëroj”, iu përgjigja. Atëherë ai më tha: "Ulu, të flas për agjërimin. Allahu i Lartmadhëruar ia ka hequr udhëtarit gjysmën e namazit. Ndërsa agjërimin ia ka hequr udhëtarit, gruas shtatzënë dhe gjidhënësës". Për Zotin, i Dërguari i Allahut (a.s.) tha këto dy gjëra, të dyja ose njërën. Ç'fatkeqësi për mua! Ah, sikur të kisha ngrënë prej ushqimit të Dërguarit të Allahut (a.s.).”²¹⁸

Dobi dhe rregulla

E para: Mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij, i Cili i ka çliruar nga disa dispozita të Sheriatit ata që nuk kanë mundësi, që dëmtohen ose ndjejnë vështirësi në kryerjen e tyre.

E dyta: Morali i lartë dhe bujaria e Pejgamberit (a.s.), kur e ftoi Enesin për të ngrënë me të, dhe interesimi i Profetit për t'i mësuar umetit gjërat që kishin nevojë t'i dinin.

E treta: Udhëtarit i lejohet të mos agjërojë, si dhe të shkurtojë namazin. Këto janë lehtësime nga Allahu. Allahu do që robërit të zbatojnë lehtësimet e Tij, ashtu sikurse dëshiron ti përmbahen urdhëresave të Tij.

E katërta: Allahu i Lartësuar ia ka lejuar gruas shtatzënë që mos të agjërojë, ngaqë foshnja në bark ushqehet me ushqimin e saj. Kësisoj, agjërimi mund ta dëmtojë atë ose foshnjën e saj, prandaj Ligjvënësi i Urtë (Allahu) e ka lejuar të mos agjërojë.

E pesta: Allahu i Lartësuar ia ka lejuar gruas gjidhënëse që të mos agjërojë, sepse ajo ka nevojë për ushqim të vazhdueshëm, ndërsa agjërimi mund t'i shkaktojë mundim ose të dëmtojë shëndetin e saj ose të foshnjës.

E gjashta: Këtij lejimi i bashkangjiten edhe rastet që e kanë të domosdoshme prishjen e agjërit, si: për shuarjen e zjarrit, për shmangien e ndonjë agresioni, për shpëtimin e jetës së njeriut, kur jeta e tij është në rrezik.²¹⁹

E shtata: Nëse gruaja shtatzënë dhe gjidhënëse e prishin agjërimin për shkak se i druhen shëndetit të tyre ose shëndetit të tyre dhe të foshnjës, ato vetëm agjërojnë më vonë aq ditë sa nuk kanë agjëruar në ramazan. Në këtë rregull nuk ka mosmarrëveshje ndërmjet dijetarëve, sepse ato konsiderohen si i sëmuri që e prish agjërimin nga frika për veten e tij. Nëse ato e prishin agjërimin nga frika për fëmijën e tyre, kjo është pikë diskutimi mes dijetarëve, por fetvaja që

²¹⁸ Shënon Ahmedi (4\347), Ebu Daud (2408) dhe Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është hasen (715). Këtë hadith e sjell edhe Ibn Maxhe (1667), Ibn Ebi Asim në ahadë ue methani (1493), Taberani fi elkebir (1\263) numër (765) dhe Bejhakui (4\231). Albani në librin Sahih Ebi Daudi thotë se hadithi është hasen sahih, por edhe Ibn Bazi e vlerëson të saktë në Mexhmu fetava (15\224).

²¹⁹ Shih Sherh ElMumtia (6\350- 351) dhe Munteka min fetva Shejh Feuzan (3\141).

zbatohet në Arabinë Saudite - dhe kjo, në dashtë Allahu, është e saktë – thotë se ato duhet vetëm të agjërojnë këto ditë më vonë, sepse gjykohen njëlloj si të sëmuret.

Gjithashtu, Profeti (a.s.) barazoi në gjykim gruan shtatzënë apo gjidhënëse me gjendjen e udhëtarit, për sa i përket mosagjërimit. Dihet që udhëtari i agjëron më vonë ditët që ka lënë. Ai nuk ka detyrë të ushqejë për çdo ditë një të varfër, e po kështu është dhe gruaja shtatzënë dhe gjidhënëse.²²⁰

26- Agjërimi dhe mosagjërimi në udhëtim

Aishja përcjell se Hamza Ibn Amr Eslemij i tha të Dërguarit (a.s.): “A të agjëroj në udhëtim?”, pasi ai agjëronte shumë. Profeti (a.s.) i tha: “Agjëro ose jo, si të dëshirosh”. Këtë e shënon Buhariu e Muslimi.²²¹

Ibni Abasi (r.a.) tregon se: I Dërguari i Allahut (a.s.) udhëtoi njëherë në muajin e ramazanit. Ai agjëroi gjersa arriti vendin e quajtur Usfan, pastaj kërkoi t'i jepej ena e ujit. Ai piu prej saj gjatë ditës, që ta shihnin njerëzit. Nuk agjëroi pastaj, derisa arriti në Mekë. Ibn Abasi thoshte: “I Dërguari i Allahut (a.s.) edhe agjëronte në udhëtim, edhe nuk agjëronte, prandaj kush të dojë, le të agjërojë e kush të dojë, le të mos agjërojë.”²²²

Enes Ibn Maliku (r.a.) thotë: “Kur udhëtonim me të Dërguarin (a.s.), ata që agjëronin nuk i qortonin ata që nuk agjëronin, ashtu si ata që nuk agjëronin nuk i qortonin ata që agjëronin.”²²³

Ebu Seid Hudrij (r.a.) thotë: "Gjatë ramazanit, kemi vajtur në betejë me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Kishte prej nesh që agjëronin, por kishte edhe që nuk agjëronin. Ai që agjëronte nuk zemërohej me atë që nuk agjëronte, por as ai që nuk agjëronte me atë që agjëronte. Ata besonin se ai që e shihte veten të fuqishëm, agjëronte, dhe kjo quhej gjë e mirë, ndërsa kush ndihej i dobët dhe hante në ditët e agjërimit edhe kjo vlerësohej si gjë e mirë.”²²⁴

Ai përcjell përsëri e thotë: “Udhëtuam me të Dërguarin (a.s.) për në Mekë. Kur qëndruam në një vend, i Dërguari (a.s.) tha: “Ju po i afroheni armikut, kështu që prishja e agjërimit ju bën më të fortë për t'u përballur me të”. Kësaj here, Pejgamberi (a.s.) thjesht bëri një lëshim, prandaj disa e mbajtën agjërimin dhe disa e prishën, por më pas, kur zbriti në një vend tjetër, ku ishim më pranë armikut, u tha: “Në të gdhirë ju do të ndesheni me armikun dhe prishja e agjërimit ju bën më të fortë.” Ndaj dhe ne e prishëm të gjithë agjërimin.” “Kësaj here - thotë transmetuesi -

²²⁰ Shih Mugni (4\393- 394) dhe Dhehiretu Ukba (211\214).

²²¹ Shënon Buhariu (1841) Muslimi (1121).

²²² Shënon Buhariu (4029) Muslimi (1113).

²²³ Shënon Buhariu (1845) dhe Muslimi (1118).

²²⁴ Shënon Muslimi (1116), Tirmidhi(713) dhe Ahmedi (3\12).

Pejgamberi (a.s.) ua bëri detyrë prishjen e agjërimit". Pas kësaj here, ne agjëronim me të Dërguarin kur ishim në udhëtim".²²⁵

Dobi dhe rregulla

Së pari: Toleranca në Islam, lehtësia e dispozitave, marrja në konsideratë e gjendjes së atyre që kanë përgjegjësi, dhe për të gjitha këto, falënderimi i takon Allahut!

E dyta: Udhëtari mund të zgjedhë ndërmjet agjërimit ose mosagjërimit. Suneti është që të bëjë atë që e ka më të lehtë, sepse hadithet tregojnë se ai është i lirë të zgjedhë.

E treta: Udhëtari që e ka të vështirë agjërimin është më mirë të mos agjërojë, kurse ai që e ka më të vështirë shlyerjen më vonë, sesa agjërimin në udhëtim, është më mirë të agjërojë në udhëtim, për arsye se kështu largon nga vetja vështirësinë e mëvonshme dhe shlyen detyrimin sa më parë.

E katërta: Ata që janë gjithmonë në udhëtim ose kanë udhëtime të shumta për shkak të punës, siç janë shoferët, për shembull, është më mirë që ta agjërojnë ramazanin në udhëtim, nëse agjërimi nuk i dëmton dhe nuk kanë vështirësi, me qëllim që të përmbushin këtë detyrim. Madje, agjërimi mund të jetë detyrim mbi ta gjatë udhëtimit, nëse nuk kanë kohë tjetër për të agjëruar.

E pesta: Njeriu që ka përgjegjësi duhet ta çlirojë veten me sa të jetë e mundur nga detyrimet fetare.

E gjashta: Hadithet që flasin për udhëtimet e të Dërguarit (a.s.), na bëjnë të kuptojmë se agjërimi dhe mosagjërimi ishin në varësi të arritjes së dobisë më të madhe dhe shmangies së dëmit dhe vështirësisë. Për këtë arsye, muslimani duhet t'i përmbahet në këtë pikë udhëzimit të Pejgamberit (a.s.).

E shtata: Hadithi i Hamza Eslemiut është fakt që njeriu duhet të pyesë për çdo gjë që i paraqitet, a është e lejuar apo është më e vlefshme, se kështu vepronin sahabët - Allahu qoftë i kënaqur me ta!

E teta: Prijësit i lejohet të urdhërojë njerëzit që të veprojnë më të lehtë, dhe në këtë rast ajo bëhet e detyrueshme, sepse ata e kanë detyrë t'i binden prijësit. Bindja ndaj prijësit, në këtë rast, nuk është mëkat.

E nënta: Prijësi duhet të sillet butë me ata që janë nën kujdesin e tij. Ai duhet të marrë në konsideratë gjendjen e të dobtëve. Pejgamberi (a.s.) i urdhëroi të gjithë shokët e tij që të prishnin agjërimin, për të qenë më të fortë në përballjen me armikun. Megjithëse në mesin e tyre kishte të fortë, që nuk ndikoheshin nga agjërimi, ngaqë ishin mësuar me të, kishte edhe të tjerë që agjërimi

²²⁵ Shënon Muslimi (1120), Ebu Daud (2406) dhe Amedi (3\35).

i dobësonte. Kështu, Profeti (a.s.) i urdhëroi të gjithë që të mos agjëronin, duke marrë parasysht kategorinë e atyre që i dobësonte agjërimi.

E dhjeta: Në të tilla rregulla, ku muslimani ka mundësi zgjedhjeje, ka lirshmëri, kështu që nuk duhet të qortojmë tjetrin për atë që zgjedh. Kjo vlen edhe për çështjet e diskutueshme, për të cilat nuk ka argumente të prera, pra edhe në këto çështje ka lirshmëri, në dashtë Allahu.

E njëmbëdhjeta: Mendimet e ndryshme të muslimanëve lidhur me trajtimin e disa lehtësimeve fetare apo mbi kuptimin e teksteve të Sheriatit nuk duhet të bëhen shkak për përçarje e armiqësi mes tyre.

E dymbëdhjeta: Këto hadithe tregojnë se sa të vëllazëruar e të dashur ishin dhe sa mirë i kuptonin çështjet e fesë sahabët - Allahu qoftë i kënaqur me ta! Ai që zgjidhte lehtësimin fetar të mosagjërimin nuk e shante atë që agjëronte dhe ai që agjëronte nuk e shante atë që zgjidhte lehtësimin.

E trembëdhjeta: Lejohet udhëtimi gjatë ramazanit. Vetë Profeti (a.s.) udhëtoi gjatë ramazanit vitin kur u çlirua Meka.²²⁶

E katërbëdhjeta: Kush ka ndër mend të udhëtojë të nesërmen, gjatë ramazanit, nuk i lejohet ta bëjë nijet që në darkë se nuk do të agjërojë të nesërmen, sepse nuk mund të konsiderohesh udhëtar për qëllimin që ke, por konsiderohesh udhëtar vetëm atëherë kur nis udhëtimin.²²⁷

E pesëmbëdhjeta: Kush ka ndër mend të udhëtojë, nuk i lejohet të prishë agjërimin kur është në vendin e tij, derisa të dalë në udhëtim ose të ketë hipur në mjetin e udhëtimit.²²⁸

27- Zbutja e epshit me agjërim

Ibn Mesudi (r.a.) përcjell se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “O të rinj! Kush ka mundësi prej jush të martohet, le të martohet, pasi kjo ndihmon për uljen e shikimit dhe për ruajtjen e nderit. Por kush nuk e ka këtë mundësi, atëherë le të agjërojë, sepse agjërimi e shuan epshin.”²²⁹

Gjithashtu, Xhabir Ibn Adilahi (r.a.) përcjell se, një burrë në moshë të re shkoj tek i Dërguari (a.s.) dhe i kërkoi që ta lejonte të tridhej. Profeti (a.s.) i tha: “Agjëro dhe lute Allahun që të të japë nga mirësitë e Tij”.²³⁰

²²⁶ Temhid (22\48).

²²⁷ Temhid (22\49).

²²⁸ Temhid (22\49).

²²⁹ Shënon Buhariu (1806) dhe Muslimi (1400).

Abdulla Ibn Amri (r.a.) tregon: “Një burrë shkoi tek i Dërguari (a.s.) dhe i tha: “O i Dërguari Allahut, më lejo që të tridhem!” I Dërguari (a.s.) i tha: “Për umetin tim, ‘tredhja’ është agjërimi dhe namazi i natës”.²³¹

Dobi dhe rregulla

E para: Dëshira e madhe që kishin sahabët (r.a.) për t’iu bindur Allahut të Lartësuar, frika e kundërshtimit të Tij, pyetja për çështjet e fesë dhe ambicia e tyre për botën tjetër.

E dyta: Ndalimi i tredhjes për ndërprerjen e epshit. Kjo vepër është haram.

E treta: Ai që do të martohet, por nuk ka mundësi, i lejohet të përdorë barna që frenojnë epshin, bazuar në urdhrin e Profetit për kurimin nëpërmjet agjërimit.²³²

E katërta: Vlera e martesës për ata që kanë mundësi. Martesa është ibadet dhe mirësi nga Allahu i Lartësuar.

E pesta: Ai që nuk ka mundësi për martesë, duhet të bëjë lutje, t’i kërkojë Allahut t’i japë prej mirësive të Tij dhe, njëkohësisht, duhet të agjërojë derisa t’ia mundësojë Allahu.

E gjashta: Tradita e Pejgamberit (a.s.) ishte të kënaqej me gjërat e këndshme dhe të lejuara, qofshin ushqime, pije apo edhe martesë. Kush i braktis këto gjëra me pretekstin e devocionit dhe ibadetit është në kundërshtim me Sunetin e Pejgamberit (a.s.).

28- Numri i rekatëve të teravive.

Aishja (r.a) tregon: “Pejgamberi (a.s.) nuk falte më tepër se njëmbëdhjetë rekatë namaz nate, as në ramazan dhe as në muajt e tjerë. Ai falte katër rekatë, - mos e pyet sa mirë e sa gjatë, - më pas falte sërish katër rekatë, - mos e pyet sa mirë e sa gjatë, - pastaj falte tre rekatë. I thashë njëherë:

²³⁰ Shënon Ahmedi (3\382) dhe Ibn Mubarek në Zuhd (1107). Transmetusit e tij janë të saktë, me përjashtim të transmetusi nga Xhabiri (r.a.) i cili është i panjohur, por dëshmojnë për të dy hadithet e tjera.

²³¹ Shënon Ahmedi (2\173), Begaviu në Sherhu suneh (2238). Hejthemiua ia referon Tabaranit, dhe thotë se transmetusit e tij janë “thikatë”, por disa prej tyre janë të diskutueshëm (4\253). Ahmed Shakir e vlerëson të saktë (6612). Edhe Albani thotë se është i saktë duke marrë parasysh rrugët e tij në “Silsileti sahihati” (1830), por pa shprehjen e fundit “namazi i natës”, pasi ajo është shtesë e dobët.

²³² Shih sherhu suneh të Begaviut (9\6).

O i Dërguari Allahut, a fle gjumë para se të falësh vitrin?” – “O Aishe, sytë e mi flenë, por zemra ime nuk fle!” – m’u përgjigj ai”.²³³

Në një variant tjetër po tek Buhariu dhe Muslimi shënohet: “I Dërguari (a.s.) falte gjatë natës trembëdhjetë rekatë, tek të cilët përfshihej vitri dhe dy rekatët e sabahut.”²³⁴

Musruki (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “E pyeta Aishen (r.) për namazin e të Dërguarit (a.s.) gjatë natës. Ajo tha: “Falte shtatë, nëntë ose njëmbëdhjetë rekatë, përveç dy rekatëve të sabahut”.²³⁵

Ibn Abasi (r.a.) thotë: “I Dërguari (a.s.) falte gjatë natës trembëdhjetë rekatë namaz”.²³⁶

Abdurrahman Ibn Hurmuz E’arexhi ka thënë: “Njerëzit që kam gjetur, që kur i mbaj mend, i mallkonin qafirat në lutje gjatë namazit të taravive në ramazan. Kënduesi që u printe njerëzve në namaz lexonte suren Bekare në tetë rekatë. Po ta lexonte për dymbëdhjetë rekatë, njerëzit mendonin se e kishte falur namazin shkurt”.²³⁷

Dobi dhe rregulla

E para: Namazi i Profetit (a.s.) gjatë natës në ramazan ishte i njëjtë me atë në muajt e tjerë.²³⁸

E dyta: Një veçori e profetëve është se atyre iu flinin sytë, por jo zemrat, prandaj ëndrrat e profetëve ishin të vërteta.²³⁹

E treta: Dijetarët janë në ixhma (një mendje) se namazi i natës në Ramazan dhe jashtë tij është i gradës sunet. Masa e tij nuk është e përcaktuar, prandaj sipas dëshirës, dikush zgjat qëndrimin në këmbë dhe shkurton numrin e rekatëve, e dikush tjetër shkurton qëndrimin në këmbë dhe shton rekatët.²⁴⁰

E katërta: Tradita e Pejgamberit në faljen e namazit të natës, në Ramazan dhe jashtë tij, ishte qëndrimi i gjatë në këmbë, në ruku dhe sexhde, duke mos falur më tepër se njëmbëdhjetë rekatë. Kjo është më mirë se të falesh shkurt e të shtosh numrin e rekatëve.²⁴¹

²³³ Buhari (1096) dhe Muslimi (738).

²³⁴ Ky është varianti që përcjell Buhariu (1089), por i ngjashëm me të është dhe tek Muslimi (738).

²³⁵ Ky është varianti i Buhariut (1088).

²³⁶ Shënon Buhariu (1087) dhe Muslimi (764).

²³⁷ Shënon Maliku (1\151), Abdurrezaku (7734) dhe Bejhakiu 2\497) me isnad të saktë. Abdurrahman ibn Hurmuz, i cili ka qenë prej tabiinëve të mëdhenj, tregon në rrëfimin e tij sesi vepronin banorët e Medines në kohën e Tij. Shih jetëshkrimin e tij në Sijer a’lam ennubela (5\69).

²³⁸ Istidhkarë (2\98).

²³⁹ Istidhkarë (2\101) Sherhu Nevevij (6\21).

²⁴⁰ Istidhkarë (2\102) Temhid (21\70).

²⁴¹ Shih mexhmuë fetava Shejh Islam (23\69-72).

E pesta: Kishte raste kur Profeti (a.s.) falte më tepër se njëmbëdhjetë rekatë, pra falte trembëdhjetë rekatë. Ndoshta falte edhe më pak, si shtatë ose nëntë rekatë, bazuar në hadithe të tjera. Ndërsa Aishja (r.a.) tregon se si vepronte më së shumti Profeti (a.s.), që praktika e tij e rregullt ishte të mos i kalonte njëmbëdhjetë rekatë.²⁴²

E gjashta: Profeti (a.s.) jepte selam pas dy rekatëve. Ndërsa falja e katër rekatëve - ose më shumë - me një selam bie ndesh me traditën e vazhdueshme të tij. Bazë për këtë është fjala e Aishes (r.a.) kur përshkruan namazin e Profetit (a.s.) gjatë natës: "Ai jepte selam pas dy rekatëve dhe përfundonte me një rekat tek".²⁴³

Gjithashtu, Profeti (a.s.) ka thënë: "Namazi i natës është dy e nga dy."²⁴⁴ Këtu nuk bën fjalë për namazin e vitrit, sepse muslimani mund ta falë vitrin tre ose pesë rekatë, duke u ulur për teshehud veçse në fund të tyre, siç përcillet në hadithin e Aishes (r.a.), e cila thotë: "I Dërguari i Allahut falte gjatë natës trembëdhjetë rekatë, nga të cilët pesë i kishte vitër. Në vitër ai ulej për teshehud veçse në fund".²⁴⁵

E shtata: Sahabët dhe tabiinët - Allahu qoftë i kanaqur prej tyre! - e zgjasnin namazin e teravive. Kjo ishte tradita e tyre në Medinë, siç dëshmon tabi'ini i nderuar Adurrahman Ibn Hurmuz - Allahu i Lartësuar e mëshiroftë!

E teta: Lejohet mallkimi dhe lutja kundra qafirëve në duanë e kunutit, në namazin e teravive, qoftë ndaj atyre me të cilët kemi pakt sigurie, qoftë ndaj atyre që nuk kemi të tillë pakt, sepse ata e meritojnë për shkak të kufrit të tyre. Megjithatë, kjo nuk është e detyrueshme. Tradita e Pejgamberit në këtë çështje është t'i lutemi Allahut kundra kafirëve me të cilët jemi në gjendje lufte, t'i shkatërrojë e t'i ndëshkojë, ndërsa për ata me të cilët kemi marrëdhënie paqësore apo që shpresohet hyrja e tyre në islam t'i lutemi Allahut që t'i udhëzojë e t'i drejtojë.²⁴⁶

E nënta: Gjatë Ramazanit, sahabët dhe tabiinët në Medinë, lutjen që bënin kundra qafirëve në kunut e bazonin në duanë e kunutit të Profetit (a.s.) në rastet e fatkeqësive për vrasjen e

²⁴² Shih fetvanë (9353) të Komisionit të përhershëm të fetvave. Fet'hu ElBari i Ibn Haxher (3\20), Sherh Nevevji (6\18) dhe Subul selam (2\13).

²⁴³ Sahih Muslim (736).

²⁴⁴ Shënon Buhariu (946) dhe Muslimi (749) nga Ibn Umeri (r.a.). Shejh Ibn Baz (Allahu e mëshiroftë!) ka nxjerr një vërejtje ku kritikon ata imamë xhamiash që falin katër rekate taravi të njëpasnjëshme me një selam, më datë 19\9\1414h. Këtë praktikë e ka kritikuar edhe Shejh Ibn Utheimi (Allahu e mëshiroftë!) në librin Fikhu el Ibadatë (203-205).

²⁴⁵ Shënon Muslimi (737).

²⁴⁶ Shih librin Istidhkarë (2\73). Buhariu në kapitullin e lutjeve, në temën me numër (58), dhe në kapitullin 'el xhihadi ue sije', në temën me numër (98), vendos si nënkaptull temën: "Lutje kundër idhujtarëve për shpartallim dhe tronditje". Me këtë temë ai ka përmendur hadithe që dëshmojnë për diçka të tillë. Gjithashtu Buhariu në kapitullin e 'lutjeve' ka vendosur në librin e tij një nënkaptull tjetër (59) me temë: "Lutja për të mirën e paqësorëve prej tyre". Ndërsa në kapitullin e xhihadit, ka vendosur nënkaptullin (100) me temë: "Lutja për idhujtarët që të udhëzohen, si një mënyrë për të fituar zemrat e tyre". Për më shumë, unë kam sjellë fjalët e dijetarëve rreth kësaj çështjeje në një studim të shkurtër në librin "el Mufid fi hutabi xhumati uel iid (3\279-294).

kënduesve të Kuranit nga fiset Riël, Dhekuan, Beni Lahjanë dhe Usajetu.²⁴⁷ Banorët e Medinës e bënë një gjë të tillë nga gjysma e Ramazanit deri në fund të tij²⁴⁸.

E dhjeta: Lutja kundra qafirëve që bëhet ditën e xhuma, në pjesën e dytë të hutbes, bazohet në veprën e sahabëve dhe tabi'inëve të mëdhenj, në Medinë, të cilët i mallkonin qafirët kur bënë duanë e kunutit. Hafidh Ibn Abdulberri (Allahu e mëshiroftë!), mbas konfirmimit të këtij përfundimi, thotë: "A'rexhi ka patur mundësinë të arrijë një numër të konsiderueshëm sahabësh dhe tabi'inësh të mëdhenj. Prandaj, kjo do të thotë se kështu veprohej në Medinë".²⁴⁹

29- Kur e prish agjërimin udhëtari?!

Xhaferri Ibn Xhebri rrëfen: "Njëherë, hipa bashkë me Ebu Besra El Gifarin, një shok i Pejgamberit (a.s.), në një anije nga qyteti i Fustatit (në Egjipt), në muajin e Ramazanit. Sapo hipi dhe u nis anija, ende pa i kaluar shtëpitë, ai kërkoi që t'i shtrohej sofa e ushqimit. Pasi u shtrua sofa, më ftoi për të ngrënë, por unë i thashë: "A nuk i sheh shtëpitë?! " Ebu Besra tha: "Si kështu, po i largohesh sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.)?!" Xhaferri tregon më pas se Ebu Basre hëngri.²⁵⁰

Përcillet nga Muhamed Ibn Kabi se ka thënë: "I shkova Enes Ibn Malikut në Ramazan, kur donte të udhëtonte, ndërsa kafshën e kishte të përgatitur për udhëtim. Ndërkohë që veshi rrobat e

²⁴⁷ - Istidhkarë (2\73).

²⁴⁸ [Ebu Daudi dhe Bejhakui kanë sjellë dy transmetime, njëri nga Haseni dhe tjetri nga Ibn Sirini se Ubeji bente lutje kunuti veçse në gjysmën e dytë të ramazanit, por këto dy transmetimi janë të dobëta. Në një transmetim të saktë që gjendet tek Ibn Huzejme përmendet se në gjysmën e dytë të ramazanit, në kohën e Umerit, bënë lutje që Allahu t'i shkatërronte qafirët, transmetim ky i përmendur në mësimin e tetë. Euzaiu, siç shënon Bejhakui, ka treguar se në përgjithësi bëhej kunutë nga fillimi i ramazanit deri në fund të tij, me përjashtim të banorëve të Medinës të cilët bënë lutje kunuti veçse në gjysmën e fundit të ramazanit. Bejhakui sqaron se hadithi i Enesit ku tregohet se Pejgamberi bënte lutje kunuti nga gjysma e ramazanit deri në fund të tij është i dobët. Në një hadith të saktë të cilin e shënon Ebu Daudi, tregohet se Pejgamberi e bënte lutjen e kunutit të vitrit para rukuje. Nga shqyrtimi i hollësishëm i transmetimeve në këtë temë del se Pejgamberi nuk e bënte rregullisht lutjen e kunutit të vitrit, kështu që është mirë të lihet ndonjëherë]

²⁴⁹ Referimi i mëparshëm (2\75).

²⁵⁰ Shënon Ebu Daudi (2412), Amedi (6\398), Darimiu (1713), Taberani në El Kebir (2\279-280) me numër (2169-2170). Shukani thotë: Transmetusit e tij janë të saktë, Nejlu eutarë (4\311). Shih Tuhfetu El Afedhi (3\430). Albani e vlerëson të saktë në librin Irvaë (4\163) me numër (928).

udhëtimit, kërkoi t'i jepej ushqim dhe hëngri. Unë i thashë: "Sunet është ky veprim?" Ai tha: "Po, sunet është", - dhe i hipi kafshës".²⁵¹

Dobi dhe rregulla

E para: Nga suneti i Pejgamberit është dhe mosagjërimi në udhëtim. Nga i Dërguari (a.s.) është përcjellë se ai edhe ka agjëruar në udhëtim, edhe nuk ka agjëruar. Një gjë e tillë është përcjellë edhe për sahabët në disa udhëtime me të Dërguarin (a.s.).

E dyta: Këto hadithe tregojnë se kush fillon udhëtimin, i lejohet që ta prishi agjërimin, edhe nëse nuk e ka kaluar qytetin ose fshatin, prej të cilit nis udhëtimin. Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Kur nisin udhëtimin sahabët, e prishnin agjërimin, pa marrë parasysh kalimin e shtëpive të vendbanimit. Ata thoshin se kjo qe tradita e Pejgamberit (a.s.)."²⁵²

E treta: Nga hadithet përfitohet se, kushdo që gdhin agjëruet dhe më pas niset për udhëtim, i lejohet që ta prishë agjërimin gjatë ditës, ndryshe nga ata që e ndalojnë një gjë të tillë. Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Nga këto dëshmi del fare qartë se kushdo që niset për udhëtim gjatë ditës së Ramazanit, ka të drejtë ta prishë agjërimin".²⁵³

30- Marrdhëniet seksuale gjatë ditës së agjërit

Ebu Hureja (r.a.) tregon: "Ndërkohë që ne ishim ulur me të Dërguarin (a.s.), erdhi një burrë dhe tha: "U shkatërrova, o i Dërguari i Allahut!" - "Pse u shkatërrove?" - i tha ai. Ai u përgjigj: "Kam kryer marrëdhënie intime me gruan time në Ramazan". Profeti (a.s.) i tha: "A ke pasuri të lirosh një rob?" Ai tha: "Jo!" - "A mundesh të agjërosh dy muaj pa ndërprerje?" - e pyeti. - "Jo!" - i tha sahabi. Profeti (a.s.) e pyeti: "A ke me se të ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?" - "Jo" - u përgjigj ai.

²⁵¹ Shënon Tirmidhiu dhe thotë: Hadithi është hasen (799-800). Shënon edhe Dijau në El Muhtarë (2602), Darekutni (2\187), Bejhakiu (4\247). Albani e vleron të saktë në Irvaë (4\64) dhe në Sahih Termidhi.

²⁵² Zadu el mead (2\56). Kjo është një çështje për të cilën ka mosmarrëveshje. Nga imam Ahmedi përcillet se e prish agjërimin mbasi të kesh dalë nga shtëpitë, kurse Is'hak Ibn Rahavejhi thotë: "Që momentin kur vendos këmbën në mjetin e udhëtimit udhëtarit i lejohet të prishë agjërimin, siç veproi Enesi (r.a.). Shih: El Mugni (4\345-348) dhe Fet'h Bari (4\180-182).

²⁵³ Zadu el mead (2\57). Shih dhe Tehdhib es sunen (7\39). Kështu thotë edhe Sha'biu, Ahmedi, Is'haku, Daudi, dhe Ibn Mundhiri, ndryshe nga mendimi i tre imamëve dhe i Euzait të cilët janë të mendimit se kushdo që gdhin agjëruet dhe do të udhëtojë nuk i lejohet ta prishi agjërimin e asaj dite. Shih: Muhtesar sunen Et Tirmidhi (3\291).

Profeti priti njëfarë kohe dhe pastaj i sollën një kosh me hurma arabie (rreh 30 kg – sh.p). Profeti (a.s.) i tha: "Merri këto dhe jepi sadaka! Ai tha: "T'ua jap atyre që janë më të varfër se ne?! Pasha Allahun, nuk ka shtëpi në Medine më nevojtare për to sesa ne!" Profeti (a.s.) qeshi derisa iu dukën dhëmballët, pastaj tha: "Shko dhe ushqe me to familjen tënde!".²⁵⁴

Dobi dhe rregulla

E para: Kush kryen marrëdhënie intime gjatë ditës së Ramazanit pa arsye, siç janë: udhëtimi, harresa apo detyrim me forcë, ka kundërshtuar Allahun e Madhëruar, ka bërë gjynah. Ai duhet të pendohet dhe njëkohësisht duhet ta vazhdojë agjërimin e asaj dite. Gjithashtu, agjërimi i asaj dite quhet i prishur, prandaj është e detyrueshme shlyerja e tij.²⁵⁵

E dyta: Për shlyerjen (*kefare*-n) respektohet kjo radhë: së pari, fillohet me lirimin e robit. Nëse nuk ka mundësi, agjëron dy muaj pa ndërprerë, e nëse nuk mundesh, ushqen gjashtëdhjetë të varfër.

E treta: Nga hadithi përfitohet se burrit i lejohet të tregojë gjëra që ndodhin mes tij dhe gruas, nëse është e nevojshme.²⁵⁶

E katërta: Nëse njeriu bën ndonjë gjynah dhe pyet për gjykimin e tij apo çfarë detyrimi ka, kjo nuk konsiderohet shfaqje e gjynahut.²⁵⁷

E pesta: Sjellja e butë me ata që mëson, përfitimi i zemrave në fe, pendimi për mëkatën e bërë dhe ndjenja e frikës nga Allahu i Lartësuar.²⁵⁸

E gjashta: Lejohet t'i jepet ushqimi i shlyerjes një familjeje.²⁵⁹

E shtata: Interesimi që tregonin shokët e Muhamedit (a.s.) për pastrimin e nefsit, për të shpëtuar nga shkaqet e dënimit.²⁶⁰

²⁵⁴ Shënon Buhari (1834) Muslimi (1111).

²⁵⁵ Fetava erkan el Islam i Ibn Utnejmin (474) dhe Sherhu el mumti (6\401). Shumica e dijetarëve janë të mendimit që ai duhet ta zëvendësojë atë ditë, shih: Mufhim (3\172). Rreth kësaj zëvendësimit (kazasë) së kësaj dite ka sjell një hadith Ebu Daudi (2287), Maliku (1\297) dhe Darekutni (2\190). Ku thuhet se Pejgamberi e urdhëroi atë ta agjërojë kaza atë ditë, por ky transmetim ka probleme. Edhe transmetimi tjetër që gjendet tek Ebi Daudi (2393), në të cilën përmendet se duhet ta agjëroj kaza atë ditë, është *shadh* (i pasaktë, jonormativ), sepse katër transmetues kanë kundërshtuar dyzet transmetues të tjerë, shih Tehdhīb sunen të Ibn Kajimit (7\18-19). Mendimi i dytë është se ai nuk e agjëron kaza. Këtë mendim e ka përkrahur Shejh el Islam Ibn Tejmije, duke thënë: "Po ta kishte urdhëruar për diçka të tillë, nuk do ta kishin lënë pa transmetuar gjithë këta transmetues. Kjo është një dispozitë që duhej sqaruar, që do të thotë se përderisa nuk e ka urdhëruar për ta bërë kaza, kjo tregon që zëvendësimi (kazaja) i kësaj dite nuk i pranohet". Marrë nga Hakikatu es sijam (25- 26).

²⁵⁶ Fet'hu el bari i Ibn Haxherit (4\173).

²⁵⁷ Sherh Ibn Mulkin alaelumdeti (5\215).

²⁵⁸ El Feth (4\173).

²⁵⁹ Rferimi i më parshëm (4\174).

E teta: Personi që ka detyrë shlyerjen i lejohet të hajë prej ushqimit të *kefare-s* (shlyerjes) nëse nuk ka ç'të japë, gjithashtu një personi të tillë i lejohet që këtë masë ushqimi t'ia japë sadaka dhe familjes së tij.²⁶¹

E nënta: Burri ka detyrë të shpenzojë për familjen edhe kur nuk ka ç'të shpenzojë. Buhariu - Allahu i Lartësuar e mëshiroftë! - ka titulluar një nënkapitull në librin e tij: "Shpenzimi i të varfërit për familjen".²⁶²

E dhjeta: Kjo shlyerje e rëndë është për atë që e prish agjërimin me marrëdhënie intime, jo për ata që e prishin me të ngrënë e të pirë. Sipas kësaj që u përmend, jepet edhe fetvaja nga dijetarët.²⁶³

E njëmbëdhjeta: Gëzimi i prijësit me kryerjen e nevojave të vartësve, qofshin ato që kanë lidhje me këtë botë dhe me botën tjetër.²⁶⁴

E dymbëdhjeta: Njeriut i lejohet që të ankohet për hallin që ka tek dikush që ka mundësi ta ndihmojë, nëse kjo nuk tregon pakënaqësi me caktimin e Zotit.

E trembëdhjeta: Nëse ka kryer marrëdhënie intime në një ditë të Ramazanit, dy herë ose më shumë, dhe nuk ka bërë shlyerjen e këtij gjynahu, ai bën vetëm një shlyerje, dhe për këtë nuk ka mospajtim mes dijetarëve.²⁶⁵

E katërbëdhjeta: Nëse kryen marrëdhënie intime në dy ditë të Ramazanit apo më shumë, muslimani ka detyrë të bëjë shlyerje për çdo ditë të Ramazanit.²⁶⁶

E pesëmbëdhjeta: Nëse muslimani kryen marrëdhënie intime kur është duke agjëruar për të zëvendësuar (kaza) ditët që ka prishur në Ramazan, atij i prishet agjërimi dhe ka detyrë të agjëroj atë ditë më vonë, dhe nuk e ka detyrë shlyerjen, sepse shlyerja bëhet vetëm për shkak të shkeljes

²⁶⁰ Bulug elmeram me shpjegimin e Fajrabit (1\426).

²⁶¹ Blug el meram me shpjegimin e Fajrabit (1\426).

²⁶² Shih Buhari (5\2053). Shih: Shrh Ibn Mulkin ala elumdeti (5\254).

²⁶³ Në kundërshtim me Hanefitë dhe Malikitë të cilët thonë se edhe ai që ha e pi duhet të bëjë *kefare-n*. Shih: El Mufhim (3\173). Mendimi tjetër është që nuk është detyrë shlyerja e rëndë për ngrënien dhe pirjen, dhe ky është mendimi i shafive dhe hanbelive, bazuar në kuptimin e drejtpërdrejtë të tekstit të hadithit të mësipër në të cilin kjo kefare e rëndë është caktuar për prishjen e ditës së ramazanit me marrëdhënie intime, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, nuk përmendet gjë në të për gjërat e tjera që prishin agjërimin. Por edhe duke marrë parasyshë faktin tjetër që, parimisht, njeriu nuk ka detyrë të shlyej për veprimet e tij, përveç nëse ka ndonjë argument të qartë që veprimi duhet të shlyhet. Shih: Fetvatë e Lexhnes (93930).

²⁶⁴ Bulug me shpjegim të Fejrabit (1\426).

²⁶⁵ Mexhmuë (6\349) dhe Eshbah ue nedhair li Sujuti (127).

²⁶⁶ Mugni (4\386) dhe el Mexhmu (6\386). Ky është qëndrimi i lexhne daime (komisionit të përhershëm të dijetarëve). Ndërsa Ibn Xhibrini (Allahu e mëshiroftë!) ka dhënë fetva se nëse muslimani kryen marrëdhënie intime në dy ditë të ramazanit dhe nuk ka bërë shlyerje për asnjërën ditë, ai e ka detyrë të bëjë vetëm një shlyerje për të dyja ditët "Fetava sijam (70).

së shenjtërisë së Ramazanit, sipas mendimit më të saktë, ndërsa agjërimi kaza nuk e ka një shenjtëri të tillë.²⁶⁷

E gjashtëmbëdhjeta: Kushdo që e gjen agimi duke kryer marrëdhënie intime dhe e shkëput kontaktin menjëherë, nuk ka detyrë asgjë. Nëse vazhdon kontaktin me gruan, ai është mëkatar, prandaj duhet të pendohet dhe ka detyrë shlyerjen, por këtë ditë duhet të vazhdojë të ruhet nga gjërat që e prishin agjërimin.²⁶⁸

E shtatëmbëdhjeta: Kush e prish agjërimin duke ngrënë ose pirë për të kryer marrëdhënie intime, ai është mëkatar, për shkak të prishjes së agjërit pa arsye dhe mashtrimit në fe. Ndaj tij nuk bie detyrimi i shlyerjes.²⁶⁹

E tetëmbëdhjeta: Mësojmë për tolerancën dhe lehtësinë që karakterizojnë legjislacionin e kësaj feje (Sheriatin). Toleranca dhe lehtësia shfaqen qartë në rastin e këtij burri, i cili bëri këtë mëkat kaq të madh në Ramazan. Ai shkon i frikësuar tek Profeti (a.s.), dhe thotë: “U shkatërrova!”. Në një variant tjetër thuhet: “Mendoj se jam shkatërruar!”. Kjo tregonte që ai ishte penduar, dhe Allahu ia pranoi pendimin. Profeti (a.s.) i dha hurmat e arabisë për ta shlyer atë mëkat, ndërsa ai ia dha familjes së vet, ngaqë ishin shumë të varfër. Për këtë arsye qeshi i Dërguari (a.s.).²⁷⁰

E nëntëmbëdhjeta: Nëse njeriu nuk e di se është ditë Ramazani dhe kryen marrëdhënie intime, mendimi më i saktë është se ai nuk e ka detyrë shlyerjen.²⁷¹

E njëzeta: Nëse kryen marrëdhënie intime me harresë, agjërimin e ka të saktë dhe nuk ka detyrë as shlyerjen dhe as agjërimin kaza.²⁷²

31- Vlera e faljes së teravive me xhemat

Përcillet se Ebu Dherri (r.a.) ka thënë: “Njëherë, në kohën që agjëronim me të Dërguarin (a.s.) muajin e Ramazanit, ai nuk e fali asnjë natë me ne namazin e teravive derisa kishin mbetur vetëm shtatë netët e fundit të muajit. Kur kishin mbetur vetëm kaq netë (pra kur ishin në natën e

²⁶⁷ Shih: El Um (2\100), Tefsirin e Kurtubiut (2\284) dhe el Mugni. Ibn Kudame e sjell këtë mendim nga shumica e dijetarëve përveç Katades (4\378). Kështu ka dhënë fetva edhe komisioni i përhershëm i fetvave (13475).

²⁶⁸ Shih: EL Mexhmu (6\316) dhe Rroudatu talibin (2\365). Në Mugni (4\379) dhe Keshaful Kinaë (2\325) sillet mendimi tjetër që thotë se, edhe nëse e shkëput kontaktin menjëherë, prishet agjërimi, sepse shkëputja e kontaktit është kënaqësi. Bejhakiu sjell në Sunen (4\219) se Ibn Umeri (r.a.) ka thënë “Nëse thirret ezani ndërkohë që burri është duke kryer marrëdhënie me të shoqen, kjo gjë nuk ka pse ta ndalojë nga agjërimi. Nëse do të agjërojë, ai duhet të çohet dhe të marrë gusël, e pas kësaj plotëson ditën e agjërit”. Kjo është e sakta, në dashtë Allahu i Lartësuar.

²⁶⁹ Shih Mexhmu fetava të Ibn Tejmijes (25\260) dhe elëlam el muvakiin (3\247).

²⁷⁰ Shih: Munhat elBari (4\379) dhe Fet’hulbari (4\171).

²⁷¹ Ky është mendimi që ka zgjedhur Ibn Tejmie në Fetava (25\228), por edhe Ibn Ibrahim në fetvatë e tij (4\195).

²⁷² Shih: El Umm (2\99), Istidhkarë (10\111), Mufhim (3\169) dhe Sherh Ibn Mulekin ala elumdeti (5\217).

23 të muajit), ai u çua dhe fali me ne teravitë, derisa kaloi një e treta e natës. Një natë më pas nuk i fali me ne. Natën e pestën të mbetur na i fali gjersa kaloi gjysma e natës. Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, sikur të na falje më tepër nafie me xhematë edhe pjesën e mbetur të natës...” Profeti (a.s.) tha: “Nëse burri falet me imamin, derisa ai të largohet, i llogaritet sikur është falur gjithë natën.” Ebu Dherri thotë më pas: “Natën e katërt të mbetur nuk na i fali. Kurse natën e tretë të mbetur, Profeti mblodhi familjen dhe njerëzit e tjerë dhe fali me ne teravitë derisa patëm frikë se mos na ikte felahu.” Transmetuesi thotë: “E pyeta: Ç’është felahu?” – “Syfyri” - më tha ai.” Profeti (a.s.) – vijon Ebu Dherri - nuk na i fali me xhemat pjesën e mbetur të muajit”.²⁷³

Dobi dhe rregulla

E para: Namazi i teravive është sunet. Profeti (a.s.) i fali ato njëherë, dhe pastaj i ndërpreu, nga droja se mos bëheshin detyrë për muslimanët

E dyta: Namazi i teravisë me xhematë në xhami është i ligjshëm edhe për gratë, sepse edhe Profeti (a.s.) grumbulloi familjen, gratë e veta dhe njerëzit, dhe u fal me ta.

E treta: Kush ngrihet e falet me imamin, derisa imami të largohet, do t’i shkruhet sikur është falur gjatë gjithë asaj nate. Muslimani nuk duhet ta neglizhojë këtë mirësi të madhe. Ai duhet të përpiqet që ta plotësojë namazin e teravive bashkë me muslimanët në çdo natë të Ramazanit. Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) është pyetur: “Të pëlqen që personi të falet vetëm në Ramazan apo me xhemat?” Ai tha: “Të falet me xhemat, se kështu ngjall sunetin profetik.” Pastaj tha: “Mua më pëlqen që t’i falë teravitë dhe vitrin me imamin”.²⁷⁴

E katërta: Namazi i teravive është sunet që të falet në fillim të natës, siç ka vepruar i Dërguari (a.s.) dhe sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) është pyetur: “A duhet të shtyhet falja e namazit të natës - d.m.th teravisë – deri në fund të natës?” – “Jo, - u përgjigj ai, - tradita e muslimanëve më pëlqen më shumë”.²⁷⁵

Është pyetur dijetari i nderuar Abdulaziz Ibn Bazi (Allahu e mëshiroftë!): “Po sikur besimtarët të bien dakord që namazin e vitrit ta falin në fund të natës?” – “Namazi me xhemat bashkë me njerëzit në fillim të natës është më mirë” - tha ai.

E pesta: Nëse njeriu është aktiv dhe ka forcë për të bërë adhurim, e plotëson namazin me muslimanët në fillim të natës, më pas, në fund të natës, falet më vete sa të dëshirojë. Në këtë mënyrë, ai arrin dy të mirat, faljen me imamin derisa ai largohet dhe mirësinë e namazit në fund të natës.

²⁷³ Ebu Daudi (1375) dhe Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është i mirë dhe i saktë (806). Shënon dhe Nesai (3\83), Ibn Maxhe (1327) dhe Ahmedi (5\163). Hadithin e ka vlerësuar të saktë Ibn Huzejme (2205) dhe Ibn Hibani (2547).

²⁷⁴ Tuhfetu El Ahfedhi (3\448) shih: Mugni (1\457).

²⁷⁵ EL Mugni (1\457).

32- Koha e çeljes së iftarit.

Ibn Umeri (r.a.) përcjell se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Kur të vijë nata që këndeje (nga ana e lindjes) dhe të largohet dita që andej (nga ana e perëndimit) dhe të perëndoje dielli, hyn koha e çeljes së agjëruesit". Këtë hadith e sjell Buhariu e Muslimi.²⁷⁶ Në një variant tek Tirmidhiu thuhet kështu: "...dhe kur zhduket dielli (perëndon disku i tij), hyn koha e çeljes".²⁷⁷

Kurse në variantin e Ebu Daudit thuhet: "Kur vjen dita këndeje (nga ana e lindjes) dhe kur largohet dita që andej (nga ana e perëndimit), dhe humb dielli, hyn koha e çeljes së agjëruesit".²⁷⁸

"Abdullah Ibn Ebu Eufa tregon: "Ishim me Pejgamberin (a.s.) në një udhëtim. Sapo perëndoi dielli, Pejgamberi i tha një burri: "Zbrit dhe më trazo çorbën me ujë!" Ai tha: "O i Dërguari i Allahut! Sikur të prisje derisa të binte plotësisht mbrëmja!" Pejgamberi sërish i tha: "Zbrit dhe trazo çorbën (për të çelur)". Ai tha: "O i Dërguari i Allahut! Sikur të prisje derisa të binte plotësisht mbrëmja! Ke akoma ditë!" – "Zbrit dhe trazo çorbën!", - i dha urdhër për herë të tretë Pejgamberi (a.s.). Kështu, pas herës së tretë, burri zbriti dhe trazoi çorbën". Pejgamberi a.s., pasi piu, bëri shenjë me dorë nga lindja, duke thënë: "Kur të shikoni natën duke ardhur që këndeje, ka hyrë koha e çeljes së agjëruesit!".²⁷⁹ Në një variant tek Muslimi thuhet se: "Bëri me shenjë nga lindja". Kurse në variantin e Ahmedit thuhet: "...ka ardhur koha e çeljes së agjërimit". Ndërsa tek varianti i Ebu Daudit përmendet se: Këtë ia ka thënë Bilalit (r.a.).²⁸⁰

Dobi dhe Rregulla:²⁸¹

²⁷⁶ Buhariu (1853) dhe Muslimi (1100).

²⁷⁷ Xhamiu Tirmidhi (698) dhe thotë: Hadithi është i mirë i saktë. Shënon dhe Ahmed (1\35) e Daremiu (1700).

²⁷⁸ Sunen Ebi Daud (2351), Ahmed (1\54) dhe Ibn Ebi Shejbe (2\277).

²⁷⁹ Buhari dhe Muslimi.

²⁸⁰ Buhariu (1854), Muslimi (1101), Ebu Daudi (2352) dhe Ahmed (4\382).

²⁸¹ Sherhu Ibn Betal ala el Buhari (4\103), Sherhu i Neveviut 7\209-211), Mufhim (3\158-159), ElFet'h (4\196-198) dhe Aunu el Maëbudë (6\343).

E para: Kur dielli perëndon, agjëruesit i lejohet të çelë. Shprehja ‘...kur të vijë nata që këndeje (nga ana e lindjes) dhe të largohet dita që andej (nga ana e perëndimit)..’ nënkupton fshehjen e diskut të diellit në perëndim edhe pse në horizont e nëpër rrugica vazhdon të ketë akoma ndriçim.²⁸²

E dyta: Profeti (a.s.) ishte i interesuar që të sqaronte dispozitat e Sheriatit me hollësi. Shohim që ai ka treguar tre shenja që tregojnë kohën e iftarit: ardhja e natës, ikja e ditës, perëndimi i diellit. Në fakt, kur shfaqet njëra shenjë, patjetër që shfaqen edhe të tjerat. Profeti (a.s.) i ka përmendur të gjitha, - dhe Allahu e di më së miri, – për faktin se ndoshta agjëruesi nuk e sheh perëndimin e diskut të diellit për shkak të ndonjë pengese, mirëpo shikon nga ana e lindjes që ka rënë errësira e natës, dhe në këtë rast i lejohet të çelë iftarin.²⁸³

²⁸² Kurtubiu thotë: " Bilali ia tha një gjë të tillë, sepse ai shikonte rrezet e diellit të shkëlqenin, edhe pse ishte zhdukur disku i tij. I Dërguari (a.s.) nuk e mori parasyshtë shkëlqimin e rrezeve, por perëndimin e diskut të diellit. Pas kësaj, Pejgamberi sqaroi shenjën që duhet të marrë parasyshtë ai që nuk shikon dot diskun e diellit: e kjo shenjë është errësira që shfaqet nga ana e lindjes". Marrë nga libri Mufhim (3\159). [Nëse njeriu ndodhet në një vend ku shikohet perëndimi i diellit, si në shkretëtirë, fushë, rrafshnaltë, lartësi malore, kodrinore, detë, bregdet, ku nuk e pengon nga shikimi i perëndimit ndonjë mal apo kodër, koha e akshamit dhe e çeljes për të hynë me tu fshehur diksu i diellit, edhe pse mbeten akoma rrezet dhe shkëlqimi i tij në horizont apo tek retë. Në këtë rast nuk është e nevojshme të shihen shenjat e tjera, si ardhja e errësirës nga lindja, edhe pse perëndimi i diellit në fakt shoqërohet me humbjen e rrezeve të tij dhe shfaqjen e errësirës në lindje. Sipas versionit të Abdurrezakut, Abdullah Ibn Ebi Eufa thotë: "Ishim me Pejgamberin a.s. në një udhëtim. Pejgamberi, ngaqë ishte agjërues, i tha një burri: "Zbrit dhe më trazo një pije!" Ai tha: "O i Dërguari i Allahut! Ja, rrezet e diellit!" Pejgamberi sërish i tha: "Zbrit dhe trazo pijen (për të çelur)". Kështu, ai zbriti, trazoi pijen dhe Pejgamberi piu". Sikur në këtë moment të përpiquej ndonjëri që ishte hipur në deve për të shikuar diellin, kishte për ta parë! Mbasi piu, Pejgamberi a.s. bëri shenjë me dorë nga lindja, duke thënë: "Kur të shikoni natën duke ardhur që këndeje, ka hyrë koha e çeljes së agjëruesit"].

²⁸³ [Kur njeriu ndodhet në një luginë, pas një kodre apo pas një mali, ku nuk shihet perëndimi i diellit, duhet të presë derisa të mos duken më rrezet e diellit në majat e kodrave e të maleve apo të fillojë errësira në anën e lindjes, sikurse kanë përmendur dijetarët në shpjegimin e haditheve të mësipërme të Ibn Ebi Eufas dhe të Umer Ibn Hatabit. Ashtu sikurse shfaqet agimi për hyrjen e kohës së sabahut në anën e lindjes, ndërkohë që gjithandej ka errësirë, po ashtu shfaqet errësira në anën e lindjes kur hynë koha e akshamit, kur perëndon dielli, ndërkohë që gjithandej ka ditë. Neveviu thotë: "Dijetarët kanë thënë se Pejgamberi a.s. e ka përmendur perëndimin e diellit, shfaqjen e errësirës (në anën e lindjes) dhe largimin e ditës (në anën e perëndimit), për të qartësuar se perëndimi i diellit nga sytë (jo gjithmonë) është i mjaftueshëm, pasi ka mundësi që në disa vende dielli të zhduket nga sytë, edhe pse nuk ka perënduar realisht, kështu që (në vende të tilla) pajtetër duhet të merret parasyshtë rënia e errësirës së natës (nga ana e lindjes) dhe largimi i ditës" (El Mexhmu). Ky sqarim përmendet dhe në librat: Sherh Sahih Muslim, Mevahibul Xhelil, Hashijetul reudil murbi etj. Rasti kur disku i diellit fshihet pas kodrës, pas malit apo pas një ndërtese të madhe, por nga ana tjetër duken rrezet e tij në anën nga lind dielli dhe në majat e maleve e të kodrave, ky rast pra nuk quhet perëndim dielli as fetarisht, as logjikisht dhe as konkretisht. Këtë gjë e ka përmendur edhe shejh Albani në një prej kasetave të serisë "el Huda ven Nur".]

E treta: Kur perëndon i tërë disku i diellit, agjëruesi çel, pa u ndikuar nga ndriçimi i kuqërremtë që ka mbetur në horizont. Në fakt, kur fshihet i tërë disku, shfaqet errësira nga ana e lindjes.

E katërta: Kurrë nuk është detyrë me agjëruar ndonjë pjesë të natës. Për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët.²⁸⁴ Gjithashtu, nuk pëlqehet vonimi i çeljes, përkundrazi pëlqehet shpejtimi i saj, siç tregojnë edhe hadithet.

E pesta: Njerëzit nxitojnë të kundërshtojnë për çështje që nuk i dinë. Kështu ndodhi me Bilalin (r.a.), kur nuk nxitoi të zbatonte urdhrin e Profetit (a.s.), pasi nuk e dinte se lejohej çelja e iftarit në atë kohë.

E gjashta: Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) ndonjëherë i kërkonin shpjegim Profetit (a.s.), për të qenë më të sigurt ose për të marrë njohuri më të hollësishme për gjykimin ose për më shumë dituri, dhe pastaj menjëherë e vinin në zbatim. Bilali i kërkoi sqarim disa herë Profetit lidhur me çeljen, kur pa shkëlqimin e rrezeve të kuqe pas perëndimit të diellit. Ai mendoi se çelja e iftarit lejohej veçse mbas zhdukjes së kësaj drite. Ai pandehi se Profeti (a.s.) nuk e kishte parë atë ndriçim, ndaj donte ta kujtonte për një gjë të tillë.

E shtata: Dijetarit ose imamet mund t'ia kujtosh gjërat që ti mendon se ai i ka harruar ose nuk i ka vënë re. Mirëpo nuk duhet të përsëritësh të njëjtën gjë më tepër se tri herë.

E teta: Ai që nuk e di gjykimin e një veprimi lejohet të pyesë përsëri, të kërkojë sqarim e të diskutojë, derisa ta mësojë.

²⁸⁴ Për këtë çështje ka sjell ixhma Ibn Betal në shpjegimin e tij të Buhariut. [Kalendari aktual që boton KMSH-ja e shënon kohën e akshamit disa minuta më vonë se perëndimi i diellit, por minutat e vonës ndryshojnë nga një vend në tjetrin, pasi dihet se perëndimi i diellit nuk është për të gjitha vendet njësoj; përshembull, nga mali i Dajtit, ose nga Kërraba, perëndimi i diellit mund të vërehet dy deri në katër minuta përpara asaj që shënohet në kalendarë ose njëherësh me të; nga fshatrat më poshtë lartësisë së maleve perëndimi i diellit mund të vërehet përafërsisht katër deri në tetë minuta para kalendarit; në bregdet perëndimi i diellit mund të shihet përafërsisht pesë minuta para kalendarit. Këto unë i kam konstatuar vetë nga vërtetimi i perëndimit të diellit në pika dhe vende të ndryshme të vendit. Nëse njeriu e respekton kalendarin deri në atë masë sa që, edhe pse shikon perëndimin e diellit apo e merr vesh sigurtë atë, e vonon ezanin e akshamit ose çeljen e agjërit derisa të hyjë koha sipas kalendarit, kjo është bidatë në fe. E nëse kalendarit përdoret thjeshtë për lehtësim, sikurse ora e dorës, duke e korigjuar rregullisht në bazë të perëndimit të diellit dhe shenjave të tjera për kohët e namazeve të tjera, kjo s'ka gjë. Nga ana tjetër, duhet të bëjmë kujdes se në ndonjë vend dielli mund të perëndojë pas asaj që shënohet në kalendarë, sepse kalendarët mund të kenë dhe probleme të tilla].

E nënta: Hadithi aludon për kundërshtimin e çifutëve dhe krishterëve, të cilët e vononin çeljen mbas perëndimit të diellit. Gjithashtu, ai është kundërpërgjigje edhe ndaj rafidive, të cilët e vonojnë iftarin gjersa të dalin yjet.

E dhjeta: Lejohet agjërimi në udhëtim për atë që nuk e dëmton.

E njëmbëdhjeta: Agjëruesi gjatë kohës që çel iftarin mund të përsërisë fjalët e muezinit dhe të lutjet mbas ezanit. Argumentet në tërësi tregojnë që pëlqehet një gjë e tillë. Ato nuk përjashtojnë rastin e angazhimit me ngrënien e iftarit.²⁸⁵

E dymbëdhjeta: Për çdo person, çasti i fillimit të agjërit, i çeljes së iftarit dhe i kohëve të namazit, përcaktohen sipas vendit ku ndodhet ose hapësirës ajrore në të cilën udhëton. Kështu, nëse perëndon dielli kur je në aeroport ose nëse ke falur akshamin, dhe më pas, kur niset avioni në drejtim të perëndimit, ti shikon diellin, nuk e ke detyrë më të vazhdosh agjërimin ose të falësh sërish akshamin. Agjërimi dhe namazi janë të saktë, sepse koha e iftarit dhe e namazit përcaktohen sipas tokës mbi të cilën gjendet personi. Mirëpo, nëse avioni niset disa minuta para perëndimit të diellit dhe vazhdon të jetë ditë, nuk të lejohet të çelësh iftar e as të falesh pa perënduar dielli i hapësirës ajrore mbi të cilin udhëton. Edhe nëse udhëton në hapësirat ajrore të një vendi ku banorët e tij e kanë çelur iftarin dhe e kanë falur akshamin, ty nuk të lejohet të çelësh iftar as të falesh për sa kohë shikon diellin.²⁸⁶

33- Gjykimi për atë që vjell me dashje gjatë agjërit

²⁸⁵ Fetava Ibn Uthejmin (1\531- 532).

²⁸⁶ Fetava lexhnetu daimeti (2254) shih Mexhmuë Fetava Ibn Baz. [Ndryshimi i hyrjes së kohës së namazit nga një vend në tjetrin dhe nga një zonë në tjetrën në varësi të perëndimit të diellit në secilin vend a zonë është krejt i natyrshëm dhe në përputhje me sunetin e Pejgamberit, kurse njësimi i kohës për këto vende a zona të ndryshme është në kundërshtim me sunetin. Prandaj, themi se në çdo vend e në çdo zonë duhet të thirret ezani dhe të çilet agjërimi atëherë kur perëndon dielli, pa marrë parasysh vendet dhe zonat e tjera. Kështu, ata që janë në bregdet do të çelin atëherë kur shohin perëndimin e diellit, përafërsisht pesë minuta para kalendarit aktual; ata që ndodhen në fshatrat apo kodrat me një lartësi mesatare nga niveli i bregdetit, përsëri do të çelin kur shohin perëndimin e diellit, që sipas vërtetimit tim në vende të tilla dielli perëndon para kalendarit aktual nga katër deri në tetë minuta në varësi të stinëve; ata që ndodhen në malin e dajtit apo në kërrabë do të çelin kur të shohin perëndimin prej atje, që i bie përafërsisht dy minuta para kalendarit, ose diçka më shumë se kaq, ose njëherësh me të; ata që ndodhen pas një kodre, pas një mali, apo në një luginë ku nuk e shohin dot perëndimin e diellit do të çelin kur të mos shohin më aspak rreze dielli në majat e kodrave dhe të maleve apo në anën e lindjes, qoftë dhe nëse kjo shkon vetëm dy minuta para kalendarit apo njëherësh me kalendarin, sepse kjo është hyrja e kohës për ta.]

Ebu Hurejra (r.a.) tregon se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Ai që i vjen për të vjellë, nuk e ka detyrë ta përsërisë ditën e agjërit, e ai që e nxjerr vetë ushqimin, duke provokuar të vjellët, le ta zëvendësojë ditën e agjërit." ²⁸⁷

Mi'dan Ibn Talha (Allahu e mëshiroftë!) rrëfen: "Ebu Derda (r.a.) më tregoi që, njëherë, i Dërguari (a.s.), pasi volli, e ndërpreu agjërimin. Pastaj, unë takova në xhaminë e Damaskut Theubanin - skllav i liruar nga i Dërguari (a.s.) - dhe i thashë: "Ebu Derda më ka treguar se i Dërguari (a.s.) volli dhe e ndërpreu agjërimin. Ai më tha: "Të vërtetën ka thënë, sepse unë më pas i hodha ujin për abdes". ²⁸⁸

Dobi dhe rregulla

E para: Prej mëshirës së Allahut të Lartësuar ndaj robërve të Tij, njeriu nuk merret në llogari për veprat që ndodhin pa vullnetin e tij. I tillë është edhe rasti me të vjellët. Nëse ai ndodh qëllimisht për shkak të provokimit me anë të gishtërinjve, ose me futjen e ndonjë sendi në gurmaz, ose me nuhatjen e ndonjë ere të keqe, ose me shikimin e ndonjë pamje të bezdishme, ose me çfarëdo mjeti qoftë, e prish agjërimin. Ndërsa kur vjellja ndodh pa vullnetin e njeriut, agjërimi nuk priset. Dijetarët janë unanimë mbi këtë rregull që del nga këto hadithe.

E dyta: Për sa i përket transmetimit që tregon se i Dërguari (a.s.) volli, pastaj e prishi agjërimin, thuhet se ai (a.s.) u dobësua për shkak të vjelljes, prandaj e prishi agjërimin, jo se ai e prishi për shkak se të vjellët (pa provokim) e prish agjërimin. Kështu i kanë kuptuar dijetarët dy hadithet që janë përcjellë për këtë çështje. Në një variant që e shënon Tahavi, tregohet se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "E prisha agjërimin, ngaqë volla dhe u bëra i pafuqishëm për të agjëruar." ²⁸⁹

²⁸⁷ Shënon Ebu Daudi (2380), Ahmedi (2\498), Ibn Xharudi (385). Ibn Huzejme (1960) dhe Ibn Hibani (3518) e vlerësojnë të saktë. Edhe Hakimi ka thënë se hadithi është në kushtin e Buhariut e të Muslimit. Me këtë mendim është edhe Dhehebiu (1\598-590).

²⁸⁸ Shënon Ebi Daudi (2381), Ahmedi (6\19), Nesai në Kubra (3210-3129) dhe Ibn Xharudi (8). Ibn Hibani e vlerëson të saktë (1097). Hakimi ka thënë se hadithi përmbush kushtet e Buhariut e të Muslimit, por nuk e kanë shënuar në librat e tyre. Dhehebiu është i të njëjtit mendim me të (1\588-589).

²⁸⁹ Sherhul meani el Athar (2\97). Shih: Umdetu el Karië(11\ 36).

E treta: Hadithet dëshmojnë se ai që provokon vetë të vjellët e prish agjërimin. I njëjti gjykim jepet në rastin kur e vjella është ushqim, lëng i hidhur, gëlbasë, gjak etj., sepse hadithi i përfshin që të gjitha.²⁹⁰

E katërta: Agjëruetit nuk i lejohet të provokojë të vjellat gjatë ditës së Ramazanit. Nëse vjell, i prishet agjërimi, përveç rastit kur është i sëmurë dhe është e nevojshme një gjë e tillë. Në këtë rast, ai është i arsyetuar me sëmundjen. Allahu i Lartësuar thotë: “Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër, të agjërojë më vonë aq ditë sa nuk i ka agjëruar.” [Bekare: 184]. Kështu, ai e prish agjërimin atë ditë dhe e agjëron më vonë.²⁹¹

E pesta: Gjykimi i dhënë nga Sheriati për prishjen e agjërit të atij që vjell me dashje, dëshmon për drejtësinë e Sheriatit dhe se dispozitat e Allahut janë të gjitha drejtësi dhe mëshirë për njerëzit e ngarkuar me detyra fetare. Dijetari Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Agjëruetit i ndalohet të konsumojë gjëra që i japin forcë fizike dhe vlera ushqyese si: ushqimi dhe pija. Po ashtu, atij i ndalohet të nxjerrë çdo gjë që i shkakton dobësi dhe mungesë të lëndëve me të cilat ushqehet trupi. Përndryshe, kjo do ta dëmtonte dhe atëherë ai do të konsiderohej tejkalues i caqeve dhe jo i drejtë, në lidhje me adhërimin.”²⁹²

34- Përdorimi i misvakut dhe i kuhlit²⁹³ për agjëruetin

Ebu Hurejra (r.a.) përcjell se i Dërguari Allahut (a.s.) ka thënë: "Po të mos ia vështirësoja punët umetit tim, do t'i kisha urdhëruar të përdornin misvakun para çdo namazi".²⁹⁴

²⁹⁰ El Mugni i Ibn Kudame (3\24).

²⁹¹ Shih: Salat i Ibn Kajim (134).

²⁹² Mexhmuë Fetava (25\250- 251).

²⁹³ *Kuhli ithmid* është një element metalik i kristaltë, i ngurtë i brishtë, i shkrifët, me ngjyr të kuqërremtë, gjendet në vendet e Hixhazit .Lloji më i mirë i kuhlit sillet nga Asbahani. Kuhli vihet në sy. Dobia është se ai i thanë lotët, e pastron syrin, mbron shëndetin e tij dhe e forcon shikimin. Por nëqoftë se vënia e kuhlit për burrat ngjall ndonjë dyshim, atëherë duhet të mënjanohet (sh..për.).

Aishja (r.a.) gjithashtu tregon se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Misvaku është pastrim për gojën dhe e kënaq Allahun e Lartmadhëruar".²⁹⁵

Ibn Umeri r.a thotë: "Misvaku përdoret në fillim të ditës dhe në fund të saj."²⁹⁶ Gjithashtu, ai ka thënë: "Nuk ka gjë nëse agjëruesi përdor misvak të njomë e të thatë".²⁹⁷

Përcillet nga Muadhi (r.a.) se: "I Dërguari (a.s.) i ka urdhëruar të përdorin misvakun", megjithëse ai e dinte që goja e agjëruesit do të ketë grahamë, edhe pse përdor misvakun. Nuk ka mundësi t'i ketë urdhëruar që të grahamonin me dashje, sepse kjo nuk ka asnjë dobi, përkundrazi është diçka e keqe. Ndryshe është çështja e atij që është sprovuar me një gjë të tillë dhe nuk ka se çfarë të bëjë.²⁹⁸

Nga ana tjetër, tregohet nga Enes Ibn Maliku se ai vinte kuhël në sy kur ishte me agjërime.²⁹⁹ Haseni (Allahu e mëshiroftë!) ishte i mendimit se nuk ka gjë që burri të vërë kuhël kur agjëron.³⁰⁰ Kështu, përcillet dhe nga Zuhri (Allahu e mëshiroftë!) se ka thënë: "Nuk ka gjë që agjëruesi të përdorë kuhlin."³⁰¹

Dobi dhe rregulla

E para: Vlera e misvakut dhe theksimi i përdorimit të tij, aq sa i Dërguari (a.s.) për pak sa nuk dha urdhër për përdorimin e tij para çdo namazi.

E dyta: Mëshira e Profetit (a.s.) për umetin e tij dhe largimi i vështëresive ndaj tyre.

²⁹⁴ Buhariu (847) dhe Muslimi (252).

²⁹⁵ Shënon Ahmedi (6\62), Nesai (1\10), Darimiu (684) dhe Ebu Ja'ela (4916). Ibn Huzejme (135) dhe Ibn Hibani (1067) e vlerësojnë të saktë.

²⁹⁶ Buhari shprehet prerazi që është thënie e Ibn Umerit, por nuk e sjell me sened (2\681), kurse Ibn Ebi Shejbe e sjell me sened të pashkëputur, siç përmend El Hafidh në Fet'h (4\154). Shih taglik el Ta'elik (3\151). Gjykimi i saktë është se kjo është një thënie e Ibn Umerit, ndërsa ata që e kanë sjellë si thënie të Profetit (a.s.) kanë gabuar, siç përmendet në Hulasatu el Bdril el munir (1149).

²⁹⁷ Shënon Ibn Ebi Shejbe (2\296).

²⁹⁸ Shënon Taberani në El Kebir (20\70) numër (133) dhe në Musned Shamijin (2250). Hafidhi në Talhis e vlerëson isnadin se është i mirë (2\202), porse Hejthemi e përcakton të dobët për shkak të Bekr Ibn Hunejs, duke shtuar se Ibn Mein e ka vlerësuar korrekt (3\165).

²⁹⁹ Shënon Ebu Daudi (2378) dhe Ibn Ebi Shejbe (2\304). Ky është qëndrim i Enesit. Tirmidhiu në sunenin e tij thotë se nuk ka ndonjë transmetim të saktë nga Profeti (a.s.) në këtë çështje (3\105).

³⁰⁰ E Shënon Ibn Ebi Shejbe (2\304).

³⁰¹ Shënon Ibn Ebi Shejbe (2\304).

E treta: Misvaku përdoret në fillim të ditës së agjërimit dhe në fund të saj. Përdorimi i misvakut është sunet për atë që agjëron dhe atë që nuk agjëron. Ky gjykim nuk ndryshon për të dy rastet, bazuar në tërësinë e haditheve lidhur me këtë çështje.

E katërta: Agjëruesi ka të drejtë të përdorë misvak pa ndonjë ndryshim a është i njomë apo i thatë.³⁰²

E pesta: Nëse ndodh që gjatë përdorimit të misvakut del gjak nga mishi i dhëmbëve, kjo nuk e prish agjërimin, por ai nuk duhet ta përcjellë gjakun.³⁰³

E gjashta: Agjëruesit i lejohet të përdori kuhlën, të lëshojë pika në sy e në vesh, edhe nëse ndjen shijen e tij në gurmaz, sepse syri e veshi nuk përmenden tekstualisht dhe nuk janë njësoj si ato që përmenden në tekste, pasi ata nuk janë rrugë e ushqimit dhe e pijes.³⁰⁴

E shtata: Pikat që lëshohen me pikatore në hundë, nëse zbresin e bien në stomak, e prishin agjërimin, sepse i Dërguari (a.s.) e ka ndaluar agjëruesin të tërheqë fort ujin me hundë kur merr avdes. Por nëse pika e hundës nuk arrin në stomak, atëherë nuk ka gjë.³⁰⁵

E teta: Agjëruesit i lejohet të përdorë pulverizatorin (pompën) e astmës, i cili arrin në mushkëri. Atij nuk i prishet agjërimi dhe nuk mëkaton me përdorimin e tij.³⁰⁶

E nënta: Gjilpërat kuruese nuk e prishin agjërimin, edhe nëse ndjen shijen e ilaçit në gurmaz. Kjo vlen për gjilpërat që bëhen në vena e në muskuj, ndërsa gjilpërat ushqyese, të cilat janë në vend të ushqimit, e prishin agjërimin.³⁰⁷

³⁰² Buhariu (Allahu e mëshiroftë!) ka emërtuar një nënkapitull me temën: “Përdorimi i misvakut të njomë e të thatë nga agjëruesi (2\682). Hafidh në Fet’h thotë: Buhariu me këtë emërtim të kapitullit nënkupton kundërpërgjigje ndaj atyre që e bëjnë të urryer për agjëruesin përdorimin e misvakut të njomë, si Malikitë dhe Sha’biu. Më pas ka përmendur thënien e Ibn Sirinit se si ai e krahason misvakun e njomë me ujin që shpërllan gojën. Shih: Fet’h (4\158) dhe Temhid (19\58).

³⁰³ Shih: Fetava El Lexhne (10\265) dhe fetvanë numër (3785).

³⁰⁴ Shih Mexhmui Fetava të Ibn Bazit (15\260-261). Këtë mendim ka zgjedhur edhe shejhu el islam Ibn Tejmije, siç ka përmendur dijetari i nderuar Ibn Utthejmin në Fikhu el ibadat, i cili gjithashtu e përkrah këtë mendim (191-192).

³⁰⁵ Shih: Fetva Ibn Baz (15\260) dhe Fetava Ibn Utthejmin (1\520).

³⁰⁶ Shih Fetva Ibn Baz (15\265) dhe Fetava Ibn Utthejmin (1\500). [Edhe hapa e zemrës që vendoset nën gjuhë dhe që nuk arrin fyt nuk e prish agjërimin].

³⁰⁷ Shih: Mexhmui Fetava dhe resail të Ibn Utthejmin (19\213-215).

E dhjeta: Agjëruesi që ka nevojë për gjilpëra ushqyese ose gjëra të tjera që prishin agjërimin, e prish agjërimin, për shkak të sëmundjes dhe e agjëron më vonë *kaza*.

E njëmbëdhjeta: Nëse e lyen trupin me ndonjë gjë që bie erë të fortë, shijen e të cilës e ndjen në fyt, ajo nuk ta prish agjërimin, sepse aromat nuk ta prishin agjërimin, edhe nëse janë të forta.³⁰⁸

E dymbëdhjeta: Supostat dhe ovulat nuk e prishin agjërimin, prandaj agjëruesit i lejohet t'i përdorë.³⁰⁹

E trembëdhjeta: Pasta që përdoret për të larë dhëmbët nuk e prish agjërimin, njësoj si misvaku, por duhet pasur kujdes mos të kalojë në gurmaz. Nëse kalon diçka në gurmaz pa dashje, s'ka gjë. Megjithatë, nëse e vonon larjen e gojës deri në mbrëmje, është më e sigurt.

E katërbëdhjeta: Ilaçi që përdoret me anë të gargarasë në gojë, nuk ta prish agjërimin, përderisa nuk e përcjell. Agjëruesi duhet ta shtyjë më mirë përdorimin e tij për në darkë. Këtu bën përjashtim rasti kur është i nevojshëm përdorimi i tij gjatë ditës.³¹⁰

E pesëmbëdhjeta: Nuk ka gjë nëse përdor spërkatës për të larguar erën e keqe nga goja, nëse lënda e tij nuk arrin në gurmaz.³¹¹

E gjashtëmbëdhjeta: Nëse e kapërdin pështymën, nuk ka gjë. Për këtë nuk ka kundërshtime mes dijetarëve. Ndërsa gëlbasën nuk lejohet që ta kapërdish, sepse njeriu mund ta shmangë atë.³¹²

E shtatëmbëdhjeta: Klizma nuk e prish agjërimin.³¹³

32- Vlera e agjëritit vullnetar.

³⁰⁸ Mexhmuë Fetava ue resail Ibn Uthejmin (19\225-228).

³⁰⁹ Fetava Ibn Uthejmin (1\205).

³¹⁰ Shih Mexhmui Fetava ue Resail Ibn Uthejmin (19\290).

³¹¹ Munteka min fetava El Feuzan (3\130).

³¹² Fetava Lexhnetu daimetu (9584) dhe Fetava Ibn Baz (3\251).[Gjithsesi, edhe nëse agjëruesi e kapërdin gëlbasën nuk i prishet agjërimi].

³¹³ Tuhfetu el ihvan i Ibn Baz (82).

Ebu Uname (r.a.) thotë: "Shkova tek i Dërguari (a.s.) dhe i thashë: 'Më urdhëro për një vepër që ta marr nga ti!' Ai më tha: **'Mbaj agjërim, se nuk ka si ai!'**". Në një variant tjetër thuhet se Ebu Uname (r.a.) e pyeti të Dërguarin (a.s.): "Cila vepër është më e mirë?" Profeti (a.s.) u përgjigj: **"Kushtoji rëndësi agjërimit, se nuk ka gjë që barazohet me të."**

Sipas një varianti tjetër, Ebu Uname tha: "Më urdhëro për një vepër, prej së cilës të hyj në Xhenet!" Profeti (a.s.) i tha: **"Mbaj agjërim, se nuk ka si ai!"** Transmetuesi thotë se pas kësaj, në shtëpinë e Ebu Umames nuk shihej tym gjatë ditës, vetëm kur u vinte ndonjë mik. Kur shihnin tym gjatë ditës, e kuptonin se u kishte ardhur ndonjë mik".

Kurse në një variant tjetër, ai tregon: "I thashë: 'O i Dërgari i Allahut, më urdhëro për ndonjë punë!'" Profeti (a.s.) tha: **"Agjëro, se nuk ka si ai."** Transmetuesi tregon se, pas kësaj, Ebu Umamen, gruan dhe shërbëtorin e tij i shihje veçse duke agjëruar. Ai, gjithashtu, thotë se, kur shihej që dilte tym gjatë ditës nga shtëpia e tyre thuhej: "U paska ardhur ndonjë mysafir".

Ebu Uname vazhdoi këtë rrugë aq sa deshi Allahu. Më pas, ai tregon: "Shkova tek i Dërguari (a.s.) dhe i thashë: 'O i Dërguari Allahut, na urdhërove që të agjërojmë dhe shpresojmë të na ketë bekuar Allahu në atë agjërim që kemi bërë deri më tani, por më urdhëro të bëj ndonjë punë tjetër.'" Profeti (a.s.) tha: "Dije se, sa herë që bën një sexhde, Allahu të ngre për shkak të saj një gradë dhe të fshin një gjynah."³¹⁴

Dobi dhe rregulla

E para: Interesimi i madh që kishin sahabët për gjërat që u bënë dobi në botën tjetër.

E dyta: Agjërimi është prej veprave më të mira. Ky hadith tregon se ai është puna më e mirë, ndonëse në një hadith tjetër thuhet për namazin se është vepra më e mirë. **"Dijeni se vepra juaj më e mirë është namazi"**. Me sa duket, vlera e këtyre veprave ndryshon në varësi të personit. Agjërimi mund të jetë më i mirë për disa njerëz, ngaqë i frenon nga epshet e ndaluara dhe u

³¹⁴ Shënon Nesai (4\165) dhe Ahmedi (5\248). E vlerëson të saktë Ibn Huzejme (1893), Ibn Hibani (3425), Hakimi (1\582) dhe El Hafidh në fet'h (4\104). Trasmentimi i parë dhe i dyti janë të Nesait. I treti është i Ibn Hibanit, kurse i katërti është i Ahmedit.

pastron zemrën për të adhuruar Allahun e Lartësuar. Ndërsa namazi mund të jetë më i mirë për disa të tjerë, ngaqë trupi i tyre nuk e përballon agjërimin ose dobësohen për shkak të tij në kryerjen e adhurimeve tjera. Ibn Kajimi (Allahu i Lartësuar e mëshiroftë!) thotë: "Për atë që dominohet nga epshi ndaj grave, agjërimi është më i mirë sesa për të tjerët".

E treta: Agjërimi i frenon dëshirat epshore, të cilat bëhen shkak për gjynahe e largim nga bindja ndaj Allahut. Prandaj të rinjtë që nuk kanë mundësi të martohen dhe kanë frikë se bien në haram janë urdhëruar të agjërojnë. Nuk ka vepër më të mirë për ta, sesa agjërimi, në këtë aspekt.

E katërta: Nënshtrim i menjëhershëm i Ebu Umames dhe pjesëtarëve të familjes së tij ndaj urdhrit të Profetit (a.s.). Ky është një fakt që tregon se sa të shpejtë ishin sahabët në zbatimin e urdhërave të fesë së dëlirë.

E pesta: Respektimi i mikut. Një mënyrë e respektimit është lënia e agjërit vullnetar për hatër të tij.

36 – Hixhameja për agjëruenin

Shedad Ibn Eusi tregon se Pejgamberi (a.s.) shkoi tek një burrë në Bekia, që po bënte hixhame në ditën e tetëmbëdhjetë të ramazanit. Ndërkaq, duke më kapur për dore, tha: **"Agjërimin e prish edhe ai që bën hixhame, edhe ai të cilit i bëhet hixhameja"**.³¹⁵

E njëjta gjë përcillet nga Theubani,³¹⁶ Rafië Ibn Hadixh³¹⁷ dhe një grup sahabësh, aq sa disa dijetarë thonë që është *hadith mutevatir*.

Ndërsa Ibn Abasi (r.a.) përcjell se i Dërguari (a.s.) bëri hixhame ndërkohë që ishte *muhrim* (në gjendje iharmi) dhe agjëruenin.

³¹⁵ Shënon Ebu Daudi (2369), Nesai në Kubra (3126), Ibn Maxhetu (1681), Ahmedi (4\123). E klasifikojnë të saktë Ali Ibn Medini dhe Buhariu, siç shënohet në Telhis el Habir (2\193). Abdulla Ibn Imam Ahmed përcjell nga babai i tij në Mesail se ky hadith është prej haditheve më të sakëta që trasmentohen nga Profti (a.s.) në lidhje me prishjen e agjërit të atij që bën hixhame dhe atij që i bëhet hixhame (682). Hadithin e klasifikon të saktë Ibn Hibani (3533) dhe Hakimi i cili thotë se Ibn Rahavejhi e klasifikon të saktë (1\593). Edhe Neveviu e klasifikon të saktë në Mexhmuë, ku thotë se hadithi përmbush kushtin e Muslimit (6\350).

³¹⁶ Shënon Ebi Daudi (2371), Ibn Maxhe (1680), Darimiu (1731), Ahmedi (3\465) dhe Tajalisi (989). E klasifikon të saktë Ibn Hibani (3532) dhe Ibn Huzejme (1962- 1963).

³¹⁷ Shënon Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është i mirë e i saktë (774). E shënon edhe Ahmedi (3\465). Ndërsa Ibn Hibani e klasifikon si të saktë (3535).

Në një variant tjetër, që e shënon Ibn Daudi, qëndron: "Profeti (a.s.) bëri hixhame ndërkohë që ishte agjërues".³¹⁸

Shube thotë: "E kam dëgjuar Thabit Bunanin duke e pyetur Enes Ibn Malikun (r.a.): "A e urrenit që agjëruesi të bëjë hixhame?" – "Jo" - u përgjigj ai, - veçse për shkak të dobësimit". Shënon Buhariu.

Ebu Daudi shënon nga Enesi (r.a.): "Shkaku që shikonim se agjëruesi duhet ta lërë hixhamen, ishte se nuk parapëlqenim që ai të mundohet në agjërime për shkak të saj".³¹⁹

Dobi dhe rregulla

E para: Hadithe të shumta tregojnë se hixhamja ia prish agjërimin atij që bën hixhame dhe atij që i bëhet hixhame. Hadithe të tjera tregojnë se Profeti (a.s.) ka bërë hixhame kur ishte agjërues. Për këtë arsye, dijetarët kanë kundërshtime lidhur me hixhamen. Shumica e tyre janë të mendimit se agjëruesit i lejohej të bëjë hixhame, ndërsa hadithet që e ndalojnë janë anuluar me hadithet që e lejojnë.³²⁰

Mendimi në medhhebin e imam Ahmedit është që hixhamja e prish agjërimin. Këtë mendim ka përzgjedhur shejhu i islamit Ibn Tejmije dhe nxënësi i tij Ibn Kajimi³²¹ Këtë mendim mbështet edhe komisioni i përhershëm i fetvave në Arabinë Saudite.³²² Ky është mendimi i përzgjedhur

³¹⁸ Shënon Buhariu (1836), Muslimi (1202), Ebu Daudi (2372-2374) dhe Tirmidhiu (775-777).

³¹⁹ Shënon Buhariu (1838), ndërsa transmetimi i dytë është i Ebi Daudit (2375).

³²⁰ Lejimi i bërjes së hixhames për agjëruesin është përcjellë nga Ebi Seid El Hudri, Ibn Mesudi dhe Umu Seleme. Të njëjtën gjë ka thënë edhe Urve dhe Seid Ibn Xhubejr. Ky është mendimi i dijetarëve të tre medhhebëve, Ebi Hanifes, Malikut dhe Shafiut. Shih: Mugni (4\350) dhe Istidhkarë. Në këtë fundit Ibn Abdulberr përmend, se hadithet që ndalojnë hixhamen për agjëruesin janë abroguar nga hadithet që e lejojnë atë (3\324-326). Shih dhe librat Muhala (6\204-205), Fet'hul Bari të Ibn Haxherit (4\174-178), Subulus selam (2\158-160) dhe Nejlul eutarë (4\275).

³²¹ Me mendimin që hixhamja e prish agjërimin është: Atau, Abdurrahman Ibn Mehdi, Imam Ahmed, Is'haku, Ibn Mundhiri. Ibn Kudame përcjellë nga një grup i Sahabësh se ata bënë hixhame natën kur agjëronin, nga të cilët janë: Ibn Umeri, Ibn Abasi, Ebu Musa dhe Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Shih: Mugni (4\350), Mexhmuë Fetava (25\257), Risaletu Hakikatu es sijamë (81-84), Tehdhibë es Sunen (6\354-368), l'lamu el Mukiinë (2\52). Ibn Kajim në librin Zad (4\61-62) thotë: Nuk mund të vërtetohet mendimi që i lejohej agjëruesit të bëjë hixhame vetëm se me katër gjëra: E para: I Dërguari (a.s.) ka bërë hixhame ndërkohë që ishte i shëndetshëm dhe jo i sëmurë. E dyta: E ka bërë kur ishte vendali dhe jo udhëtar. E treta: E ka bërë hixhamen gjatë agjërit të detyrueshëm dhe jo gjatë agjërit vullnetar. E katra: E ka bërë hixhamen mbasi e kishte ndaluar më parë, dhe jo para se ta ndalojë. Nëse plotësohen këto katër gjëra, atëherë mund të themi që i lejohej të bëjë hixhame agjëruesi, përndryshe: jo.

³²² Shih Fetava El Lexhnetu (10\261-262), numri i fetvasë (11917).

nga shumica e dijetarëve të Arabisë Saudite.³²³ Bazuar mbi sa u citua më lart, për të qenë më i sigurtë, agjëruesi nuk duhet të bëjë hixhame. Në këtë mënyrë, ai çliron veten nga përgjegjësia dhe tejkalon këtë çështje, e cila ka mospajtim.³²⁴

E dyta: Hadithi i Enesit (r.a.) tregon se shkak i ndalimit të hixhames për agjëruesin është se ajo e dobëson atë. Kjo është një prej mirësive të Sheriatit, i cili shmang dëmin nga ata që kanë detyrime fetare.

E treta: Prej urtësive të prishjes së agjërimit të atij që i bëhet hixhamja është se ai dobësohet prej saj. Ndërsa urtësia e prishjes së agjërimit për atë që u bën hixhame të tjerëve është se ai gjatë thithjes me gojën e tij, mund t'i arrijë gjaku në gurmaz. Këtu bën përjashtim rasti kur hixhameja bëhet me mjete moderne, pa e thithur gjakun me anë të gojës. Domethënë, në këtë rast nuk i priset agjërimi i tij.³²⁵

E katërta: Prerja e venës ose çarja e lëkurës për nxjerrjen e gjakut e prishin agjërimin e atij që i nxirret gjaku, ndërsa atij që bën prerje ose çarjen nuk i priset agjërimi.³²⁶

E pesta: Nëse e ngacmon hundën me dashje, që t'i rrjedhë gjaku, për të lehtësuar kokën ose për ndonjë qëllim tjetër, në këtë rast priset agjërimi nëse vërtet i rrjedh gjak. Ndërsa kur i rrjedh gjaku nga hunda pa dashje, nuk e prish agjërimin, edhe nëse rrjedh shumë.³²⁷ Por në rast se trupi dobësohet për shkak të hemoragjisë, lejohet që ta prishësh agjërimin, sepse quhesh i sëmurë.

³²³ Mendimi se hixhameja e prish agjërimin: Ibn Saëdi në përzgjedhjet e tij (62), Muhamed Ibn Ibrahim në fetvatë e tij (6\378-381) dhe në fetvatë e tij me numër (1\521) dhe Ibn Xhibrini në Fetava sijamë (54-56).

³²⁴ [Mendimi i shumicës së dijetarëve se hixhamja nuk e prish agjërimin është më i saktë, sepse një hadith tjetër i saktë provon se Pejgamberi (s.a.u.s.) e ka anuluar një gjë të tillë. Ibni Hazmi, sikurse e citon Ibn Haxheri në *Fethul Bari*, thotë: "S'ka dyshim që hadithi: "Agjërimin e prish edhe ai që bën hixhame, edhe ai të cilit i bëhet hixhameja" është i vërtetë, porse, nga ana tjetër, ne kemi nxjerrë nga hadithi i Ebu Said Hudriut se Pejgamberi (s.a.u.s.) e toleroi (i bëri lehtësim) agjëruesit të bëjë hixhame. Senedi i këtij hadithi është i vërtetë. Rrjedhimisht, mbështetja në këtë hadith është detyrë, sepse lejimi vjen pas ndalimit. Kësisoj, hadithi i fundit provon faktin se rregulli i prishjes së agjërimit për shkak të hixhames është anuluar, qoftë për atë që bën hixhamen, qoftë për atë të cilit i bëhet hixhameja." Hadithin e mësipërm të Ebu Saidit e shënojnë Nesaiu, Ibn Huzejme dhe Darekutni.]

³²⁵ Shih: Sherhu el Mumtië (6\382).

³²⁶ Kështu ka dhënë fetva komisoni i përhershëm i fetvave (10\262), numëri i fetvasë (547). Kështu mendon edhe Shejhul Islam në Mexhmu fetava (25\268). Këtë mendim e ka përzgjedhur edhe Dijetari i nderuar Muhamed Ibn Ibrahim në fetvatë e tij (4\191). [Ndërsa sipas mendimit tjetër që hixhamja nuk e prish agjërimin dhe që është më i sakti, edhe atij që i nxirret gjaku nëpërmjet prerjes së venës ose çarjes së lëkurës nuk i priset agjërimi.]

³²⁷ Ky është mendimi që e ka zgjedhur Ibn Tejmije në Ihtijarat el Fikhije (108) Ibn Ibrahim (4\191) dhe Ibn Uthejmini në Mexhmu fetava (19\249). Shih fetvatë e komisionit të përhershëm të fetvave (10\264). Fetvaja me numër (3455). [Sipas mendimit më të saktë që sqaruam më lart në lidhje me hixhamen, rrjedhja e gjakut nga hunda, qoftë pak apo shumë, me angacmim apo jo, nuk e prish agjërimin.]

E gjashta: Analiza e gjakut, që bëhet me pak gjak, nuk ndikon tek agjëruesi, prandaj nuk e prish agjërimin. Megjithatë, më mirë është të bëhet gjatë natës, për të qenë sa më i sigurt, pasi ka mendime që e konsiderojnë agjërimin të prishur edhe në këtë rast. Në rastin kur merret shumë gjak për analiza, agjërimi prishet, prandaj kjo analizë le të bëhet veçse natën. Sidoqoftë, nëse nevojitet të japësh shumë gjak për analiza për shkak të sëmundjes, e prish agjërimin ngase quhesh i sëmurë dhe atë ditë e agjëron më pas.³²⁸

E shtata: Nëse del shumë gjak pa vullnetin e agjëruesit, për shkak të ndonjë aksidenti ose ndonjë plage, kjo gjë nuk ndikon në agjërim, vetëm nëse duhet ta prishësh agjërimin për shkak të dobësisë trupore. Në këtë rast, merr gjykimin e të sëmurit, kështu që e prish agjërimin dhe agjëron më vonë.³²⁹

E teta: Nuk prishet agjërimi nëse heq dhëmballën, edhe nëse del shumë gjak, sepse ajo nuk hiqet me qëllim që të rrjedhë gjak. Megjithatë, gjakun nuk duhet ta kapërdish. Nëse e kapërdin me dashje, agjërimi prishet.³³⁰

E nënta: Larja e veshkave (dializa) me anë të aparturave mjekësore, të cilat pastrojnë gjakun dhe më pas e kthejnë atë në trup, duke i shtuar disa lëndë kimike dhe ushqyese si sheqerna e kripëra etj., e prish agjërimin.³³¹

E dhjeta: Dhurimi i gjakut e prish agjërimin, ashtu si hixhamja, ndaj mund të bëhet veçse gjatë natës. Sidoqoftë, nëse lind nevoja për të dhuruar gjak që të shpëtohet jeta e një njeriu, atëherë e prish agjërimin dhe e shlyen më vonë.³³²

E njëmbëdhjeta: Gjilpërat ushqyese (serumet) e prishin agjërimin.³³³

³²⁸ Shih Fetvatë e Komisionit të përhershëm të fetvave (10\263) fetva nr. (56), Mexhmu Fetava Ibn Baz (3\238-239) dhe Mexhmuë Fetava Ibn Utnejmin (19\250-251). [Analizat e gjakut qoftë me pak gjak apo shumë nuk e prishin agjërimin, siç u sqarua me lart.]

³²⁹ Shih: Fetava Ibn Utnejmin (1\514).

³³⁰ Shih: Mexhmuë Fetava të Ibn Utnejmin (19\249-253).

³³¹ Shih: Fetvatë e komisionit të përhershëm (9944).

³³² Shih: Fetvanë e Ibn Utnejmin (1\511). [Sipas mendimit më të saktë që hixhamja nuk e prish agjërimin, dhurimi i gjakut nuk e prish agjërimin, ndërsa marrja e gjakut e prish agjërimin, por siç u sqaruar më lart kur njeriu ka nevojë të marrë gjak gjatë ditë së agjërit për shkak të sëmundjes, e prish agjërimin dhe e zëvendëson atë pas ramazanit].

³³³ Fetava Lexhne (5176).

37- Disa nga vlerat e agjërimit

Ebu Hurejra (r.a.) tregon se i Dërguari (a.s.) ka thënë: **"Agjërimi është mburojë."**³³⁴

Ndërsa në variantin e Ahmedit përcillet me këtë tekst: **"Agjërimi është mburojë dhe kështjellë që të mbron nga zjarri"**.³³⁵

Kurse Xhabir Ibn Abdilahi (r.a.) përcjell nga i Dërguari (a.s.) se: **"Agjërimi është mburojë, që e mbron njeriu nga zjarri"**.³³⁶

Uthman Ibn Ebu As El Thekafij (r.a.) thotë: "E dëgjova të Dërguarin (a.s.) duke thënë: **"Agjërimi është mburojë ndaj zjarrit të xhehenemit, ashtu si mburojat tua të luftës."**³³⁷

Ebu Ubejde Ibn Xherahi (r.a.) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin (a.s.) të thotë: **"Agjërimi është mburojë, për aq kohë sa nuk e ka dëmtuar."**³³⁸

Atëherë, fjala 'agjërimi është mburojë' është me kuptimin: mburojë nga Zjarri i Xhehenemit.³³⁹

Dobi dhe rregulla

E para: Agjërimi është shkak për vënien nën kontroll të dëshirave epshore, që e shpion njeriun në Zjarr. Iraki ka thënë: "Agjërimi është mburojë që të mbron nga zjarri, sepse ai është

³³⁴ Shënon Bhariu (1795) dhe Muslimi (1151).

³³⁵ Ky është varianti i Ahmedit (2\402).

³³⁶ Shënon Ahmedi (3\396).

³³⁷ Shënon Ahmedi (4\22) Nesai (4\176) dhe Ibn Maxhe (1639). Ibn Huzejmetu e klasifikon të saktë (2125), por edhe Ibn Hibani (3649).

³³⁸ Shënon Nesai (4\167), Ahmedi (1\195), Tajalisi (227), Ebu Jaëla (878), Darimiu (1732). Mundhir thotë se hadithi është i mirë (2\940) numër (1643). Ndërsa Dijetari i nderuar Ahmed Shakir e vleron hadithin të saktë (1690). Në zinxhirin e trasmetimit të këtij hadithi gjendet Beshar Ibn Ebi Sejf El Xhuremij të cilin nuk e konsideron korrekt veçse Ibn Hibani, ndërsa Albani e ka klasifikuar të dobët këtë hadith në Daif Sunen El Nesai, ndoshta shkak për të cilin e ka klasifikuar të dobët është transmetuesi Beshar, por gjithsesi këtë sened e përforcojnë hadithet e tjera. [Në silsile daife (6438) Albani ka sqaruar se hadithi është i dobët për shkak se ka disa problem, njëri prej të cilëve është ekzistenca e dy transmetuesve të dobët në sened. Por e sakta, - sqaron Albani, - sipas një rruge tjetër të saktë që e sjell Nesaiu është se kjo është një thënie e sahbiut Ebi Ubejdes r.a., dhe jo hadith i Pejgamberit].

³³⁹ Kurtubi, mbasi ka pohuar faktin që agjërimi është mburojë, sqaron kuptimet e të qenit të agjërimit mburojë: a) Sipas ligjit fetar agjërimi është mburojë, çka do të thotë se agjëruesi duhet ta ruaj këtë mburojë nga gjërat që e cenojnë apo e prishin. Pikërisht, këtë kuptim ka fjala e Pejgamberit, duke folur për etikën e agjëruesit: "Kur të jeni me agjërime mos e fëlliqni gojën me fjalë të këqija....".

b) Agjërimi është mburojë, duke marrë parasyshë efektin që jep, e që është dobësimi i dëshirave epshore. Për këtë kuptim flet thënia e të Dërguarit (a.s.) në hadithin kudsij: "Agjëruesi lë plotësimin e dëshirës dhe ushqimin për Mua".

c) Agjërimi është mburojë, duke marrë parasyshë shpërblimi që ka. Kjo përmendet qartë në hadithin: "Kush agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Allahu i Lartësuar ia largon fytyrën nga Zjarri shtatëdhjetë vite".

vetëpërmbytje nga epshi e dëshirat e liga, kurse zjarri i Xhehenemit është i rrethuar me epshe, me gjëra që i dëshiron nefs. "³⁴⁰

E dyta: Agjërimin ka vlera, prandaj besimtari duhet të shtojë sa më shumë agjërim vullnetar, nëse e përballon dhe nëse kjo nuk e pengon ndaj punëve të tjera të mira që kanë përparësi ndaj agjërimin nafie, siç është xhihadi etj.

E treta: Agjërimi që të mbron nga zjarri është ai që nuk është përlyer me vepra që ia humbin ose ia pakësojnë shpërblimin, si: përgojimi, mbartja e fjalëve për të prishur mes njerëzve, gënjeshtër e sharja, bazuar në transmetimin që është përcjellë nga Ebu Ubejde: "Agjërimi është mburojë që të mbron, **për atë kohë sa nuk është dëmtuar** (çarë)". Mburoja e agjërimin çahet nga veprimi i të ndaluarave, prandaj agjëruesi duhet ta ruajë agjërimin nga gjërat që ia heqin ose ia pakësojnë shpërblimin, në mënyrë që ai të jetë mburojë nga zjarri.

E katërta: Qëllimi me agjërimin është pastrimi i shpirtit e përmirësimi i zemrës, jo thjesht privimi nga të ngrënët e të pirët.

38- Agjërimi kur gdhin xhunub

Allahu i Lartësuar thotë: **“Tani është e lejuar për ju që, gjatë netëve të agjërimin, të shkoni me bashkëshortet tuaja”**. [Bekare:187]

“Prandaj, ju lejohet bashkimi me bashkëshortet tuaja (gjatë netëve të ramazanit) dhe tani kërkoni atë që ka caktuar Allahu për ju (lindjen e fëmijëve). Hani e pini, derisa të dalloni fijen e bardhë të agimit nga fija e zezë”. [Bekare 187].

Aishja dhe Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të dyja!) tregojnë se: “I Dërguari (a.s.) gdhijet xhunub nga kontakti me bashkëshortin, pastaj lahej dhe agjëronte.”

³⁴⁰ Tarhu tethrib fi sherhi et tekrib (4\90).

Në një variant që e shënon Muslimi, Umu Seleme (r.a.) thotë se: "I Dërguari (a.s.) gdhihej xhunub nga kontakti me gruan, jo nga ëndërrimet erotike, dhe nuk e prishte agjërimin as nuk e shlyente kaza atë ditë".³⁴¹

Gjithashtu, Muslimi shënon nga Ebu Bekr Ibn Abdurrahman (Allahu e mëshiroftë!), i cili thotë: "E dëgjova Ebu Hurejren (r.a.) që, ndër të tjera, u tregonte njerëzve: “Kë e zë agimi xhunub, të mos agjërojë.” Këtë ia tregova Abdurrahman Ibn Harithit (transmetuesi, Ebu Bekri, e ka fjalën për babain e vet, Abdurrahmanin), i cili e kundërshtoi. Abdurrahmani u nis dhe unë bashkë me të, gjersa u futëm tek Aishja dhe Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të dyja). Abdurrahmani i pyeti për këtë dhe që të dyja i thanë: “Profeti (a.s.) gdhihej xhunub jo nga ëndërrimet erotike, dhe pastaj agjëronte. Më pas, ikëm prej aty dhe shkuam tek Mervani. Abdurrahmani ia tregoi atij këtë. Mervani tha: “E ke detyrë të shkosh tek Ebu Hurejra e ta sqarosh”. Shkuam tek Ebu Hurejra. Ndërkohë, Ebu Bekri, - transmetuesi i hadithit, - tregon se ishte prezent në tërë këtë ngjarje. Abdurrahmani ia tregoi këto Ebu Hurejres. “Vërtet, ato të dyja ta thanë këtë gjë?” - pyeti Ebu Hurejra. - “Po” - tha ai. Atëherë, Ebu Hurejra ia ktheu: “Ato e dinë më mirë.” Pastaj Ebu Hurejra tha se i referohej Fadil Ibn Abasit në atë që kish thënë. Ai tha: “Unë e kam dëgjuar atë nga Ibn Abasi dhe jo nga i Dërguari (a.s.).” Kështu, Ebu Hurejra u tërhoq nga mendimi që kishte patur. Ibn Xhurejxhi, një nga transmetuesit në sened, tregon se ka pyetur Abdulmelikun, një transmetues tjetër pararendës në sened: “A kanë pohuar Aishja dhe Umu Seleme se kjo ka ndodhur në Ramazan?” Ai tha: “Pohimi i tyre është se ai gdhihej xhunub, jo prej ëndrrave erotike, dhe pastaj agjëronte”.³⁴²

Muslimi shënon nga Aishja (r.a.) se një burrë shkoi tek i Dërguari (a.s.) për ta pyetur, kurse ajo po e dëgjonte mbas derës. Ai tha: “O i Dërguari i Allahut, hyn koha e namazit, ndërkohë që unë akoma jam xhunub. A të agjëroj?” I Dërguari (a.s.) tha: **“Edhe mua më gjen koha e namazit xhunub dhe agjëroj.”** Ai i tha: “Ti nuk je si ne, o i Dërguari i Allahut, sepse ty t’i ka falur

³⁴¹ Shënon Buhariu (1921) dhe Muslimi (1171).

³⁴² Ky është transmetimi i Muslimit (1109). Ebu Hurejra përmend se këtë gjë e kishte dëgjuar nga Fadli, ndërsa në variantin tjetër që e shënon Nesaiu ai përmend që e ka dëgjuar nga Usame Ibn Zejd. Shih: Sunen El Kubra (2931-2931). Por mbase e ka dëgjuar nga të dy. Shih: Sherh En Nevevij (7\222), Mufhim (3\168), dhe Sherh Ibn Mulekin (5\197).

Allahu gjynahet e kaluara dhe të mëvonshmet.” Profeti tha: “Pasha Allahun, unë shpresoj se jam më i frikësuari ndër ju prej Allahut, dhe unë e di më mirë se ju se çfarë duhet t’i ruhem”.³⁴³

Dobi dhe rregulla

E para: Lejohet kontakti seksual me bashkëshorten gjatë gjithë netëve të Ramazanit. Ndërsa lënia e kësaj gjëje për “devotshmëri” është në kundërshtim me udhëzimin profetik, përveç dhjetë netëve të fundit të Ramazanit për atë që ka hyrë në itikaf.

E dyta: Kushdo që kryen marrëdhënie intime ose bëhet xhunub prej ëndrrave erotike gjatë netëve të Ramazanit dhe e vonon guslin deri mbas agimit, le të vazhdojë agjërimin, me pajtimin e plotë të dijetarëve.³⁴⁴

E treta: Të mirat që Nënave të Besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) i kanë bërë këtij umeti, duke ruajtur dijen që ka të bëjë me gjendjen e të Dërguarit (a.s.) në shtëpinë e tij, me gratë e tij dhe me përcjelljen e kësaj dijeje shumë të nevojshme te njerëzit.

E katërta: Fjalët e Nënave të Besimtarëve që kanë të bëjnë me gjendjen e Profetit (a.s.), në shtëpinë e tij, gjë të cilën nuk mund ta vërenin të tjerët veç tyre, kanë përparësi mbi fjalët e të tjerëve.³⁴⁵

E pesta: Vonimi i larjes prej xhunubimit deri mbas shfaqjes së agimit, nuk është e posaçme për Profetin (a.s.), por është për të gjithë umetin.

E gjashta: Në thënien e Umu Selemes (r.a.) "Gdhihej xhunub nga kontakti me gruan, jo nga ëndërrimet erotike" ka dy dobi:

- 1- I Dërguari (a.s.) kryente marrëdhënie intime në Ramazan dhe e vononte guslin deri pas shfaqjes së agimit, për të treguar se kjo gjë është e lejuar.

³⁴³ Shënon Muslimi (1110), Malik (1\289) dhe Ibn Hibani (3495).

³⁴⁴ Sherh Ibn Betal alel Buhari (4\49), Sherhu el umdetu libn Mulekin (5\195), Fet’hu el bari i Ibn Haxherit (4\147) dhe Nejlul eleutarë (4\91).

³⁴⁵ Referimi i mëparshëm (4\147), shih: El Fet’h (4\144).

- 2- Xhunubllëku i tij ishte nga marrëdhëniet intime e jo nga ëndërrimet erotike, sepse Profeti (a.s.) nuk shihte ëndrra erotike, pasi ato janë prej Shejtanit, ndërsa ai ishte i mbrojtur prej tij.³⁴⁶

E shtata: Profeti (a.s.) ishte ndër njerëzit më i devotshmi ndaj Allahut të Lartësuar dhe më i dituri se në çfarë të ruhej.

E teta: Nga këto hadithe përfitojmë se gratë me menstruacione dhe lehoni, nëse pastrohen para agimit dhe lahen mbas hyrjes së tij, e kanë të saktë agjërimin, qoftë kur e lënë larjen me harresë apo me qëllim, me arsye apo pa arsye, njësoj si në rastin e xhunubllëkut.³⁴⁷

E nënta: Këto hadithe nxisin për të marrë për shembull të Dërguarin (a.s.). Gjithashtu, ato dënojnë thellimin e tepruar, braktisjen gjërave të lejueshme dhe pyetjet jo të duhura.³⁴⁸

E dhjeta: Agjërimi i atij që është xhunub dhe i gruas me mestrunacione ose lehonë është i saktë, edhe nëse marrin gusël pasi të ketë hyrë agimi. Këtu përfshihen të gjitha llojet e agjërimeve, si në Ramazan edhe jashtë tij, qoftë vaxhib, qoftë për zotim, kaza ose nafile.

E njëmbëdhjeta: Nëse gjejmë kundërshtim në ndonjë çështje, duhet t'i referohemi për sqarim atij që ka më shumë njohuri për të, prandaj Ebu Hurejra (r.a.) tha: "Ato e dinë më mirë", duke patur për qëllim Aishen dhe Umu Selemen (Allahu qoftë i kënaqur nga të dyja!), sepse ato kishin njohuri për këtë çështje më shumë se çdokush tjetër.

E dymbëdhjeta: E vërteta e prerë dhe argumenti që nuk mund të hidhet poshtë, në rastet e mosmarrëveshjeve është Suneti i Profetit (a.s.).

³⁴⁶ Shih: El Mufhim (3\167) dhe El Fet'h (4\144). Lidhur me këtë është transmetuar një dëshmi e dobët nga Ibn Abasi (r.a.), ku thotë: "Asnjë Profet nuk ka parë ëndërr erotike, sepse ëndrrat erotike janë prej shejtanit". Shënon Tabarani në El Kebir (11\225) nr: (11564) dhe në El Eusat (8062). Në zinxhirin e transmetimit të tij është Abdulaziz Ibn Ebi Thabit i cili me pajtimin e të gjithëve është i dobët, siç përmend Hejthemiu në Zevaid (1\267). Neveviu ka përzgjedhur mendimin që ëndrrat erotike kanë qenë ta pamundura për profetët. Hadithin në fjalë, Neveviu e shpjegon me kuptimin që Pejgamberi gdhiehet xhunub nga marrëdhëniet intime, e jo nga ëndrra erotike, sepse kjo e fundit është e pamundur për profetin. Ky rast ka përafërsi me shpjegimin e thënies së Allahut të Lartësuar: "...**dhe në kundërshtim me çdo të drejtë i vrisnin të Dërguarit...**", pasi dihet që nuk ka ndonjë rast ku mund të jetë e drejtë vrasja e tyre. Marrë nga Sherh Sahih Muslim (7\222). Po kështu thotë edhe Ibn Mulkin në Sherh el Umde (5\201).

³⁴⁷ Shih El istidhkarë (10\48), Sherhu El Nevevi (7\222) dhe Sherh Ibn Mulkin (5\200).

³⁴⁸ Temhid (17\420) dhe El Fet'h (4\149).

E trembëdhjeta: Pranimi i gabimit dhe paanësia kur dëgjon faktet, siç veproi Ebu Hurejra, kur pranoi se nuk e kishte dëgjuar nga i Dërguari (a.s.) atë që kishte thënë, por e kishte dëgjuar nga të tjerë.

39- Ligjshmëria e itikafit

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që bëjnë tavaf, që rrinë aty në itikaf dhe që falen duke bërë ruku e sexhde!”** [Bekare:125].

“Mos iu afroni atyre (bashkëshorteve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurim (bëni itikaf) në xhami! Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos iu afroni atyre! Kështu ua shpjegon njerëzve urdhëresat, që ata të ruhen nga të këqijat”[Bekare: 187].

Abdullahi i biri i Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: "I Dërguari (a.s.) qëndronte në itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit".³⁴⁹

Aishja (r.a.) thotë se i Dërguari (a.s.) qëndronte në itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Ai e bënte një gjë të tillë çdo vit, gjersa Allahu i Lartmadhëruar i mori shpirtin. Pas Profetit (a.s.), qëndronin në itikaf gratë e tij.³⁵⁰

Dobi dhe rregulla

E para: Itikafi ka qenë i ligjshëm edhe për popujt para nesh.

E dyta: Itikafi është i ligjshëm. Ai është sunet i fortë. Ai është prej adhurimeve të mëdha që të afron tek Allahu i Lartësuar, prandaj Profeti (a.s.) e vazhdoi rregullisht. Zuhriu (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Sa çudi për muslimanët, si e lanë itikafin! Ndërsa Profeti nuk e la asnjëherë,

³⁴⁹ Shënon Buhariu (1921) dhe Muslimi (1171).

³⁵⁰ Shënon Buhariu (1922) dhe Muslimi (1172).

qysh kur hyri në Medinë, por e vazhdoi çdo vit, në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, gjersa ia mori shpirtin Allahu i Lartësuar".³⁵¹

Ndërsa Ata'u El-Hurasani (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Më herët thoshin: Ai që qëndron në itikaf është si rob i cili është ndalur i përulur para Zotit të tij dhe thotë: 'O Zot, nuk do të largohem, derisa Ti të më falësh! O Zot, nuk do të largohem, derisa Ti të më falësh!'"³⁵²

E treta: Itikafi mund të bëhet veçse nëpër xhami, edhe nëse ato janë xhami ku nuk falet xhumaja. Atë nuk e prish dalja për faljen e xhumasë, madje, edhe nëse del herët për të falur xhumanë, lejohet.

E katërta: Atyre që nuk e kanë detyrë xhumanë u lejohet të qëndrojnë në itikaf në xhamitë ku nuk falet namaz me xhemat, siç janë: xhamitë e braktisura, xhamitë e tregjeve, xhamitë që janë ndërtuar në ferma etj.³⁵³

E pesta: I Dërguari (a.s.) qëndonte në itikaf në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit. Kështu vepruan edhe gratë e tij (Allahu qoftë i kënaqur me to!). Një nga synimet e qëndrimit të Profetit (a.s.) në itikaf ishte kërkimi i Natës së Kadrit.

E gjashta: Nuk lejohet përqaftimi, përkëdhelja e prekja me trup e bashkëshortes kur je duke qëndruar në itikaf. Nëse kryen marrëdhënie intime, prishet itikafi, por nuk ka shlyerje dhe as kaza. Nga Ibni Abasi përcillet: "Nëse ai që qëndon në itikaf kryen marrëdhënie intime, i prishet itikafi, por mund ta fillojë përsëri".³⁵⁴

E shtata: Nëse kryen marrëdhënie intime me bashkëshorten prej harresës, itikafi nuk prishet, ashtu sikurse nuk prishet agjërimi prej harresës.³⁵⁵

40 – PËR NATËN E NJËZETENJËTË

³⁵¹ Sherh Ibn Betal ala El Buhari (4\181).

³⁵² Referimi i mëparshëm (4\182).

³⁵³ Shih Sherhu elmumtië (6\509).

³⁵⁴ E shënon Ibn Ebi Shejbe (2\338) dhe e vleron të saktë Albani në Irvaë, duke theksuar se hadithi përmbush kushtet e Buhariut e të Muslimit (4\148).

³⁵⁵ Shih Istidhkarë (3\404).

Ebu Selemeh Ibn Abdurrahmani tregon: “Një ditë, kur përkujtuam me njëri-tjetrin natën e Kadrit, unë shkova tek Ebu Said El Khudriu (radijallahu anhu), të cilin e kisha shok, dhe i thashë: ‘A shkojmë tek palmat!’ Ai doli i veshur me një pelerinë. Unë e pyeta se a e kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut të fliste për natën e Kadrit. Ai u përgjigj me po dhe pastaj tha: ‘Ne bëmë itikaf me të Dërguarin e Allahut, duke qëndruar me të në xhami dhjetëditëshin e mesëm të ramazanit, dhe dolëm në mëngjesin e ditës së njëzetë. I Dërguari i Allahut mbajti fjalim dhe tha: **‘Mua m’u tregua nata e Kadrit, mirëpo e harrova atë - ose ‘m’u hoq nga mendja’, - prandaj kërkojeni atë në çdo natë teke të dhjetëditëshit të fundit. Gjithashtu, m’u tregua se bëja sexhde në ujë e në baltë, prandaj ai që bëri itikaf me të Dërguarin e Allahut le të kthehet.’** Ne u kthyem në xhami e nuk pamë asnjë pupë reje në qiell, por pastaj u vrenjt dhe ra shi aq sa rodhi çatia e xhamisë, e cila ishte ndërtuar me degë palmash. Kur po kryhej namazi, pashë të Dërguarin e Allahut të binte në sexhde në ujë e në baltë, dhe pas namazit pashë në ballin e tij shenjat e baltës.”³⁵⁶

Në një transmetim tjetër të Ebu Saidit, ai thotë: “Qëndruam në itikaf me të Dërguarin e Allahut dhjetëditëshin e mesëm të ramazanit dhe në mëngjesin e njëzetë i zhvendosëm gjërat tona personale;. I Dërguari i Allahut erdhi dhe na tha: **“Kush ka qenë në itikaf, le të kthehet tek vendi i itikafit të tij, sepse mbrëmë unë pashë në ëndërr veten time duke rënë në sexhde në ujë e baltë.”** Kur i Dërguari i Allahut u kthye tek vendi i tij i itikafit, tha: **“Gjithashtu, pashë që qielli u vrenjt dhe ra shi.”** Pasha Atë të Cilin e dërgoi Muhamedin me të vërtetën, qielli u vrenjt në fund të asaj dite dhe ra shi. Xhamia ka qenë e mbuluar vetëm me degë palmash dhe unë pashë në hundën e tij gjurmët e ujit dhe të baltës.”³⁵⁷

Në një transmetim tjetër, Ebu Saidi thotë: “I Dërguari i Allahut qëndronte në xhami në dhjetëditëshin e mesëm të muajit ramazan. Kur vinte mbrëmja, pasi kishin kaluar njëzet netë dhe po vinte e njëzetënjëta, kthehej në banesën e tij. Gjithashtu, edhe ata që kishin qëndruar me të ktheheshin në banesat e tyre. Në një prej muajve të ramazanit, në itikafin e tij, kur po afronte nata që do të largohej për në banesë, u mbajti fjalim njerëzve dhe, ndër të tjera, tha: **“Unë pata qëndruar në itikaf gjatë këtyre ditëve, por vendosa që të bëj itikaf në dhjetëditëshin e fundit, prandaj kush ka qenë në itikaf me mua, le të qëndrojë në vendin e tij. Mua m’u tregua kjo natë, por më pas e harrova. Kërkojeni atë në dhjetëshin e fundit dhe kërkojeni në çdo natë teke. Gjithashtu, unë pashë të bija në sexhde në ujë e në baltë.”** Atë natë, qielli u mbush me re dhe ra shi. Në vendin e sexhdes ku falej i Dërguari i Allahut kishte gjerbuar ujë, dhe kjo ndodhi natën e njëzetënjëte. Sytë e mi panë të Dërguarin e Allahut kur mbaruam namazin e sabahut. Fytyra e tij qe lagur e qe bërë me baltë.”³⁵⁸

³⁵⁶ Buhariu 1912 dhe Muslimi 1167.

³⁵⁷ Ky transmetim është i Muslimit, Buhari 1935.

³⁵⁸ Buhariu 1914.

Dobitë dhe dispozitat

E para: Ecja ne kërkim të dijes dhe shfrytëzimi i vendit dhe kohës së përshtatme për të pyetur dijetarët.

E dyta: Nxënësi të mundohet që të kërkojë prej dijetarit një vend të qetë e të rehatshëm, me qëllim që të arrijë të marrë përgjigjen e duhur për problemin që ka.

E treta: Personi që është duke falur namaz nuk duhet të fshijë gjërat që i ngjiten në fytyrë e në ballin e tij, vetëm nëse diçka e tillë e mundon shumë ose i heq përqëndrimin ndaj namazit.³⁵⁹ Gjithashtu, lejohet bërja e sexhdes mbi baltë e në ujë.

E katërta: Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) ishte qenie humane, dhe si i tillë edhe mund të harronte, përveç kur urdhërohej të komunikonte diçka, sepse në këtë rast e ruante Allahu prej harresës. Ëndrrat e profetëve janë të vërteta dhe realizohen ashtu sikurse janë parë prej tyre.

E pesta: Në ëndrrën e Profetit mbi natën e Kadrit, mundet që ai ta ketë ditur atë ose të ketë parë shenjat e saj. Në Sahih-un e Buhariut transmetohet nga Ebu Saidi se Xhibrili e njoftoi të Dërguarin e Allahut se nata e Kadrit është në dhjetëshen e fundit të netëve të ramazanit.³⁶⁰

E gjashta: Dijetari, nëse ka pasur njohuri mbi diçka dhe më pas e ka harruar, mundet që t'u tregojë shokëve dhe nxënësve të tij për harresën e ta pranojë atë.³⁶¹

E shtata: Në hadith ka argument për pëlqimin e itikafit në ramazan. Dhjetëditëshi i mesit të muajit është më i vlefshëm se dhjetëditëshi i parë, ndërsa dhjetëditëshi i fundit është më i vlefshëm se dhjetëditëshi i mesit.

E teta: Prijësi e ka të ligjshme t'u mbajë fjalim njerëzve e të sqarojë çështjet e rëndësishme për ta.

E nënta: Kujdesi dhe përpjekja e plotë e Profetit për t'i mësuar popullit të tij atë që ishte e dobishme për ta dhe, gjithashtu, kujdesi dhe përpjekja e shokëve të tij në kërkimin e natës së Kadrit.

E dhjeta: Vlera e itikafit në dhjetëditëshin e fundit të ramazanit dhe klasifikimi i kësaj vepre si sunet i fortë, për shkak se i Dërguari i Allahut e ka kryer atë vazhdimisht.

E njëmbëdhjeta: Nata e Kadrit kërkohet në dhjetënetëshin e fundit, sidomos në netët teke të tyre. Më e shpresuara e këtyre netëve teke është nata e njëzetënjtë.

³⁵⁹ Buhariu përcjell prej Humejdut se prej sunetit është edhe mosfshirja e ballit në namaz. Neveviu mbi këto fjalë ka shtuar: kështu kanë thënë dijetarët se është e pëlqyeshme të mos e fshijë ballin në namaz (shpjegimi i muslimit 8/61). Ibn Mulakin ne shpjegimin e Umdes ka thënë: kjo gjë është unanimitet tek dijetarët (5/423).

³⁶⁰ Buhariu 780.

³⁶¹ Ibn Mulakin në shpjegimin e Umdes 5/424.

E dymbëdhjeta: Duhet që ta vendosim mirë ballin dhe hundën në tokë gjatë sexhdes, ashtu si ka vepruar i Dërguari i Allahut.

E trembëdhjeta: Ky hadith tregon se si ishin muslimanët në kohën e të Dërguarit të Allahut: me pak gjëra të kësaj bote e me një jetesë mjaft të thjeshtë, saqë xhamia ishte e mbuluar me degët e palmës dhe se shiu binte mbi ta gjatë kohës që ishin në namaz.

E katërbëdhjeta: Vlera e natës së njëzetënjëte, e cila supozohet të jetë nata e Kadrit, kështu që nuk duhet që muslimani ta neglizhojë adhurimin në këtë natë.

41- Gjallërimi i dhjetënetëshit të fundit me ibadet

Nga Aishja transmetohet se ka thënë: “Kur hynte dhjetëditëshi i fundit, Profeti shtrëngonte mesin, gjallëronte natën dhe zgjonte familjen e tij.”³⁶²

Nga Aishja transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut bënte përpjekje në dhjetëditëshin e fundit si asnjëherë tjetër.”³⁶³

Nga Aliu transmetohet se i Dërguari i Allahut e zgjonte familjen e tij në dhjetë netët e fundit të Ramazanit për adhurim.³⁶⁴

Në një shprehje të Imam Ahmedit transmetohet se i Dërguari i Allahut, kur hynte dhjetëditëshi i fundit, zgjonte familjen e tij dhe e shtrëngonte mesin e tij. Ebu Bekër Ibn Ajash e kanë pyetur: “Çfarë kuptojmë me shtrëngim të mesit?” Ai është përgjigjur: “Largimi nga marrëdhëniet intime me gratë.”³⁶⁵

Dobitë dhe dispozitat

³⁶² Buhariu 1920, Muslimi 1174.

³⁶³ Muslimi 1175.

³⁶⁴ Tirmidhiu, hasen-sahih 795.

³⁶⁵ Musned Ahmed 1/132.

E para: Përpjekjet e mëdha të Profetit në adhurim, edhe pse Allahu ia kishte falur gjynahet e kaluara dhe të mëvonshme. Përpjekjet e tij ishin më të mëdha në dhjetë netët e fundit të ramazanit.

E dyta: Udhëzimi profetik në dhjetëshen e fundit të ramazanit është gjallërimi i natës me namaz e me përmendje të Allahut dhe me largim prej grave.

E treta: Zgjimi i familjes për namaz nate në dhjetëshen e fundit të ramazanit është vepër e pëlqyer. Nëse e kanë bërë zakon të rrinë zgjuar gjatë muajit ramazan, siç ndodh në kohën tonë, atëherë le të bëhet kjo me namaz e me përkujtim të Allahut e jo me argëtime e lojra.

E katërta: I lejohet burrit që t'i shtyjë e t'i detyrojë gratë dhe fëmijët në kryerjen e adhurimeve vullnetare, dhe ata në këtë rast e kanë obligim t'i binden atij.³⁶⁶

E pesta: Në dhjetënetëshin e fundit të ramazanit është e pëlqyeshme që e tërë nata të kalohet me namaz e në përmendje të Allahut, nëse është e mundur, sepse kështu ka vepruar i Dërguari i Allahut, sikurse tregohet qartë në hadithet e transmetuara mbi këtë temë. Ndërsa transmetimet në lidhje me ndalesën e namazit në tërë natën, mund të themi se ato u drejtohen vazhdimësisë së një veprë të tillë përgjatë tërë vitit, ndërsa netët të cilat kanë vlera më shumë, si dhjetë netët e fundit të ramazanit, veçohen nga ky përgjithësim.³⁶⁷

E gjashta: Urtësia e përpjekjeve në adhurim përgjatë dhjetë netëve të fundit të ramazanit është kërkimi i natës së Kadrit. Kufizimi i natës së Kadrit në këto net është mëshirë prej Allahut, sepse po të ishte përgjate gjithë vitit e pa kufizuar, njerëzit do të mundoheshin shumë në kërkim, e shumica e tyre nuk do t'ia arrinin qëllimit për gjetjen e saj.³⁶⁸

³⁶⁶ Shih Sherh Ibn Battal 4/159 dhe El mufhim 3/249.

³⁶⁷ Shih shpjegimi i sahih Muslim të Neveviut 8/71, fetauat kubra Ibn Tejmijeh 2/498.

³⁶⁸ Sherh Ibn Battal 4/159.

42- Shenjat e natës së Kadrit

Allahu i Lartësuar thotë: **“Në të zbresin melekët dhe shpirti, me lejen e Zotit të tyre, për çdo çështje. Ajo është paqe, derisa të shfaqet agimi.”**

Prej Zir Ibn Hubejshit përcillet se ka thënë: “Unë kam dëgjuar Ubej Ibn Ka`bin të thotë se Abdullah Ibn Mes`udi ka thënë: ‘Kush fal namaz nate përgjatë gjithë vitit e arrin natën e Kadrit.’ Ubeji pas kësaj fjale të Ibn Mes`udit ka thënë: ‘Pasha Allahun përveç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, ajo (nata e Kadrit) gjendet në ramazan. Pasha Allahun, unë e di se cila natë është ajo. Ajo është nata në të cilën na urdhëroi i Dërguari i Allahut të ngriheshim e të faleshim. Ajo është nata që i paraprin agimit të njëzeteshtatë të ramazanit. Prej shenjave të saj është lindja e diellit në mëngjes i bardhë e pa rreze.”³⁶⁹

Në një transmetim të Ibn Hibanit thuhet: “Prej shenjave të natës së Kadrit është lindja e diellit në mëngjes, i bardhë e pa rreze, si një tas.”³⁷⁰

Nga Ibn Mes`udi transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Nata e Kadrit është në gjysmën e shtatëshes së fundit të ramazanit. Dielli në mëngjesin e saj lind i qartë e pa rreze.”** Ibn Mes`udi më pas ka thënë: “Unë e vështrova lindjen e Diellit dhe ishte ashtu sikurse e kishte përshkruar i Dërguari i Allahut.”³⁷¹

Prej Ebu Hurejres përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë për natën e Kadrit: **“Ajo është nata e njëzeteshtatë ose e njëzetënëntë. Melekët atë natë janë në tokë me një numër më të madh se numri i guralecëve.”**³⁷²

Ubadeh Ibn Samiti përcjell se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Disa shenja të natës së Kadrit janë: ajo është natë e kthjellët dhe e ndritshme, si një natë me hënë, e qetë, as e ftohtë e as e nxehtë dhe nuk mund të ketë goditje meteorësh derisa të agojë. Shenjë tjetër është edhe dielli që lind në mëngjes i qartë e pa rreze, si hëna katërmëdhjetëshe. Atë ditë, shejtanit nuk i lejohet të dalë bashkë me të.”**³⁷³

Xhabiri përcjell se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Unë doja të tregoja për natën e Kadrit, por pastaj e harrova. Gjithsesi, ajo është në dhjetënetëshin e fundit. Ajo është natë e kthjellët, e ndritshme, as e nxehtë e as e ftohtë. Ajo duket si natë me një hënë që me ndriçimin e saj ia zbeh ndriçimin yjeve. Shejtani i asaj nate nuk del, derisa të çelë agimi.”**³⁷⁴

³⁶⁹ Muslimi 762.

³⁷⁰ Ibn Hiban 3690.

³⁷¹ Ahmed 1/406, saktësoi Ahmed Shakir 3857.

³⁷² Ahmed 2/519, saktësoi Ibn Khuzejme 2194, Albani e ka konsideruar hadith të mirë (Hasen) shih Sahihah 2205.

³⁷³ Ahmed 5/324, Hejthemi ka thënë se personat në zinxhirin e transmetimit janë të besueshëm, Zeuaid 3/175.

³⁷⁴ Ibn Khuzejme 2190, Ibn Hiban 3688, saktësoi Albani.

Ibn Abasi transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë në lidhje me natën e Kadrit se: **“Ajo është natë e kthjellët, as e nxehtë e as e ftohtë. Dielli në mëngjesin e saj lind i kuq e i dobët.”**³⁷⁵

Dobitë dhe dispozitat

E para: I lejohet dijetarit të mos tregojë ndonjë gjë që di, nëse mendon se një veprim i tillë është i dobishëm, sikurse fshehu Ibn Mes'udi diturinë që kishte mbi natën e Kadrit, me qëllim që njerëzit të mos neglizhonin e të mos rrinin pa falur namaz nate gjatë dhjetë netëve.

E dyta: Dijetari u sqaron njerëzve atë që duhet ta dinë, sikurse sqaroi Ubej Ibn Ka'bi natën e Kadrit.

E treta: Lejohet që dijetarët të përpiqen dhe të kenë mendime të ndryshme, për sa u përket dobive dhe dëmeve. Kjo nuk është e ndaluar, nëse vjen si rrjedhojë e një përpjekje të saktë dhe kur qëllimi është arritja e të vërtetës.

E katërta: Nata e Kadrit gjendet në dhjetë netët e fundit. Shpresohet që ajo të jetë në një prej netëve teke dhe nata më e shpresuar është nata e njëzeteshtatë, sikurse betohet për një gjë të tillë Ubej Ibn Ka'bi.

E pesta: Këto tekste tregojnë se nata e Kadrit ka disa shenja, të cilat janë:

1. Numri i madh i melekëve, me në krye Xhibrilin (alejhi selam), që zbresin këtë natë, për të marrë pjesë me njerëzit që falen nëpër xhamitë e tyre. Numri i tyre është aq i madh, saqë ia kalon numrit të guralecëve të tokës. Kjo shenjë nuk u shfaqet njerëzve.
2. Shpëtimi shtohet në natën e Kadrit, në sajë të bindjes dhe nështrimit të njerëzve ndaj Allahut.
3. Dielli në mëngjesin e asaj nate lind i bardhë, pa rreze. Shkaku i kësaj, sipas disa dijetarëve, është ngritja në qiell e melekëve, drita dhe krahët e të cilëve mbulojnë dhe pengojnë rrezet e diellit,³⁷⁶ pasi atë natë numri i melekëve që zbresin në tokë është shumë i madh.
4. Nata e Kadrit është e kthjellët, e qetë, as e ftohtë e as e nxehtë, por kjo është një çështje relative, e cila ndryshon në bazë të vendeve të ndryshme, ku të ftohtët dhe të nxehtët janë të ndryshme. Megjithatë, ajo natë nuk është as e ftohtë e as e nxehtë, në lidhje me netët që i paraprijnë dhe ato që e pasojnë.

³⁷⁵ Ibn Khuzejme 2192, sakesoi Albani.

³⁷⁶ Ikmal elmualim 4/148, sherh en nevevij ala Muslim 8/65, el mufhim 2/391, ed dibaxh 3/259, fajdul kadir 5/396.

5. Shejtani nuk del me lindjen e diellit në mëngjesin e natës së Kadrit, kjo sepse dielli lind midis dy brirëve të Shejtanit, përveç mëngjesit të natës së Kadrit.

6. Shumica e shenjave që janë përmendur u bëhen të qarta njerëzve vetëm pasi nata e Kadrit ka kaluar. Dobia e kësaj është që, ai i cili e arrin këtë natë, të falënderojë Allahun për suksesin dhe angazhimin me adhurim që i mundëson Ai gjatë asaj nate. Nga ana tjetër, të pikëllohet neglizhenti ndaj natës së Kadrit, i cili tani duhet të vendosë që të angazhohet plotësisht në vitin që vjen për ta arritur atë.

7. Këto shenja janë sistematike për çdo natë Kadri që vjen dhe nuk janë të veçanta për periudhën profetike.

8. Muslimani duhet të përpiqet që ta gjejë këtë natë, për shkak të vlerave të mëdha që ajo ka.

43 – Kërkimi i natës së Kadrit në natën e njëzetetretë të ramazanit.

Prej Abdullah Ibn Unejs El Xuheni përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“M’u tregua nata e Kadrit, pastaj e harrova atë. Gjithashtu, pashë se në agimin e saj bëja sexhde në ujë e në baltë.** Gjithashtu, përcillet se ka thënë: “Natën e njëzetetretë ra shi. I Dërguari i Allahut e fali namazin dhe, kur po largohej, pamë gjurmët e ujit e të baltës në ballin dhe në hundën e tij. Abdullah Ibn Unejsi ka thënë: “Ajo ka qenë nata e njëzetetretë.”³⁷⁷

Në një transmetim të imam Malikut përcillet se Abdullah Ibn Unejsi i ka thënë të Dërguarit të Allahut: “O i Dërguar i Allahut, unë e kam shtëpinë larg. Më thuaj një natë që të vij për të!” I Dërguari i Allahut i tha: **“Eja natën e njëzetetretë të ramazanit.”**³⁷⁸

Prej Ibn Abasit transmetohet se ka thënë: “Dikush më erdhi në gjumë në një prej netëve të ramazanit e më tha: ‘Sonte është nata e Kadrit.’ Unë u ngrita si nëpër gjumë dhe u kapa tek mbajtëset e shtratit të Dërguarit të Allahut. Pastaj shkova tek i Dërguari i Allahut, të cilin e gjeta duke u falur. Mësova se ishte nata e njëzetetretë.”³⁷⁹

³⁷⁷ Muslim 1168.

³⁷⁸ Mu`ata Malik 1/320.

³⁷⁹ Ahmed 1/255, Hejthemi në Mexhmau zeuaid 3/76 ka thënë se transmetuesit në zinxhirin e Ahmedit janë transmetues të sahihut.

Prej Ebu Hudhejfes, ky prej një prej shokëve të Muhamedit (a.s.), transmetohet se ka thënë: “Pashë se hëna në agimin e natës së Kadrit ishte si një gjysëm tave dheu.” Ebu Is’hak Es Sebi’ij ka thënë se hëna merr formë të tillë në agimin e natës së njëzetetretë.³⁸⁰

Prej Ebu Hurejres transmetohet se ka thënë: “Ne përkujtuam natën e Kadrit në prani të Profetit, që na tha: **“Cili prej jush e kujton kur hëna doli dhe qe sa një gjysmë tave dheu?”**”³⁸¹

Dobitë dhe dispozitat

E para: Të Dërguarit të Allahut iu harrua nata e Kadrit dhe kjo ka urtësi. Ajo nuk u tregua që njerëzit të mos neglizhonin e të mos i kaplonte përtacia në adhurim gjatë netëve të tjera veç saj.

E dyta: Kujdesi i madh i sahabeve në gjetjen e netëve me vlerë dhe pyetja për to me qëllim që t’i gjallëronin me adhurim e të përpiqeshin për të përfiturat prej vlerave të tyre.

E treta: Vlera e natës së njëzetetretë. Ajo mund të jetë edhe nata e kadrit kështu që muslimani duhet ta kalojë zgjuar me ibadet e të përpiket të kryejë sa më shumë adhurim në të.

E katërta: Hëna në natën e njëzetetretë është sa gjysma e një tasi të madh ose sa gjysma e një tave dheu, dhe nata e Kadrit atë vit për të cilin flasin këto hadithe ka qenë pikërisht atë natë.

44 – Vlera e natës së Kadrit

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne e zbritëm atë në një natë të begatë. Ne ua tërhoqëm vërejtjen. Në të ndahet çdo çështje e urtë.”** (Ed Dukhan)

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne e zbritëm atë natën e Kadrit. E nga e di ti se ç’është nata e Kadrit. Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj. Në të zbresin melekët dhe Shpirti, me lejen e Zotit të tyre për çdo gjë. Ajo është paqe, derisa të lindë agimi.”** (El Kadr).

Nga Ebu Hurejra përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Kush çohet për natën e Kadrit me besim e me shpresë në shpërblim, atij do t’i falen të gjitha gjynahet e kaluara.”**³⁸²

Në një transmetim tjetër të Buhariut thuhet: **“Kush e kryen adhurime natën e Kadrit me besim e me shpresë në shpërblim, atij do t’i falen të gjitha gjynahet e kaluara.”**

³⁸⁰ Ahmed 5/369, e ka konsideruar hadith hasen Ahmed Shakir 793.

³⁸¹ Muslim 1170.

³⁸² Buhariu 35, Muslimi 760.

Nga Ebu Hurejra përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: “**Ajo është nata e njëzeteshtatë ose e njëzetënëntë. Melekët atë natë janë në tokë me një numër më të madh se numri i guralecëve.**”³⁸³

Dobitë dhe dispozitat

E para: Vlera e madhe që ka nata e Kadrit, që do ta shpjegojmë më poshtë:

- 1 – Ajo ka vlerë të madhe tek Allahu i Lartësuar.
 - 2 – Ajo është më e mirë se një mijë muaj, që janë të barabartë me tetëdhjetë e tre vite e katër muaj.
 - 3 – Numri i madh i melekëve që zbresin në të, aq sa ia kalojnë numrit të guralecëve të tokës.
 - 4 – Kurani madhështor është zbritur në këtë natë, pra, natën e Kadrit.
 - 5 – Shpëtimi prej ndërkshimit atë natë është i madh, i cili mundësohet me anë të adhurimit e veprave të mira që kryejnë robërit e Allahut. Ajo është shpëtim, që vjen prej mëshirës dhe faljes që hedh Allahu mbi robërit e Tij. Ajo natë është shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit.
 - 6 – Ajo është natë e begatë, për shkak të vlerave dhe veçorive të shumta të saj.
 - 7 – Kush kryen adhurime këtë natë duke besuar në premtimin e Allahut dhe duke shpresuar në shpërblimin e saj, do t’i falen gjynahet që ka bërë para saj.
 - 8 – Natën e Kadrit shkruhet çdo gjë që do të ndodhë përgjatë gjithë vitit.
 - 9 – Kush e gjallëron këtë natë me adhurim fiton një pozitë të lartë tek Allahu, si edhe meriton mëshirën dhe faljen e Tij.
- E dyta: Muslimani duhet të përpiqet ta arrijë natën e Kadrit. Këtë duhet ta bëjë duke u kujdesur për kryerjen e namazit të natës përgjatë dhjetë netëve të fundit të ramazanit, si edhe me lutje e përmendje të Allahut. Ndaj një nate që ka këto vlera neglizhon vetëm se një person i privuar. Lusim Allahun të mos na privojë prej vlerës dhe mirësisë së saj.

³⁸³ Ahmed 2/519, saktësoi Ibn Khuzejme 2194, Albani e ka konsideruar hadith të mirë (Hasen) shih Sahihah 2205.

E treta: Mirësia e natës së Kadrit qëndron te mirësia e veprave gjatë saj, sepse për atë që përpiket me adhurime këtë natë, vlera e tyre kap atë të vlerës së një mijë muajve me adhurime, dhe kjo pa dyshim që është një mirësi madhështore prej Allahut të Lartësuar.

E katërta: Një prej mirësive të Allahut mbi këtë umet është edhe dhurimi i kësaj nate për çdo vit, e për këtë falënderimi i takon Allahut.

E pesta: Nata e Kadrit është pa diskutim nata më e mirë. Nuk është e saktë të thuhet që nata e xhumasë është më e mirë se ajo, por nëse ndodh që nata e Kadrit përkon me natën e xhumasë, atëherë kemi mirësi mbi mirësi.

E gjashta: Nata e Israsë dhe Miraxhit sa i përket të Dërguarit të Allahut është më e mirë se nata e Kadrit, sepse atë natë ai u ngrit në qiell, ku i foli vetë Zoti i Lartësuar. Ky është nderimi dhe pozita më e lartë. Ndërsa për besimtarët muslimanë, përfitimet në natën e Kadrit janë më të mëdha e më të shumta se të natës së Israsë e Miraxhit.³⁸⁴

E shtata: Disa dijetarë kanë thënë se kjo natë madhështore është një prej veçorive të këtij umeti. Kjo është përmendur edhe në disa hadithe të dobëta. Gjithashtu, gjenden hadithe të tjera që tregojnë se ajo ka qenë edhe për popuj të tjerë para nesh ose për profetët e tyre, por edhe këto hadithe janë të dobëta.³⁸⁵

E teta: Në një transmetim të Sahih-u i Muslimit thuhet: **“Kush ngrihet natën e Kadrit dhe rastis në të, me besim e me shpresë, atij i falen gjynahet.”** Të mbështetur në këtë transmetim, disa kanë thënë se natën e Kadrit mund ta arrijë vetëm një person i cili e gjen se ajo natë në të cilën ai po bën përpjekje është pikërisht nata e Kadrit. Mirëpo teksti i drejtpërdrejtë i hadithit nuk

³⁸⁴ Mexhmu al fetaua Ibn Tejmijeh 25/286.

³⁸⁵ Prej haditheve që tregojnë se nata e Kadrit ka qenë edhe për popujt e tjerë para nesh, është ai i Ebu Dherit, ku thuhet: ‘Unë pyeta të Dërguarin e Allahut: Ajo ka për të qenë me profetët derisa të jenë ata dhe kur të mos jenë më do të ngrihet, apo do të jetë deri në ditën e Kijametit? Ai tha: **‘Deri në ditën e kijametit.’** Këtë e transmeton Ahmedi 5/171, En Nesai 3427, e ka saktësuar Hakimi sipas kushteve të Muslimit dhe e ka miratuar Dhehebiu 1/307. Mirëpo, hadithin e ka konsideruar si të dobët Albani në shkrimet e tij ndaj Sahih Ibn Khuzejme 2170, duke argumentuar se në zinxhirin e transmetimit të këtij hadithi gjendet Murthed Ez Zimani, i cili është i panjohur dhe Ukajli ka thënë se ky person, në hadithet që transmeton, nuk ka njeri që ta fuqizojë (ose nuk gjendet dikush tjetër që të transmetojë po atë hadith që transmeton ai).

Ndërsa për natën e Kadrit si veçori e këtij umeti, imam Malik transmeton me sened të shkëputur se të Dërguarit të Allahut ju tregua mosha e popujve të mëparshëm, kështu që mosha e njerëzve të popullit të tij iu duk e shkurtër dhe se me këtë nuk mund të arrinin të punonin vepra të mira aq shumë sa punuan popujt e kaluar të cilët jetonin shumë më gjatë. Për këtë arsye, Allahu i dha atij natën e Kadrit, e cila është më e vlefshme se një mijë muaj. Këtë e transmeton Maliku në Mua`ta me termim ‘më ka arritur’ 1/321. Hafidh Ibn Adul Bar ka thënë: ‘Nuk di që ky hadith të transmetohet me sened të plotë, qoftë edhe me ndonjë rrugë të vetme, dhe nuk di të gjendet diku tjetër përveç Mua`ta-s me sened (zinxhir transmetimi të plotë) apo mursel (Me zinxhir transmetimi të shkëputur). ‘Et Temhid’ 24/373. Një hadith që përcillet prej Enesit thotë: ‘Allahu i Lartësuar i dhuroi umetit tim natën e Kadrit dhe nuk ja ka dhënë atë atyre që ishin para jush.’ (Transmeton Dejemli, 647). Në fakt, ky hadith është i trilluar, sikurse sqarohet në Daif al Xhami`u (1669). Neveviu, duke radhitur veçorite e natës së Kadrit, ka thënë: ‘Kjo natë është e veçantë për këtë umet, që Allahu e nderoftë, dhe nuk ka qenë për ata që ishin para tij.....dhe ky është mendimi i saktë dhe i njohur të cilin e kanë zgjedhur të gjithë shokët tanë dhe shumica e dijetërëve.’ El Mexhmu`u 6/457.

tregon për diçka të tillë. Ky hadith tregon se natën e Kadrit e arrin secili musliman që kryen ibadet atë natë, me qëllimin që të arrijë natën e Kadrit, edhe pse ajo vetë mund të ketë qenë nata e Kadrit, apo edhe pse personi nuk e di që ajo ka qenë në të vërtetë nata e Kadrit.³⁸⁶

Sido që të jetë, muslimani duhet të përpiqet në secilën natë të dhjetë netëve të fundit të ramazanit, duke qenë se ka mundësi që secila të jetë nata e Kadrit, se kështu mund ta qëllojë atë.

45 – Kërkimi i natës së Kadrit në shtatë netët e fundit të ramazanit.

Prej Ibn Umerit përcillet se, disa shokë të Muhamedit panë në ëndër natën e Kadrit të ishte në shtatë netë e fundit. Atëherë, i Dërguari i Allahut tha: **“Unë po shoh që ëndrrat tuaja janë bashkuar në shtatë netët e fundit, kështu që kush dëshiron ta gjejë atë, le të përpiqet gjatë shtatë netëve të fundit.”**

Në një transmetim të Muslimit thuhet: **“Kërkojeni atë në dhjetëshen e fundit, e nëse ndonjëri prej jush plogështohet ose nuk mundet, atëherë të mos humbasë në shtatëshen e mbetur.”**

Në një transmetim tjetër të Muslimit thuhet: **“Kërkojeni natën e Kadrit në shtatë netët e fundit.”**³⁸⁷

Dobitë dhe dispozitat:

E para: Ky umet është i ruajtur prej gabimit në transmetim, në mendim dhe në ëndërr, sepse i Dërguari i Allahut e mori në konsideratë bashkimin e ëndrrave të tyre mbi të njëjtën çështje.³⁸⁸

E dyta: Nata e Kadrit duhet kërkuar dhe duhet kaluar me adhurim, për shkak të mirësisë dhe vlerës së madhe që ka. Diçka e tillë nuk është detyrë, por është e pëlqyeshme.³⁸⁹

E treta: Në hadithin e lartpërmendur tregohet për peshën e madhe që ka ëndrra, lejimin e mbështetjes tek ëndrra për orientimin në çështjet egzistenciale, me kusht që diçka e tillë të mos

³⁸⁶ Tarh et Tethrib4/164.

³⁸⁷ Buhari 1911, Muslimi 1165.

³⁸⁸ l'alam el mueki'in 1/84.

³⁸⁹ El Istidhkar 3/416.

bjerë ndesh me rregullat e sheriatit,³⁹⁰ dhe të mos teprohet në marrjen përbazë të tyre, aq sa të dilet nga rruga e drejtë e të ndërpriten veprat e mira.

E katërta: Ëndrrat mund të jenë prej Allahut, mund të jenë pëshpëritje të vetvetes dhe mund të jenë prej shejtanit. Kur ëndrrat e besimtarëve përputhen, atëherë kemi të bëjmë me diçka të vërtetë, sikundër përputhen transmetimet dhe mendimet e tyre. Ndodh që një person të ngatërrohet, të gënjejë, të gabojë në mendim ose të zgjedhë me dëshirë të kotën, mirëpo nëse bashkohen disa vetë për një çështje, ata nuk bashkohen për të kotën.³⁹¹

E pesta: Në të gjejmë argument mbi të punuarit sipas mendimit të shumicës, me kusht që të mos bjerë ndesh me ndonjë tekst fetar, me unanimitetin e umetit apo me ndonjë analogji juridike të qartë.³⁹²

E gjashta: Disa prej sahabëve panë një ëndërr të njëjtë, se nata e Kadrit është në shtatë netët e fundit të ramazanit. Atë vit, i Dërguari i Allahut urdhëroi që nata e Kadrit të kërkohej përgjatë shtatë netëve të fundit të ramazanit, kështu që këto net janë më të shpresuarat për natën e Kadrit.³⁹³

E shtata: Disa njerëz mund ta identifikojnë natën e Kadrit nëpërmjet ëndrrës, duke parë disa prej shenjave dhe ndriçimit të saj, apo duke parë në ëndërr dikë që i thotë se kjo është nata e Kadrit, ose Allahu i vendos në zemër shikim dhe qartësi, me anë të së cilës e gjen natën e Kadrit.³⁹⁴

46 –Itikafi i grave

Prej Aishes transmetohet se i Dërguari i Allahut tregoi se do të bënte itikaf në dhjetëditëshin e fundit të ramazanit. Aishja kërkoi leje për kryer itikaf me të dhe ai e lejoi. Hafsa i kërkoi Aishes që të merrte leje tek i Dërguari i Allahu dhe për të, dhe ajo ia kreu. Zejneb bintu Xhahshi, kur mësoi për këtë ngjarje, urdhëroi t'i ndërtohej një vendqëndrim në xhami, dhe ia ndërtuan. I

³⁹⁰ Sherh Ibn Mulakin alal Umdeh 5/411, Fethul Bari 4/257.

³⁹¹ Minhaxh es suneh en nebeuijeh 3/500, Mederixh es salikin 1/51.

³⁹² Sherh Ibn Mulakin alal Umdeh 5/414

³⁹³ Ibn Batal në shpjegimin te tij të Sahihul Buhari 4/151 mbi hadithin e Ibn Umer “Kërkojeni atë në shtatë netët e fundit” me këtë ka për qëllim vitin në të cilin sahabët panë të njëjtën ëndërr mbi natën e kadrit e cila është nata e njëzet e tre sepse ai në hadithin e Ebu Saidit ka thënë: ‘Kërkojeni atë në dhjetëshin e fundit, në netët teke. Unë pashë në ëndërr sikur rashë në sexhde në ujë e në baltë. Natën e njëzet e një ra shi.’ Sipas këtij hadithi të Ebu Saidit, nata e Kadrit në atë vit ka qenë jashtë shtatë netëve të fundit. Tahaui ka thënë: ‘Sipas këtij shpjegimi, nuk bien ndesh hadithet dhe lajmet mbi natën e Kadrit.’

³⁹⁴ Mexhmu el fetaua 25/286.

Dërguari i Allahut, kur mbaronte namazin, largohej për tek vendqëndrimi i tij. Kur pa venqëndrimet e ndërtuara, pyeti “Çfarë janë këto?” Ata thanë se ishin venqëndrime të Aishes, Hafsas dhe Zejneb. Ai pastaj tha: ‘Bamirësia ishte qëllimi?! Unë nuk po bëj më itikaf.’ Dhe kështu u kthye. Kur mbaroi ramazanin, bëri itikaf dhjetë ditë të muajit Sheual.

Sipas një transmetimi të Muslimit, ka thënë: ‘Kur dëshironte të hynte në itikaf, i Dërguari i Allahut falte namazin e sabahut dhe pastaj shkonte në vendin ku do të qëndronte gjatë itikafit. Ai kërkoi t’i ndërtonin një strehëz të vogël në xhami dhe ata ia përgatitën, sepse do të qëndronte në itikaf përgjatë dhjetëditëshit të fundit të ramazanit. Zejnebja urdhëroi t’i ndërtonin një strehëz, dhe ata ja ndërtuan. Gjithashtu, edhe disa nga gratë e tjera të Profetit vepruan të njëjtën gjë. I Dërguari i Allahut, kur fali namazin e sabahut dhe deshë të largohej, pa strehëzat dhe tha: ‘Bamirësia ishte qëllimi i kësaj?!’ Atëherë dha urdhër që të mblidhej e të hiqej strehëza e tij, dhe kështu u bë. Atë vit nuk bëri itikaf në dhjetëshen e fundit të ramazanit, por e bëri në dhjetëditëshin e parë të muajit Sheual.³⁹⁵

Dobi dhe dispozita:

E para: Itikafi i grave në xhami, nëse nuk përbën fitne, është vepër e lejuar.³⁹⁶

E dyta: Gruaja nuk mund të bëjë itikaf pa lejen e burrit të saj, dhe ky është gjykim unanim. Nëse gruaja bën itikaf pa lejen e burrit, atëherë burri ka të drejtë ta nxjerrë prej itikafit. Gjithashtu, nëse burri i jep leje gruas të qëndrojë në itikaf, por pastaj e ndërpret prej itikafit për ndonjë arsye të vetën, kjo i lejohet.³⁹⁷

E treta: Ndërpreja e itikafit, nëse është e nevojshme, është vepër e lejuar.

E katërta: Itikafi nuk vlen në ndonjë vend tjetër përveç xhamisë, sepse po të ishte i saktë diku tjetër, do t’i lejohej gruas që të hynte në itikaf në vendfaljen e saj brenda shtëpisë.³⁹⁸

E pesta: Edukimi i gruas dhe i pjesëtarëve të familjes nga ana e burrit është i ligjshëm, nëse shesh prej tyre diçka që meriton edukim. I Dërguari i Allahut i pengoi gratë e tij prej itikafit pasi u kishte dhënë vetë leje. Këtë e bëri nga frika se mos ato i prekte krekosja dhe garimi, që burojnë prej xhelozisë.³⁹⁹

³⁹⁵ Buhariu 1940, Muslimit 1172.

³⁹⁶ Sherh En Nevevi 8/70, El Mufhim 3/284. Ibn Abdul Ber përcjell prej El Ethram se ka dëgjuar të pyetet imam Ahmedi për itikafin e grave, dhe ka thënë po, gratë më parë kanë bërë itikaf. Et Temhid 1/195.

³⁹⁷ Ibn Mulekin fi sherh El Umdeh 5/429.

³⁹⁸ Sherh En Neueuij 8/70, El Fet’h 4/277.

³⁹⁹ Sherh En Neuevij 8/69, El Mufhim 3/245.

E gjashta: Lejohet zëvendësimi i veprave vullnetare kur nuk arrin ta kryesh në kohën e saj.⁴⁰⁰

E shtata: Xhelozia e tepërt është e keqe, sepse ajo buron prej zilisë, e cila është gjithashtu e keqe.

E teta: Lënia e një veprë më të mirë është gjë e lejuar, nëse ka dobi.⁴⁰¹

E nënta: Itikafi nuk bëhet obligim për shkak të qëllimit.⁴⁰²

E dhjeta: I lejohet personit që hyn në itikaf që të zgjedhë për veten një vend të qetë në xhami, ku të qëndrojë në vetmi gjatë kohës së itikafit. Të zgjedhë, për shembull, një vend nga fundi i xhamisë ose në qoshet e saj, me qëllim që të mos shkaktojë ngushti tek njerëzit dhe që të jetë vetë më i qetë.⁴⁰³

E njëmbëdhjeta: Vihet në pah morali i lartë i Profetit dhe bashkëjetesa shembullore me gratë e tij. Kur i largoi gratë prej itikafit për qëllim edukativ dhe për t'i ruajtur prej syfaqësisë, ai e la dhe vetë itikafin. I Dërguari i Allahut kishte të drejtë t'i largonte gratë e tij dhe të vazhdonte vetë, mirëpo ai e ndërpreu itikafin në shenjë ngushëllimi për to, për t'i qetësuar zemrat e tyre dhe për ta zbukuruar e përmirësuar akoma më shumë bashkëjetesën.⁴⁰⁴ I tillë duhet të jetë çdo musliman me familjen e tij, pra, të mos i kalojë kufijtë e edukimit me hakmarrje dhe mllef.

E dymbëdhjeta: Nëse gruas që ka hyrë në itikaf i vijnë menstruacionet, atëherë duhet ta ndërpresë itikafin e të dalë prej xhamisë. Sigurisht, kur të pastrohet, ajo mund ta plotësojë itikafin e vet.⁴⁰⁵

E trembëdhjeta: Kush ka qëllim të nisë ndonjë adhurim dhe akoma nuk e ka nisur, mund ta lërë fare atë adhurim ose mund ta shtyjë për më vonë.

E katërbëdhjeta: Mund të ndalohet dhe t'i ndërpritet vepra një personi që hetohet se po e kryen atë për syfaqësi. Për këtë mbështetemi te fjala e të Dërguarit të Allahut: “Bamirësia ishte qëllimi?!”, që nënkupton: ‘Apo deshët të arrinit përfitim vetjak dhe pozitë tek i Dërguari i Allahut?!’ Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ua ndërpreu grave të tij atë që ato deshën të bënin dhe e shtyu për më vonë itikafin e vet.

E pesëmbëdhjeta: Gjatë itikafit pëlqehet shkëputja prej njerëzve dhe familjes, përveç rasteve të domosdoshme, si tubimet për namaz, ushqim apo diçka tjetër.⁴⁰⁶

⁴⁰⁰ Sherh En Neuevij 8/69, El Mufhim 3/245.

⁴⁰¹ Sherh Ibn Battal 4/182, El Fet`h 4/277.

⁴⁰² Neveviu për këtë ka transmetuar unanimitetin e dijetarëve. Sherh Muslim 8/68.

⁴⁰³ Sherh En Neuevij 8/69.

⁴⁰⁴ Minhatal Bari 4/44.

⁴⁰⁵ Sharh Ibn Battal 4/183.

⁴⁰⁶ Sharh Ibn Battal 4/183.

E gjashtëmbëdhjeta: Itikafi në ramazan është prej udhëzimit dhe praktikës së profetit Muhamed. Ai lejohet edhe në muaj të tjerë veç ramazanit, sikurse tregohet në këtë hadith, ku i Dërguari i Allahut e zëvendësoi itikafin në muajin sheual.⁴⁰⁷

E shtatëmbëdhjeta: Strehëzat e itikafit në xhami, të cilat i kanë dyert po brenda xhamisë, vlerësohen si pjesë e xhamisë, mirëpo kur janë jashtë xhamisë, nuk konsiderohen pjesë e xhamisë, edhe nëse dyert e tyre gjenden në pjesën e brendshme të xhamisë.⁴⁰⁸

47 – Kërkimi i natës së Kadrit në netët teke.

Prej Ubadeh Ibn Samit transmetohet se ka thënë: ‘I Dërguari i Allahut kishte dalë për të na treguar natën e Kadrit, mirëpo dy myslimanë u grindën mes njëri-tjetrit dhe ai, pas kësaj, tha: **“Unë dola për t’ju treguar natën e Kadrit, mirëpo u grind filani me filanin, dhe pas kësaj dija u ngrit, e ndoshta kjo është më mirë për ju. Kërkojeni atë në të nëntën, në të shtatën dhe në të pestën natë.”**⁴⁰⁹

Prej Ebu Said El Khudri transmetohet se ka thënë: ‘I Dërguari i Allahut hyri në itikaf dhjetë ditët e mesit të ramazanit për të kërkuar natën e Kadrit, përpara se t’i tregohej. Kur u plotësua dhjetëditëshi, urdhëroi që të hiqej strehëza, dhe ata e hoqën. Më pas iu bë e qartë se nata e Kadrit gjendej në dhjetëditëshin e fundit, kështu që urdhëroi të rindërtohej strehëza dhe ata e bënë. I Dërguari i Allahut doli përpara njerëzve dhe tha: **“O njerëz, nata e Kadrit më qe bërë e qartë dhe dola t’ju tregoj edhe juve, mirëpo erdhën dy persona duke u grindur. Me ta ishte dhe shejtani, dhe për këtë shkak m’u harrua. Kërkojeni atë në dhjetë netët e fundit të ramazanit, kërkojeni në të nëntën, të shtatën dhe të pestën.”**⁴¹⁰

Dobitë dhe dispozita:

E para: Ndalimi i përçarjes dhe i mosmarrëveshjes. Grindja mes muslimanëve dhe armiqësitë e kota mund të shkaktojnë dëm mbi personat që grinden dhe mbi të tjerët. Për shkaqe të tilla largohen mirësitë prej njerëzve, si në këtë rast kur përcaktimi i prerë i natës së Kadrit u ngrit dhe

⁴⁰⁷ Sharh Ibn Mulakin alal umdeh 5/435.

⁴⁰⁸ Fikhul ibadat Ibn Uthejmin 208. Fetauat lexhneh 6718.

⁴⁰⁹ Buhari 1919.

⁴¹⁰ Buhari 1913, Muslimi 1167.

u la e pa përcaktuar përgjatë dhjetë netëve të fundit të ramazanit.⁴¹¹ Prandaj i pengohet dhe shtyhet falja personave që janë grindur me njëri-tjetrin, derisa ta zgjidhin problemin mes tyre e të pajtohen.⁴¹²

E dyta: Në hadithin e Ubadeh Ibn Samit tregohet se shumica mund të ndërshkohet edhe me gabimin e disa personave të veçantë.⁴¹³

E treta: Nata e Kadrit vazhdon të jetë, dhe ky është mendimi unanim i dijetarëve. Ajo që është ngritur prej saj është dija se në ç'natë do të ishte. Këtë harroi dhe i Dërguari i Allahut kur po dilte para njerëzve.⁴¹⁴

E katërta: Një mirësi për muslimanët në ngritjen e diturisë mbi përcaktimin e natës së Kadrit është dhe të përpjekurit me adhurim për arritjen e natës së Kadrit në të gjitha netët e dhjetëshes së fundit.

E pesta: Shpresohet më së shumti që nata e Kadrit të gjendet në netët teke të dhjetë netëve të fundit të ramazanit.

E gjashta: Nata e Kadrit në fillim ishte e fshehur ndaj Profetit, pasta iu tregua dhe pastaj iu harrua.

E shtata: Kujdesi i madh që tregonte i Dërguari i Allahut për të gjetur natën e Kadrit, kur e kërkoi atë në dhjetë netët e mesit të muajit ramazan, përpara se t'i tregohej se gjendej në dhjetë netët e fundit, edhe pse Allahu i kishte falur atij çdo gabim të së kaluarës e të ardhmes.

E teta: Përkujdesja në kërkimin e natës së Kadrit është ecje në shembullin e Profetit dhe gjetja e saj mund të arrihet vetëm duke gjallëruar të dhjetë netët e fundit të ramazanit, sidomos netët teke.

48 – Çka i lejohet personit që qëndron në itikaf.

Prej Aishes përcillet se, gjatë kohës që i Dërguari i Allahut qëndronte në itikaf, vinte pranë dhomës së saj, fuste kokën brenda dhe ajo i rregullonte flokët, ndërkohë që Aishja ishte me menstruacione.

Në një transmetim të Muslimit përcillet se “Ai hynte në shtëpi vetëm për nevojat e njeriut.”⁴¹⁵

⁴¹¹ Ikmal el mualim 4/148.

⁴¹² El Istidhkar 3/412.

⁴¹³ Ikmal el mualim 4/146.

⁴¹⁴ Sherh Ibn Battal 4/157.

⁴¹⁵ Buhari 1941, Muslimi 297.

Ebu Daudi përcjell prej Aishes se ka thënë: “I Dërguari i Allahut qëndronte në itikaf në xhami dhe ndonjëherë fuste kokën në një të çarë të dhomës e unë ia laja.” Në një transmetim tjetër thotë: “ .. i rregulloja flokët, ndërkohë që isha me menstruacione.”⁴¹⁶

Prej Aishes transmetohet se, kur Profeti hynte në itikaf, hynte në shtëpinë e tij vetëm për nevojat e domosdoshme të njeriut.⁴¹⁷

Prej saj transmetohet se ka thënë: ‘Unë shkoja në shtëpi për nevoja të domosdoshme e kur gjeja atje ndonjë të sëmurë, pyesja për të vetëm kalimthi.’⁴¹⁸

Ajo, gjithashtu, ka thënë: ‘Prej traditës profetike të itikafit është mosvizitimi i të sëmurit, mosmarrja pjesë në xhenaze, moskontakti me gratë, mospërqafimi i tyre, dalja nga itikafi vetëm për nevoja të domosdoshme, hyrja në itikaf vetëm se duke qenë agjërueshëm dhe hyrja në itikaf vetëm në xhami ku falet e xhumaja.’⁴¹⁹

Dobi dhe dispozita

E para: Gruaja me menstruacione është e pastër, përveç vendit ku prek papastërtia, e po kështu edhe personi xhunub.⁴²⁰

E dyta: Nxjerrja e një pjese të trupit jashtë xhamie nuk konsiderohet dalje dhe nuk ndikon tek itikafi, sikurse marrja e diçkaje ose dhënja nëpërmjet dritares së xhamisë apo derës së saj. Kjo nuk përbën ndonjë problem në lidhje me itikafin.⁴²¹

E treta: I lejohet personit që është në itikaf të lajë kokën, të rregullojë flokët, të parfumoset, të lahet, të qethet, të rregullojë paraqitjen e tij etj.⁴²²

E katërta: I Dërguari i Allahut kishte flokë të gjatë e të dendur.

E pesta: Sipas traditës profetike, ai i cili ka flokë të gjatë e dendur duhet të kujdeset për pastrimin dhe rregullimin e tyre. Çdo gjë që bie ndesh me bukurinë, me higjenën në rrroba e në paraqitje nuk është prej traditës profetike e as prej ligjit islam.⁴²³

E gjashta: Lejohet përdorimi i gjërave që i bëjnë dobi trupit të njeriut, si ushqimi, trajtimi i flokëve etj.⁴²⁴

E shtata: Burrit që qëndron në itikaf i lejohet ta vështrojë gruan e tij ose ta prekë, normalisht pa epsh.

⁴¹⁶ Ebu Daudi 2469.

⁴¹⁷ En Nesai 3369.

⁴¹⁸ Muslimi 297.

⁴¹⁹ Ebu Daud 2473.

⁴²⁰ Et temhid 8/324, sherh en nevevij ala muslim 1/134, sherh Ibn Battal 4/164.

⁴²¹ Sherh en nevevij 3/208, aun el meabud 7/102.

⁴²² Aun el meabud 7/102.

⁴²³ El Istidhkar 1/330, sherh Ibn Mulakin 5/438.

⁴²⁴ Sherh Ibn Battal ala Buhari 4/165.

E teta: Ligjshmëria e shërbimit të gruas ndaj burrit të saj, si larja e kokës, rregullimi i flokëve, larja e rrobave të tij e të tjera.⁴²⁵

E nënta: Personit në itikaf i lejohet të dalë nga xhamia vetëm për nevoja të zakonshme fiziologjike (urinim, jashtëqitje), për të ngrënë e për të pirë, nëse nuk ka njeri që t'ia sjellë ushqimin në xhami, e kështu me radhë. Për çdo gjë të nevojshme që nuk mund ta kryejë në xhami i lejohet të dalë prej xhamie, dhe kjo gjë nuk ia prish atij itikafin.⁴²⁶

E dhjeta: Kush betohet se nuk ka për të hyrë në shtëpi, dhe pastaj fut në të vetëm kokën dhe pjesa tjetër e trupit mbetet jashtë, atëherë nuk e ka thyer betimin.⁴²⁷

E njëmbëdhjeta: Kush del prej itikafit për ndonjë nevojë të domosdoshme, nuk është i detyruar të ecë me nxitim, mjafton të ecë normalisht, mirëpo duhet që të kthehet në xhami sapo të ketë mbaruar nevojën e tij.⁴²⁸

E dymbëdhjeta: Personi që është në itikaf nuk duhet të dalë nga xhamia për të vizituar të sëmurë ose për të marrë pjesë në xhenaze. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Nga ana tjetër, atij i lejohet të pyesë për gjendjen e të sëmurit kalimthi, pa e zgjatur.⁴²⁹

E trembëdhjeta: Nëse personi del prej itikafit të tij për arsye të domosdoshme, si vdekja e babait apo djalit të tij, duke qenë se ai nuk e ka kushtëzuar diçka të tillë në nijetin e tij, atëherë ai e plotëson itikafin pasi të mbarojë hallin e tij.⁴³⁰

E katërbëdhjeta: Në hadith tregohet se gruaja qëndron në shtëpinë e burrit të saj edhe nëse burri nuk ka nevojë të hyjë tek ajo, ose e pengon diçka e ligjshme për t'u kthyer në shtëpi si udhëtimi apo itikafi. Gruaja duhet të dalë prej shtëpisë së burrit të saj vetëm se me lejen e tij.⁴³¹

E pesëmbëdhjeta: Nëse del prej itikafit pa qenë nevoja, atëherë itikafi konsiderohet i prishur.⁴³²

E gjashtëmbëdhjeta: Kushtëzimi i të qënurit agjërueshëm gjatë itikafit dhe kryerja e tij në një xhami kryesore, ku falet xhumaja, janë dy çështje mbi të cilat dijetarët janë në mospajtim. Mendimi i zgjedhur është moskushtëzimi i të qenët me agjërime gjatë itikafit, sepse i Dërguari i Allahut bëri itikaf edhe në muajin sheual. Gjithashtu, lejohet itikafi në një xhami ku kryet namazi me xhemat, edhe sikur të mos falet xhumaja në të, sepse njeriu mund të dalë prej asaj xhamie e të shkojë në një xhami tjetër ku falet xhumaja, dhe kjo nuk e prish itikafin. Më e mira, sigurisht, është kryerja e itikafit në një xhami kryesore, në të cilën falet xhumaja.⁴³³

⁴²⁵ Sherh en nevevij 1/134.

⁴²⁶ Et temhid 8/327, el mugni 3/68, el furu`u 3/134.

⁴²⁷ Sherh Ibn Battal 4/166, aun el meabud 7/102.

⁴²⁸ El mugni 3/69.

⁴²⁹ Sher Ibn Battal 4/166, sherh Ibn mulakin 5/439.

⁴³⁰ Sherh Ibn Battal 4/166.

⁴³¹ Sherh Ibn Mulakin 5/440.

⁴³² El mugni 3/70.

⁴³³ Fetaua lexhneh ed daimeh nr;6718.

49 – Lutja në natën e Kadrit

Prej Aishes transmetohet: “Unë thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, nëse kuptoj se një natë është vetë nata e Kadrit, çfarë të them në të?’ Ai tha: **‘Thuaj: O Allahu im, Ti je Falës Bujar, e do faljen, prandaj më fal mua!’**”⁴³⁴

Në një transmetim të Ibn Maxhes prej Aishes, thuhet: ‘O i Dërguari i Allahut, po sikur ta gjej natën e Kadrit, si të lutem?’ Ai tha: ‘Thuaj: **O Allahu im, Ti je Falës Bujar, e do faljen, prandaj më fal mua!**’”⁴³⁵

Dobitë dhe dispozitat

E para: Vlera e natës së Kadrit. Kujdesi i Nënës së Besimtarëve, Aishes, në verifikim e saj, në gjallërimin me adhurim dhe në lutjen gjatë kësaj nate.

E dyta: Kujdesi i sahabëve për të pyetur rreth gjërave të dobishme.

E treta: Vlera e lutjes gjatë natës së Kadrit. Ka shumë shpresë që të pranohen lutjet gjatë kësaj nate.

E katërta: Përdorimi i fjalëve kuptimplote e koncize gjatë lutjes është mjaft e pëlqyer. Gjatë lutjes nuk duhet të përpiqemi të zgjedhim fjalë me rimë apo fjalë të vështira për t’u kuptuar.

E pesta: Lutja e sugjeruar nga i Dërguari i Allahut është një prej lutjeve më gjithëpërfshirëse e më të dobishme. Ajo përfshin mirësitë e kësaj bote e të botës tjetër. Kur Allahu i fal robërit e Tij në këtë botë, i heq ndërshkimet ndaj tyre dhe u jep mirësi të njëpasnjëshme, dhe kur i fal ata në botën tjetër i shpëton prej zjarrit të Xhehenemit dhe i fut në Xhenet.

E gjashta: Pohohet për Allahun cilësia e dashurisë, cilësi kjo që Allahut i takon sipas madhësisë dhe lartësisë së Tij, dhe se Allahu i Lartë e do faljen.

⁴³⁴ Tirmidhi 3513, i cili ka thënë se ky hadith është hasen, sahih. E ka saktësuar Hakimi, sipas kushteve të Buhariut e Muslimit 1/712.

⁴³⁵ Ibn Maxheh 3850.

E shtata: Vlëra që ka falja ndaj njerëzve, sepse Allahu e do faljen dhe shpëtimin e njerëzve.

E teta: Këshilla e Profetit ndaj popullit të tij dhe mësimi i tyre për atë që u bënë dobi.

50 – Vizita e personit që është në itikaf.

Prej Safije Bintu Hujejin transmetohet se ka rrëfyer: “I Dërguari i Allahut ishte në itikaf. Unë shkova e vizitova në mbrëmje, bisedova me të, pastaj u ngrita për t’u kthyer në shtëpi. Ai u ngrit dhe erdhi të më shoqëronte. Banesa ishte pranë shtëpisë së Usame ibn Zejdit. Pranë nesh kaluan dy burra prej ensarëve, të cilët, kur panë të Dërguarin e Allahut, nxituan. I Dërguari i Allahut i tha: **“Prisni, kjo është Safije Bintu Hujej.”** Ata thanë: “I Lartësuar është Allahu, o i Dërguar i Allahut!” Ai tha: **“Me të vërtetë, shejtani lëviz përbrenda njeriut ashtu sikurse lëviz gjaku, dhe unë pata frikë se mos gjuan në zemrat tuaja ndonjë të keqe.”** Ose tha: **“diçka”**. Në një transmetim tjetër thuhet: **“Shejtani arrin tek njeriu atje ku arrin dhe gjaku.”**⁴³⁶

Prej Ali Ibn Husej transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: ‘I Dërguari i Allahut po qëndronte në xhami. Me të ishin edhe gratë e tij, që më pas u larguan. Kur po largoheshin, ai i tha Safije bintu Hujej: ‘Prit, mos u ngut, se po vij me ty!’ Banesa e saj ishte pranë shtëpisë së Usames. I Dërguari i Allahut doli me të. Rrugës u takuan me dy burra prej ensarëve, të cilët, kur panë të Dërguarin e Allahut, nxituan të largoheshin. I Dërguari i Allahut u tha: **“Ejani këtu! Kjo është Safije bintu Hujej.”** Ata thanë: “I Lartësuar është Allahu, o i Dërguar i Allahut!” Ai tha: **“Me të vërtetë, shejtani lëviz përbrenda njeriut ashtu sikurse lëviz gjaku, dhe unë pata frikë se mos gjuan në vetet tuaja ndonjë të keqe.”**⁴³⁷

Dobitë dhe dispozitat

E para: Mëshira e Profetit ndaj popullit të tij ishte mjaft e madhe. Ai ishte i kujdesshëm ndaj nevojave të tyre. I drejtonte njerëzit në mënyrë që të ruanin zemrat dhe gjymtyrët e tyre. Këtë tregon edhe ky hadith, kur i Dërguari i Allahut u kujdes ndaj dy personave që kaluan pranë tij. Ai pati merak se mos shejtani u hidhte dyshime në zemër. Mendimi i keq ndaj një profeti është mohim ose kufër.⁴³⁸

Imam Shafi'u, - Allahun e mëshiroftë - ka thënë: “I Dërguari i Allahut veprimi kështu me ata dy njerëz nga frika se mos binin në mohim, po të mendonin keq mbi të Dërguarin e Allahut. Ai nxitoi t’i përshkruante realitetin. Ai e bëri këtë përpara se shejtani t’u hidhte në zemër diçka të keqe, e kështu të shkatërroheshin më pas”.⁴³⁹

⁴³⁶ Buhariu 3107, Muslim 2175.

⁴³⁷ Buhari 2038, Muslimi 2175.

⁴³⁸ Sherh en nevevij ala muslim 14/56.

⁴³⁹ Fethul Bari 4/280.

E dyta: Vizita e personit që ka hyrë në itikaf është e lejueshme. Gruas i lejohet të vizitojë burrin e saj në xhami e të bisedojë me të qoftë ditën apo natën. Kjo nuk e cënon itikafin, por shpeshimi i këtyre vizitave bëhet pengesë për adhurimin. Ndoshta mund të shkaktojë edhe prishjen e itikafit, nëse burri kontakton me gruan e vet.

E treta: Muslimani duhet t'u ruhet pozitave akuzuese dhe vendeve që vënë në dyshim personalitetin e tij. Kur ndjen se mund të hamendësohet diçka e keqe rreth tij, atëherë duhet ta largojë atë duke sqaruar njerëzit, sidomos nëse është prej njerëzve të rëndësishëm, të cilët merren për shembull, si dijetarët dhe të devotshmit. Njerëzve të tillë nuk u lejohet të bëjnë veprime të cilat hedhin dyshime mbi personalitetin e tyre, edhe nëse kanë arsye, sepse kjo pengon përfitimin prej diturisë dhe mirësisë së tyre. Si shembull për këtë po marrim rastin e gjykatësit. Kur ai jep ndonjë vendim, duhet t'i shpjegojë të ndërkoharë edhe arsyet e vendimit, në rast se vendimi duket disi i paqartë, me qëllim që të largojë hamendësitë për veprime të padrejta.

E katërta: Besimtari duhet të jetë në gadishmëri ndaj shejtanit dhe kurtheve të tij, sepse ai lëviz tek njeriu sikurse lëviz gjaku.

E pesta: Lejimi i thënies 'Subhanallah' (I Pastër e i Lartë është Allahu) për të treguar habi ndaj diçkaje ose për të treguar se është diçka e madhe. Kjo tregohet edhe në Librin e Allahut, mbi ngjarjen e shpifjes ndaj Aishes: “ **I Pastër e i Lartë je Ti, o Allah, kjo është shpifje e madhe!**”⁴⁴⁰

E gjashta: Personi në itikaf e ka të lejuar të angazhohet me vepra të lejuara fetarisht, si përcjellja e vizitorit të tij, qëndrimi dhe biseda me të, por pa e tepruar.

E shtata: Personit që ka hyrë në itikaf i lejohet mësimdhënia ose pjesëmarrja në mësimet fetare, të shkruajë çështje fetare, por gjithmonë duke mos e tepruar në këto gjëra, sepse qëllimi i hyrjes në itikaf është përkushtimi maksimal në adhurim.

E teta: Personit që ka hyrë në itikaf i lejohet të blejë gjërat e nevojshme, si ushqim apo diçka tjetër.

E nënta: Personit që ka hyrë në itikaf i lejohet veçimi me gruan e tij, por duhet të bëjë kujdes të mos kontaktojë me të.

E dhjeta: Gruas i lejohet të dalë natën, nëse është e garantuar siguria e saj personale.

E njëmbëdhjeta: Lejohet dhënia e selamit një burri që është në shoqërinë e gruas së tij. Në një tjetër trasmetim të hadithit të mësipërm⁴⁴¹ përmendet se dy personat, kur kaluan pranë Profetit, e përshëndetën me selam, dhe ai nuk e ndaloj një vepër të tillë.

E dymbëdhjeta: Lejohet bashkëbisedimi me njerëz të tjerë, edhe nëse personi është në shoqërinë e gruas së tij apo në shoqërinë e ndonjë gruaje tjetër prej të afërmeve të tij, sidomos kur është

⁴⁴⁰ Suretu Nur: 16.

⁴⁴¹ Buhari 1930. Ibn Maxheh 1779.

nevoja të sqarohet ndonjë gjykim apo të pengohet ndonjë e keqe. Një vepër e tillë nuk përbën sjellje të pahijshme e nuk e ul personalitetin e muslimanit.

E trembëdhjeta: Personit që është në itikaf i lejohet të pengojë hamendësimin e gabuar ndaj tij duke e sqaruar diçka të tillë me fjalë, sikurse veproji i Dërguari i Allahut. Gjithashtu, i lejohet të pengojë diçka të dëmshme ndaj tij edhe me veprime ndaj atij që e cënon. Personi në itikaf nuk është në një pozitë më të rëndësishme sesa personi që fal namaz. Njeriut që është duke u falur i lejohet të pengojë dikë që i kalon përpara vetes, po kështu i lejohet personit që është në itikaf të mbrohet ndaj dikujt që tenton ta qëllojë me duar dhe, me këtë, itikafi i tij nuk priset.

E katërbëdhjeta: Muslimani duhet të tregohet i qetë e të mos nxitohet përveç rasteve të domosdoshme. Prandaj i dërguari i Allahut i tha dy ensarëve; ‘prisni’.

E pesëmbëdhjeta: Drejtësia e Profetit ndaj grave të tij. Gratë e vizituan Profetin në itikafin e tij. Kur deshën të largoheshin, i Dërguari i Allahut, i tha Safijes: ‘Mos u nxito!’”. Veçimi i Safijes për të qëndruar pak më shumë ndodhi për shkak se ajo u vonua në ardhje disi më shumë sesa gratë e tjera. Kështu, i Dërguari i Allahut i tha të qëndronte pak, në mënyrë që të barazohej kohëqëndrimi i saj me atë të grave të tjera. Ndoshta, shkak ka qenë edhe fakti se shtëpia e saj nuk ishte afër, prandaj i Dërguari i Allahut e shoqëroi vetë. I tillë duhet të jetë muslimani: i drejtë me gratë e tij dhe i kujdesshëm ndaj tyre.

51 – Kërkimi i natës së Kadrit në natën e njëzet e shtatë të ramazanit.

Nga Zir Ibn Hubejshi vjen ky rrëfim: “I thashë Ubej Ibn Ka`bit: ‘Vëllai yt Ibn Mes`udi thotë se kush fal namaz nate gjatë tërë vitit, e arrin natën e Kadrit. Ai më tha: ‘Ibn Mesudi e ka thënë këtë me qëllim që njerëzit të mos neglizhojnë, sepse ai e di fort mirë se nata e Kadrit është në Ramazan, dhe se është në dhjetë netët e fundit të tij dhe se ajo është nata e njëzet e shtatë.’” Pas këtyre fjalëve, Ubej Ibn Ka`bi u betua pa bërë përjashtim (pa thënë insha`Allah) se nata e Kadrit është nata e njëzet e shtatë e Ramazanit. Unë i thashë: “Mbi ç`bazë e thua këtë, o Ebul Mundhir?” Ai tha: “Në bazë të shenjës që na ka treguar i Dërguari i Allahut se: **“Dielli lind pa rreze në mëngjesin e saj.”**”⁴⁴²

Në një transmetim të Ahmedit përcillet se: **“Dielli lind të nesërmen e asaj nate si një tas dhe pa rreze”**.⁴⁴³

Në një transmetim të Tirmidhiut përcillet se Ubej Ibn Ka`bi ka thënë: “Pasha Allahun, Ibn Mesudi e ka ditur se ajo është në ramazan dhe se ajo është në natën e njëzet e shtatë, mirëpo nuk i pëlqeu t’ju tregonte juve, për shkak se mos neglizhoni.”⁴⁴⁴

⁴⁴² Muslimi 762, ebu Daud 1378, Tirmidhi 3351 dhe Ahmed 5/130.

⁴⁴³ Ahmed 5/130, sahih Ibn Hibban 3690.

⁴⁴⁴ Tirmidhiu 793 dhe ka thënë se është hasen - sahih.

Nga Muavije përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Nata e Kadrit është nata e njëzet e shtatë.”**⁴⁴⁵

Abdullah Ibn Abasi tregon se një burrë shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, unë jam plak i moshuar, i dobët dhe e kam të rëndë namazin e natës. Më trego një natë, që ndoshta Allahu të më mundësojë të gjejë natën e Kadrit. I Dërguari i Allahut i tha: **“Kujdesu për të shtatën.”**⁴⁴⁶

Dobi dhe dispozita

E para: Kujdesi i të parëve tanë për të bërë më të mirën dhe përpjekjet e tyre në adhurim gjatë sezoneve më të vlefshme.

E dyta: Dijetarit i lejohet fshehja e diturisë, nëse e sheh të dobishme këtë vepër, si në rastin kur ka frikë se njerëzit neglizhojnë ndaj veprave të mira.

E treta: Njeriu lejohet të betohet për diçka që është i sigurt ose për diçka që mendon se është më e sigurt në çfarëdo çështje.

E katërta: Prej shenjave të natës së Kadrit është lindja e diellit të nesërmen i bardhë e pa rreze.

E pesta: Muslimani në sezonet e vlefshme duket t’i mundësojë vetes njëfarë shkëputjeje nga angazhimet e dynjasë e t’i përkushtohet adhurimit, që të arrijë mirësi të shumta me pak punë, si në rastin e dhjetë netëve të fundit të ramazanit, për të arritur natën e Kadrit.

E gjashta: Mendimi më i zgjedhur i dijetarëve mbi natën e Kadrit është se ajo lëviz në netët teke të dhjetëshes së fundit të ramazanit, dhe më e shpresuara e këtyre netëve është nata e njëzet e shtatë, sikurse është betuar edhe Ubej Ibn Ka’bi.

E shtata: Ngjarja e Profetit me plakun e moshuar e të pafuqishëm, ku tregohet se nata e Kadrit është nata e njëzet e shtatë, nuk bie ndesh me hadithet e tjerë që tregojnë se nata e Kadrit gjendet në netë të tjera, sepse lajmërimi i Profetit në këtë ngjarje ka qenë për natën e Kadrit në atë vit të cilin ka pyetur pyetësi, dhe se në këtë mënyrë mund t’i bashkërendisim tekstet që duken mospajtuese mbi këtë temë.

52 –Për agjërimin ka një derë në Xhenet

⁴⁴⁵ Ebu Daud 1386, Ibn Hibani 3680, dhe e ka saktësuar Albani.

⁴⁴⁶ Ahmed 1/240, Bejhaki 4/312, Taberani 11/311. Hejthemi në Mexhma` ez zeuaid 3/176 ka thënë se personat e zinxhirit të këtij hadithi janë transmetues të sahihut. Gjithashtu këtë hadith e ka saktësuar Ahmed Shakir 2149.

Prej Sehl Ibn Sadit përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Xheneti ka tetë dyer. Ai ka një derë që quhet Rejan, tek e cila hyjnë vetëm agjëruesit.”**⁴⁴⁷

Në një transmetim tjetër në Sahihun e Buhariut ka thënë: **“Xheneti ka një derë, që quhet Rejan. Ditën e Gjykimit, tek ajo hyjnë vetëm agjëruesit dhe askush tjetër. Atë ditë thuhet: ‘Ku janë agjëruesit?’ Ata ngrihen në këmbë dhe prej asaj dere nuk futet më askush. Kur agjëruesit futen në të, ajo mbyllet dhe nuk hapet më për askënd.”**⁴⁴⁸

Sipas një transmetimi të Tirmidhiut thuhet: **“Në Xhenet ka një derë që thirret Rejan. Për të kaluar në të thirren agjëruesit. Kush ka qenë prej agjëruesve hyn në të, e kush hyn në të nuk do të ketë më etje kurrë.”**⁴⁴⁹

Prej Ebu Hurejres përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Kush shpenzon dy gjëra në rrugë të Allahut, thirret prej dyerve të Xhenetit: ‘O rob i Allahut, kjo është mirësi! Kush ka qenë prej njerëzve të namazit, thirret prej derës së namazit; kush ka qenë prej njerëzve të xhihadit, thirret prej derës së xhihadit; kush ka qenë prej njerëzve të agjërimit, thirret prej derës së Rejanit; kush ka qenë prej njerëzve të sadakasë, thirret prej derës së sadakasë.”** Ebu Bekri tha: “O Dërguar i Allahut, të bëfsha kurban nënën dhe babain! Kush thirret prej këtyre dyerve nuk ka më pas saj asnjë dëm, por desha të di se a ka ndonjë person që do thirret prej të gjitha atyre dyerve?” Ai tha: “Po, dhe shpresoj që t’i të jesh prej tyre.”⁴⁵⁰

Në një transmetim tjetër: **“...kujdestari i çdo dere thërret: Eja, ti filan, eja!”**⁴⁵¹

Në Musnedin e imam Ahmedit transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Njerëzit e përkushtuar ndaj një vepre do të kenë një derë në Xhenet, prej nga ku do të thirren sipas veprës që kanë punuar më shumë. Kështu, njerëzit që janë dalluar në agjërime do të thirren prej derës së Xhenetit, së cilës i thuhet Rejan.”** Ebu Bekri tha: “O Dërguari i Allahut, a ka ndonjë person i cili do të thirret prej të gjitha këtyre dyerve?” Ai tha: **“Po, e unë shpresoj që ti të jesh një prej tyre, o Ebu Bekër.”**

Ebu Bekri e pyeti të Dërguarin e Allahut se a do të thirret dikush prej të gjitha dyerve të Xhenetit, duke parashtruar se, të thirresh prej një dere të vetme të Xhenetit është e mjaftueshme. Nuk është nevoja të thirresh prej të gjitha dyerve, sepse qëllimi është të hysh në Xhenet, e ky qëllim arrihen edhe vetëm me një.

Dobitë dhe dispozitat

E para: Vlera e agjërimit, ku enkas për të është përgatitur një prej tetë dyerve të Xhenetit.

⁴⁴⁷ Buhari 3084, Muslim 1155.

⁴⁴⁸ Buhariu 1797.

⁴⁴⁹ Tirmidhi 765.

⁴⁵⁰ Buhari 1798, Muslim 1027.

⁴⁵¹ Buhari 2686, Muslim 1027.

E dyta: Rejan është emër i përveçëm i një prej dyerve të Xhenetit. Ky emër rrjedh prej fjalës arabe ‘Rajun’, që nënkupton shuarjen e etjes dhe është e kundërta e fjalës ‘atashu’ - etje. Meqë agjëruesi e pengon veten nga pirja e ujit, ndonëse është shumë i etur, atëherë si shpërblim i jepet të pijë në botën tjetër e kurrë më nuk do të ndihet i etur.

E treta: Adhurimet e përmendura në hadith, si namazi, xhihadi, agjërimi, sadakaja janë dyer të Xhenetit. Çdo derë është e veçantë për njerëzit e këtyre adhurimeve, domethënë për ata që kanë qenë të dalluar në njërin prej tyre.

E katërta: Dyert e Xhenetit kanë melekë si kujdestarë. Ata thërresin çdo person në derën përkatëse, sipas veprës që ka vepruar më shumë. Kjo tregon se melekët i duan njerëzit që janë të mirë dhe gëzohen me ta.⁴⁵²

E pesta: Ky hadith tregon pozitën e lartë që gëzon Ebu Bekri. Ai do të thirret prej të gjitha dyerve të Xhenetit, sepse ka qenë i dalluar në të gjitha veprat e mira. Fjala e të Dërguarit të Allahut “shpresoj që t’i të jesh prej tyre” do të plotësohet me patjetër. Në hadithin e Ibn Abasit tregohet se Ebu Bekri do të thirret prej të gjitha dyerve të Xhenetit. Jo vetëm kaq, por ai do të thirret prej gjithë banesave dhe dhomave të Xhenetit.⁴⁵³

E gjashta: Hadithi i lartpërmendur të jep ndjesinë se ata që do të thirren prej të tetë dyerve janë një pakicë.⁴⁵⁴

E shtata: Ky hadith sinjalizon se bëhet fjalë për vepra vullnetare (nafile) e jo për veprat e detyrueshme, sepse ka shumë njerëz që i kryejnë të gjitha adhurimet e detyrueshme, mirëpo nuk ka shumë njerëz që t’i kryejnë të gjitha llojet e veprave nafile, e që më pas të thirren prej të gjitha dyerve të Xhenetit.⁴⁵⁵

E teta: Lejohet lavdërimi i një personi në prani, nëse kjo nuk sjell rrezik ndaj tij, si vetëpëlqim apo diçka tjetër.⁴⁵⁶

E nënta: Thirrja e personit që i kryen të gjitha këto vepra vullnetare pa shkëputje nga të gjitha dyert e Xhenetit bëhet në shenjë shpërblimi dhe nderimi për të, por ai hyn nëpërmjet një dore të vetme të Xhenetit.

E dhjeta: Veprat e mira, me shumëllojshmërinë e tyre, në shumicën e rasteve nuk mund t’i realizojë që të gjitha një person i vetëm. Në shumicën e rasteve, kujt i lehtësohet realizimi i një lloji të tyre privohet prej të tjerave. Realizimi i të gjitha llojeve të veprave të mira mund të arrihet prej një pakice njerëzish dhe Ebu Bekri është pjesë e asaj pakice.⁴⁵⁷

⁴⁵² Fethul Bari 7/29.

⁴⁵³ Sahih Ibn Hiban 6867, në të ka dobësi por e ka përforcuar Hejthem i në Mexhma`u zeuaid 9/46.

⁴⁵⁴ Fethul Bari 7/28.

⁴⁵⁵ Fethul Bari 7/28-29.

⁴⁵⁶ Sherhun Nevevij ala Muslim 7/117.

⁴⁵⁷ Et temhid 7/184.

E njëmbëdhjeta: Kush bën një vepër shumë e shpesh, njihet me të dhe etiketohet me të. Këtë e tregon fjala e Profetit: “kush është prej njerëzve të namazit”, domethënë kush është i spikatur në namaze nafile, sepse ndryshe të gjithë muslimanët janë njerëz të namazit.⁴⁵⁸

53 – Kush premtun të bëjë itikaf.

Prej Umer Ibn Hatabi përcillet se i ka thënë të Dërguarit të Allahut: “Unë kam premtuar në kohën e injorancës që të qëndroj një natë në Xhaminë e Shenjtë.” I Dërguari i Allahut i tha: **“Plotësoje premtimin tënd.”** Atëherë Umeri bëri itikaf një natë.

Në një transmetim tjetër përcillet se Umer Ibn Hatabi, kur po kthehej nga Taifi në vendin e quajtur El Xhirraneh, pyeti të Dërguarin e Allahut: ‘O i Dërguari i Allahut, unë kam premtuar në kohën e injorancës të qëndroj në itikaf një ditë në Xhaminë e Shenjtë. Çfarë të bëj?’ Ai tha: **“Shko dhe qëndro një ditë në itikaf.”**⁴⁵⁹

Në një transmetim tjetër thuhet: “Kur u bëra musliman, pyeta për të të Dërguarin e Allahut, e ai më tha: **“Plotësoje premtimin tënd.”**”⁴⁶⁰

Dobi dhe dispozita

E para: Premtimi dhe itikafi ishin të njohura në kohën e injorancës.

E dyta: Mbajtja e një premtimi të dhënë në kohën e injorancës është vepër e lejuar në Islam. Disa dijetarë kanë thënë se mbajtja e premtimit edhe në këtë rast është detyrë.

E treta: Kujdesi i Umerit të çlirohej nga premtimi që kish bërë në kohën e injorancës. Kjo tregon për devotshmërinë dhe përpikmërinë e Umerit r.a.

E katërta: I Dërguari i Allahut e urdhëroi Umerin ta mbajë premtimin, edhe pse që një premtim i bërë në kohën e injorancës. Kjo tregon se islami e përforcon rëndësinë e mbajtjes së premtimit dhe e lufton thyerjen e tij.⁴⁶¹

E pesta: Itikafi një ditë apo një natë të vetme është i saktë, në bazë të hadithit të lartpërmendur.

⁴⁵⁸ Et temhid 7/185.

⁴⁵⁹ Buhari 1937, Muslim 1656.

⁴⁶⁰ El Bezar 140, Bejhaki 10/76.

⁴⁶¹ Sherh Ibn Batal 4/168.

E gjashta: Me këtë hadith argumentohen edhe ata që thonë se itikafi është i saktë edhe pa agjërim, sepse nata nuk është kohë agjërimi.⁴⁶²

E shtata: Në bazë të atyre që thonë se itikafi është i saktë edhe pa agjërim, që është dhe mendimi më i saktë, i lejohet të sëmurit që e ka prishur agjërimin e tij për shkak të sëmundjes të bëjë itikaf.⁴⁶³

E teta: Për diçka që nuk e dimë duhen pyetur dijetarët, sepse Umeri për premtimin e tij shkoi të pyeste të Dërguarin e Allahut. Gjithashtu, është detyrë t'i sqarohet çështja e fesë atij që pyet.

E nënta: Nëse premtim të bësh itikaf në një xhami tjetër përveç tri xhamive kryesore të Islamit (përkatesisht në Mekë, Medinë dhe xhaminë Aksa) dhe lipset të ndërmarrësh udhëtim enkas (në formë pelegrinazhi) për të, atëherë përmbushja e këtij premtimi nuk lejohet, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Nuk lejohet të ndërmarrësh udhëtim enkas, në formë pelegrinazhi, drejt ndonjë faltoreje, përveç tri xhamive kryesore.” Nëse nuk nevojitet të bësh udhëtim, atëherë lejohet.⁴⁶⁴

54 – Agjërimi për të vdekurin

Prej Aishes transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Kush vdes duke pasur agjërim borxh, atëherë për të duhet ta agjërojë përgjegjësi i tij.”**⁴⁶⁵

Prej Ibn Abasit përcillet se një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe e pyeti: “O i Dërguar i Allahut, nëna ime vdiq dhe ka borxh agjërimin e një muaji. A ta kryej unë në vend të saj?” I Dërguari i Allahut tha: **“Po të kishte nëna jote para borxh, a do t'ia shlyeje atë borxh asaj?”** Ai tha: “Po.” I Dërguari tha: **“Borxhi ndaj Allahut meriton më së shumti të shlyhet.”**

Sipas një transmetimi tjetër, një grua erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, nëna ime vdiq dhe la borxh një premtim për agjërim, a mund ta agjëroj unë në vend të saj?” Ai tha: **“Po të kishte nëna jote borxh e ti t'ia shlyeje, a do të quhej i shlyer ky borxh?”** Ajo tha: “Po.” I Dërguari i Allahut tha: **“Atëherë, agjëroje për nënën tënde.”**⁴⁶⁶

Nga Burejdeh transmetohet se ka thënë: “Unë isha duke qëndruar me të Dërguarin e Allahut, kur erdhi një grua dhe tha: “Unë i pata dhuruar nënës time një robëreshë. Nëna më vdiq.” I Dërguari

⁴⁶² Prej atyre që e kanë vënë si kusht agjërimin gjatë itikafit janë; Ibn Umer, Ibn Abas, Malik, Sha'biu, Euzajj, Theuri, hanefitë, Ahmedi në një transmetim, Kurtubiu, Ibn Kajim, ndërsa prej atyre që nuk e kanë vënë si kusht janë; Aliu, Ibn Mes'udi, Hasan el Basri, Ata'u Ibn Ebu Rrabaha, Umer Ibn Abdulaziz, Shafiu, Ahmedi, Is'haku, dhahiritë e të tjerë, gjithashtu këtë kanë zgjedhur dy dijetarët e kohës sonë Ibn Baz dhe Ibn Uthejmin, dhe komisioni i përhershëm i fetvave.

El Istidhkar 10/291, tehdhibes sunen 7/105, Sherh En Neveij 11/124, El Mufhim 4/241, Ibn Mulakin 5/446, Tuhfetul Ahuedhij 15/119, Sherh bulugul meram 1/372, fetaua Lexhneh daimeh 6718.

⁴⁶³ Ibn Mulakin 5/446.

⁴⁶⁴ El fetaua es Sa'dije 231.

⁴⁶⁵ Buhariu 1851, muslimi 1147.

⁴⁶⁶ Buhariu 1852, Muslimi 1148.

i Allahut tha: **“Ti e ke marrë shpërblimin tek Allahu për të dhe trashëgimia po ta rikthen prapë ty.”** Ajo tha: “O i Dërguari i Allahut, nëna kishte borxh agjërimin e një muaji, a ta agjëroj unë për të?” Ai tha: **“Agjëroje ti për të.”** Ajo tha: “Ajo nuk bëri haxh kurrë. A të bëj haxh për të?” Ai tha: **“Kryeje ti haxhin për të.”**⁴⁶⁷

Dobi dhe dispozita

E para: Në origjinë, adhurimet trupore nuk mund të kryhen me përfaqësi ose nga dikush tjetër. Agjërimi dhe haxhi përjashtohen nga ky rregull, për shak të hadithit të mësipërm. Hafidh Ibn Abdul Berri ka thënë: “Dijetarët unanimitas janë të mendimit se namazi, qoftë farz apo sunet, nuk mund të kryhet nga dikush tjetër. Nuk mund të kryhet qoftë për një të gjallë apo për një të vdekur. Gjithashtu, nuk mund ta agjërojë një person në vend të një personi tjetër të gjallë. Kjo çështje është e prerë dhe pa asnjë mospajtim mes dijetarëve. Ndërsa për një person që i vdes një i afërm, i cili ka lënë detyrime në agjërim, se a duhet apo s’duhet ta shlyejë, mbi këtë çështje dijetarët ndajnë mendime të ndryshme në të kaluarën e në të tashmen.”⁴⁶⁸

E dyta: Një person që vdes dhe ka borxh agjërim prej ramazanit ndodh një prej dy rasteve:

1. Vdes para se të ketë mundësi të agjërojë, për shkak të kohës së pamjaftueshme, për arsye udhëtimi, për arsye shëndetësore etj. Një person i tillë nuk ka asnjë detyrim, sipas fjalës së shumicës së dijetarëve.

2. Vdes para se t’i mundësohet shlyerja e agjërimit. Në këtë rast është prej sunetit ose pëlqehet ta agjërojë për të kujdestari i tij.

E treta: Ligji islam parashtroi heqjen e barrës ndaj të vdekurit nëpërmjet të afërmeve të tij apo dikujt tjetër. Në hadithin **“atëherë për të duhet ta agjërojë përgjegjësi i tij”**, përgjegjësi i tij këtu është trashëgimtari. Kjo ndodh në të shumtën e rasteve por nëse agjëron për të ndonjë i afërm që nuk merr pjesë në trashëgimi apo ndonjë i largët, atëherë shlyerja është e pranueshme, sikurse ndodh me borxhin. Shejhu i Islamit Ibn Tejmija ka thënë: “I Dërguari i Allahut e ka shëmbëllyer këtë çështje me borxhin, sepse shlyerja e borxhit është e pranueshme prej kujtdo. Kjo tregon se, edhe në këtë rast, shlyerja e agjërimit mund të bëhet prej kujtdo, dhe kjo nuk është e lidhur vetëm me bijtë e të vdekurit.”⁴⁶⁹

E katërta: Shlyerja e agjërimit dhe e borxhit ndaj të vdekurit nuk është obligim mbi trashëgimtarët e tij, mirëpo kjo kryhet vullnetarisht për të hequr barrën prej të vdekurit.⁴⁷⁰

E pesta: Nëse i vdekuri ka lënë ditë pa agjëruar dhe për të agjërojnë disa njerëz në një ditë të vetme në përputhje me numrin e ditëve, kjo gjë është e pranueshme dhe shlyerja është e saktë. Diçka e tillë nuk mund të veprohet me “agjërimin e kushtëzuar me vijmësi”, si në rastin e

⁴⁶⁷ Muslimi 1149, Ebu Daud 2877, Tirmidhi 667, Nesai 6314, Ibn Maxheh 2394.

⁴⁶⁸ El Istidhkar 4/340,

⁴⁶⁹ Mexhmu`ul fetaua 24/311, El Mugni 4/400, Fethul Bari 4/194.

⁴⁷⁰ El Mugni 4/399, sherh el mumti`i 6/450, tregues për mosobligimin është fjala e Allahut “askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit”. Gjithashtu, i Dërguari i Allahut e ka shëmbëllyer me borxhin dhe shlyerja e borxhit nuk është detyrim për trashëgimtarët.

shlyerjes (*kefare*) së *dhiharit*⁴⁷¹ e të vrasjes. Në këto raste duhet ta agjërojë një person i vetëm dy muaj rresht.⁴⁷²

E gjashta: Nëse askush nuk del vullnetar për të agjëruar për të vdekurin, atëherë trashëgimtarët e tij duhet të ushqejnë për çdo ditë agjërimi një të varfër, edhe nëse ky shpenzim hiqet prej trashëgimisë së tij.⁴⁷³

E shtata: Nëse trashëgimtarët gjejnë dikë me pagesë për të agjëruar për të, kjo nuk lejohet, sepse çështjet e adhurimeve nuk ndreqen duke paguar dikë tjetër.⁴⁷⁴

E teta: Nëse premton se do të agjërojë muajin Muharrem dhe vdes në muajin Dhulhixhe, në këtë rast nuk bëhet shlyerje për të, sepse nuk e ka arritur kohën e obligimit, si shembulli i një personi që vdes para se të vijë Ramazani.

E nënta: Një person i cili ka për të shlyer agjërimin e disa ditëve të ramazanit dhe dëshiron të shlyejë agjërimin e ndonjë dite të mbetur nga ramazani, të ndonjë premtimi apo ndonjë shlyerje tjetër për ndonjë të afërm të tij, atëherë ky njeri, së pari, duhet të shlyejë agjërimin e vet, pastaj të shlyejë agjërimin e të afërmit të tij.⁴⁷⁵

E dhjeta: Dita e festës së Bajramit nuk e shkëput vijmësinë e agjërimit për atë që është duke agjëruar dy muaj rresht, sepse agjërimi në ditën e festës është i ndaluar.⁴⁷⁶

55 – Shpërblimi për ramazanin është i plotë, edhe nëse muaji është i shkurtër.

⁴⁷¹ *Dhihari* është një gjendje ndërshkimore ndaj bashkëshortit, pasi i është drejtuar bashkëshortes së tij me këto fjalë: 'më je bërë si shpina e nënës time' apo diçka të ngjashme, për të aluduar se po e konsideron harram marrëdhëniet me të, ashtu sikundër e ka të ndaluar me gratë që nuk i lejohet të martohet. Shpagimi për këtë vepër është një nga veprat e mëposhtme, sipas radhës dhe mundësisë: 1- çlirimi i një skllavi, 2- agjërimi dy muaj rresht, 3- ushqimi gjashtëdhjetë të varfër. Ky shpagim duhet të kryhet me renditje, dmth, kush ka mundësi të lirojë një skllav, atë duhet të bëjë së pari, e kush nuk ka mundësi, atëherë sipas mundësisë të dytën ose të tretën.

⁴⁷² Transmeton Buhari prej El Hasan ta'likan se: Lejohet të agjërojnë tridhjetë burra një ditë të vetme. Fethul Bari 4/193, Sherh el mumti'i 6/352. Ky mendim e përkrah edhe shejh Ibn Baz përshtet të mos kushtëzimit të haditheve mbi këtë temë. Ndërsa për agjërimin e kefares është shprehur; Nuk lejohet ndarja e agjërimit të dy muajve të kefares midis një grupi njerëzish, por duhet ta agjërojë vijmësisht një person i vetëm, sikurse e ka bërë ligj Allahu. Fetaua Ibn Baz 15/375.

⁴⁷³ Sherhul mumti'i 6/456.

⁴⁷⁴ Sherh el mumti'i 6/456.

⁴⁷⁵ Fetaua lexhned daimeh 7942.

⁴⁷⁶ Fetaua Ibn Xhibrin 102, 125.

Nga Ebu Bekrah transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Dy muaj nuk shkurohen: muaji i festës së ramazanit dhe muaji i dhulhixhes.”**

Në një transmetim tjetër thuhet: **“Dy muajt e festave nuk shkurohen: ramazani dhe dhulhixhe.”**⁴⁷⁷

Ky hadith është shpjeguar prej disave kështu: Ramazani dhe Dhulhixhe nuk shkurohen që të dy në të njëjtin vit. Nëse njëri shkurohet, atëherë tjetri plotësohet, e kjo ndodh në të shumtën e rasteve.

Gjithashtu, është thënë se nuk pakësohet shpërblimi dhe vlera e tyre, edhe pse mund të shkurohet numri i ditëve të muajit dhe ky shpjegim duket si më i sakti.⁴⁷⁸

Dobi dhe dispozita

E para: Ligjvënësi i Urtë (Allahu) i ka veçuar këto dy muaj, ramazanin dhe dhulhixhen, me këtë dispozitë, për shkak se lidhen me agjërimin dhe haxhin.⁴⁷⁹

E dyta: Bashkëngjitja e festës së Fitër Bajramit muajit ramazan, edhe pse festa është në fillim të muajit sheual. Në një transmetim të imam Ahmedit thuhet: “Dy muaj nuk shkurohen dhe në secilin prej tyre ka festë: ramazan dhe dhulhixhe.”⁴⁸⁰

E treta: Gabimi në lidhje me përcaktimin e hyrjes së muajit është gjë që ndodh dhe njerëzit nuk duhet të vihen në vështirësi, përderisa veprojnë në përputhje me udhëzimet islame në lidhje me parjen e hënës apo plotësimin e muajit, kur shikimi i hënës është i pamundur.

E katërta: Çdo vlerë dhe dispozitë e lidhur me muajin ramazan dhe dhulhixhe arrihet, qoftë ramazani me tridhjetë ditë, qoftë me njëzet e nëntë ditë, qoftë qëndrimi në Arafat përkon me ditën e nëntë të muajit dhulhixhe apo nuk përkon, me kusht nëse njerëzit përpiqen të jenë sa më të saktë në lidhje me parjen e hënës.⁴⁸¹

E pesta: Prej dobive të këtij hadithi është heqja e dyshimit dhe e shqetësimit prej zemrës, që mund të lindin kur agjërohet njëzet e nëntë ditë ose kur qëndrohet në Arafat ditën e gabuar, pasi mund të ndodhë që njerëzit të qëndrojnë në ditën e tetë në Arafat, për shkak të dëshmisë së rreme

⁴⁷⁷ Buhariu 1813, Muslimi 1089.

⁴⁷⁸ Ikmal el mualim 4/24, el mufhim 3/145.

⁴⁷⁹ Fethul bari 4/125.

⁴⁸⁰ Ahmedi 5/47.

⁴⁸¹ Sherh en Nevevij 7/199, Fethul Bari 4/126, Umdetulkarrij 10/285.

të ndonjë personi mbi parjen e hënës në muajin e dhulhixhes. Megjithatë, ky shqetësim është i zgjidhur, se adhurimi është i saktë dhe shpërblimi është i plotë, me lejen e Allahut.⁴⁸²

E gjashta: Ky hadith tregon se shpërblimi mbi adhurimet nuk është gjithmonë i lidhur me praninë e vështirësisë, sepse Allahu dhuron prej mirësisë së Tij, kur muajin e mangët e barazon në shpërblim me muajin e plotë.⁴⁸³

E shtata: Në këtë hadith ka argument mbështetës për palën e dijetërëve që janë të mendimit se për agjërimin e tërë muajit të ramazanit mjafton një njet i vetëm, për arsye se Ligjvënësi i Urtë e ka konsideruar tërë muajin si një adhurim të vetëm.

56 – Sadakaja e fitrit

Prej Ibn Umerit transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut e ka bërë obligim sadakanë e fitrit një *sa`e*⁴⁸⁴ me hurma ose me elb për çdo person musliman, të lirë, rob, mashkull, femër, i vogël e i madh. Ai ka urdhëruar që ky obligim të kryhet para se njerëzit të dalin për namazin e Bajramit.”⁴⁸⁵

Në një transmetim tjetër të Buhariut, Nafi`u ka thënë: “Ibn Umeri e jepte sadakanë e fitrit për çdo të vogël e të madh, saqë jepte edhe për të vegjlit e mi. Ai ua jepte sadakanë atyre që e praninin. Ata e jepnin sadakanë e fitrit një ose dy ditë para festës së Fitër Bajramit.”⁴⁸⁶

Prej Ebu Said El Khudri transmetohet se ka thënë: “Ne nxirrnim sadakanë e fitrit një *sa`e* me ushqim, me elb, me hurma, me djath ose me rrush të thatë.”⁴⁸⁷

Nga Ibn Abasi transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut e ka bërë obligim sadakanë e fitrit, që shërben si pastrim për agjëruesin nga veprimet e kota dhe sjelljet e pahijshme dhe si ushqim për të varfrit. Kush e kryen këtë detyrë përpara namazit të Bajramit, i konsiderohet sadaka e

⁴⁸² Fethul Bari 2/126.

⁴⁸³ Fethul Bari 4/126.

⁴⁸⁴ Njësi matëse në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), rreth tre kilogram (sh.p).

⁴⁸⁵ Buhariu 1432, Muslimi 984.

⁴⁸⁶ Buhariu 1440.

⁴⁸⁷ Buhari 1435, Muslimi 985.

pranuar, ndërsa atij të cilit e kryen pas namazit, i konsiderohet si një sadaka normale e jo sadaka fitri.⁴⁸⁸

Prej Kajs Ibn Sa`dit përcillet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut na urdhëronte të nxirrnim sadakanë e fitrit përpara se bëhej obligim nxjerrja e zekatit të pasurisë. Kur u bë detyrë nxjerrja e zekatit, atëherë as na urdhëronte e as na ndalonte, ndërsa ne e jepnim (sadikan e fitrit).⁴⁸⁹

Dobi dhe dispozita

E para: Sadakaja e fitrit është detyrë mbi çdo musliman. Ajo ka qenë detyrë përpara zekatit të pasurisë dhe ka mbetur detyrë sikurse qe më parë, edhe pasi që është obliguar zekati i pasurisë.

E dyta: Çdo musliman e ka detyrë ta nxjerrë këtë sadaka për veten e tij dhe për ata që është i detyruar të shpenzojë, si gruaja dhe fëmijët e tij.

E treta: Nëse gruaja dhe fëmijët fitojnë para ose kanë pasuri, atëherë më e mira është ta nxjerrë sadakanë e fitrit secili për vete, sepse urdhri u drejtohet edhe atyre. Megjithatë, lejohet ta nxjerrë sadakanë e fitrit për ta kujdestari i tyre, edhe kur ata zotërojnë pasuri.

E katërta: Nuk lejohet nxjerrja e sadakasë së fitrit në vlerë monetare. Ky është dhe mendimi i shumicës së dijetarëve. I Dërguari i Allahut nuk ka urdhëruar diçka të tillë, nuk e ka vepruar vetë dhe as shokët e tij nuk e kanë vepruar diçka të tillë, edhe pse nxjerrja e saj përsëritej për çdo vit. Kur të varfërit i jepet ushqim, përfiton me të edhe familja e tij, ndërsa po të jepet vlera në para, ai mund t’i shpenzojë vetë, pa çuar gjë te familja e vet. Gjithashtu, dhënia e sadakasë së fitrit në vlerë monetare çon në humbjen e madhështisë së kësaj vepre.

E pesta: Nxjerrja e sadakasë së fitrit fillon që në natën e njëzet e tetë të ramazanit. Sahabët e nxirrnin atë një ose dy ditë përpara festës. Koha e nxjerrjes, sikurse është përshkruar në hadithe, shkon deri para namazit të Fitër Bajramit.

E gjashta: Sadakaja e fitrit u jepet atyre që e meritojnë, domethënë fukarenjve e nevojtarëve, dhe për këtë i Dërguari i Allahut e ka quajtur: **“ushqim për të varfrit”**. Është gabim t’u jepet komshinjve ose të afërmve, nëse nuk e meritojnë, sikurse është bërë zakon tek disa njerëz, që shkëmbejnë sadakanë e fitrit mes tyre, ashtu sikurse shkëmbejnë mishin e kurbanit ose mishin e akikas (Kurbani kur lind fëmija), prej së cilëve lejohet dhurimi edhe për ata që nuk janë të varfër. Gjithashtu, është e gabuar që t’u jepet për çdo vit familjeve të njëjta, sepse ndodh që ndonjë familje prej tyre të pasurohet, dhe atëherë nuk lejohet ti jepet akoma zekat fitri.

⁴⁸⁸ Ebu Daud 1609, Ibn Maxheh 1827, e ka saktësuar Hakimi 1/568 dhe e ka konsideruar të mirë Shejh Albani.

⁴⁸⁹ Nesai 5/49, Ibn Maxheh 1828, e ka saktësuar Hafidh Ibn Haxher në Fethul Bari 3/267.

E shtata: Më parësore është nxjerrja e sadakasë së fitrit për fukarenjtë e vendit ku jeton muslimani, por lejohet dërgimi i saj në vende të tjera, sidomos kur atje ka shumë nevojtarë dhe njeriu nuk njeh ndonjë nevojtar në vendin e tij, ose kur nevojtarëve të vendit të tij ka kush u jep sadaka.

E teta: Në sadakanë e fitrit gjen urtësi e dobi të shumta:

1 – Demonstrimi i falënderimit për mirësinë e Allahut ndaj robit, që arrin të plotësojë agjërimin e muajit dhe që arrin festën e Bajramit. Allahu i Lartësuar thotë: “...**ta plotësoni ciklin, ta madhëroni Allahun për udhëzimin që ju dha, e ndoshta do të falënderoni.**” [Bekare 185].

2 – Ajo është pastrim për trupin, të cilin Allahu e ka lejuar të jetojë përgjatë tërë vitit.

3 – Sadakaja e fitrit shërben si pastrim për agjërimin e njeriut prej veprave të kota dhe sjelljeve të pahijshme, sikurse tregohet në hadith.

4 –Nxjerrja e sadakasë së fitrit shfaq mbështetjen ndaj fukarenjve dhe nevojtarëve dhe u krijon atyre mundësinë për të qenë të barabartë me muslimanët e tjerët në festë, për të qenë të gëzuar, të mirë ushqyer e të ngopur, pa qenë nevoja të lypin tek të tjerët.

5 – Ajo e edukon agjëruetin për bujari, për kontribut dhe e mbron atë ndaj dorështrengimit dhe koprracisë.

E nënta: Lejohet që një grup njerëzish ose një familje t’ia japë sadakanë e fitrit një të varfri të vetëm, sikurse lejohet që sadakaja e një personi të vetëm t’u shpërndahet disa të varfërve.

E dhjeta: Sadakaja e fitrit obligohet sapo të perëndoje dielli i ditës së fundit të ramazanit. Një person i cili vdes përpara perëndimit nuk e ka detyrë nxjerrjen e zekatit të fitrit, sepse ai ka vdekur përpara shkakut të obligimit. Po kështu, nëse lind ndonjë fëmijë pas perëndimit të diellit ditën e fundit të agjërimin, nuk është obligim nxjerrja e sadakasë për të, mirëpo kjo pëlqehet.

E njëmbëdhjeta: Personi i cili ka marrë punëtorë dhe shërbyes me pagë të caktuar nuk e ka detyrë të japë sadakanë e fitrit për ta, vetëm nëse diçka e tillë ka qenë e kushtëzuar në aktmarrëveshje. Ai mund ta nxjerrë sadakanë për ta në shenjë bamirësie dhe mirësjelljeje ndaj tyre.

E dymbëdhjeta: Nëse muslimani harron ta japë sadakanë e fitrit në kohën e duhur dhe kujtohet vetëm pas namazit të Bajramit, atëherë e jep sadakanë në ato momente, sepse është i arsyetuar prej harresës.

E trembëdhjeta: Nëse agjërueti ia lë në dorë nxjerrjen e sadakasë së fitrit një përfaqësuesi të tij, atëherë ky përfaqësues duhet t’ia dërgojë atë të varfrit përpara namazit të Bajramit. Mirëpo, nëse vetë i varfëri i kërkon përfaqësuesit ta mbajë në ruajtje sadakanë derisa të shkojë vetë, lejohet në këtë rast që sadakaja të qëndrojë tek ky përfaqësues, derisa të vijë i varfri e ta marrë, qoftë edhe pas namazit të Bajramit.

57 – Kërkimi i natës së Kadrit në natën e fundit të ramazanit

Prej Ujejne Ibn Abdurrahmanit përcillet se babai i tij ka thënë: “Dikush përmendi natën e Kadrit në prani të Ebu Bekrah, dhe ai tha: “Për shkak të një fjale, që e kam dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut, kam për ta kërkuar natën e Kadrit vetëm në dhjetë netët e fundit të ramazanit. I Dërguari i Allahut ka thënë: **“Kërkojeni atë në nëntë netët e mbetura, ose në shtatë netët e mbetura, ose në pesë netët e mbetura, ose në tre të mbeturat, ose në natën e fundit.”** Ebu Bekrah falte namaz gjatë njëzet netëve të ramazanit sikurse falej përgjatë gjithë vitit, por kur hynte dhjetëditëshi i fundit përpiquej më shumë.⁴⁹⁰

Nga Muauje Ibn Ebu Sufjani transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kërkojeni natën e Kadrit në natën e fundit të ramazanit. Këtë hadith e ka nxjerrë Ibn Khuzejme në Sahihun e tij dhe e ka klasifikuar nën temën me titull: ‘Urdhër për kërkimin e natës së Kadrit në natën e fundit të ramazanit, dhe se mundet që në ndonjë vit të qëllojë të jetë në natën e fundit.’”⁴⁹¹

Dobi dhe dispozita

E para: Nata e Kadrit është në dhjetë netët e fundit të ramazanit dhe më së shumti shpresohet të jetë në netët teke të tyre. Mund të jetë edhe në netët çift, duke pasur parasysh natën e fundit që mbetet kur muaji plotësohet. Për këtë muslimani duhet ta kërkojë atë në të gjitha netët e dhjetëshes së fundit të muajit.

E dyta: Kujdesi i sahabëve në kërkimin dhe gjallërimin e natës së Kadrit.

E treta: Nata e Kadrit mund të jetë në natën e fundit të ramazanit në ndonjë vit, pasi shumë hadithe tregojnë që nata e Kadrit është e lëvizshme.

E katërta: Muslimani nuk duhet të ndëpresë namazin, leximin e Kuranit dhe gjallërimin e natës pas natës së njëzet e nëntë ose pasi imami të ketë mbaruar leximin e tërë Kuranit, sepse ajo mund të jetë edhe në natën e fundit.

⁴⁹⁰ Tajalisi 881, Ahmed 5/39, Tirmidhiu 794 dhe ka thënë hasen-sahih, Nesai 3403.

⁴⁹¹ Sahih Ibn Khuzejme 2189, Albani në silsileh sahihe 1471.

58 – Ndryshimet e muajit hënor

Prej Ibn Umerit transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Muaji është kështu e kështu e kështu...”**, duke i shtrirë tri herë përpara dy pëllëmbët e tij me të gjitha gishtërinjtë, domethënë tridhjetë ditë. Pastaj tha: **“Ose kështu e kështu e kështu”**, duke i shtrirë dy herë përpara dy pëllëmbët e tij me të gjitha gishtërinjtë, ndërsa herën e tretë i shtriu duke fshehur një prej gishtërinjve të mëdhenj të dorës së djathtë apo të majtë, domethënë njëzet e nëntë ditë.⁴⁹²

Në Sahih-un e Buharit transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Ne jemi popull analfabet, që nuk shkruajmë e nuk llogarisim. Muaji është kështu ose kështu”**, duke treguar me gishta, domethënë, ose tridhjetë ditë, ose njëzet e nëntë ditë.

Në Sahih-un e Muslimit transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Muaji është kështu e kështu e kështu”**, duke treguar me gishta tridhjetë ditë dhe njëzet e nëntë ditë.

Në Sahih-un e Muslimit transmetohet se Ibn Umeri dëgjoi një person duke thënë: “Sonte është gjysma e muajit” Ibn Umeri i tha: “E ku e di ti që është gjysma? Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: **‘Muaji është kështu e kështu’**.”, duke treguar të dhjetë gishtërinjtë e tij tri herë, pastaj i tregoi përsëri tri herë, por në të tretën fshehu gishtin e madh të njërës dorë.⁴⁹³

Prej Sa’d Ibn Ebu Uekasit transmetohet se i Dërguari i Allahut bashkoi dy duart e tij dhe tha: **“Muaji është kështu e kështu”**, e në të tretën fshehu një gisht.⁴⁹⁴

Prej Ibn Abasit përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Më erdhi Xhibrili dhe më tha se muaji është njëzet e nëntë ditë.”**⁴⁹⁵

Prej Ibn Mes’udit transmetohet se ka thënë: **“Me të Dërguarin e Allahut kemi agjëruar më shumë njëzet e nëntë ditë sesa tridhjetë ditë.”**⁴⁹⁶

Tirmidhiu ka thënë: “Në lidhje me këtë temë, prej Umerit, Ebu Hurejres, Aishes, Sa’d Ibn Ebu Uekasit, Ibn Abasit, Ibn Umerit, Enesit, Xhabirit, Umu Selemeh dhe Ebu Bekrah përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Muaji është njëzet e nëntë ditë.”**⁴⁹⁷

⁴⁹² Buhariu 4996, Muslimi 1080.

⁴⁹³ Buhariu 4996, Muslimi 1080.

⁴⁹⁴ Muslimi 1086, Nesai 4/138.

⁴⁹⁵ Nesai 4/138 dhe saktësoi Albani.

⁴⁹⁶ Ebu Daud 3322, Tirmidhi 689, saktësoi Albani.

⁴⁹⁷ Xhamiu Tirmidhi 3/73.

Dobi dhe dispozita

E para: Muaji hënor gjatë së cilit besimtari kryen veprat e mira mund të jetë tridhjetë ditë ose me një ditë më pak, pra, njëzet e nëntë ditë.

E dyta: Shpërblimi jepet i plotë edhe nëse muaji është i shkurtër, me 29 ditë, sikurse tregon Ibn Mesudi, se, me të Dërguarin e Allahut, ata kishin agjëruar më shumë njëzet e nëntë ditë, sesa tridhjetë ndër vite të ndryshme.

E treta: Ky hadith kundërshton matematicienët dhe astrologët dhe tregon qartë se përcaktimi i dispozitave fetare si agjërimi, festa e Bajramit apo haxhi bazohen në shikimin e hënës e jo në përlogaritje.

E katërta: Lejimi i përdorimit të shenjave treguese, që janë forma të qartësimit dhe të mësimit të gjërave.⁴⁹⁸

E pesta: Muajt me njëzet e nëntë ditë mund të jenë rresht dy, tre ose katër të tillë, por nuk mund të ndodhë që të jenë më shumë se katër muaj njëzet e nëntë ditorë njëri pas tjetrit.⁴⁹⁹

E gjashta: Ky popull quhet si popull analfabet, sepse shkrimi në kohën e tyre ka qenë shumë i rrallë dhe Profeti i këtij populli gjithashtu ka qenë analfabet. Allahu thotë: **“Ai çoi tek analfabetët të dërguar prej tyre.”** Gjithashtu ka thënë: **“Ti, përpara këtij, nuk pate lexuar ndonjë libër e as nuk e pate shkruar me të djathtën tënde, sepse kështu do të dyshonin pasuesit e së kotës.”** Prej mirësisë së Allahut ndaj këtij populli është kjo fe. Ata nuk e kanë marrë librin prej dikujt tjetër, por me shpallje prej Allahut tek i Dërguari i Tij.⁵⁰⁰

E shtata: Umeti islam nuk e ka të nevojshme që, për kohën e adhurimeve, të bëjë kërkime shkencore apo llogari matematike, sepse Ligjvënësi i Urtë e ka lidhur këtë me shikimin, e kjo është shumë e lehtë për të gjithë njerëzit.

E teta: Ne si muslimanë nuk jemi të obliguar të njohim libra shkencorë e të bëjmë llogari matematikore për të ditur kohën e agjërit apo kohën e ndonjë adhurimi tjetër, sepse njohja e kohëve të adhurimeve tona është e lidhur me gjëra të dukshme, me shenja të qarta, përpara të cilave të gjithë janë të barabartë, ata që janë matematicienë dhe ata që nuk janë.

⁴⁹⁸ Fethul Bari 4/127.

⁴⁹⁹ Sherh En Nevevij ala Muslim 7/191.

⁵⁰⁰ Umdetulkarri 10/286.

E nënta: Një person i cili premtan ose betohet se do të agjërojë një muaj të caktuar, si muajin Rexhep apo Shaban, dhe pasi e agjëron atë del me njëzet e nëntë ditë, atëherë ai e ka plotësuar premtimin ose betimin e vet.

E dhjeta: Nëse dikush premtan apo betohet se do të agjërojë një muaj pa caktuar emrin e muajit, mendimi më i zgjedhur është se atij i mjafton të agjërojë njëzet e nëntë ditë, sepse muaji është me kaq ditë.

E njëmbëdhjeta: Dita e dyshimtë është e sanksionuar që të jetë ditë e muajit Shaban, prandaj nuk lejohet agjërimi i asaj dite si ditë e Ramazanit, sepse i Dërguari i Allahut e ka lënë nisjen e agjërit në varësi të shikimit të hënës së Ramazanit.

E dymbëdhjeta: Nga hadithet përfitojmë se përdorimi i teknologjisë moderne, si sateliti apo teleskopi e të ngjashme, për përcaktimin e vendit ku mund të shfaqet hëna e re ose lehtësimin e shikimit të saj, nuk është i ndaluar, megjithatë, ajo që merret për bazë është vështrimi me sy të lirë.

59 – Vlera e agjërit të gjashtë ditëve

Nga Ebu Ejub el Ensari transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Kush e agjëron ramazanin, pastaj e pason atë me agjërimin e gjashtë ditëve të Sheualit, është sikur të ketë agjëruar gjithë kohës.”**

Nga Theubani përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Agjërimi i Ramazanit është i barasvlefshëm me dhjetë muaj, agjërimi i gjashtë ditëve me dy muaj, e kështu është agjërim gjatë tërë vitit.”**

Në një transmetim thuhet: **“Kush agjëron gjashtë ditë pas Fitër Bajramit është sikur ta ketë agjëruar një vit të plotë. Allahu thotë: ‘Kush kryen një vepër të mirë, do ta ketë shpërblimin sa për dhjetë të tilla’.”**

Dobi dhe dispozita

E para: Këto hadithe tregojnë vlerën e agjërimit të gjashtë ditëve të Sheualit. Kush i agjëron ato pas ramazanit, është sikur ta ketë agjëruar gjithë kohës. Kjo është një punë dhe një mirësi shumë e madhe.

E dyta: Pëlqehet që besimtari të shpejtojë në agjërimin e gjashtë ditëve, sepse shpejtimi në kryerjen e veprave të mira është gjithmonë i pëlqyeshëm dhe gjithashtu të mos humbasë mundësi të tilla kaq të mira.

E katërta: Agjërimi i këtyre ditëve mund të kryhet në fillim, në mes ose në fund të muajit sheual, të njëpasnjëshme ose të ndara. Të gjitha këto mundësi janë të lejuara dhe, me lejen e Allahut, shpërblimi për to është i plotë.

E pesta: Kush ka ditë mangët prej ramazanit, së pari, duhet të plotësojë ditët e ramazanit, pastaj t’ia nisë me gjashtë ditët e sheualit. Ky përfundim vjen duke u mbështetur në kuptimin e drejtpërdrejtë të hadithit ku thuhet: “Kush agjëron ramazanin...” Pra, kush e agjëron atë të plotë, sepse ai që i kanë mbetur ditë prej ramazanit nuk konsiderohet si agjërues i ramazanit plotësisht, derisa t’i shlyejë ato ditë që i ka borxh. Gjithashtu, shlyerja e një borxhi është më parësore se kryerja e ndonjë veprë të pëlqyer.

E gjashta: Ligjvënësi i Urtë i ka vendosur obligimet midis veprave vullnetare. Ai ka vendosur vepra të pëlqyera para dhe pas obligimeve, sikurse ka bërë me namazet, me agjërimin në muajin Shaban dhe me agjërimin e gjashtë ditëve të muajit sheual, midis të cilëve është dhe agjërimi i detyruar i Ramazanit.

E shtata: Këto vepra të pëlqyera plotësojnë magësitë në obligime, pasi njeriu nuk shpëton prej veprave që e mangësojnë shpërblimin e agjërimit, si fjalët e kota, shikimi i pakontrolluar etj.

60 – Disa prej dispozitave të festës

Prej Enesit transmetohet se ka thënë: “Kur erdhi në Medinë, i Dërguari i Allahut pa që njerëzit kishin dy ditë të veçanta për argëtim. Ai pyeti: **‘Çfarë janë këto dy ditë?’** Ata thanë se në këto dy ditë argëtoheshin në kohën e injorancës. I Dërguari i Allahut tha: **“Allahu ua ka zëvendësuar këto dy ditë me dy më të mira, me festën e Kurbanit dhe me festën e Fitrit.”**⁵⁰¹

Prej Ebu Ubejdit, një rob i Ibn Ez’herit, transmetohet se ka thënë: “Unë kam qenë për ditë Bajrami me Umer Ibn Khatabin, i cili tha: “I Dërguari i Allahut ka ndaluar të agjërohen këto dy

⁵⁰¹ Ebu Daudi 1134, e saktësoi Albani.

ditë, ditën e Bajramit të Fitrit, pas mbarimit të agjërimit tuaj, dhe ditën tjetër, kur hani prej kurbanit tuaj.”⁵⁰²

Nga Ebu Saidi transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut e ka ndaluar agjërimin në ditën e Bajramit të Fitrit dhe në ditën e Bajramit të Kurbanit.”⁵⁰³

Prej Ibn Abasit përcillet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut, ditën e Bajramit të Fitrit doli e fali vetëm dy rekatë namaz dhe nuk fali asgjë para dhe pas tyre.”⁵⁰⁴

Prej Umu Atijeh përcillet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut na urdhëroi t’i nxirrnim të gjitha gratë në festën e Bajramit të Fitrit dhe të Bajramit të Kurbanit: plakat, të rejat dhe gratë me perioda. Gratë me perioda urdhëroi që të qëndronin mënjanë nga vendfalja e të qëndronin pranë, për të qenë të pranishme në mirësinë dhe lutjen e muslimanëve.”⁵⁰⁵

Dobi dhe dispozita

E para: Allahu i dhuroi mirësi muslimanëve kur i ligjëroi dy festa, Bajramin e Fitrit dhe Bajramin e Kurbanit, duke i bërë të panevojshme për ta festat e xhahilijetit (kohës kur ishin pa islam).

E dyta: Festat e ligjshme islame dallohen prej festave të jomuslimanëve në aspekte të ndryshme:

1 – Festat e muslimanëve përcaktohen në bazë të shikimit të hënës, ndërsa jomuslimanët i bëjnë me përllogaritje.

2 – Dy bajramet e muslimanëve lidhen me dy adhurime dhe manifestime madhështore, përkatësisht agjërimi me sadakanë e fitrit dhe haxhi me kurbanin.

3 – Manifestimet e festave janë gjithashtu adhurime që të afrojnë me Allahun, si tekbiret, falja e namazit të dy bajrameve dhe fjalimet në to, e jo si festat e jomuslimanëve, të cilat përmbajnë manifestime të mohimit e të humbjes, të epsheve e sjelljeve të pahijshme.

4 – Në dy festat gjejmë demonstrim të bamirësisë, mirësjelljes, plotësim të nevojave sociale nëpërmjet sadakasë së fitrit, shpërndarjes së mishit të kurbanit etj.

5 – Dy festat e muslimanëve nuk kanë lidhje me bestytnitë e të tjerëve, si festa e Vitit të Ri, shenjat e horoskopit, përkujtimoret, shenjtërimi i personave, festat nacionaliste dhe raciste, por

⁵⁰² Buhari 1889, Muslim 1137.

⁵⁰³ Buhari 1890, Muslim 827.

⁵⁰⁴ Buhari 945, Muslim 884.

⁵⁰⁵ Buhari 931, Muslimi 890.

ato janë dy festa të sinqerta vetëm për Allahun e Lartësuar. Detyra e muslimanit në këto festa është falënderimi ndaj Allahut për mirësitë e mëdha që u ka dhuruar njerëzve, dhe ky falënderim kryhet duke zbatuar urdhëresat e Tij dhe duke u larguar prej ndalesave edhe gjatë ditëve të festës, gëzimit e të haresë.

E treta: Gjatë festës, muslimanët duhet të kenë kujdes të mos bëhen mohues të mirësive të Allahut me haramet, si, për shembull, me moskryerjen e detyrimeve fetare, me shkujdesjen e grave në mbulimin e trupit të tyre, me përzierjen e burrave me gratë, me shpenzime të tepruara në veshje, ushqim e pije, me muzikë dhe këngë etj.

E katërta: Muslimani duhet të lahët për festë dhe të veshë rrobat më të mira. Këto janë gjëra të pëlqyera dhe që të parët tanë i kanë bërë.

E pesta: Në mëngjesin e Bajramit të Fitrit, përpara se muslimani të nisët për faljen e namazit, është e pëlqyeshme që të hajë diçka, sepse kështu ka vepruar i Dërguari i Allahut dhe kështu nxiton në zbatimin e urdhrit të Allahut për të ngrënë në Bajram.

E gjashta: Nxjerrja e grave dhe e fëmijëve ditën e festës për të marrë pjesë në namaz dhe në lutje është prej traditës profetike dhe vepër e pëlqyer. Gratë me perioda distancohen paksa nga vendi i faljes, por dëgjojnë hytben dhe shohin faljen e namazit.

E shtata: Ecja në këmbë për në namazgja ditën e festës është traditë profetike, siç është edhe ndryshimi i rrugës së kthimit me rrugën e vajtjes.

E teta: Pasi të falë namazin e Bajramit, muslimani është më mirë të qëndrojë në vendfaljen e tij për të dëgjuar hytben e për të thënë ‘Amin’ pas lutjeve, sepse i Dërguari i Allahut ka thënë për gratë me perioda: ‘Le të jenë të pranishme në mirësinë dhe lutjen e muslimanëve.’

E nënta: Namazi i festës nuk ka sunete të rregullta as përpara e as pas, mirëpo muslimani është i urdhëruar që, kur të hyjë në xhami, të falë dy rekatë namaz përshëndetës, edhe nëse është kohë ndalese, sepse dy rekatet përshëndetëse të xhamisë janë namaz me shkak.

E dhjeta: Gjatë pritjes së imanit për të dalë për në namaz, është e mira që muslimani të angazhohet me tekbire, sepse ky është adhurimi i momentit. Ai mund të lexojë Kuran ose të kryejë namaz nafile, nëse nuk është kohë ndalese, mirëpo angazhimi me tekbire është më i mirë.

E njëmbëdhjeta: Nëse njerëzit njoftohen për Bajramin vetëm pas drekës, atëherë e falin namazin e Bajramit të nesërmen. Nëse një person vjen dhe e gjen imamin në fundin e namazit, atëherë çohet pas imanit dhe plotëson dy rekatet, duke kryer edhe tekbiret.

E dymbëdhjeta: Nëse muslimani nuk e arrin namazin e festës, atëherë nuk e shlyen atë, sepse nuk ka argument fetar që të tregojë se, nëse të ikën namazi i festës, duhet ta falësh atë më pas.

E trembëdhjeta: Gëzimi me festën është i ligjshëm për aq sa nuk kalohen kufijtë. Muslimani duhet t'ua shtojë të mirat fëmijëve dhe familjes së tij, sepse gëzimi në Bajram është prej manifestimeve të festës dhe të fesë në përgjithësi.

E katërbëdhjeta: Në ditën e Bajramit është mirë të mblidhen njerëzit për të ngrënë bashkarisht, sepse diçka e tillë e paraqet akoma më bukur festën dhe është një mundësi që zemrat të afrohen e të bashkohen.

E pesëmbëdhjeta: Nuk ka gjë të keqe nëse uron festën. Të parët tanë, kur takoheshin në ditë feste, uronin njëri-tjetër me fjalët: 'Allahu e pranofte prej nesh e prej jush!' Urimet mund të jenë edhe sipas traditës së vendeve të ndryshme, përderisa nuk ka fjalë të ndaluara apo imitime të urimeve të jomuslimanëve, që i përdorin për festat e tyre.